

**ÇËSHTJE TË PABARAZISË GJINORE NË VITET 1920 - 1967
DHE NDIKIMI I TYRE NË ZHVILLIMIN SHOQËROR
TË SHQIPËRISË.**

Përgatitur nga

EZMERALDA XHERAJ

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

**Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Sociale,
me profil - Sociologji Antropologji, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.**

Udhëheqës shkencor: Akademik i Asociuar, Prof. Dr. Kosta Barjaba.

Numri i fjalëve: 59. 000.

Tiranë, Korrik 2016.

DEKLARATA E AUTORËSISË.

Deklaroj se, studimi është punimi im origjinal. Burimet dhe literatura e shfrytëzuar janë cituar sipas standardeve të kërkuara.

ABSTRAKTI.

Barazia njerëzore është tipar dhe e drejtë jashtë hapësirës fizike, përtej sistemit të vlerave dhe formimit kulturor. Ajo në radhë të parë është thjeshtë barazi shpirtërore. Për të prishur harmoninë, funksionimin apo ekzistencën e dobishme të sistemit - përballë paaftësisë së vlerave dhe mungesës së kulturës - është i dukshëm konflikti midis autoritetit të institucioneve shtetërore dhe autoritetit shpirtëror. Analiza mbi shkaqet e lindjes së pabarazisë dhe padrejtësisë në shoqërinë njerëzore, mbështetet mbi këtë tezë filozofike.

Ndryshimet politike, ekonomike dhe kulturore në Shqipërinë e pasluftës, ndikuan në rikonfigurimin e problemit gjinor dhe situatën mbi pabarazinë gjinore, e cila ka qenë dhe mbetet ndër problemet e mprehta të shoqërisë shqiptare.

Problemi gjinor në Shqipëri u ndie me intensitet të lartë në vitet 30-të të shekullit të kaluar. Ndjeshmëria ndaj problemit gjinor dhe pabarazisë gjinore, u pasqyruan në mendimin shoqëror shqiptar të kohës, sidomos në mendimin dhe krijimtarinë letrare. Megjithatë, për shkak të kushteve historike, politike, ekonomike e shoqërore, emancipimi real i grave dhe vajzave, në kontekstin e viteve '30-të, ishte i vështirë dhe pothuajse i pamundur.

Gjatë gjithë historisë moderne të vendit, në shoqërinë shqiptare janë konstatuar ndërveprime dhe ndërvarësi të dukshme midis problemit gjinor dhe problemit fetar. Trajektorja e ndikimit të institucioneve, besimeve dhe ideve fetare në shoqërinë shqiptare prodhoi midis të tjerave trajektoren e problemit gjinor, të pabarazisë gjinore dhe qëndrimit të spikatur të shoqërisë ndaj fesë.

Gratë shqiptare gjatë periudhës së Mbretërisë Shqiptare, kanë qenë mjaftë të marginalizuara. Prej kësaj pozite, ato nuk përfituan prej fillimit të proceseve të përhapjes dhe forcimit të arsimit kombëtar në Shqipëri. Pozita e tyre mbështetej por dhe vështirësohej nga legjislacioni jo

favorizues në interes të zgjidhjes së problemit të emancipimit femëror dhe të pranisë së pabarazisë gjinore.

Pozita e gruas në pabarazi gjinore, pësoi ndryshime të rëndësishme në disa aspekte thelbësore, gjatë shndërrimeve ekonomike, politike dhe kulturore të viteve 1945 - 1967. Këto përmirësime përfshinë gjendjen sociale të grave, nxitjen e arsimimit, shkollimit dhe nivelit kulturor të tyre, rritjen e hapësirave për pjesmarrje në tregun e punës dhe jetën ekonomike, rritjen e mbështetjes për pjesmarrje në jetën politike, shoqërore e komunitare etj.

E drejta e mohuar ndër vite përballë tendencave të lirisë dhe normave social - juridike shtrënguese të paperspektiv, përbëjnë tiparin themelor të situatës së rënduar në sfondin e paaftësisë institucionale, për të realizuar në kohë perceptime të drejta në opinionin shqiptar dhe për të gjetur apo ofruar zgjidhje në interes të progresit social - ekonomik, etiko - moral dhe kulturor për gratë dhe vajzat në shoqërinë shqiptare.

Politikat institucionale të kohës së para dhe pas luftës, në mënyrë tepër të shtrënguar dhe me tendenca kundërshtuese, përjashtuese për gratë dhe vajzat shqiptare, për shkak të tradicionalizmit i shndërruan në tipare themelore elementët frenues, duke i sunduar në kohë dhe në hapësirë të gjithë faktorët qytetërimor e civilizues, që ndikonin në heqjen e këtyre barrierave.

Lëvizja për të drejtat e grave dhe vajzave, që shpërtheu në mes të viteve 1960, ishte një dukuri e importuar dhe imponuar prej refleksioneve ideologjike, politike dhe kulturore ndërkombëtare. Sidomos revolucioni kulturor kinez ushtroi ndikim të dëmshëm, asfiksues dhe deformues të jetës shoqërore, politike dhe kulturore në Shqipëri, veçanërisht në procesin e socializimit mbi bazën e traditës historike të marrëdhënieve gjinore.

Trashëgimia dhe puna e kujdesëshme për të minimizuar pabarazinë gjinore gjatë gjithë historisë së vendit, tendencat dhe ndikimet e pakta në kushtet e një shoqërie që lëvizte me ritme të ulëta

zhvillimi, në kushte të reja, u kthye në domosdoshmëri shkaksore, që solli hapësira më të mëdha në përfshirjen dhe rritjen e rolit aktiv të grave dhe vajzave në proceset emancipuese të shoqërisë në Shqipëri.

ABSTRACT.

Human equality is right out feature and physical space, beyond the system of values and cultural background. Firstly, it is simple spiritual equality. To break the harmony, or the existence of useful operation of the system - in front of incompetence and lack of cultural values - is notable conflict between state institutions and authority of spiritual authority. On this philosophical thesis, based analysis of the causes of the birth of inequality and injustice in human society.

Political, economic and cultural life in Albania after the war, led to the reconfiguration of gender and gender inequality problem, which has been and remains one of the acute problems of the Albanian society. Gender problem in Albanian society felt high intensity in 30 years of the last century. Its sensitivity to the problem of gender and gender inequality was reflected in the Albanian social thought of the time, especially at the thought and literary creativity. However, due to historical conditions, political, economic, social, real emancipation of women and girls in the context of the '30s, it was difficult, almost impossible. Throughout the modern history of the country, they were found in Albanian society and interdependence apparent interactions between gender problems and religious problems. The trajectory of the impact of institutions, beliefs and religious ideas in Albanian society has produced among others the trajectory of gender problem, gender inequality and social attitude toward religion protruding.

Albanian women during the period of the Kingdom of Albania, they were very vulnerable. From this position, they have not benefited from the start of the processes of proliferation and

strengthening of national education in Albania. Their position was supported but more difficult by unfavorable legislation in the interest of solving the problem of female emancipation and gender inequality. The position of women in gender inequality, underwent significant changes in some fundamental respects during the economic transformations, political and cultural life of the years 1945 - 1967. These improvements include the social status of women, promoting education, educational and cultural level of their growth spaces for participation in the labor market and economic life, increasing support for participation in political, social and community etc.

Justice denied for years, opposite trends freedom and social norms - legal austerity paperspektiv, constitute the key feature of the aggravated situation on the background of incompetence and institutional, to realize in time perceptions rights in public opinion and to find or offer solution in the interest of social progress - economic, ethical - moral and cultural development for women and girls in society. Institutional policies of the time before and after the war, so incredibly tight, with tendency to the contrary, exclusive for Albanian women, changed the basic features elements inhibitor and ruled in time and space all the factors civilizational of civilization, that affect the removal of these barriers.

The movement for the rights of women and girls, which erupted in the mid-1960s, was an imported phenomenon and reflections imposed by ideological, political and international culture. Especially the Chinese Cultural Revolution, filed a detrimental effect, stifling and distorting of social, political and cultural life in Albania, particularly in the process of socialization on the basis of historical tradition of gender relations. Legacy and work cautious to minimize gender inequality throughout the country's history, trends and impacts of the few in terms of a society moving at low rates of development, in new conditions, became necessary causal, that brought more room great involvement and increasing active role of women in the processes of democratic transformations in Albania.

DEDIKIMI

Këtë studim ia kushtoj përpjekjeve dhe sakrificës njerëzore të brezave të shqiptarëve nën diktaturë, grave dhe vajzave, të cilët në kohë të vështira me përpjekjet e tyre, i dhanë dritë dhe shpresë popullit shqiptar, i dhanë dritën e dijes nga shpirti dhe zemra e tyre e paepur plotë zjarr atdhedashurie, brenda dëshirës së madhe për kulturë qytetërimore progresiste kundër sfidave të kohës, duke ngjizur në breza me guxim dhe forcën e shpirtit dhe të mendjes së tyre, dëshirën dhe dritën e diturisë për një të ardhme më të ndritur në liri dhe demokraci.

Ja kushtoj familjes time, që më motivuan dhe më krijuan të gjitha mundësitë të hulumtoj në një fushë kaq interesante, në përkushtimin personal drejt evidencimit të vlerave humane e njerëzore, në shërbim të familjes time dhe të shoqërisë.

Nderim dhe respekt për të gjitha gratë dhe vajzat shqiptare, që u bënë shembulli i humanizmit, qëndresës, përballimit, rezatuese të dritës dhe diturisë kundër errësirës dhe obskurantizmit politik të kohës, që u kthyen në pika reference për gjeneratat e reja drejt një Shqipërie Demokratike.

FALENDERIME.

Paraqitja e tezës në kërkim të gradës “Doktor i Shkencave”, u bë e mundur përveç punës time sistematike, njëkohësisht fal mbështetjes së profesorëve bashkëpunues të Universitetit European të Tiranës.

Shpreh falenderim të veçantë për pedagogët e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit, posaçërisht Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara.

Ky punim pasqyron gjithashtu ndihmën dhe mbështetjen e gjithanshme të udhëheqësit shkencor, Akademikut të Asociuar, Prof. Dr. Kosta Barjaba, të cilin e falenderoj.

Falenderim dhe mirënjohje të thellë i shpreh familjes time, për përballimin e ngarkesave emocionale të shkaktuara kohë pas kohe, të cilat më nxitën dhe frymëzuan, duke trasmetuar tek unë energjitë pozitive për një punë të mundimshme dhe cilësore gjatë punës sistematike për hartimin dhe zhvillimin plotësues të tezës së doktoraturës.

Mbi këtë falenderim dhe mirënjohje kam kuptuar thelbin e ekzistencës humane, e cila sot kërkon debatin etno - fetar, kulturor, etik të mbështetur mbi rrugëtimet historike, pa shkëputur për asnjë çast vëmendjen ndaj realitetit që jetojmë dhe perspektiva e tij. Mbështetur në këtë konstatim politiko - filozofik, drejtësia në mendim - *bazuar tek e vërteta* - ofron debatin e dobishëm, atëherë kur respektohen ligjësitë metodologjike të rrugtimeve historike, civilizuese dhe të gjenezës së kombit tonë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS.

KAPITULLI I: Objektivat, metodologjia, pyetjet kërkimore dhe hipotezat.....f. 16

1.1. Hyrje.....f. 16

1.2. Objektivat e kërkimit.....f. 17

1.3. Metodologjia.....f. 18

1.4. Kufizimet e studimit..... f. 30

1.5. Rëndësia e studimit.....f. 31

1.6. Pyetjet kërkimore..... f. 32

1.7. Hipotezat.....f. 33

KAPITULLI II: Gruaja dhe problemi gjinor në mendimin shoqëror dhe letrar të viteve '30-të: letërsia, si sociologji alternative.....f. 34

2.1. Nga zona e “heshtjes” në realitetet e ndaluara: pozita sociale e femrës në botën shqiptare të viteve '30-të.....f. 35

2.2. Ndryshimi i gruas buron nga arsimi, si ngushtues i pabarazisë gjinore.....f. 44

2.3. Vështirësitë e emancipimit real të femrës në vitet '30-të.....f. 52

KAPITULLI III: Pozita e grave dhe pabarazia gjinore gjatë periudhës së Mbretërisë Shqiptare.....f. 60

3.1. Pozita e grave në Mbretërinë Shqiptare: fillimet e arsimit në Shqipëri.....f. 60

3.2. Legjislacioni mbi çështjet gjinore sipas Kodit Civil të Mbretërisë Shqiptare.....f. 76

KAPITULLI IV: Ndërveprimi dhe ndërvarësitë midis problemit gjinor dhe problemit fetar në shoqërinë shqiptare.....f. 79

4.1. Feja në periudhën midis dy luftrave.....f. 79

4.2. Sjellja e klerikëve gjatë L.A.N.Ç, qëndrimi i tyre ndaj regjimit komunist.....f. 83

4.3. Ndryshimi i statusit të besimit në Shqipëri në vitet '50-të.....f. 89

4.4. Feja nën regjimin komunist.....f. 98

4.5. Sulmi ndaj fesë, në emër të revolucionarizimit.....f. 103

4.6. Ndryshimet social - kulturore si pasojë e revolucionarizimit, reflektimi në problemin gjinor.....f. 115

KAPITULLI V: Pozita e gruas dhe pabarazia gjinore gjatë shndërrimeve ekonomike, politike dhe kulturore, 1945 - 1967.....f. 120

5.1. Gjëndja sociale e gruas gjatë L.A.N.Ç. dhe pas çlirimit.....f. 120

5.2. Reformat e ndërmara për punësimin e gruas, si tregues i emancipimit.....f. 124

5.3. Zhvillimi kulturor i gruas.....	f. 137
5.4. Sinergia e çështjes gjinore me luftën kundër fesë.....	f. 149

KAPITULLI VI: Lëvizja për të drejtat e grave dhe vajzave, dukuri e importuar nga ndikimet ndërkombëtare, reflektimet ideologjike, politike dhe kulturore në mjedisin social shqiptar.....

6.1. Ndikimi i R.K.K. në deformimin social, politike dhe kulturor në Shqipëri.....	f. 154
6.2. “Revolucionarizimi” i arsimit, rritja e mbështetjes për prani të vajzave në shkollim.....	f. 160
6.3. Ndikimi i proceseve “revolucionarizuese” në deformimin e socializimit të zhvillimeve gjinore.....	f. 170

KAPITULLI VII: Përfundime.....

BIBLIOGRAFI.....

LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE:

Tabela nr. 1: Tabela përmbledhëse për vitet 1933 - ‘39, numri i nxënësve femra dhe meshkuj për institucionet arsimore... ..	f. 69
Tabela nr. 2: Numri i nxënësve, femra dhe meshkuj, në vitet 1934 - 1939.....	f. 70

Tabela nr. 3: Pasqyra përmbledhëse për arsimin fillor [meshkuj - femra].....f.	71
Tabela nr. 4: Të dhënat statistikore të pranisë së femrave në sistemin e shkollave të mesme, nga viti 1934 deri në vitin 1940.....f.	72
Tabela nr. 5: Tabela nr. 5: Statistikat për vitet 1934 - 1935 [meshkuj dhe femra].....f.	73
Tabela nr. 6: Statistikat për vitet 1935 - 1936 [meshkuj dhe femra].....f.	73
Tabela nr. 7: Statistikat për vitet 1935 - 1936 [meshkuj dhe femra].....f.	73
Tabela nr. 8: Statistikat për vitet 1937 - 1938 [meshkuj dhe femra].....f.	74
Tabela nr. 9: Statistikat për vitet 1938 - 1939 [meshkuj dhe femra].....f.	74
Tabela nr. 10: Statistikat për vitet 1939 - 1940 [meshkuj dhe femra].....f.	75
Tabela nr. 11: Numri i punëtoreve dhe nënpunëseve të sektorit socialist sipas degëve të ekonomisë popullore, në 31 dhjetor 1961.. ..f.	132
Tabela nr. 12: Renditja progresive e meshkujve të punësuar në degët e industrisë..... f.	133
Tabela nr. 13: Të dhënat statistikore mbi numrin e femrave në ekonomi.....f.	136
Tabela nr. 14: Numri i përgjithëshëm i punonjësve femra në sektorët e ekonomisë, arsim, kulturë dhe shëndetësi; 1956; 1960..... f.	137
Tabela nr. 15: Pjesëmarrja në zgjedhjet e k.p në vitet 1949; '52; '54; '55; '56; '60.....f.	142
Tabela nr. 16: Numri i deputetëve për vitet 1945; '50; '54; '58, '62.....f.	142
Tabela nr. 17: Numri i deputetëve të K.P sipas rretheve v. 1945; '50; '54; '58; '62.....f.	144
Tabela nr. 18: Arsimi 8 - vjeçar në qytet dhe fshat për vitet shkollore 38 - 70..... f.	164

Tabela nr. 19: Arsimi i niveleve në vitet shkollore '38/'39; '50/51; '55/56; '59/60. [përfshihen shkollat, nxënësit, studentët, personeli mësimor i ditës dhe i mbrëmjes].....f.	168
Figura nr. 1: Rritja e numrit të nxënësve femra, vitet 1938 / 1939 - 1969 / 1970.....f.	166
Figura nr. 2: Përqindja e numrit të nxënësve femra gjatë v. 1938 / 1939 - 1969 / 1970.....f.	167
Figura nr. 3: Femra e meshkuj [në %] nxënëse gjatë v. 1938 / 1939 - 1969 / 1970.....f.	168

LISTA E SHKURTIMEVE:

A.Q.SH.i R.SH. - Arkivi Qëndror Shtetëror, i Republikës së Shqipërisë.

B.G.SH. - Bashkimi i Grave të Shqipërisë.

B.R.S.S. - Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike.

B.S. - Bashkimi Sovjetik.

D.S. - Dosje.

K.A.N.Ç - Këshilli Antifashist Nacional - Çlirimtar.

K.N.E.R. - Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke.

K.Q. - Komiteti Qëndror.

P.K.SH. - Partia Komuniste Shqiptare.

P.P.SH. - Partia e Punës së Shqipërisë.

R.K.K. - Revolucioni Kulturor Kinez.

F.A. - Forcat e Armatosura.

F.V.V.P. - Forcat Vullnetare të Vetmbrojtjes Popullore.

M.D.H. - Materializmi Dialektik dhe Histroik.

K.P - Këshillat Popullor.

Ligjet dhe traditat që frenojnë gruan, frenojnë të gjithë shoqërinë.

Hillary Rodham Clinton

KAPITULLI I: Objektivat, metodologjia, pyetjet kërkimore dhe hipotezat.

1.1. HYRJE.

Ndryshimet politike, ekonomike dhe kulturore në Shqipërinë e paspavarësisë, ndikuan në mënyrë të ngadalëshme në rikonfigurimin e problemit gjinor dhe pabarazisë gjinore, e cila ka qenë dhe mbetet në të gjithë kohët ndër problemet e mprehta të sistemit politiko social shqiptar. Orientimi mbi bazën e ngjarjeve dhe fakteve të dokumentuara në arkivin e historisë, e bën çështjen të kapëshme në çdo sistem politik, me përfundime në ditët e sotme dhe perspektivën e zhvillimit të shoqërisë shqiptare.

Me ngritjet dhe rëniet e tij ky problem sa social kulturor po aq dhe politik, në prurjet historike sjell një panoramë të palakmueshme në evidentimin e vlerave pozitive.

“Historia nuk është as fatalitet, as subjekt i kulluar, pa ç’ka se në të ka ngjarje fatale dhe marrëzi nga pasioni dhe dëshirat. Por në udhrrëfimin përfundimtar, historia është vepra e njerëzimit bazuar nën ideimin e progresit dhe nën frymën e veprimit për zhvillim, ushqyer me pasionet për të afruar të ardhmen dhe me padurimin për të mos mbetur në gjendje vegjetuese”. [Kabo, Përparim 2014:10].

Gratë, gjatë gjithë historisë së vendit kanë qenë pjesëmarrëse aktive në jetën shoqërore, ekonomike, politike dhe kulturore të Shqipërisë. Pjesëmarrja e tyre ka pasur luhatjet e veta, vertikale dhe horizontale. Vertikale, sepse gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit historik, mbështetja, roli dhe kontributi i grave ka shënuar nivele të ndryshme, në varësi të situatave dhe sfidave të zhvillimit, por dhe të mundësive e shanseve që kushtet shoqërore u mundësonin grave. Horizontale sepse mbështetja, pjesëmarrja dhe kontributi i grave ka qenë i ndryshëm, në pikëpamje sasiore dhe cilësore, në aspekte të ndryshme të zhvillimit, e specifikuar kjo sipas zonave të ndryshme të vendit. Gratë kanë qenë të pranishme me rolin e tyre në mjaft ngjarje të rëndësishme shoqërore e politike dhe beteja historike të kombit, por prania femërore në udhëheqje ka qenë një dukuri e rrallë. Gratë kanë përballuar nevojat e mëdha për mbijetesën

ekonomike të familjeve shqiptare, por fuqia e tyre e tregut ka qenë e dobët. Gratë kanë pasur dhe krijuar potenciale të mëdha zhvillimi, por ato nuk kanë mundur t'i sendërtojnë dhe mobilizojnë këto energji në zhvillimin shoqëror.

Kjo tezë doktriture, adreson ndikimin e pabarazisë gjinore gjatë viteve 1920 - 1967, ndikimin e tyre në zhvillimin shoqëror të Shqipërisë.

Studimi është bazuar në burime dokumentare arkivore, dokumente dhe materiale të institucioneve shtetërore, të shtypit, si dhe në burime bibliografike që adresojnë çështje dhe përvoja të ngjashme me vendet e tjera.

1.2. Objektivat e kërkimit.

Studimi synon të përmbushë objektivat e mëposhtëme:

- Analiza e problemit gjinor në shoqërinë shqiptare, gjatë periudhës 1920 - 1967.
- Analiza e pozitës së grave dhe pabarazia gjinore, gjatë shndërrimeve ekonomike, politike dhe kulturore, 1945 - 1967.
- Zbulimi dhe argumentimi i përmbajtjes dhe dimensionit të *“Lëvizjes për të drejtat e grave dhe vajzave”*, në synimet e lëvizjes kundër konservatorizmit, si instrument i sundimit partiak.
- Analiza e *“Lëvizjes për të drejtat e grave dhe vajzave”*, si fenomen i importuar dhe ndikimi i situatave ndërkombëtare ideologjike, politike dhe kulturore në këtë lëvizje, në interes të zhvillimit shoqëror dhe kulturor në Shqipëri.
- Argumentimi i ndërthurjes midis trashëgimisë dhe vazhdimësisë në pabarazinë gjinore dhe përfshirjes aktive të grave dhe vajzave në jetën social politike të vendit.

- Paraqitja e përfundimeve mbi zbutjen e pabarazisë gjinore dhe nxitjen e përfshirjes, mbështetjes dhe kontributit të grave dhe vajzave në zhvillimet politiko shoqërore në Shqipëri.

1.3. Metodologjia.

Teza: Çështje të pabarazisë gjinore gjatë lëvizjes *“për revolucionarizimin e jetës së vendit dhe ndikimi i tyre në zhvillimin shoqëror në Shqipëri”*, mbështetet në burimet teorike, arkivore dhe analizën individuale të përvojës historike në një periudhë të caktuar. Në katër metodat kryesore të kërkimit sociologjik: testimi, analizës së të dhënave ekzistuese, punës në fushë dhe eksperimentit, në këtë punim është përdorur kryesisht metoda e dytë, e cila mbështetur në të dhëna statistikore të nxjerra nga dokumente arkivore të tabeluara me saktësi, i janë nënshtruar analizës problemore dhe krahasuese sipas periudhave historike, duke rritur forcën argumentuese në përfundimet e arritura në studim. Metodologjia analitike e përdorur është e përshtatshme për qëllimin dhe objektivat e përcaktuara.

Mbi këtë model të trajtimit të çështjes thelbësore në studim, metodologjia analitike, metodat dhe instrumentat e kërkimit dhe ajo krahasuese janë të përshtatshme për studimin. Në këtë përshkrim të zgjeruar të metodologjisë dhe instrumentave të saj, po paraqes një pasqyrë të qartë të shtjellimit dhe realizimit të synimeve dhe objektivave, duke e bërë të besueshme hipotezën nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve kërkimore. Kjo metodë më ka çuar në përfundime të vlefshme me karakter të veçantë dhe përgjithësues, që më bindin për vet seriozitetin e këtij objekti studimor. Metodologjia shkencore shfaq vlerat e saj të mbështetura në burimet arkivore, referimet ekzistuese të botimeve, jo vetëm në analizën krahasuese por dhe në atë analitike, të cilat janë të alternuara gjatë shtjellimit të kapitujve.

Kapitulli i parë, në mënyrë specifike përveç pjesës hyrëse, janë parashtruar objektivat, metodologjia, rëndësia, pyetjet kërkimore dhe hipoteza e studimit, të cilat në thelb pasqyrojnë kujtesencën e tij dhe anën metodologjike të organizimit tërësor. Metoda e analizës së të dhënave ekzistuese me burime arkivore dhe referuese, si lënda kryesore në bazën e trajtimit problemor të studimit të shtjelluar në pjesën hyrëse, marrin formën e plotë nëpërmjet shtrirjes së përmbledhur në mënyrë vertikale dhe horizontale të disa çështjeve specifike të pabarazisë gjinore në Shqipëri, të lidhura me kontekstin historik.

Ky këndvështrim në mënyrë logjike dhe studimore, ka përcaktuar në detaje objektivat e studimit, duke i shtrirë ato sipas periudhave kohore historike të sistemeve politik në Shqipëri dhe raportet e tyre me qëndrimin, synimet, përpjekjet për zbutjen e fenomenit të pabarazisë gjinore. Në tërësi objektivat synojnë të orientojnë qartë vijueshmërinë e përpjekjeve që janë bërë për evidentimin e elementëve institucional për rritjen e rolit të gruas shqiptare në jetën social kulturore të vendit. Synimi për trajtimin e ndikimeve kanunore me bazë tradicionale kulturore dhe fetare, tenton të zbulojë shkaqet sociale dhe evidentimin e pasojave, duke e plotësuar materialin studimor në mënyrë korrekte në anën metodike dhe cilësore të tij.

Përcaktimi i objektivave ka sjell natyrshëm kufizimet që imponohen në studim, për shkak të periudhës kohore të përcaktuar dhe ndryshimeve të sistemeve politik në Shqipëri në periudhën prej vitit 1920 deri në 1967. Kufizimet në studim janë pasqyruar në dy aspekte.

Së pari, në vet kufizimet dhe pamundësinë shoqërore drejt përpjekjeve për t'i dhënë hapësirë luftës kundër pabarazisë gjinore, qoftë në periudhën e Mbretërisë Shqiptare dhe të regjimit komunist, për shkak të rrënjëve të thella të konservatorizmit apo dogmave politike. Ato diktohen nga arkivi jo i plotë për këtë problem të mprehtë social, duke e spostuar atë në periferi të veprimtarisë social politike. Trajtesat mbi të vërtetat historike të mbështetura në sasinë shifrore

me karakter prpogandistik të të dhënave dhe përballja me një realitet që shfaqte më së shumti anën e jashtëme të tij, është një prej kufizimeve në studim, i cili është kapërcyer jo pa vështirësi.

Së dyti, materiali studimor ka kufizimet për shkak të burimeve jo të mjaftueshme arkivore [veçanërisht për periudhën e Mbretërisë dhe pushtimit fashist të vendit], dhe në regjimin komunist me përballjen e një inflacioni të ideve politiko ideologjike, fjalimeve, propogandës “*në emër të emancipimit shoqëror të grave dhe vajzave*”, duke e bërë të vështirë trajtimin të ndikuar nga mënyra empirike e njohjes dhe trajtimit në thelb të fenomenit.

Në këtë kapitull në mënyrë të përmbledhur është trajtuar rëndësia që paraqet materiali studimor në planin teorik, duke sjell me fakte të dokumentuara analizën korrekte kundër anës jo reale të propagandës së kohës për pretendimet mbi një investim të madh politik në interes të emancipimit shoqëror në Shqipëri. Për shkak të vështirësisë së mungësës së anës sasiore, në planin teorik studimi mbetet i hapur. Duke përfshirë metodën analitike krahasuese mbi faktet historike sipas periudhave, materiali nëpërmjet konstatimeve, kritikës dhe përfundimeve shfaq rëndësinë e tij praktike, duke rritur vlerat e punës studimore në këtë fushë delikate të veprimtarisë shoqërore.

Pasqyrimi në mënyrë të saktë i pyetjeve me karakter kërkimor dhe hipotezës kryesore të studimit, në vijueshmëri logjike dhe metodologjike në lidhjen e tyre shkakësore, plotësojnë kapitullin e parë të studimit në kuptimin dhe paraqitjen e thelbit të përmbajtjes tërësore të tij.

Kapitulli i dytë, trajton në mënyrë të përmbledhur dhe problemore vendin dhe rolin e gruas shqiptare dhe fillesat e shtrirjes së problemit gjinor në mendimin shoqëror dhe letrar të viteve '30-të, duke sjellë në mënyrë kronologjike fakte dhe dokumente të kohës, veçanërisht në aspektin e trajtesave letrare si fusha e sociologjisë alternative për kohën, autorët më në zë, të cilët u bënë pararendës të thyerjes së heshtjes shekullore. Analiza në këtë kapitull përfshin të dhëna empirike të mbështetura në botimet artistike e letrare të kohës dhe të dhëna të burimeve dytësore nga dokumente të shtypit, botime të autorëve të ndryshëm veçanërisht autoreve femra, të cilat

janë të arkivuara dhe vlerësuara si fakte historike të dokumentuara dhe bazë mbështetëse për një vështrim analitik studimor në ditët e sotme.

Duke trajtuar çështje të rëndësishme me karakter të thellë social në një periudhë të vështirë që do vlerësohet si “*periudhë zgjimi për femrën shqiptare*”, është e dukëshme përpjekja serioze në studim për t’i përfshirë trajtesat në kontekst më të gjerë, duke përdorur me shumë efikasitet metodën analitike në këndvështrimin e përgjithëshëm por dhe të veçantë të tyre, duke evidentuar mundësitë për të dalë nga zona e “*heshtjes*” në një realitet gati të ndaluar për pozitën sociale të femrës në botën shqiptare të viteve ‘30-të. Lënda e trajtuar në këtë kapitull arrin të realizojë një lidhje metodike të pranuar në vijeshmërinë e përmbajtjes dhe analizës në kapitujt e mëposhtëm. Nëse kjo është një periudhë “*zgjimi*” me nxitje dhe bazë letrare, pas vitit 1928 problemi merr rrugë institucionale, e mbështetur në veprimtarinë kushtetuese e ligjore të sistemeve politik në Shqipëri.

Kapitulli i tretë, trajton problemin e pozitës së grave dhe pabarazisë gjinore gjatë periudhës së Mbretërisë Shqiptare nëpërmjet shtrirjes së sistemit arsimor dhe krijimin e shkollës shqiptare me karakterin e saj kombëtar. Përballë tradicionalizmit skllavërues kanunor, janë fillesat e përpjekjeve për barazi gjinore me bazë juridike. Konstatohet se fillimet e arsimit në Shqipëri ishin e vetmja fushë ku vajzat kishin mundësinë e arsimimit me efekte emancipuese edhe në planin shoqëror.

Megjithatë nga studimi i arkivave, as Republika e as Mbretëria Shqiptare nuk arritën ta ndryshonin prapambetjen arsimore të gruas, përkundrazi në disa spekte veçanërisht në zonat fshatare, e thelluan më tej atë. Propaganda në shtyp do të përkrahte përhapjen e arsimit dhe kulturës, por në rrugë shtetërore u bë shumë pak për realizimin e këtyre premtimeve.

Objekt kryesor në këtë kapitull janë të dhënat statistikore të shprehura në 11 tabela, të cilat pasqyrojnë praninë e vajzave shqiptare në shtrirjen e sistemit shkollor në Shqipëri. Raportet

meshkuj - femra për kohën ishin një dukuri e re premtuese, e cila po shtrihej dhe vepronte mbi një brez të ri edhe pse në raport me popullsinë e vendit numri i nxënësve zinte vetëm 4 për qind të saj.

Është periudha e hapjes së shkollave të huaja dhe krahas shkollave shtetërore dhe ato private. Nëpërmjet paraqitjes së 11 tabelave statistikore në këtë kapitull, është arritur të sigurohet një lëndë e mjaftueshme për të pasqyruar ndryshimin e situatës së postpavarësisë dhe futjes në rrugë ligjore të arsimit dhe nëpërmjet tij, vlerësimit të femrës shqiptare. Kodi Civil i miratuar më 1 prill të vitit 1929 nën ndikimin e modelit francez, veçanërisht mbi rolin e familjes dhe martesës, përfaqëson një risi në realitetin që prezantonte shteti dhe shoqëria shqiptare e asaj kohe. Analiza statistikore dhe kritika mbi realitetin në respektimin e barazisë gjinore, përshkojnë thelbin e këtij kapitulli.

Kapitulli i katërt, ku shtjellohet ndërveprimi dhe ndërvarësitë midis problemit gjinor dhe problemit fetar në shoqërinë shqiptare, duke përfshirë analizën mbi besimin fetar në periudhën midis dy luftërave dhe më pas në regjimin komunist në Shqipëri. Një problem delikat që u ballafaqua me një realitet shumë kompleks të ndërthurjes së ndikimit kanunor e fetar dhe tendencave të kundërvënies deri në përjashtim, në emër të emancipimit të grave dhe vajzave, të luftës kundër zakoneve të prapambetura dhe në tërësi të emancipimit shoqëror të shoqërisë shqiptare. Analiza e situatës dhe të dhënave për periudhën e Mbretërisë Shqiptare është një plotësim në mënyrë shkakësore që i bëhet kapitullit të katërt.

Dokumentet arkivore të mjaftueshme japin një sistuatë të plotë të qëndrimit klerik gjatë luftës për çlirim dhe më pas deri në vitin 1967 nën regjimin komunist. Në mënyrë analitike janë evidencuar tendencat e klerit dhe të shtetit, mospajtimet, kundërvëniet ligjore dhe përballë tyre ndikimi në opinionin shqiptar në ndryshimin e situatës. Analiza ka vënë në dukje lidhjet shkakësore midis besimit fetar dhe ndikimit kanunor në raportet dhe kërkesat e barazisë gjinore, të cilat nën

politikat shtetërore sollën ndryshime cilësore në jetën sociale të vendit, veçanërisht pas ndryshimit të statusit të besimit në Shqipëri në vitet '50-të.

Kapitulli i pestë, trajton pozitën e gruas dhe pabarazinë gjinore gjatë shndërrimeve ekonomike, politike dhe kulturore në periudhën e viteve 1945 - 1967. Si piknisje është trajtuar gjendja e gruas në periudhën e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, një periudhë e spikatur për pjas marrjen e grave shqiptare në radhët e formacioneve partizane. Përparësitë e kësaj periudhe u munduan të shfrytëzohen në propogandën partiake për të siguruar përkrahjen në mbështetjen politike të gati gjysmës së popullsisë në periudhën e pushtetit popullor të pasçlirimit. Në materialin studimor paraqiten një sërë dokumentesh arkivore, që evidencojnë vëmendjen partiake ndaj rolit të grave në luftë dhe organizimin e tyre të veçantë.

Synimi për arsimimin e tyre u bë objekt i rëndësishëm i luftës kundër analfabetizmit. Në tërësinë e direktivave partiake, në studim është synuar të veçohen me kujdes të gjithë elementët që lidhen me rolin e gruas dhe përfitimet e saj nga sistemi. Trajtimi i çështjeve arsimore, të zhvillimit kulturor dhe të punësimit nëpërmjet garantimit të të drejtave në bazë juridike dhe sociale, duke ndjekur ritmikisht nëpërmjet të dhënave shifrore rritjen sasiore dhe cilësore të këtyre niveleve, ka mundësuar të evidencojë vlerat pozitive të kësaj periudhe, pa anashkaluar kritikën ndaj fenomeneve që shoqëronin jetën e grave shqiptare në pjesën e padukëshme të saj.

Fakti që në këtë drejtim regjimi punoi shumë për t'i ardhur në ndihmë familjes dhe mbi të gjitha gruas, ngritja e institucioneve të shumta, duke filluar nga çerdhet, kopshtet, kampet e pushimit për fëmijë, shkolla, qendra kulturore, kinema, teatro, stadione, qendra sportive, duke e kthyer edukimin e brezit të ri në një detyrë jo vetëm të familjes por të të gjithë shoqërisë, nuk i shmanget kritikës analitike mbi synimin për të krijuar dhe edukuar një brez të ri, tërësisht të ideologjizuar në shërbim të pushtetit.

Duke vlerësuar lëndën e shumtë burimore në këtë kapitull, metoda analitike nxjerr në pah një problem të spikatur, i cili funksiononte në të gjithë hallkat e ndërtimit të piramidës shoqërore në Shqipëri. Veprimtaria dhe ndërvarësia me nxitje nga *“poshtë - lartë”* dhe anasjelltas e dukurive me lidhje shkakësore dhe reagimeve politiko - sociale në mënyrë masive, arritën të formonin për kohën një ndjesi shoqërore të alternuar, e cila në asnjë rast nuk doli nga kuadri politik i synimeve të pushtetit. Përkundazi, evidentohet një mbështetje masive, e cila shpesh ka si piknisje nisma të individëve dhe grupeve sociale në shërbim të politikave partiake. Kjo mënyrë veprimi u zbatua edhe në luftën kundër fesë dhe zakoneve të vjetra, të cilat zenë vend të rëndësishëm në këtë kapitull. Kjo dukuri e mbështetur *“në mbrojtjen e interesave të shumicës”* nën efektet e një propagande të fuqishme, arriti të përfitonte terren politik me masivitetin e saj dhe orientoi organizatat e masave në mbështetje të politikave partiake.

Këtë dukuri e konstatonte edhe udhëheqja politike e shteti dhe në forma të ndryshme, në emër të popullit, të mbrojtjes së vendit, të nevojës së rritjes ekonomike dhe përmirësimit të jetës, në emër të emancipimit shoqëror, në mënyrë ligjore dhe partiake ushtronte trysninë në opinion nën veprimin e frymës kolektive.

Në analizën e mirëfilltë të problemit të barazisë gjinore dhe rritjes së rolit të gruas, studimi arrin të balancojë arritjet me përshkrimin fenomenologjik të tyre, nëpërmjet interpretimit kuptimor të këtij realiteti, evidentimit të pikave të errëta që së jashtëmi me bujë propogandonte arritjet e sistemit, por në fakt së brendëshmi vetëdija sociale e njerëzve shfaqet me probleme. Në mënyrë analitike të disiplinuar mbi realitetin dhe kritikën, e cila është e pranishme në pjesën kryesore të kapitullit, mbi këtë bazë metodike në studim jepet një konstatim jo pak i rëndësishëm: Gratë në regjimin komunist në Shqipëri, më shumë u burrëruan për të shfrytëzuar energjitë e tyre, se sa u emancipuan.

Kapitulli i gjashtë, në te cilin trajtohet çështja mbi lëvizjen për të drejtat e grave dhe vajzave, si një dukuri e importuar: ndikimi i konteksteve ndërkombëtare ideologjike, politike dhe kulturore. Metoda bazë është analiza kritike, veçanërisht ndaj ndikimit të Revolucionit Kulturor Kinez në deformimin e jetës shoqërore, politike dhe kulturore në Shqipëri, me ndikime edhe në këtë shtresë sociale të shoqërisë. Jo pa qëllim janë evidencuar disa nga anët negative të këtij revolucioni, për të nxjerrë në pah politikën e gabuar të udhëheqjes partiake të vendit, gabim të cilin vite më vonë E. Hoxha do ta kritikonte me doza justifikimi.

Revolucioni Kulturor Kinez u zhvillua në një realitet të ndryshëm historik, krahasimisht me Shqipërinë. Ai synonte të realizonte edukimin socialist, për të konsoliduar ideologjinë proletare dhe diktaturën e proletariatit në të gjitha fushat e jetës, për të luftuar ideologjinë revizioniste. Ideologjia e Revolucionit Kulturor Kinez, ishte një përqasje midis teorisë së marksizëm - leninizmit dhe konfucianizmit tradicional historik kinez [parimet e Konfucit, ideologut të lashtësisë kineze], të cilat nuk kishin asgjë të përbashkët me realitetin shqiptar. Në Kinë ai u kthye në një anarshi të vërtetë, fillimisht i drejtuar nga ushtria, e më pas nga organizatat rinore, duke dalë tërësisht jashtë kontrollit policor brenda vendit. U kritikuan rëndë vepra artistike e romane. Në thelb, ky revolucion nuk ishte proletar. Propaganda komuniste u intensifikua me fillimin e Revolucionit Kulturor në vitin 1961. Çdo formë e shfaqjes së kulturës së huaj borgjeze konsiderohej reaksionare. Revolucioni kulturor duhej të luftonte çdo mbeturinë si dhe paragjykimet e zakonet e vjetra, të cilat u konsideruan kundërshtarë, madje armiq të vijës marksiste - socialiste. Udhëheqëse e këtij revolucioni do të ishte rinia, si e vetmja trashëgimtare e revolucionit proletar. Qëllimi i tij ishte krijimi *“i njeriut të ri”*.

Në brendinë e kapitullit kritika evidenton pasojat e rënda që përjetoi shoqëria shqiptare, të cilat nuk u pranuan asnjëherë si gabim i udhëheqjes partiake, por përgjegjësia kaloi në kritikën ndaj tij. Periudha e zbatimit të ndikimeve të këtij revolucioni përkon me luftën kundër fesë, zakoneve

prapanike, luftën kundër burokratizmit, brenda të cilave roli i grave dhe vajzave shqiptare ishte gjithpërfshirës.

Në pjesën e dytë të këtij kapitulli trajtohet çështja e “*revolucionarizimit*” të arsimit dhe rritjes së mbështetjes për vajzat në shkollimin e tyre. Nëpërmjet shfrytëzimit të lëndës arkivore, në mënyrë tabelore dhe analitike, evidentohen një sërë arritjesh në fushën e arsimit, ku veçohet prania e grave dhe vajzave. Krahasimi me periudhën e Mbretërisë Shqiptare i synimeve, arritjeve dhe direktivave politike në interes të arsimit nga regjimi, konsiderohet një veprim propogandistik për të rritur artificialisht besimin e popullit ndaj pushtetit.

Një pasqyrim i saktë i rritjes së sitemit universitar dhe shkollor në të gjithë nivelet dhe numrit të nxënësve të arsimit të përgjithëshëm dhe atij profesional, nxjerr në pah synimin ambicioz të pushtetit politik nëpërmjet riorganizimit të programeve mësimore në interes të ideologjisë sunduese në vend. Për hir të së vërtetës, në vitin shkollor 1969 - 1970, për herë të parë përqindja e femrave që vazhdonin shkollën, ishte më e lartë se sa përqindja e meshkujve: 55.9 %, kundrejtë 44.1 % të tyre.

Revolucionarizimi i shkollës u drejtua nga direktivat partiake, duke u zbatuar nga komisioni i posaçëm i K.Q. të drejtuar nga Kryeministri. Proceset “*revolucionarizuese*” në fushën e arsimit patën ndikimin e tyre në socializimin e zhvillimeve gjinore në Shqipëri.

Por, thellimi i të ashtuquajturit, “*procesi i revolucionarizimit*”, synonte që edukimi i brezit të ri të ishte në përputhje dhe shërbim të ideologjisë komuniste. Përfshirja e rinisë, grave e vajzave në aksione, stërvitje ushatarake dhe praktika të tjera, disa të huazuara nga Revoluzioni Kulturor Kinez, disa të tjera origjinale nga praktika e vet regjimit, deformuan thellësisht procesin e socializimit të rinisë dhe e orientuan mbështetjen e saj dhe të grave, drejt proceseve që synonin sterilizimin e jetës shpirtërore, kulturore, arsimore dhe shoqërore të vendit.

Në sistemin arsimor, kultura fizike dhe përgatitja ushtarake morën rëndësi të veçantë për të mbrojtur vendin nga armiqtë imagjinarë. Kalitja fizike, si iniciativë e masave dhe imitim i jashtëm, u shtri kudo. Stërvitja fizike dhe ushtarake trajtohej si shprehje e kuptimit politik të situatës. Grupimi i grave dhe vajzave në strukturat ushtarake, nuk i pati mundësitë e përfaqësimit si grup interesi për karrierën dhe kontributin, por u trajtuan nën frymën e ndikimit të përgjithëshëm të zbatimit të direktivave partiake, të cilat po aq sa jepnin hapësirën formale të vlerësimeve gjinore, po aq arrinin të mbulonin me një lloj konservatorizmi tradicional vlerësimin dhe kontributin real të potencialeve të mëdha që përfaqësonin gratë dhe vajzat në këtë strukturë. Hartimi dhe zbatimi i politikave gjinore në sektorët e dominuar historikisht nga meshkujt, veçanërisht pjesmarrja e grave dhe vajzave në strukturat ushtarake të shtetit, përbënte një sfidë të kohës.

Në kapitull trajtohen në kompleks të gjithë elementët që u bënë objekt i këtij revolucionarizimi. Revolucionari ideologjik u pasua nga revolucionari tekniko - shkencor, zhvillimi i kulturës me karakter socialist, e cila u shtri në gjitha nivelet e arsimit dhe në tekstet shkollore. Ky synim bëri që shkollimi dhe dijet shkencore të asfiksoheshin nga indoktrinimi ideologjik. Revolucionarizimi i jetës përfshiu administratën publike qendrore dhe vendore. Ai u shoqërua me krijimin e atmosferës së rrezikut dhe nevojës së mbrojtjes nga rreziqet e jashtme dhe të brendshme. Gjithashtu, artit iu imponua të pasqyronte heroin e ditës. Krijimi i “njeriut të ri” ishte një prirje e sistemit, i cili mbi bazën e ideologjisë së re u fut në një proces të gjatë ndryshimesh, por që nuk ja arriti qëllimit.

Është kjo një arsye bindëse, që analiza në materialin studimor, në funksion të raporteve midis individit dhe shoqërisë, shpjegon në mënyrë shkencore kuptimin real dhe bindjen se, ideja e formimit “të njeriut të ri socialist” ishte një dështim i radhës për regjimin komunist. Trajtimi që u është bërë këtyre elementëve në materialin studimor, edhe pse në pamje duket sikur propagandohen arritjet “e hatashme” në fushat e ndryshme të jetës shqiptare, edhe pse ato kanë

pozitivitetin e tyre në pamje të jashtme, në thelb dalin në dritë raportet e brendëshme të lidhjes shpirtërore të popullit, masës së grave dhe të vajzave shqiptare me falsitetin apo nënshtrimin e butë ndaj rrjedhave të jetës, që buronin nga natyra e sistemit dhe pushtetit.

Në këtë kapitull delikat ballafaqimi i jam përmbajtur me skurpulozitet parimit vetjak: Analiza dhe kritika e mbështetur mbi parimet e lirisë, të shpirtit të lirë të individit brenda një sistemi që gjeneron energji pozitive, nuk lejon të përgjithësohen vlerat e sistemit të kaluar.

Në përfundim, metoda studimore shkencore e kërkimit në këtë fushë interesante nëpërmjet analizës dhe kritikës, mundëson arritjen e njohrive të reja për këtë periudhë historike në dy sisteme politike të ndryshme. Krahaseshmëria sjell një aspekt të veçantë, e cila në mënyrë indirekte respekton traditën e mirë kulturore e fetare të popullit shqiptar. Kjo ka sjell disa përfundime të reja mbi njohuritë dhe kuptueshmërinë e realitetit në dy sisteme politike, nëpërmjet pyetjeve kërkimore të cilat kanë interes mbi këtë fenomen social.

Larg ndikimeve politike të periudhave historike të analizuara dhe krahasuara me kujdes, është arritur në përfundime bindëse për mundësinë e masave parandaluese dhe përpjekjet për zgjidhje institucionale e ligjore të shtetit dhe shoqërisë shqiptare, të cilat ishin rrjedhojë e analizës historike të fakteve dhe ngjarjeve, dukurive më të spikatura të periudhave të caktuara të historisë, duke e sjellë në vëmendjen e opinionit të gjerë social çështjen e barazisë gjinore. Mbi bazë kushtetuese dhe ligjore, si në periudhën e Mbretërisë Shqiptare dhe atë të shtetit komunist, çështja e barazisë gjinore mori në tërësi një karakter unik të domosdoshëm, të mbështetur në masa dhe hapësira ligjore për institucionet shtetërore e shoqërore, pavarësisht arritjeve, pamundësive dhe deformimeve me karakter politik dhe ideologjik. Në këtë fasadë të përgjithëshme, në studim janë bërë përpjekje serioze për zbulimin dhe trajtimin analitik të shkaqeve reale serioze të shtrimit të problemit të barazisë gjinore në një kontekst më të gjerë

social, duke sjellë më afër kritikën në interes zhvillimeve pozitive të emancipimit të shoqërisë shqiptare.

Metoda analitike është shtrirë në pjesën më të madhe të studimit, veçanërisht në periudhën e regjimit komunist në Shqipëri, për shkak të dallimeve politike të vet sistemit ideologjik, i cili për interesa politike e trajtoi çështjen e barazisë gjinore në konceptimin dhe këndvështrimin e vet, në shërbim të interesave partiake në drejtimin e vendit. Brenda kësaj hapësire studimore objekt me rëndësi janë vlerësuar ndikimet e jashtëme, të cilat iu kundërvunë tradicionalitetit në jetën shqiptare, duke sjellë deformime të dëmshme.

Metoda krahasuese në objektin e saj studimor është bërë me periudhën e Mbretërisë Shqiptare, e cila edhe pse në aspektin ligjor institucional e vlerësoi problemin gjinor, në fakt solli më pak ose aspak ndryshime në jetën reale të grave dhe vajzave shqiptare. Krahasueshmëria e dy periudhave në sisteme politike të ndryshme ka ruajtur me kujdes thelbin tradicional të reflektuar në historinë shqiptare, mbi të cilën është konstatuar me vërtetësi se, pavarësisht konservatorizmit maskilist shqiptar dhe ndikimit të traditës kanunore, femra shqiptare në kohë të caktuara ka spikatur në rolin e saj, duke lënë gjurmë të ndjeshme në histori.

Përparësia e studimit nëpërmejt analizës së dokumenteve arkivore i ka shërbyer kërkimit vërtetues [konfirmues në mbështetje të hipotezës] për të reduktuar në fakt mënyrën ideale të trajtimit të problemit të barazisë gjinore veçanërisht në sistemin komunist, duke specifikuar në shumë raste anën propogandistike me realitetin që vepronte në shoqërinë shqiptare. Kjo përparësi gjykoj se ka rritur anën cilësore në kontekstin historik, stilistik, verifikues me sinteza të besueshme nga dëshmitë e së kaluarës.

Burimet dytësore përfshijnë botime të mëparshme rreth kësaj fushe, përfundimet e studiuesve dhe anlistëve në fushën studimore mbi pabarazinë gjinore dhe ndërthurjen e saj ndërmjet treguesve të zhvillimit social dhe pabarazisë sociale. Burimet teorike përfshijnë përkufizimet dhe

konceptet mbi çështjet gjinore, sipas situatave dhe zhvillimeve politike dhe shoqërore në vendet ish komuniste.

Në këto konstatime, tema studimore e paraqitur merr rëndësi teorike dhe praktike në format rekomanduese dhe aplikuese të saj, e ndërthurur kjo me aspektin politik, juridiko - shkencor dhe penal, që krijon hapësira për varjante e alternativa për vendimarrje me natyrë sociale në interes të rritjes së vlerave, kontributit të grave dhe vajzave shqiptare në jetën social - politike të vendit.

1.4. Kufizimet e studimit.

Punimi i paraqitur përmban disa kufizime, që rrjedhin nga natyra e tij problemore.

Analiza e problemit gjinor në periudhën e paraçlirimit të Shqipërisë, ishte një detyrë e vështirë për t'u realizuar. Kufizimet e mëdha prej të cilave vuante shoqëria e varfër shqiptare, e spostonin problemin gjinor në problem periferik të shoqërisë. Kjo vështirësoi gjetjen e burimeve teorike dhe dokumentare për thellimin e mëtejshëm të analizës.

Analiza e problemit gjinor në regjimin komunist në Shqipëri, ofroi një pamje tjetër. Retorika politike dhe ideologjike, demagogjia, botimet dhe fjalimet e pafund politike, inflacioni i mendimit politik dhe shoqëror mbi të ashtuquajturin "*emancipim të gruas*", ishte pengesë për të zbuluar gjendjen e vërtetë të grave dhe vajzave shqiptare dhe përmasat e vërteta të pabarazisë gjinore gjatë regjimit komunist. Mungesa e lirisë ishte e vështirë të kapërcehej dhe të mundësonte afirmimin real të potencialeve dhe energjive totale të grave dhe vajzave. Në një shoqëri jo të lirë, liria për gratë dhe vajzat ishte utopi. Retorika, ideologjizimi dhe politizimi i shoqërisë dhe veprimit shoqëror, ishte pengesë për të zbuluar përmbajtjen dhe përmasat e problemit gjinor në përmbushje të detyrimeve politike të vet thelbit të sistemit komunist në Shqipëri.

Analiza e problemit gjinor në shoqërinë shqiptare, nuk ishte e lehtë. Ajo ndihet ende e pa çliruar nga ndikimet dhe kufizimet e parahistorisë së saj. Investimi për barazinë e shanseve për të dy gjinitë është nisur nga vizioni i kufizuar mbi këto shanse, duke i reduktuar ato vetëm në pjesëmarrje në institucionet politike, sidomos në degën legjislativë dhe ekzekutive të qeverisjes, por jo në jetën reale. Kjo ishte dhe mbetet vështirësia tjetër me mjaft ndikim mbi analizën e problemit gjinor në shoqërinë e sotme shqiptare.

1.5. Rëndësia e studimit.

Studimi; *“Çështje të pabarazisë gjinore në vitet 1945 - 1967 dhe ndikimi i tyre në zhvillimin shoqëror të Shqipërisë”*, paraqet rëndësi teorike dhe praktike.

Rëndësia teorike qëndron në sinergjinë midis analizës së gjendjes së grave dhe vajzave në periudhën e paraqitjes së Shqipërisë dhe situatën nën regjimin komunist. Problemi gjinor në shoqërinë shqiptare ka rrënjët e veta historike, ekonomike dhe kulturore. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XX-të, këto rrënjë bashkëjetuan me rrethanat politike dhe ideologjike që u krijuan në Shqipëri mbi gjendjen e të drejtave të grave dhe vajzave. Investimi politik dhe shoqëror në problemin gjinor, nuk mundi të shënonte përmirësimin cilësor të gjendjes, përmbajtjes dhe thelbit të tij. Për më tepër retorika për barazinë gjinore, shërbeu si instrument për të forcuar sundimin partiak. Kjo tezë, synon të argumentojë pikërisht lidhjen midis forcimit të sundimit partiak dhe mbytjes së lirive njerëzore në Shqipëri, me lëvizjet e rekomanduara të ashtuquajtura *“progresive e revolucionare”*, siç ishte lëvizja për revolucionarizimin e jetës së vendit dhe zgjerimin e të drejtave të grave.

Rëndësia praktike, qëndron në pritshmërinë e përfundimeve që jepen në fund të studimit, të cilat mund të shërbejnë për të krijuar më shumë mundësi dhe prurje reale për nxitjen e barazisë dhe

mundësive për zhvillimin dhe pjesëmarrjen harmonike të të dy gjinive në zhvillimin ekonomik, shoqëror, politik dhe kulturor në Shqipërinë e sotme dhe në të ardhmen e saj.

Duke sjellë në këtë shtjellim të koncentruar të përmbajtjes së studimit, përfundime specifike dhe të karakterit përgjithësues, të cilat dallohen në brendinë dhe thelbin e trajtesës mbi të dhëna historike kam dalë në përfundimin se, rëndësia teorike dhe praktike e tezës kryesore të parashtruar dhe të detajuar në këtë temë, qëndron në faktin konkret të vet thelbit të përmbajtjes së punës kërkimore - shkencore, analiza dhe refleksionet në fushën politiko - ideologjike, fetare dhe juridike, të mbështetura të treguesit e tradicionalizmit shqiptar.

Sjellja e këtij fenomeni shoqëror me përfundime më pranë realitetit të sotëm të shoqërisë shqiptare, do të synojë ngushtimin e hapësirave të ndikimit të tij në mjedisin shqiptar. Në lidhjen filozofike shkak - pasojë, nuk mund të pranohet më që në kohët moderne, dallime të tilla gjinore të shkaktojnë tronditje të rënda psikologjike në gjirin e shoqërisë.

1.6. Pyetjet Kërkimore.

Punimi ka në bazë argumente që mbështesin analizën mbi temën studimore, duke dhënë përgjigje pyetjes kërkimore bazë:

- Cilat kanë qenë ndikimet kryesore të pabarazisë gjinore në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë?
- Si është shfaqur dhe si ka ndikuar ndërvarësia midis çështjes gjinore dhe çështjes fetare në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë?

1.7. Hipoteza.

Mbi bazën e pyetjeve kërkimore, puna studimore në mbështetje të tezës kryesore të doktoraturës ka si synim vërtetimin e hipotezës së mëposhteme:

- Pabarazia gjinore ka qenë dhe mbetet një ndër aspektet më të rëndësishme dhe një faktor për thellimin e pabarazisë shoqërore në Shqipëri.
- Ndërruesia midis çështjes gjinore dhe çështjes fetare pengon zbutjen e pabarazisë gjinore dhe rritjen e rolit të besimeve fetare në mbështetje të zhvillimit shoqëror të Shqipërisë.

KAPITULLI II: Gruaja dhe problemi gjinor në mendimin shoqëror dhe letrar të viteve '30-të: letërsia, si sociologji alternative.

Shoqëria shqiptare ka qenë tradicionalisht e mbizotëruar jo thjesht nga meshkujt, por nga normat, autoriteti dhe vendimarrja mashkullore. Problemi gjinor në shoqërinë shqiptare ka pasur dhe vazhdon të ketë përmbajtje më të gjerë se sa mungesa e mundësive apo pabarazia gjinore. Gratë kanë qenë të pranishme me rolin e tyre në mjaft ngjarje të rëndësishme shoqërore e politike dhe beteja historike të kombit, por prania femërore në udhëheqje ka qenë një dukuri e rrallë. Ato kanë përballuar nevojat e mëdha për mbijetesën ekonomike të familjeve shqiptare, por fuqia e tyre e tregut të politikës dhe të punës ka qenë e dobët. Gratë, kanë pasur dhe krijuar potenciale të mëdha zhvillimi, por ato nuk kanë mundur t'i sendërtojnë dhe mobilizojnë këto energji në zhvillimin shoqëror. Pabarazia gjinore gjatë viteve 1920 - 1944 dha ndikimet e veta në zhvillimin shoqëror të Shqipërisë.

Vetërespekti dhe vetëprezantimi me vullnet shpirtëror i grave dhe vajzave shqiptare në kohën e sotme, vëtdijshmëria dhe vetëlartësimi i tyre, *“do të shprehin përmbajtjen e emocionale, kënaqësitë apo pakënaqësitë për personalitetin, cilësitë dhe aftësitë, mendimet dhe sjelljet”* [Dragoti, Edmond, 2004:46], duke njohur dhe respektuar aftësitë dhe vlerat e vetes drejt optimizmit për ndryshimin e kësaj shtate të deformuar nën petkun e demokracisë, kundër qëndrimeve të deritanishme të përgjegjësisë individuale dhe institucionale, të cilët vazhdojnë t'ia atribuojnë sukseset vetes dhe dështimet në këtë fushë veprimi faktorëve të jashtëm. Nevojat dhe domosdoshmëritë e demokracisë janë më të vlefshme se sa nevojat e individit.

Regjimet politike kohë pas kohe, janë pajtuar dhe e kanë shfrytëzuar për interesa të ngushta politike këtë strukturë sociale dhe kulturore të shoqërisë. Ndërkohë, regjimi komunist u veçua nga regjimet e mëparshme, sepse nga njera anë mobilizoi burime politike dhe kulturore për të ashtuquajturin *“ndryshim të ekuilibrave tradicional gjinore”*, ndërsa nga ana tjetër ruajti të pa

ndryshuar dhe nuk arriti të ndërhyjë në rrënjët dhe shkaqet kryesore kulturore dhe historike, që ushqenin pabarazinë dhe problemin gjinor në shoqërinë shqiptare.

2.1. Nga zona e “heshtjes”, në realitetet e ndaluara; pozita sociale e femrës në botën shqiptare të viteve ‘30-të.

Idetë më të rëndësishme mbi pozitën dhe rolin e gruas në shoqërinë shqiptare, janë pasqyruar më gjerësisht në mendimin letrar dhe krijimtarinë letrare të shkrimtarëve shqiptarë të kohës. Kjo, nuk ishte e rastësishme. Mendimi letrar dhe krijimtaria letrare gjatë viteve 1920 - 1930, ishin produkti më i spikatur në mendimin shoqëror shqiptar. Letërsia dhe kritika letrare, ishin hapësirat kryesore të rrahjes së mendimeve dhe ideve mbi zhvillimin e shoqërisë. Në këtë kontekst, shkrimtarët dhe kritikët ishin jo vetëm kritikët kryesorë të realitetit shoqëror, por gjeneruesit potencial për kohën të ideve mbi zhvillimin, ndryshimin dhe të ardhmen e shoqërisë. Është fakt që, filozofët dhe sociologët shqiptarë të kësaj periudhe, lindën kryesisht në terrenin e letërsisë dhe të kritikës letrare. Ky është shkak që në këtë kapitull, referencat kryesore mbi pozitën dhe rolin e grave në shoqëri, burojnë nga krijimtaria dhe kritika letrare e kohës.

Gruaja shqiptare e viteve të periudhës së pavarësisë, dallon nga ajo e cilësuar si jetë e viteve “30-të”. Arsyeja më bindëse qëndron në raportin e saj më të tërën. Para viteve ‘30-të, gruaja vishej me petkun e një simbolike “burrërie”, e cila ishte rrjedhojë e ndikimit që reflektonte në popull çështja kombëtare shqiptare. Citojmë dy vargje nga poema e Fishtës, “*Lahuta e Malcis*”, në përmbajtjen e të cilave kuptojmë vlerat që përfaqësonte për kohën gruaja shqiptare. “*Edhë dielli dheut i ra/ Gjallë por Tringa Shkjaut n’dorë s’ra*”. [Elsie, Robert, 1997:295].

Brenda kësaj ekzistence, lidhej dhe gjallonte fati i saj luftarak, virtytshmëria deri në shenjtëri. Kjo veçori historike u krijua si mbirealitet, nga vet hiperbolizimi i faktorit historik. Është një

Tringë fishtjane, e cila do i paraprij një heroine si Shote Galica. Dhe pse jemi në fillimet e shekullit të XX-të, kur Evropa falë revolucionit industrial e ngriti gruan në statusin e punëtore dhe kur Lufta e Parë Botërore trokiti në dyert e kontinentit, gratë do të arrinin të merrnin pjesë në procesin e prodhimit të armatimeve në interes të luftës. Këto detaje, së bashku me shkrirjen e tyre në lëvizjet punëtore, sindikaliste, u dhanë atyre vendin përcaktues në shoqëri, të drejtën e votës. Këtë faktor historik do ta shohim më poshtë, kur krahasojmë feminitetin intelektual shqiptar me atë european, duke u nisur nga ngritja e dinjitetit të saj tek përkatësia social - punëtore.

Parë nga ky këndvështrim dualitetesh, ndihet e nevojshme të jemi ende “*modestë*” në ndryshimin e moralit shqiptar. Një punëtore europiane e shtyrë drejt vendit të saj në zhvillimin e shoqërisë, duke e nisur të ardhmen përmes punës, e ka brenda këtij formati afërsinë e saj gjinore. Puna është e vetmja vlerë ku dinjiteti njerëzor e kupton dhe e ndjen ekzistencën. Kur i referohemi situatës së femrës shqiptare, do të pranonim konceptin mbi një realitet ndryshe. Arsimimi i tyre kishte qëllim zgjimin e moralit, dokeve, kundër patriarkalizmit mbytës apo fatit vetëvrasës të një “*ngujimi paramartesor*”. Në kontinentin tonë gruaja punëtore ishte e aftë të mbante familjen, por dhe të gjendej një ditë “*e ve*”, nën pasojat e divorcit.

Për studimin e situatës brenda jetës shqiptare, duke iu referuar vërtetësisë letrare në njohjen e botës shqiptare, nisemi nga dy krahasime letrare, nga atdhetari Pashko Vasa me romanin e tij “*Bardha e Temalit*”, botuar në Paris më 1890, dhe Henrik Ibsen me dramën “*Shtëpia e kukulles*”, botuar më 1882. Do mjaftonte një raport krahasues i thelbit të përmbajtjes së tyre, për të kuptuar shumë kundërshti në gjendjen dhe të drejtat e gruas. Autori shqiptar e trajton të drejtën e femrës në tragjizmin e saj brenda dashurisë, duke rikrijuar skena në roman, të cilat herë të kujtojnë “*Ferrin*” dantesk, e herë ledi Makbeth. Në rastin e Norës së Ibsenit, e drejta e saj nuk qëndron tek pasioni, flijimi romantik, por tek dashuria e të qenit femër dhe respekti ndaj vetes. Mbi të gjitha, citimi i saj në mbyllje të dramës se: “*Këtë e kanë bërë mijëra gra Torvald...*”

[Ibsen, Henrik, 1882:47,121], shpjegon gjithçka. Sipas kritikës, nga që Ibsen ka qenë estetikisht tejet realist dhe i drejtpërdrejtë, heroina e tij do mbetet një nënë, duke e “*fshehur*” qenien e saj si grua. Kjo për vetë dëshirën dhe vullnetin e saj emancipues.

Në fillimi të shekullit të XX-të, sidomos gjatë dekadave 1920 dhe 1930, mendimi letrar shqiptar e pasqyron femrën shqiptare herë si “*profeci*” naimiane brenda panteizmit, e herë plot “*Migjen*”. Konstatohet një “*ishullim*” femëror shqiptar, i mbyllur deri në kyçje për çdo të drejtë. Por nga ana tjetër, kur femra hyn në *folklorizëm*, ajo paraqitet si qenie gati e paarritshme. Në këtë marrëdhënie që e fsheh deri diku gruan shqiptare, është morali burror kombëtar, i cili nuk i lejon asaj të kuptojë se çfarë mund të përfaqësojë.

Po t’i referohemi në thelb e drejtpërdrejtë dy botimeve të mësipërme, do të duhej të zbulonim së pari; se përtej një nëne, amvise, luftëtare, në shumë raste e mbetur në vetminë e saj, normalisht do të shtrohej pyetja: çfarë mund të ketë bërë në jetën e saj kjo grua e “*tretur*” dhe pa identitet real? Përjashtohet në këtë vlerësim Migjeni në rastin që shpreh një anonimat, si moslejim për të ndryshuar një Shqipëri kaq dramatike, me plot tragjizma dhe mbetje prapa kudo! Deri në fund të viteve ‘20-të, gruaja përshtatej brenda patriarkalizmit në kufijtë vrasës. E ngujuar kudo, ajo ishte thjeshtë një “*riprodhuese*” djemsh. Në raste të tjera, ajo mallkohej nga burrëria krahinore si e pazonja për të lindur të “*shtëna*” dhe jo të “*qara*”. [Kanuni Lek Dukagjinit, 2005:10-21].

Historiku i shtypit shqiptar jep mes emrave të pendës së gazetarisë, vetëm një grua: Ikbale Çika [Marku, Mark, Boriçi, Hamit, 2010:200]. Ishte gazetare dhe bashkëpunëtoresh mes morisë së intelektualëve, të cilët këtë realitet lajmi e kishin pjesë të qenësisë së tyre politike, letrare, studimore. Pra, duket se me nisjen e arsimit, do niste realisht ndryshimi i gruas shqiptare. Sipas studimit mbi historikun e shtypit, “*kjo dekadë deri para pushtimit italian, do ketë shumë divergjenca brenda vetë kësaj bote, sa e lajmit, por e kundërshtive mes grupeve intelektuale*”.

Gazeta shihej si mjet publik, për të treguar forcën me ithtarë “lexuesish”. Ishte koha e ndarjeve të mëdha si kudo, mes të Vjetërve dhe të Rinjve.

At. Gjergj Fishta, na ndihmon të kuptojmë çfarë ndodhte realisht me këtë shtyp:

“Por ç’së ia hynë me shkruem në gazeta njerëz batalla, rrugaça, derdimena, studentë të ramë në provime, smirëzez, të cilët pa dijtë gjuhë, pa pasë zeje e dijeni në punë, me do parime morale e shoqnore, kryekëput në këndërshtim me parime të qytetnueme, përllajnë pendën krejt si gjaksbasi thikën e nën tallazgan, gjerentit përgjegjës, mësyjnë njerëz të punës dhe dijes...”. [Marku, Mark, Boriçi, Hamit, 2010:199-200].

Siç konstatohet në vet thelbin e këtij mendimi, poeti, kishtari, patrioti, gjithçka që ia kërkonte vendi së paku në përparim të dijes, e ka pasur të qartë se shtypi nuk mund të ndahej prej “krahinarizmit” intelektual. Një formë të shprehuri me mungesë etike, e cila e zbrazte vet lexuesin nga qëllimi informues. Ky krahasim jep të drejtën e mendimit mbi vet fatin ende të padukshëm të rolit të femrës së kohës në atë botë elite, por e mënjanuar nga vet diferencat e mëdha, deri në skaje të njeriut të dijshtëm dhe epidemisë vdekjeprurëse nga mos mbërritja në kufijtë e një kulture masive.

Pra siç shihet, vendi i gruas, e cila në fundin e viteve ’20-të nisi të ndjehet pjesëmarrëse, kjo dukuri pozitive ndodhi për shkak të arsimimit. Me ngritjen e shtetit gjatë periudhës së Mbretërisë Shqiptare, nisi të krijohet atmosfera elitare. Femra shqiptare nisi të gëzoj të drejta, në fillim fal pasurisë dhe përkatësisë prej familjeve të mëdha. Shfaqet, lojërat sportive, veshja dhe përshtatja me ndikimet e perëndimit, mundësuan këtë hapësirë emancipimi. Sipas burimeve arkivore, në Korçë u zhvilluan dy aktivitete; garat sportive dhe “Miss Korça”. E veçanta e dukëshme dhe intriguese ishte veshja sportive me rroba banjoje, pa dallim nga paraqitjet në vendet e tjera. Nga ana tjetër fal kësaj pasurie dhe ndikimeve të kolegjit “Nana Mbretneshe”, u reflektua një ndryshim i pakthyeshëm drejt një gruaje edukatore fillimisht brenda vetes, e më pas si përçuese e vlerave të saj tek shtresat e tjera të shoqërisë.

Bota shqiptare e në veçanti ajo femërore, analizohet kryesisht nga mendimi letrar dhe përmes faktorëve letrarë. Një pikënisje e tillë vjen nga krijimtaria e shkrimtarit Haki Stërmilli, me romanin, *“Sikur të isha djalë”*. Vet drama e vajzës për të guxuar përmes dashurisë, tregon më së miri se emancipimi gruas, vajzës shqiptare, do të kalonte përmes *“ëndrrës”* dhe *“kantierit”* të letërsisë. Duket se kjo shkencë e së bukurës si koncept, por në realitet me vlera përmbajtore, do të jetë *“dalja”* e parë reale e gruas drejt të kuptuarit të vetes. Nga një analizë shoqërore e letërsisë duhet thënë se, nëse shtypi ishte elitë për elitë të vetvetes, ai shprehte dhe një qëllim të shpejtuar në raport me prapambetjen shoqërore. Kështu, letërsia e viteve '30-të ishte një goditje përballë ngrehinës shoqërore, e cila duhet të godiste kundër faktit që kjo ngrehinë fshihte në përbërjen e saj ndërtuese kolona mbajtëse me përmbajtje orientale.

Do të duhej kohë, që Shqipëria të ecte drejt të drejtave politike e civile të grave. *“Barazia në të drejtën e votës midis burrave dhe grave në Shqipëri, u realizua për herë të parë në vitin 1946”*.

Paragjykimi i femrës del në pah me një paraqitje të qartë. Femrat ishin të pakta në jetën publike, arsimore e kulturore, siç renditen në historinë e qarqeve mësueset e para, më pas shkrimoret, studentet e rralla, për të mbërritur tek femra që i mungonte në krah elitës mashkullore shqiptare! Kështu, për një arësye madhore vet raporti letrar i krijuar nga autorët shqiptarë jepte një natyrë komplekse. Letërsia kërkonte të plotësohej me jetën reale. Në pamundësi të saj, ajo krijoi autorin, *“Unin”* e tij vetmitar.

Këta autorë, të lexuar me të gjitha prirjet bashkëkohore nga filozofia, pasikanaliza frejddjane, karakteri emancipues i femrës si personazh në letërsinë evropiane, u detyruan të zgjidhnin; ose të ishin imitatorë, por do ta ndëshkonin veten me termin *“Vdekja e lexuesit”*, ose brenda kësaj kulture kaq shpërthyes, do hulumtonin ndjesitë e kohës për të zgjuar femrën shqiptare. Reformatorët e situatës së rëndë gjinore e sociale, do të ishin të pakët. Mes tyre u dallua treshja

“mistike”, Lasgushi si pasardhës naimian, Koliqi dhe Migjeni. Diçka më “tutje” do të ishte Kuteli me veprën tabu në raport inçesti, “Vdekja e Xheladin beut”.

Në artin e Rilindjes në perceptimin ndaj femrës në raportin erotik, dallon Sabri Hamiti:

“Te “Bukurija” e Naimit, ndeshim një rebelim finok, që rri mes mitizimit të atdheut dhe atij të heroit kombëtar. Pra, brenda vetë temës së dashurisë, përgjithësohet, duke “humbur” personalja. Kështu nisnin të ndërtohen të gjitha diskurset në raport Unë / Ti, dhe ç’është më e rëndësishme, këngën e dashurisë e kthen në shpërthim të erotikës. Subjekti i falet tërësisht ekstazës së vet deri në vetëshkatërrim, vetëflim”. [Hamiti, Sabri, 2010:232 - 233].

Ndërsa “princi” i poezisë Lasgushi jep një shkrirje moderne të panteizmit naimian, me atë të një lirie në përjetësi. Në raport grua shqiptare - art kemi një hon, ku personalja jo pa arsye fshihet qëllimthi. Poetëve u mbetet arti për të perceptuar jetën shqiptare, siç takuan “mikesha” jo pak gjatë studimeve të tyre në Evropë. Të mbërritur këtu, ata duhet të guxonin, duke zhveshur “traditën” nga e kaluara dhe duke i kërkuar femrës tani në arsimim, të kërkonte me dinjitet liritë njerëzore që i takonin. Pra ishte letërsia, e cila u investua për t’ia dhënë në mënyrë fillestare këtë fitore shoqërore grave dhe vajzave shqiptare.

Në nisje të ndryshimit dhe avantazhit të artit, i cili përmes figurës artistike mundi të kurorëzojë mbretërimin real të gruas shqiptare në hapësirën e përpunimit të mendimeve dhe ideve të reja, të cilat shkencat shoqërore ia dhurojnë ende ekzistencializmit të pa eksploruar të njeriut modern, këtu dallon Migjeni. Ai e trajtoi realitetin e shoqërisë shqiptare, sidomos në zonat veriore të Shqipërisë, në gjithë origjinalitetin dhe thellësinë e veprës së tij. Adresoi gjerësisht dhe qartë problemet e shumta shoqërore, duke filluar nga varfëria ekonomike deri tek problemi i gruas, gjendja e saj shoqërore, duke u dalluar në antikonformizmin e tij. Mendimi letrar dhe estetik i Migjenit gërshetohet me mendimin e tij sociologjik dhe shoqëror, duke e bërë atë një ndër mendimtarët shoqëror më të njohur dhe më të përparuar të viteve ’30-të.

Problemi i gruas dhe pozita e saj në shoqërinë shqiptare, do të trajtohen në novelat e tij, “Studenti në shtëpi”. Në këtë vepër, Migjeni do të trajtonte shumë hapur problemin e martesës së

vajzës shqiptare me një burrë të moshuar. Edhe pse vet ishte pjesë e një familje borgjeze, përsëri zakonet konservatore ishin shumë të forta në shoqëri. Pavarësisht dëshirës së vëllait për të ndryshuar situatën, ai bie pre e ndikimit të shoqërisë. Martesa, si institucion më vete trajtohet në shumë pjesë të veprës.

“...E si mos t’i vijë turp. Thonë se varzat pa ndere janë pa turp. Prandaj duhet turpi, turpi që s’të len me ngritë zanin në mbrojtjen e vetvetes prej atyne, prej atyne që të dëshrojnë shumë lumturi. Nuk e due! Jo, deri tash nuk asht ndegjue në farefisnin tonë ajo fjalë nga një vajzë e fejueme. Se secili burrë, çfarëdo qoftë, s’paku mashkull asht. E me ba mos me qenë mashkull”? [Migjeni, Nikolla, Gjergj, Millosh, 1989:289].

Tregimi *“Bukën e përditshme falna sot”*, rikujton shprehjen e Dostojevskit se: *“varfëria është nder, skamja fëlliqësi”*. Kur burri kthehet në rrugicë dhe sheh një zotëri të dalë nga dera e tij, do t’i duhet të përballët me tri dilema; a mundet të jetë njëkohësisht burrë, bashkëshort dhe baba? Ashtu si vetë nëna e Lulit, e cila do mbetet nënë. Ky ishte realiteti dhe gjendja e kohës. Në të gjithë këtë perceptim mbi fatin e femrës shqiptare, a mund të themi se çfarë kanë përfaqësuar vitet ’30-të në kontekstin historik, ku roli gruas ka qenë jo *“letrar”*, por vetëm një *“art”* riprodhues i realitetit shoqëror dhe letërsia një sociologji alternative? Realizmi migjenian dhuroi identitetin e femrës shqiptare të plotësuar si ekzistencë jo *“kombëtare”*, por klasore e sociale.

Letërsia dhe studimet shqiptare, sidomos ato letrare e sociale, vendosën në qendër femrën. Mund t’i drejtohem gjithçkaje, por vëmendja përqëndrohet te fati i saj. Kështu, Migjeni i drejtohet murgeshës. Nëpërmjet këtij rasti migjenian, mundemi të shkojmë më afër psikologjinë shqiptare dhe të kuptojmë se si ishte jeta e gruas. Cili ishte raporti i saj me ndikimet evropiane, kur mungesa e arsimit i kishte ngujuar? Cili ishte raporti i grave dhe vajzave shqiptare me besimin dogmatik që mbizotëronte në shoqëri, me prapambetjen deri në shit - blerje të fatit? Migjeni këtë gjendje e paralajmëroi, duke e afruar me fatin e tij. Një fat, ku pyetjet mbi jetën kishin një përgjigje; e vjetra duhet shembur!

Kështu shkruan Migjeni: *“Unë dhe ti murgeshë dy skaje të një litari; / të cilin dy tabore ia ngrehin njëri - tjetrit. / Lufta asht e ashpër dhe kushedi ku do dali, / e pranadaj ngrehet litari dhe përplasen njerëzit”*. [Uçi, Alfred, 2013:242].

A mund të themi se, kjo qenie femërore shqiptare e krahinarizuar, diku më ndryshe se gjetkë, përjashtoi zonën e juglindjes si Korça, veriun brenda Shkodrës, bën të kuptojmë se murgesha është kudo ku gjendet prania e gruas shqiptare? Madje, ai e fton në një përballje, duke pranuar dhe humbjen. Duke iu referuar studimit shkencor gjithëpërfshirës të Alfred Uçit, jo vetëm për Migjenin, por tërësinë e letërsisë shqiptare të stilit migjenian, reagimi ndaj shoqërisë së padrejtë shkon deri në revoltë.

Duke e vështruar logjikisht brenda nevojave të qenësisë grua, mund të arrijmë në përfundimin se,

“nëse murgesha i “zhvishet” Zotit, pra nudon ndjenjat para Tij, ndërsa një tjetër prostituon me trupin, nëse do t’i bashkojmë të dy pamjet, ato në thelb mbeten pjellë e keqtrajtimit fizik, shpirtëror dhe përbuzës. Murgesha “prostituon” shpirtërisht dhe pse ruan trupin, gruaja e përdalë dhuron trupin për tragjizmin e saj social. Nga ana tjetër, kjo grua e ruan ndjenjën”. [Uçi, Alfred, 2013:242].

Në shoqëri ndodh ndeshja shpirtërore tronditëse, e pashoqe. Murgesha sipas Migjenit, çon në dashni me shenjtët. Nga ana tjetër poeti lutet për drejtësi sociale: *“Mos u lut për mue / se pash më pash due t’i bij ferrit”*. Në kushtet e tragjizmit të jetës, njeriu shqiptar e kërkonte këtë drejtësi shoqërore. Trajtimi në kohë është bindës, real dhe pa luhajtje intelektuale e artistike. Realizmi migjenian është si një *“uragan”*, ku e drejta e jetës ende zvarritet herë mbi dhe, e herë askund. Nga ky dialog poet - murgeshë, kuptojmë shumë më tepër se një statistikë sociologjike apo e dhënë historike. Femra shqiptare ishte e paplotësuar. Kjo e bënte atë të ndjehej e fyer nga prapambetja që e reflektonte statusi i saj shoqëror, politik dhe arsimor. [Uçi, Alfred, 2013:104]. Migjeni e mori femrën nga zona e *“heshtjes”* dhe e përcolli në realitete të ndaluara. Kjo ishte një përgjigje dhe reagim ndaj pozitës së saj sociale në botën shqiptare të viteve ‘30-të.

Zhvillimi i gruas në shoqëri nis nga vetëdija e saj seksuale. Ky është një koncept studimor sociologjik, të cilin poeti e jep nëpërmjet trajtimit letrar të faktit. Migjeni nuk ishte i pari që

adresonte këto tema. Ai veçohet nga të tjerët për “*instikte të zhveshura*”, jo të fshehura. Veprat teorike që kishin tendenca të studimeve shkencore në dallimin thelbësor midis trajtimit biologjik [të Koliqit] dhe instikteve në përgjithësi, marrëdhënieve dhe trajtimit estetik të temës prej artit dhe letërsisë, filluan të bëhen gjithnjë e më të njohura. Këto raporte intime kanë qenë në një kuptim, vet thelbi i zhvillimit historik dhe shoqëror shqiptar.

Mes Migjenit kritik dhe Migjenit mendimtar e shoqëror, ka një dallim në mënyrën e konceptimit dhe të shprehjes në artin e tij letrar. Ai jep “*zonat e heshtjes*” në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, herë të pathëna e herë të mos përmendura kurrë. Të gjitha këto imazhe të mjegullta, ndihmojnë të kuptohet qartë vet fati i femrës në një kohë të vështirë. Mbyllja e saj ishte kaq dramatike, sa cilido autor përveç Migjenit, do të kërkonte ndryshimin e femrës përmes një romantizmi kombëtar.

Duke iu referuar përgatitjes kulturore të letrarëve, në kohën kur Evropa kishte larmi shkollash letrare, krijimtaria e tyre përgjithësisht nuk i përgjigjej nevojave më ekzistenciale, përjashto rastin e poetit Migjeni. Të tjerë e kanë parë rolin e gruas në letërsi vetëm si pohim se, ajo duhet të ketë vendin e saj, kryesisht si produkt dhe më pak si faktor i zhvillimit.

Europa, pas simbolizmit të viteve ‘20-të të shekullit XX-të, përjetoi pothuajse të gjitha shkollat letrare, përfshirë prirjet e reja të shkencave të psikanalizës. Ndërsa me aplikimin e të drejtës së votës për femrën, do të fillonte të ndihej roli i saj kudo. Mendimi letraro - sociologjik shfaq hapur kërkesën për të takuar gruan ideale, jo nga pamja, por nga plotësia e saj kulturore.

Do mjaftonte ky fakt nga realiteti viteve ’30-të, për të kuptuar se zhvillimi i vendit përcakton premisat dhe mundësinë e një barazie gjinore. Por kur një burrë nuk gjen punë, kur gruaja nuk ka asnjë lloj profesioni, në kushtet kur patriarkalizmi ka bërë aleancë me prapambetjen dhe frenimin e ndryshimit, atëherë “*Kanuni*” modern nuk është asgjë më shumë, por mbetet një mallkim urban.

Te proza e Koliqit, “*Hanë gjaku*” [Koliqi, Ernest, 2009:14,27], kemi një ngutje të autorit në kërkim të gruas, për të cilën çdo autor do donte ta kishte lexuesen e parë. Kjo prozë, e shfaq Koliqin të drejtpërdrejtë përballë kohës. Vajza e kësaj fabule sapo është “*kurorëzuar*” me dije e arsimim, si një qenie sociale, e cila pasi kapërcen të gjitha tabutë, është në pritje të kësaj “*Hëne...*”. Ajo është e arsimuar dhe ky investim e vendos atë një hap para djalit në krah. Koliqi mbërrin në dy përfundime të thelluara shkencore: e para, vajza e arsimuar ka jo vetëm guxim, por dija i ka zbuluar të drejtat e saj femërore; e dyta, djali është ende i traumatizuar nga një masakër e ndodhur rreth viteve 1900.

Metamorfoza e mendimit dhe e veprimit në një kohë dhe periudhë të caktuar, janë pjesë të jetës së përditëshme të shoqërisë njerëzore. Në çastet më të rëndësishme të saj individët dhe shoqëria pësojnë ndryshime cilësore, të cilat me kohën kthehen në tipare dalluese, të denja për t’iu nënshtruar studimeve të mëvonshme. Ajo rrëfen karakterin individual të autorëve të kohës, me tendenca përgjithësuese. Ideatorët letrarë të kohës nuk menduan mbi padobinë e krijimeve të tyre të spikatura, as mbi rrezikshmërinë sociale brenda një kohe të zhytur në paragjykime e errësirë. Arsyetimi logjik i situatës kohore mbi dukuritë e saj në jetën e femrës shqiptare, e trajtuar në mënyrë artistike, i shkonte për shtat gungës patriarkale të jetës shqiptare. Koha kërkonte ndryshimin.

2.2. Ndryshimi i gruas buron nga arsimi: shkollimi si ngushtues i pabarazisë gjinore.

Gjatë viteve '30-të ishte krijuar një gjendje shoqërore, shpirtërore e morale, ku atdheu dhe atdhedashuria shihej si ndjesi mbi ndjesitë. Nga ky këndvështrim kuptojmë se, ndryshimi i gruas ishte konceptuar së pari, nga arsimimi. Arsimimi të çon tek puna. Puna të jep të drejtat. Të drejtat të lejojnë zgjedhjet. Arsimimi i vajzës tek Koliqi, ka ardhur si akt heroik i krijuar nga djali, etërit

e tij. Ndjaj ai moralisht po merr jo një ndjesi, por barazinë gjinore. Por të dy të “dashuruarit” përballë kësaj “njolle gjaku”, vijnë në drejtimin e kundërt.

Bazuar mbi realitetin intelektual të kohës, Jorgaqi ka dhënë një shembëllim të gruas, e cila kishte nisur të krijonte profilin e vet mbi vlerat e përfutuara nga dija:

“...vetëm nga fundi i Rilindjes u dukën emrat e dy intelektualeve të para në jetën shqiptare. Këto janë motrat Qiriaz, Sevasti dhe Parashqevi, që ngritën shkollat shqipe, hartuan tekste shkollore, nxorën revistën “Ylli mëngjesit” në SHBA. Prej tyre do kemi vargjet e para, siç qe himni i Kongresit të Manastirit...Ishin këto sprova premtuese, shkrime me nota didaktike e frymë patriotike, që i shërbyen shkollës shqipe në hapat e para. Siç do jetë dhe nisja e shkrimeve të vargjeve të para...Të thjeshta si krijime. Nga ana tjetër, kjo punë do ndjehet në qytete me zhvillim ekonomik, si Korça, Shkodra, Elbasani, Gjirokastra, Vlora. Por kjo veprimtari bëhej në fshehtësi, jo vetëm nga fanatizmi e analfabetizmi, por mbi të gjitha nga prapambetja sociale. [Jorgaqi, Nasho, 2015: w.w.w.tiranaobserver].

Përse kjo fshehtësi, kjo heshtje e femrës për të shkruar? Nga kush do paragjykohej e ndëshkohej? Të ngujuar deri përtej “vdekjes” me rite jete të një pabarazie hakmarrëse, puna e tyre fillonte dhe mbaronte pa mbërritur në statusin e këtyre grave të denja, për të qenë pjesë e trupës dhe institucioneve ligjvënëse, arsimore, kulturore etj.

“...Gruaja shqiptare, thekson Jorgaqi, e njohur dhe çmuar botërisht për pamjen, botën shpirtërore, karakterin e veçantë s’kishte si të mos krijonte vargje, dedikuar moshës së dashurisë, të këndonte këngë djepi si nënë, të vajtonte me ligje, të rrëfente përralla si gjyshe. Një realitet i mbyllur në vetëvetë...Ndërsa realiteti shqiptar, nga vetë mungesa e zhvillimit, nuk tregonte interes për botën kreative të femrës shqiptare, sidomos për letërsinë. [Jorgaqi, Nasho, 2015: w.w.w.tiranaobserver].

Ky arsyetim logjik shpjegon “mënjanimin” e autorëve burra për të ndërtuar në letërsi rolin e femrës. Jo të femrës si qenie jetësore, por të figurës së gruas shqiptare në përgjithësi.

“E dhënë me trajta të idealizuara, bukurie, trimërie, pastërtie morale, qëndrese, themel i përtëritjes së jetës familjare dhe të Kombit (Mëmëdheut), përmendim se, qysh në folklorin tonë të lashtë mesjetar, femra shqiptare trajtohej si qenie hyjnore, e shenjtë, e idealizuar, dhe e përkryer estetikisht. Në folklore, spikat adhurimi i bukurisë fizike, ashtu dhe i virtyteve morale. E Bukura e dhët, Tanusha, Motra, Zana, Rozafa. Edhe në letërsinë e lashtë të kultivuar me tematikë fetare, ka patur figura të bukura femrash të shenjtëruara si, Sibilat, vajet e Shën Mërisë, etj, por dhe figura të shekullarizuara e emancipuara si, Zelihaja, Erveheja etj, ose Vojsava, Donika, që u aktivizuan e u ripërtërinë dhe në letërsinë shqipe, deri në vitet ’30-të. Po kështu, në fillimet e letërsisë romantike, janë krijuar sërish figura të bukura mbresëlënëse femrash si, Rina, Mara, Bardha e Temalit, Afërdita, Zoga etj. Në periudhën e Pamvarsisë zuri vend figura e femrës në poezi dhe në prozë. Spikasin për bukurinë magjepëse Vashat Lasgushiane, por dhe femrat në kushtet e një pabarazie sociale midis burrit dhe gruas në romanet, “Sikur të isha djalë” të H. Stërmillit, “Pse” të S. Spasses etj. Por Migjeni futi në temën e femrës ide dhe tema të reja”. [Uçi, Alfred, 2013:356].

Adresimi i problematikave shoqërore me qendër gruan, duket sikur prodhonte një art për artin e munguar. Konfliktet letrare si prototip i konflikteve shoqërore, e kanë projektuar gruan shqiptare në mënyrë romantike, si për nga ndjesitë ashtu dhe nga karakteri. Ky është një romantizëm patriotik. Koliqi, Spasse, Stërmilli, Bulka, Lasgushi etj, përjashtoj Migjenin, do ta trajtonin gruan si një shenjtërim të karakterit, por nuk e “ftojnë atë në mëkate lirie”.

Vitet '30-të i krijuan mendimit letrar dhe në tërësi mendimit shoqëror, mundësinë të shprehur. Prirja progresiste e kohës dhe pikëpamjet demokratike, lindën nevojën e brendëshme për të shprehur publikisht mendimin shoqëror dhe letrar.

“Kështu në faqet e gazetës “Populli”, dt. 28. 11. 1935, u botua poezia, “Vala gënjeshtare”, që nënshkruhej jo me emër të vërtetë, por me pseudonimin Kolombja. Publikimi kësaj vjershe femërore, u kthye në ngjarje. Jo vetëm u pëlqye, por ngjalli habi dhe skepticizëm. Nuk besohej të ishte shkruar nga ndonjë vajzë. Por ishin intelektualët që e morën në mbrojtje. Njëri nga poetët, Gjergj Bubani, e quan “lule e vetme, që sjell pranverë në shtypin tonë” dhe bën thirrjen: “Dil në shesh moj motër”. Ndërsa studiuesi, gazetari Fiqiri Llagami, do t’i drejtohej opinionit: “Kjo vajzë është flamurtarja e evolucionit tonë, që me punën e vet don me rrëxue një shkamb, që ka tabelën e veseve të këqija shqiptare”.
[Jorgaqi, Nasho, 2015: w.w.w.tiranaobserver].

Lëvizja feministe në vitet '30-të të shekullit të XX-të, lindi vetëm nga një mundësi: arsimimin. Kjo ishte rruga e vetme, që shpjegonte pafuqinë trashëgimore të shoqërisë shqiptare të kohës. Gruaja nuk gëzonte të drejtën e shkollimit, por frenimi i kësaj të drejte ishte i qëllimtë. Kundër këtij presioni social, mjaft prej tyre u arsimuan. Ishte origjina familjare që ua mundësoi shkollimin. Të kthyer në atdhe nga vendet e huaja, ato kuptuan rolin e letërsisë dhe të mendimit letrar në ndryshimet sociale, si përfaqësuese të denja të emancipimit të jetës shoqërore, kundërshtare ndaj pengesave dhe imponimeve kanunore, sidomos mbi jetën, martesën dhe familjen.

Trishtimi, melankolia, sentimentalizmi ishin ndjesitë kryesore, të krijuara nga mendimi dhe produktet letrare dhe artistike të kohës. Krijuesit e letërsisë, mendimtarët letrarë dhe publicistët po e ribënin atdheun. Por lufta për liri nuk ishte e veçantë nga prirja drejt përparimit shoqëror, jo vetëm drejt atij patriotik.

Kolomba, pas së cilës fshihej një vajzë 17 vjeçare nga Gjirokastra me emrin Selfixhe Ciu, do të krijonte një varg vjershash e skicash letrare, të cilat publiku do t'i lexonte në organet e kohës, si “Shtypi”, “Java”, “Diana”, “Drita”, “Bota e Re” etj. Kolomba u bë zëdhënësja e gruas shqiptare, shprehëse e të drejtave dhe e revoltës, përcjellësja e ëndrrave të saj. Pas këtij portreti femëror, kuptojmë jo vetëm angazhimin civil dhe shoqëror, por kuptimin e kërkesave ndaj jetës. Lëvizja feministe e kohës u konceptua e lidhur me lëvizjen për ndryshim politik dhe shoqëror, e orientuar drejt lëvizjeve që ngrenë dhe përmbysin pushtete. Volteri ka shkruar:

“Ideja e drejtësisë më duket një e drejtë e kategorisë së parë, kur gjysma e njerëzimit përfaqësohet nga gruaja”. Për të mbërritur brenda shekullit të XX-të ku, “...vota e grave në Francë, dukej se kishin paraqitur kërkesa të forta dhe kishin formuar shoqëritë e tyre drejtuar Shteteve të Përgjithshme”. [Xoxi, Koli, 1991:165].

Dorette Wesemann, autore e kësaj periudhe, shkruan mbi lëvizjen feministe në Evropë, e cila filloi në vitin 1848 dhe kulmoi me fillimin e Luftës së Parë Botërore, më 1914. Kjo lëvizje kishte doktrinën e vet ideologjike. Marrëdhëniet e reja industriale nuk kërkonin vetëm fuqi punëtore.

“Kur u kristalizua lëvizja e grave në shek e XIX-të, feministet e para përpiqeshin të arrinin përmirësime në fushën e të drejtave qytetare [e drejta e divorcit, për kujdestarinë e fëmijës, heqjen e tutelës së burrit në martesë etj]. E drejta e votës fillimisht, ishte e një rëndësie e dorës së dytë në kërkesat e tyre. Por shpejt, do t'i prisnin përvoja të hidhura. Pa të drejta, pa zë në sferën politike, ato vareshin nga burrat, ndërkohë që partitë apo organizatat e vjetra, i mbështesnin gratë, për aq kohë sa kjo ishte në interesin e tyre. Nëse qëllimet përmbusheshin, gratë mbeteshin vetëm. Si rrjedhim, vëmendja e tyre u përqëndrua në sigurimin e votës. Ithtare të grave u organizuan në organizata të veçanta, autonome, ose pjesërisht. Gratë e dala në publik mund të ndahen në tri grupe. “Të maturat”. Kërkonin ndryshime hap pas hapi. Brenda kuadrit të shoqërisë qytetare. Theksonin se ishin ndryshe nga burrat, pra kishin detyra të tjera nga burrat. Në këto grupe bën pjesë shoqata të krishtera bamirëse, të cilat kujdeseshin për gratë e varfëra, por dhe shumë shoqata liberale për emancipimin e grave dhe gra konservatore. Shumë prej tyre u bënë me nisjen e LIB militante në mbrojtjen e atdheut”. [Wesemann, Dorette, 1848-1914:[http:// www.dadalos](http://www.dadalos)].

Fundi i shekullit të XIX-të dhe fillimi i shekullit të XX-të, ofruan shumë zgjedhje. Në këtë periudhë u krijua realisht koncepti mbi kuptimin e pranisë së gruas në një botë të ndryshme dhe që po ndryshonte. Këto jehona mbërritën edhe në Shqipëri. “Radikalet”, si shoqata grash me prejardhje borgjeze, kuptonin dhe shkonin përtej pasurisë, duke insistuar për barazinë gjinore në të drejtën e votës. Kodet civile mbi familjen, pasqyronin dhe tentonin të zgjidhnin konfliktet mbi trashëgiminë. Gratë e përfshira në këto lëvizje ishin të pasura, por nuk zotëronin statusin e duhur

social dhe klasor. Disa prej tyre u përpoqën të lidheshin me gra socialiste, për të siguruar *një liri aktiviste*, si instrument *për të ndryshuar mentalitetet shoqërore dhe politike*.

Një grup tjetër përbëhej nga gratë socialiste.

“Ishin gra të organizuara në mënyrë relativisht autonome, brenda lëvizjes socialiste dhe më vonë ato komuniste. Bazë për kërkesat e tyre, janë ndryshimi i ligjëshmërive që krijojnë ndarjen e pasurisë sipas klasave. Njëra nga ideatorët e kësaj lëvizje ka qenë Klara Cetkin. Ato kërkuan hierarkinë e gjinive në mënyrë të ngjajshme me shpërbërjen e klasave. Në qendër të kërkesave të tyre, është krijimi i barazisë ekonomike mes punëtoreve femra dhe atyre meshkuj [e njejta gjë për secilën punë, krijimi i sindikatave të grave.]. Festimi i ditës ndërkombëtare më 8 mars, vjen nga gratë socialiste”. Një mbledhje e grave të majta europiane bën thirrje: “Në përputhje me organizatat politike dhe sindikaliste të klasës së proletariatit në vendin e tyre, gratë socialiste do organizojnë çdo vit një ditë të grave, e cila i shërben në radhë të parë agjitacionit për të drejtën e votes. [Wesemann, Dorette, 1848-1914: <http://www.dadalos.>].

Përmasa e pjesëmarrjes shoqërore dhe politike të grave në Europë, ndikoi në gjallërimin e feminizmit shqiptar. Pesë publiciste shqiptare të viteve 1930 - 1940: Ollga Pëllumbi, Musine Kokalari, Selfixhe Ciu, Mila Prela dhe Afërdita, shkruan fillimisht nën pseudonime në shtypin e kohës, duke *“trazuar”* qetësinë e burrave. Femra që zgjodhën të shkruanin me pseudonime, për të fshehur drojtjen ndaj paragjykimëve maskiliste të shoqërisë. [Gazeta “Shqip”, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>].

Në aspektin studimor shkencor, do të ishte e diskutueshme, nëse do të mund të bënim në kohë dhe hapësirë një qasje krahasuese të aktivitetit të feministeve shqiptare me lëvizjen feministe europiane. Në fakt, jemi ende larg besueshmërisë mbi aftësitë e femrës shqiptare, si një forcë e ndryshimit shoqëror. Përveç kësaj, arsimimi i tyre ishte një ëndërr për të ndryshuar veten. Ndaj është shpejt të artikulohen mendime politike të kristalizuara, doktrina dhe ide filozofike e politike mbi këtë çështje.

Vizioni i përbashkët i grave intelektuale shqiptare, ishte heqja e *“perçes”* së prapambetjes historike, kulturore, arsimore. Ato u përfshinë brenda ideve të ndryshimit shoqëror nëpërmjet mendimeve dhe prirjeve qytetëruese. Por me kalimin e kohës, pjesëmarrja e tyre në ndryshimet shoqërore dhe politike do t’i qartësonin dhe orientonin ato drejt nevojës së domosdoshme të

emancipimit rrënjësor shoqëror dhe politik të shoqërisë shqiptare. Lufta e tyre për emancipim mori në fillim trajtat e antifashizmit dhe paralel me të, ndërtimi i Botës së Re, që u identifikua me socializmin. “... Me pikëpamje përparimtare për kohën, në shkrimet e tyre ato ishin liberale aq sa kërkonin me ngulm barazinë mes burrit dhe gruas”. [Siliqi, Drita, 2003:36]. Kështu, Drita Siliqi, një tjetër publiciste e njohur për letërsinë, i ka kushtuar një studim femrës shqiptare mes periudhës së Rilindjes dhe të Pavarësisë, duke u ndalur në pesë femrat që u përmendën më lartë, të cilat kanë krijuar një trashëgimi të çmuar në publicistikë, duke artikuluar publikisht idetë e tyre për lirinë e femrës. Këto ide nuk ndryshonin shumë nga ato që Vixhinia Vulf shkruante në Londrën e shek të XIX-të. [Gazeta “Shqip”, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>].

Paragjykimi, ishte një nga dënimet pa ndëshkime fizike që i bëhej femrës. Faik Konica shpjegon në esenë studimore, “*Shqipëria, kopështi shkëmbor i Evropës Juglindore*”:

“Pak gjë mund të thuhet për jetën seksuale të shqiptarëve në një libër të caktuar për lexuesin e gjërë. Disa vese nuk janë të panjohura në qytetet, ndonëse ardhja e tyre mund të gjurmohet lehtë nga ndikimet e huaja, por zor se mund të gjendet ndonjë popull më i urtë në fshatrat shqiptare. Pafajësinë e tyre mund ta tregojë një zakon i bukur, kur bëhej një martesë, zakon që ende nuk është zhdukur. Një martesë bëhej, kur dy të rinjtë s’i kishin mbushur të njëzetat. Një anëtar i familjes së djalit, burrë gati në të moshuar, duhej t’i shpjegonte djalit dhëndër, pra burrit të martuar, anën fizike të martesës; ndërsa një femër e farefisit me një copë gëlqere, qymyr ose diçka tjetër që shërben për të shkruar, do të vizatonte një rreth të vogël për qark ”depilata virginis pudenda, ut invenis inexpers intratum facilius inveniat” [“Organet gjenitale të vajzës së turpshme, mund të jetë më e lehtë për ta gjetur të përdorur”.]. Kjo thjeshtësi baritore e një kohe të vjetër, shpjegon dhe tregon shkallën e urtësisë të shëndetit moral, që i ka bërë shqiptarët ndër shekuj të jenë bartës të fuqisë dhe shëndetit. [Konica, Faik, 1993:108].

Pra, jeta shqiptare, sidomos jeta në fshat, ngrihej mbi “*virgjërinë*” totale. Konceptit të sensualitetit i visheshin më shumë ndjesitë shpirtërore, të cilat lidhen me një botë të fshehtë, të pazbuluar. Një jetë thellësisht autoktone, me prirje drejt një sensualiteti moralizues. Dhe një riprodhimi “*natyral*”, pa e lejuar individin të shprehej haptas, duke e trajtuar dashurinë brenda një bukurie ku hyjnorja merr trajta deri abstrakte. Duke u thelluar më tej në kuptimin e fatit të gruas gjatë dekadës së Mbretërisë Shqiptare, njeri prej autorëve i drejtohet me një poezi fshehjes pas pseudonimit të autores të vetëquajtur, Kolombisë:

“O ti, që të kërkuem e s’të gjetëm / dhe s’dimë në je burrë, ose kokonë...”. Shkruan ai në strofën parë të vjershës botuar në gazetën “Drita”, në janar të vitit 1937 kushtuar Kolombisë. [Bardhyli, Alda, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>].

Dalja e firmave të grave në shtypin e kohës, ishte dukuri jo e zakonshme për shoqërinë shqiptare. Në po këtë gazetën të datës 16 korrik 1937, i bëhet jehonë një libri të botuar në Amerikë nga vajza shqiptare, Nexhmije Zajmi. Është një biografi e letrarizuar me titullin, *“Bija e shqipes”*. Shkrimi shoqërohet me shënim të redaksisë: *“Jemi të sigurt se, Nexhmija Zaimi nuk është veçse fantazi e gazetarit amerikan, i cili duket se në këtë mënyrë do t’i bëjë reklamë ndonjë romance që ka ndërmend ta botojë”*. [Bardhyli ,Alda, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>]

Menjëherë pas kësaj vjen përgënjeshtrimi kolegeve të Nexhmijes, që e vërtetojnë qenien e saj. Në vitet ’30-të u vu re hyrja e vrullshme e të rejave intelektuale shqiptare në fushën e publicistikës, të cilat thyen ndrojtjen dhe të përgatitura për të përballuar opinionin, shprehën mendimet e tyre për probleme të ndryshme shoqërore. Shtypit amerikan u tregua skeptik në përshtypjet e tij mbi rajonin dhe shqiptarët. Dyshimi mbi autorësinë e shkrimeve të grave të shquara të kohës, nuk ishte risi mediatike. Ndërsa perceptimi i realitetit ishte ende një vend ku sundimi otoman e kishte lënë orientin e vet më të largët, pra në zinë e vet, pothuajse me *“mbuluesë”* si perçja islame. Ishin vite kur jeta gjallonte jo si Rilindje, as si romantizëm, as si iluminizëm vetëflijes, por ishte dekada që vepronte mbi atdheun në prapambetje, varfëri dhe uri të gjithanëshme.

Nëse publicistet e para kontribuan shumë në lëmin letrar dhe shoqëror, realizmi migjenian shpjegoi filozofinë ekzistencialise të Sartrit. Midis Qenies dhe Thelbit, ky realizëm ka trajtuar thelbin e Qenies, njeriun. Jo atë frojdist por njeriun tonë, gruan, vajzërinë etj. Letërsia migjeniane pasqyroj jo vetëm fatin e gruas, por u drejtua te e palëvizshmja dhe e prapambetura. E reja e shihte të vjetrën nën një ironi revoltuese. Me këtë e reja pranoi fajin ndaj vetes, jo si

shkaktare por më së shumti si vonesë, ku dëshmia e “*mollës së ndalueme*” nxiti një krim ose vet krimin. Ky personazh real, i njësuar me vitet ’30-të, ishte simbolika e një dekade, ku varfëria e kudondodhur kishte lënë të “*papunë*” vet çdo përpjekje përparimtare.

Përparësia dhe origjinaliteti i Migjenit ishin paraqitja e jetës tërësore shqiptare, të problemeve të shtresave të ndryshme të shoqërisë. Kjo arritje e afroi Migjenin me letërsinë bashkëkohore europiane dhe me epërsinë e realizmit ekzistencial. Për t’iu rikthyer sërish rolit të grave, do shohim konkretisht se çfarë e preokuponte një intelektuale, aktiviste dhe se si kjo lëvizje filloi si prirje për të ndryshuar së pari, “*një femër ndryshe*” nga të tjerat.

“Vetë titujt e vjershave dhe skicave të saj, pra të Selfixhe Ciut, flasin për tematikën e mprehtë sociale që trajton, si “Shqetësim”, “Shpresa e zhdukur”, “Vajzëria”, “Mërgimtari”, “Ditë pazari”, “Vetmitari”, “Gabimi i të riut” etj. Në faqet e revistës “Bota e re”, ajo do shpallë me guxim kushtin që gruaja shqiptare i vë shoqërisë me fjalët: “Asgjë nga femra mos prisni, pa i falur lirinë e saj të plotë.”
[Jorgaqi, Nasho, 2015: www.tiranaobserver.com].

Ndryshimi i gruas në këtë periudhë buroi nga mundësia e arsimimit dhe shkollimit jashtë vendit, që çuan në ngushtimin e pabarazisë gjinore, duke pasur protagonistet e veta. Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet që, kalimi i mendimit në një realitet të ri prej gjeneratës së grave të arsimuara, për kohën ishte i dobishëm. Vlefshmëria e mendjes njerëzore u paraqit si produkt drejt mendimit të përsosur, e vënë përballë realitetit në ndryshim dhe ekzistencës së genësishme përballë dilemave të kohës, sprovave të gjinisë femërore dhe ndikimit të ashpër të padrejtësive sociale ndaj tyre. Paraqitjet e tyre të thjeshta në opinionin shqiptar, pak e nga pak do të çonin në qëndrime më të ndërlikuara, të cilat do të ndryshonin një realitet patriakal dhe vet thelbin e shoqërisë shqiptare.

2.3. Vështirësitë e emancipimit real të grave dhe vajzave në kontekstin e viteve '30-të.

Për kategorinë e brezit në demokraci, habia shmanget lehtësisht prej iluzioneve apo deformimeve të kohës, përballë opinioneve emocionale që ofrojnë metodologjia shkencore e studimit dhe logjika dialektike e prurjeve të saj, jashtë ndikimeve me ikona ideopolitike. Dija e kohës përpiqet të injorojë me finesë traditën mendjendritur të eposit filozofik të shprehur në vargje letrare, duke marrë prej tyre esencën sociale të ndikimeve të kohës.

Shtypi i shkruar i ditëve tona, me kujdesin për revokimin e këtyre proceseve me qasje historike të veçanta, po fiton tiparet e “arkivit publik”, ku historia tregohet jo si rrëfenjë, por si mbivendosje analitike reale, pa tjetërsuar identitetin e të kaluarës. Ky shembëllim në formën e dashurisë prej “narcizeje”, rrëfhet në profilin e saj intelektual dhe njerëzor të vajzës gjirokastrite, si një përpjekje për të kuptuar veten.

“Në vitin 1937, vajza me sytë e thellë të zi, dhe flokët e derdhur nën qafë, shëtiste në Firence. Njohja me letërsinë kishte nisur që gjatë kohës së shkollës së vajzave Urani Rumbos në Gjirokastrë, duke grishur tek ajo dëshirën për të parë përtej. Firenceja e asaj periudhe do t’a shtonte pasionin për shkrimin te vajza që kishte nisur të shkruante që në moshën 17 vjeçare. Duke zgjedhur për vete këtë pseudonim interesant, Kolombia. Poezinë e parë do t’a botonte në revistën “Populli”, më 28 nëntor 1935. Por shkrimet e këtyre femrave nuk ishte diçka e zakonshme në Shqipërinë e atyre viteve, por ngjalli shpresë te letrarët e rinj. Vetë Selfixheja do të shkruante në kujtimet e saj se, “shkruanim tepër të ndrojtura”, duke i quajtur skicat e para gati, “si ditare rrëfimi të vetëvetes”, por që ishin pasqyrë e shpirtit të trazuar. “Kombi ynë ka shumë mungesa, prandaj vajzat intelektuale nuk lypset të rrinë kaq indiferente, por të marrin pjesë në evolucionin e shpejtë të kombit tonë”, shkruan ajo vetë. [Bardhyli, Alda, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>].

Këto referenca historike dhe biografike të bindin mbi vështirësitë e fillimit të emancipimit real. Në nisje publikohen shkrime me pseudonime. Më pas, identifikohet një vërtetësi femërore e deklaruar dhe mbi të gjitha, një arsimim jashtë vendit. Këto gra intelektuale, nuk mund të rrinin moralisht jashtë rrymave të lëvizjeve feministe të Europës. Qasja e tyre kulmon me të gjitha pritjet e një kohe politike dhe gjinore për “regjimet” shoqërore. Në kontekstin europian dhe global, ishte epoka e fashizmit dhe më vonë e socializmit rus. Ndërsa në mjedisin shqiptar, jehonte ende një martesë djepi dhe një e shtënë pushke, jo vetëm në lindje djali. Ishte një

Shqipëri e uritur, e mbështetur mbi një dramë historike nga njëra anë dhe mbi një sistem politik, ku të drejtat identifikoheshin si “*ndodhi*”, të cilat himnizoheshin individualisht.

Lëvizja feministe shihej si devijim nga një grua tradicionale. Shihej si pritëse e parë e një nevojë intelektuale që burrat e mençur e kishin të nevojëshme për një bashkëjetesë gjinore. Kjo nxiti krijimin e një shoqërie të barabartë brenda së drejtës së arsimimit. Prej kësaj buruan të gjitha përjetimet sociale, politike, personale, intime: “*Në revistën “Bota e re”, më 16 shtator 1936, zëri i saj do të ngrihej në mbrojtje të lirisë së femrave, duke e parë atë si një krijesë të shtypur, viktimë e përbuzjes dhe shtypjes superiore të burrit*”.

Duke përfaqësuar të rejtat më të përparuara të kohës, ka besim se me këtë luftë do të fitojnë të drejtat e mohuara “*krah për krahë me djemtë dinamikë*”, për të çliruar një varg të pambaruar të burgosurash, “*që presin lirinë e dëshiruar*”. Mikeshtë e ngushtë me Musine Kokalarin, dy vajzat nuk ndanë mes tyre veç vargjet për dashurinë dhe burrat, por dhe përpjekjet për emancipimin e çlirimin e vendit. Në kujtimet e saj, ajo tregon se sa herë ndaheshin nga njëra - tjetra uleshin dhe shkruanin, për t’i dërguar më pas në gazetën “*Shtypi*”. Jeta e Selfixhesë nuk do të ishte ajo për të cilën kishte kontribuar pas Luftës. Bashkë me familjen, ajo do të internohet, por kjo nuk mundi të shuante shpirtin e ndjerë të gruas që ka të njejtin vështrim përtej, pas viteve 1990. Ajo ulet shkruan kujtimet, që sot janë dëshmi e bukur e një jete jo të zakonshme. Në të gjejmë jo vetëm lëvizjet e feminizmit në Shqipëri, por dhe fillesat e prozës femërore dhe një anë tjetër të LANÇ, përmes njerëzve që e besuan atë.

Pas mbarimit të luftës, fatet e tyre të shtynë drejt një vlerësimi njerëzor. Sot mund të kuptojmë më mirë vlerat e tyre. Persekutimi i skajshëm “*dhuron*” vet portretin e tyre historik. Do mjaftonte shkollimi i tyre në Evropë dhe humanizmi, për të vlerësuar se ato ishin gra internacionaliste, në kuptimin shoqëror dhe njerëzor. Të tilla, ato i bënë bindjet e tyre. Historikisht, ato ishin gra që jetuan brenda një kohe ku përzihehin të gjitha doktrinat. Ajo që i

karakterizonte, ishte butësia feministe. Ky tipar shpjegon sjelljen e tyre, si kundër fashizmit ashtu dhe kundër diktaturës. Kjo e fundit, ishte për to një sistem i ngritur jo mbi ndjesitë dhe shpirtin e lirë. Kështu, gjithçka pas lufte do ishte në sinkron me parashikimet e tyre. E kaluara plot uri për dije, do të zëvendësohej me urinë për liri.

Sipas Ollga Pëllumbit, “Në çdo vend të botës, derisa gruaja nuk ka ngritur zërin kundër padrejtësive që i janë bërë, nuk ka qenë e mundur t’i fitojë kurrë. Pra, më duket se shpëtimin duhet t’a presim vetëm prej vajzës, gjithë vështrimet tona duhet t’i kthejmë nga ato.” [Bardhyli, Alda. 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>]

Shpresa, siç e thërrisnin dhe nëshkruante shkrimet e saj, i shkruante këto rreshta në Shqipërinë e vitit 1937. Vajza nga Përmeti, do të zgjidhte shkrimin si përballje me jetën. Kur Tirana nuk i mjaftoi, udhëtoi nëpër Europë për të mbajtur familjen. Pas kthimit në atdhe, bëhet pjesë e lëvizjes antifashiste dhe zgjidhet Kryetare e Këshillit të Gruas Antifashiste të Tiranës. Në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, u zgjodh deputete në legjislaturën e parë të Kuvendit Popullor. Por më pas do të shkarkohej nga detyra, duke u mënjanuar nga forca politike ku kishte besuar. Sot e vlerësojmë Ollgën përmes shkrimeve.

Në artikullin “*Feminizmi dhe shoqëria*” ajo do të shkruante:

“Nuk do të jemi të denjë të qytetërimit dhe përparimit, por të vazhdojmë të admirojmë tipet e asaj familjeje, ku ekziston Zot dhe skllave, me burrin që ka të drejtë në zhvillim, me gruan që është e destinuar të kufizojë aktivitetin e saj të vetëm në kuzhinë. Familja që mbahet me të tilla lidhje, është shumë larg qëllimit njerëzor për të cilin ajo është krijuar”. [Bardhyli, Alda, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>].

Dhe pse shteti shqiptar kishte kushtetutën, sipas të cilës ndalohej mbajtja e perçeve, dhe pse arsimi fillor ishte i detyruar, edhe pse ligjërisht ndalohej gjakmarrja, këto ishin realitete virtuale. Realiteti shoqëror ishte tjetër. Ollga Pëllumbi dhe gratë shqiptare të shquara të kohës, shikonin këtë realitet dhe shkruanin për të. Dhe realiteti mbizotërohej nga morali patriarkal.

Kur shkruan mbi vlerën e jetës, Migjeni shprehet: “Unë besoj në një fuqi të njeriut, që është Puna, e cila nuk e turpëron kurrë të vërtetën për njeriun”. [Uçi, Alfred, 2013: 327]. Duke iu referuar këtij mendimi, kuptojmë një nga domethëniet ekzistenciale të jetës së shqiptarëve të

kohës, raportin midis njeriut dhe punës. Puna është mjete që ndryshon më së pari kohën jetike. Një jetë e cila jepte pashmangshmërisht një lakuriqësi, ku çdo kopshtije dhe mëhallë, nuk do të përfaqësonin të paktën në mënyrë figurative “*Kopështin e Edenit*” femënor sipas Koliqit, por ngrehina myku vjetërsish, të cilat do sillnin në jetë pafuqi “*prostitutash*” për të ndjerë jo trupin, por shpirtin. Vepra e tij është paraqitja e tërësisë së jetës shqiptare të viteve ’30-të, për të cilën në vlerësimin e tij, Arshi Pipa shkruan: “*Ndër skutat e qelbta të rrugave, mes potereve të tymosura t’mejhaneve, mbi shtratet e zhyeme të prostitutave, ndër burgje, ndër kasolla dhe më t’errta se burgjat...*” [Pipa, Arshi, 2006:44].

Ndër temat e parapëlqyera të Migjenit, ka qenë tema e femrës në botën shqiptare. Interesimi i poetit për femrën është i dyanshëm. Për të ajo është pjesë e pandarë e shoqërisë shqiptare dhe e letërsisë shqipe. Sipas Robert Elsie:

“Migjeni është i pari poet që abandonon traditën nacional - romantike, që ka sunduar për një kohë të gjatë në letërsinë shqipe. Studiuesit kanë parë tek ai karakterin e fortë social dhe etik, jo si art për art, por si një armë e fortë për të goditur padrejtësinë e shtypur sociale”. [Uçi, Alfred, 2013:357].

Migjeni, shkrimtari dhe poeti që njohu plagët shoqërore, i mbron këto gra fatkeqe, që duke u shitur bëhen shumë të njohura. Këtë realitet - helm, ai e paraqet në mënyrën e tij filozofike si një dukuri ku mbisundonte korrupsioni, vuajtja dhe imoraliteti. Migjeni ishte vëzhgues kritik dhe një analizues i mprehtë i jetës shoqërore e shpirtërore. Nëpërmjet antitezave, ai analizoi gjendjen shpirtërore të gruas prostitutë dhe të grave të zotërinjve. Ato u thyen nga jeta, sepse shoqëria nuk u kujdes për to, as për emancipimin e tyre. Në të gjitha personazhet femra të Migjenit, vihet re fatkeqësia por dhe humanizmi i tij i thyeshëm. Gruaja shqiptare ka pasur te Migjeni mbrojtësin e saj të parë e të denjë. Sipas tij, gruaja shqiptare nuk ishte grua e degjeneruar, sepse vetë jeta ia imponoi një gjë të tillë.

Në veprën letrare të tij femra zë jo vetëm një vend të rëndësishëm, por spikatin në të sidomos interpretimi i ri botëkuptimor përparimtar, tematika e gjerë që përfshin problematikën e “*zonës së heshtjes*”, domethënë të temave “*të ndaluara*” mbi jetën dhe pozitën sociale të femrës në

botën shqiptare të viteve '30-të. Gruaja, ajo që përfaqëson diçka më shumë se erotika, është për Migjenin po aq magjike dhe madhështore sa vet natyra. Në prozat e tij, ai përshkruan fuqinë e instiktit seksual, por pa e denaturuar atë. Migjeni është i saktë në konceptim, nuk ngrihet dhe as nuk rrëzohet në qartësi. Ai kupton se, dashuria njerëzore kultivohet si virtyt. Jashtë virtytit, ajo humbet kuptimin. Gjithashtu për Migjenin, ajo që mbetet qenësore dhe që përcakton thelbin e jetës, ka qenë dhe mbetet puna.

Për t'i qëndruar "*besnik*" lidhjes jo pa afëri të poetit me lëvizjen e parë feministe dhe krahasimit qytet - fshat na ndihmon kronologjia e publicistes, e cila e krijoi përvojën intelektuale pikërisht në "*zonën përjetësisht të ndaluar*", në fshat. Kjo është Afërdita Asllani, që zgjodhi për pseudonim emrin "*Afras*".

Një frymëzim i dikurshëm gjatë kohës kur punonte në fshat si mësuese për shkrimtarin Sterio Spasse, i cili ka shkruar për një Afërditë. Më 25 janar 1936, në gazetën "*Ilyria*" ajo boton shkrimin me titull: "*Emancipimi gruas shqiptare*", me pseudonimin "*Afras*". Kishte pak kohë që kishte vendosur të jetonte në Tiranë, ku sillte një tablo të trishtë të gruas në vend. "*Gjendja e gruas sonë, e gruas që përbën shumicën e popullit, na paraqet një nga problemet më me rëndësi për mundësinë e qytetërimit tonë të vështirë*". [Gazeta "Shqip", 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>].

Nisur nga përvoja e vet nga jeta në fshat, ajo kërkonte të aktivizohen grupe grash të interesuara për njëra - tjetrën.

"Në qoftë se kjo flakë do mund të marrë fuqi, përfundimet sigurisht do jenë me rëndësi për përparimin tonë. Në rrugën për emancipimin e gruas shqiptare, ajo kërkonte të luftoj mendimi konservator, po aq dhe modernizimi i gabuar, emancipimi i pëcëptë [të heqim ferexhenë, për të vënë kapelen]. Për të arritur këtë, puna duhet të fillojë në familje, për të edukuar një brez të ri të qytetëruar, që të sillet si drita e përparimit dhe ndër shtëpitë tona të errëta, ku mizerja, injoranca, mbajnë njerëzit në një nivel jo më të lartë se të kafshëve". [Gazeta "Shqip", 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>].

Në këtë analizë, trajtimi i realitetit është i ndryshëm nga trajtimi i bashkëkohësve të saj.

Përmendet injoranca, një nga "*fyerjet*" fatkeqësisht të merituar, si pjesë e një prapambetje deri

diku të vetëpranuar. Një konceptim i imponuar prej kushteve historike, që në vitet '30-të ndryshoi përmbajtjen në prapambetje ekonomike.

Shkrimtari Nonda Bulka shkruan:

“Sado të admirueshme të jenë veprat klasike, sentimentale e romantike më të çmuara, lexuesi nuk gjen në imitimet anakronike të tyre vetëveten, aspiratat e reja të jetës së tij, ndërkohë që poetët qajnë, lëngojnë dhe shfryjnë në dashuri të demoduara e përpëliten zall më zall, kurse atdheu ynë ka nevojë për vepra më të gjalla [...] duhet të largohemi nga figurat mitologjike dhe të jemi më pranë problemeve të mëdha, të rëndësishme të kohës, të jetës së popullit, të mjedisit social... [Uçi, Alfred, 2013:367].

Krahas kontributit të pesë publicistëve të mësipërme, duhet të rendisim dhe bashkëkohësen e tyre, Mila Vangjeli - Prela. Aktiviste, shkruese artikujsh, publikuese në revistën *“Bota e re”*, ajo shkruan: *“Femra nuk mund të përparojë, nëse gjendet ende brenda katër mureve të shtëpisë së saj. Është e domosdoshme që ajo të marrë pjesë në lëvizjet e ndryshme të shoqërisë ku jeton”*. [Gazeta “Shqip”, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>]. Këtë publicistja Mila e kërkonte, kur në Shqipëri vetëm një pakicë e grave e shihnin dritën e diellit lirisht, sepse shumica ishin të mbuluara. Vizioni i Milës ishte bashkëkohor. Si qenie e lirë, gruaja duhet të trajtohet e barabartë me burrin nga ligji dhe opinioni publik dhe ajo duhet të fitojë të drejtat që gëzon edhe burri. Qëllimet e gruas nuk duhet të përmbliidhen vetëm në realizimin e detyrave familjare. Për sa kohë që ajo nuk e kupton se është njeri si gjithë të tjerët, e lirë të gëzojë të drejtat njerëzore, e pavarur ekonomikisht, e zonja të përballojë jetën pa ndihmën e burrit, gruaja do të jetë gjithmonë fatkeqe. *“Kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë”*, thërret Mile Prela. [Gazeta “Shqip”, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>]

Musine Kokalari ose *“Muza”*, kishte nisur të shkruante para se të nisej në Romë me studime për letërsi. Me Selfixhenë ishin bashkëpunëtore në gazetën *“Shtypi”*. Shkrimet e saj të para, tregojnë ndjesitë e një vajze të re ndaj familjes, shoqërisë apo dashurisë. Vajza që do të kishte fatin më të hidhur nga katër mikeshat e saj, kishte nisur të shkruante një roman. Në vitin 1943, në revistën *“Gruaja shqiptare”* boton kryeartikullin; *“Dy fjalë”* dhe novelën *“Hija e djalit”*. [Gazeta

“Shqip”, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>]. Në këto shkrime, ajo zhvillon pikëpamjet politike social - demokrate, mbështetjen për luftën antifashiste dhe ëndrrën që pas lufte të vendoset një regjim demokratik. Në një shkrim u drejtohet kështu femrave shqiptare:

“Të jemi Një! Është e mira e vendit. Jemi të gjitha motra, pra jemi të pandara në këtë ditë të mjerimit, për të qenë të bashkuara dhe nesër”. “Malet janë mbushur me djemtë tanë. Ca luftojnë sot. Ca do të luftojnë nesër”. [Gazeta “Shqip”, 2015: <http://www.gazeta-shqip.com/>].

Në vitin 1939 ende studente, ajo boton librin e parë, “*Siç më thotë nënua plakë*”. Lasgushi do ta quante librin një krijim origjinal. Më 1944, boton librin “*Rreth vatrës*” dhe në fund të atij viti librin, “*Sa u tund jeta*”. Libri ishte kritik ndaj gjendjes së gruas në vend. Ajo e quante martesën në atë kohë “*tregëti*”. Martesa është tregëti për të dy palët.

Të gjitha këto pikëpamje të grave intelektuale, kërkonin ndryshimin shoqëror. Problemi qëndronte më thellë. A do mjaftonte një arsimim “*demokratik*” për të ç’rrenjosur të vjetrën? Nga periudha e Mbretërisë Shqiptare, shohim se lëvizja feministe ishte tejte intelektuale. Kjo për arsyen e një niveli europian në kulturën që ato përfaqësonin, në të kundërt kur në Evropë lëvizjet feministe buronin dhe ushqeheshin nga klasa punëtore, kryesisht nga gratë. Kjo i bënte ato të kuptonin dhe të ndjenin forcën e masivitetit. Por në Shqipëri klasa punëtore mungonte.

Lëvizja feministe shqiptare besonte te fuqia e kulturës, si një vlerë e jashtëzakonshme për kohën. Një rend i ri ekonomik do të kërkojë mohimin e kulturës elitare, duke e zëvendësuar me masivizmin, si një mjet i lëvizjeve feministe për ta çuar shoqërinë drejt barazisë gjinore. Këtu duhet kërkuar lindja e një klase femërore, e aftë të drejtojë veten dhe shoqërinë. Brenda një historizmi femëror, kërkesa ndaj vetes është zbulimi i këtij fenomeni shqiptar. Në vitet ’30-të, nuk “*guxohej*” të prekeshin gratë dhe vajzat që jetonin në realitetet “*shtëpiake të zbuluara, por të mbyllura*”, ndërsa në rrugë, foto, arkiva dhe shtypin e kohës i takon të mbuluara së jashtmi...dhe zhveshura së brendëshmi.

Zefina Hasani, ishte femra shqiptare që u ngujua përballë një artisti dhe më pas, përballë një fotografi. Tabuja e kësaj ndodhie do ishte për kohën një lëvizje feministe “*trupore*”. Lajmi ishte i bujshëm. Një femër shqiptare pozoi nudo në vitin 1938 para piktorit Abdurrahim Buza. Piktura u fsheh dhe u shfaq në vitin 2000, në Galerinë Kombëtare të Arteve. Vepra u quajt “*Post Eva*”. Ky material u zbulua nga studio “*Marubi*”. Ajo që të mbreson, është thyerja e tabusë. [Gazeta “*Lapsi.al*”, 2015: www.lapsi.al].

Albanologu Robert Elsie në studimin e tij, “*Një fund dhe një fillim*”, i konsideron gratë shqiptare si gra që shkruajnë më shumë se sa si shkrimtare e poete, që i kushtëzon Shqipëria, ky vend tradicionalisht mysliman, ku 40 vjet më parë femrat ishin analfabete dhe gratë shkrimtare e poete nuk ishin dukuri e zakonshme. Elsie radhit Adelina Mamaqin me, “*Ëndrra vashërie*” [1963], si autorja e vëllimit të parë poetik, të botuar nga një femër në Shqipëri. [Elsie, Robert, 1997:88].

Megjithëse një nga filozofitë e komunizmit ishte trajtimi i gruas si e barabartë me burrin, shumë pak autore femra mundën të shkruanin nën çensurë. Më shumë ato preferuan, në fakt u detyruan, t’i kushtohen redaktimit apo përkthimit, duke ua lënë letërsinë burrave. Në asnjë vend tjetër dhe në asnjë regjim totalitar, burrat nuk kanë mbizotëruar kaq shumë sa në Shqipërinë komuniste në uzurpimin e krijimtarisë letrare.

Vështirësitë e emancipimit real të grave dhe vajzave në kontekstin e viteve ‘30-të do të përmbledheshin në pak rreshta, duke u fokusuar në një përfundim të arsyetuar logjik. Duke mos paragjykuar në kohë, edhe pse lidhjet shkakësore të periudhave kanë vështirësinë e tyre, dyshimi për spekulime me dimensionet më të munguara të mendimit të lëvizjeve feminist në Shqipëri kanë nisur më herët, kundër pretendimeve që i atribuohen në mënyrë spekulative sistemit totalitar, duke e sendërtuar arsyetimin logjik [në fakt të etiketuar “shkencor”], mbi shtresëzime historike të padrejta.

Mbështetur mbi synime ideopolitike, ai ka ligjësuar në një farë mënyre mëkatën e arsyes mbi të vërtetat historike. Ende sot, kjo nuk e ka dëshmuar vlerën e pazëvendësueshme tek shoqëria mbi barazinë gjinore. Vetëm e çliruar nga pasionet dhe ideologjizmat, ajo do të bëhet shpirtërore dhe e lirë drejt të vërtetave historike. Ky interpretim psikofilozofik do të konsiderohet i plotë, kur veprimtaria e ushtrimit të të drejtës së grave dhe vajzave shqiptare do të jetë e plotë, në përputhje me standardet që e vendosin praninë dhe rolin e saj në bazën e progresit social ekonomik të vendit.

KAPITULLI III: Pozita e grave dhe pabarazia gjinore gjatë periudhës së Mbretërisë Shqiptare.

3.1 Pozita e grave gjatë periudhës së Mbretërisë dhe fillimet e arsimit në Shqipëri.

Situata e gruas para kohës së mbretërimit të Zogut të Parë, ishte shumë e rënduar për shkak të ndikimit të zakoneve kanunore, sidomos Kanunit të Lekë Dukagjinit. Ky i fundit e trajtonte femrën si një pronë të burrit. Por gjendja e saj ekonomike shoqërore rëndohej së tepërmi për shkak të prapambetjes së madhe ekonomike në vend. Në disa nene të Kanunit, shprehej qartë pozita sociale e grave dhe vajzave.

Nyji njimbëdhjetët - M'u martue me kanun do'me thanë m'u ba ship ,me i a shtue shpis një rob ma tepër, sa për krah të punve, sa për të shtuem të fmive. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:10]

Nyje gjashtëmbëdhjetët - Nuse pa shkuesi s'bahet. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:13]

Nyje e njëzetetët - Me rrahë burri gruen, nuk bjen në faj kah kanuja, e as prindja s'mund t'a kërkojnë të rrahmen. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:19]

Nyje njizetenandët - Grueja njifet si çalikë për me bajtë sa të jetë në derë të burrit, se prindja e s'hjeken dorë prej sojet, e ndalin për vedi e mbi vedi përgjigjemen për të, por edhe me lypë arsye, me ba me e gjetë gja. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:19]

Nyje e tridhjetëtrretë - Burri ka tager me; a) me kshillue e me qortue gruen; b) me rrahë e me lidhë gruen e vet, kur të mbërrijë me i a përbuzë fjalën e urdhin. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:21]

Nyje e tridhjetegjashtë - Kanuja njef për trashigues djalin e jo vajzën. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:26]

Sipas këtyre përcaktimeve, të cilat kishin forcë vepruese në trevat shqiptare, gjendja e grave shqiptare ishte e rëndë. Në mungesë të ligjeve, ato ishin legjitimuar si norma morale dhe ligjore, që mbanin peng vajzat dhe gratë shqiptare prej shekujsh. Trashëgimnia në këtë fushë vazhdonte të shkarkonte pasojat e saj të rënda mbi feminitetin shqiptar. Deri në periudhën e shpalljes së Pavarësisë, asgjë nuk kishte ndryshuar. Por gjendja më e rëndë ishte në fshat dhe në veri të Shqipërisë, ku Kanuni pati një ndikim shumë më poshtërues. Pa të drejtë trashëgimie, pa të drejtë mbi fëmijën, pronën dhe jetën, gruaja ishte thjesht një plaçkë dhe kafshë pune. Ajo bënte gjithçka në shtëpi, fushë, ngarkohej në mungesë së kafshës së punës.

Shoqëria shqiptare kishte trashëguar tiparet e një shoqërie maskiliste, që e konsideronte gruan vetëm riprodhuese. Në poezinë popullore gruaja ishte simbol i jetës, vazhdimësisë, bukurisë, sakrificës, flijimit, mahnitjes, madhështisë. Rilindasit ishin të parët që e panë figurën e femrës përtej traditës kanunore. Ata trasmetuan në veprat e tyre gjendjen e mjerueshme të saj, përkundrejt femrave të tjera evropiane. Para kësaj gjendje, shtypi i kohës tërhoqte vëmendjen:

“është e tepërt të theksojmë këtu rëndësinë që ka arsimi femëror për zhvillimin e shoqërisë...Mjaftojmë të shënojmë që femrat shqiptare po mbeten n’errësirë dhe duhet plotësuar sa më shpejtë kjo e metë, se pa patur vajza të mësuara, nuk mund të presim as gra të qytetëruara, as nëna të mira, as djem të mirërritur”, [Gazeta “Ora”, 1929:12].

Rilindja Shqiptare ishte lëvizja kulturore, e cila hodhi e para themelet e laicitetit në Shqipëri, nisur nga ideja e Pashko Vasës se, *“feja e shqiptarit është shqiptaria”*. Hapja e shkollave shqipe ishte kushtëzuar nga pushtuesit; shkollat ishin të pushtuesve dhe në to mësohej gjuha e tyre, turke, greke, italiane. Shkollat kishin karakter të theksuar fetar, programet ishin fetare. Gjatë Luftës së Parë Botërore me luftën e pashtershme të atdhetarëve shqiptarë, u arritën të hapeshin në Shqipëri 60-të shkolla shqipe me rreth 4. 000 nxënës.

Shkolla e parë Shqipe u hap në 7 Mars 1887, në kohën kur fatet e Shqipërisë ishin kthyer në pazar të Fuqive të Mëdha. Arsimi dhe gjuha shqipe kishin misionin më të madh të historisë, ruajtjen e identitetit kombëtar. Shkolla e parë shqipe u hap në Korçë nga motrat Qiriazi. Ajo pati karakter kombëtar pa dallime sociale, pa dallime gjinore, pa dallime fetare. Legjislacioni arsimor shqiptar hodhi themelet e tij në Qeverinë Kombëtare të Vlorës, i cili u pasqyrua në Kanunin e Përshtatshëm të administratës civile, ku u sanksionua arsimi fillor i detyrueshëm, hapja e shkollave në gjuhën shqipe dhe vet gjuha shqipe si gjuhë zyrtare e shtetit shqiptar. Drejtoritë arsimore u ngritën në çdo prefekturë.

Në Kongresin Kombëtar të Lushnjës, të mbajtur në vitin 1920, u aprovua laicizmi i sistemit arsimor dhe hartimi i dokumentacionit shkollor të unifikuar. *“Në vitet 1913 - 1914, u hapën 64 shkolla shqipe, shumica e tyre në fshatra. Në periudhën e qeverisjes së F. S. Nolit kishte 250-të shkolla fillore”*. [Historia e Popullit Shqiptar III, 2007:44-45]. Arsimi ishte me karakter laik dhe kombëtar. Qeveria e Nolit nuk arriti të ndalonte hapjen e shkollave të huaja dhe përdorimin e gjuhës së huaj në to, megjithëse hodhi bazat e shekullarizmit në Shqipëri.

Situata e arsimit ndryshoi në kohën e Mbretërisë Shqiptare. Prapambetja e madhe ishte jo vetëm në numrin e shkollave, por dhe në pjesëmarrjen e femrave në këto shkolla.

“Shkollat e hapura në vitet 1926 - 1927 në funksion ishin: 536-të shkolla fillore, nga të cilat 470-të ishin vetëm me një klasë. Numri i përgjithshëm i nxënësve ishte 26. 612, pra shumë i vogël për një popullsi 834 mijë banorë. Kishte 10 gjimnaze, ku jepnin mësim 101 arsimtarë dhe mësonin 1. 328 nxënës. Krahas tyre kishte 6 konvikte me 25 arsimtarë dhe me 574 nxënës. Ndjekja e shkollave u bë e detyrueshme për arsimin pesëvjeçar. Femrat përbënin 10 % të nxënësve të gjimnazeve, ndërsa nga bursat e jashtme përfitonin vetëm 5 %”. [Historia e Popullit Shqiptar III, 2007:255].

Në vitin 1920 - 1921, u hapën dy shkolla të mesme, *“Normalja e Elbasanit”* dhe *“Liceu i Korçës”*, ndërsa më vonë dhe gjimnazi shtetëror i Shkodrës. Në vitin 1923 - 1924 u çel liceu i Gjirokastrës dhe më vonë, më 1924 - 1925, u çelën internate në Skrapar, Mat dhe Mirditë. Si shkolla të mesme, u çelën për herë të parë: Shkolla tregtare e Vlorës, Gjimnazi i Tiranës dhe ai i

Beratit. Në vitin 1927 - 1928 u çelën konvikte fillore në Sarandë, Leskovik, Kolonjë, Bërzeshtë të Elbasanit dhe në Rubik, në Malësi të Lezhës.

Në reformën arsimore të viteve 1927 - 1928,

“gjimnazet u përcaktuan me 7 klasa dhe licetë me 6 klasa. Më vonë, u hapën Shkolla Teknike e Tiranës, Instituti femëror “Nana Mbretnesh” dhe shkolla Shqiptaro - Amerikane në Kavajë. Filluan gjithashtu përgatitjet për hapjen e shkollave profesionale dhe kufizimin e atyre të mesme”. [10 vjet Mbretni Shqiptare 1928 - 1938, 1938:154 - 156].

Mbreti Zog, si në periudhën republikane, ashtu edhe në atë mbretërore, i kushtoi rëndësi gjendjes së arsimit, po ashtu emancipimit të gruas. Shkollat shqipe u bënë qendra të vetëdijësimit dhe të përhapjes së vlerave të identitetit shqiptar.

Megjithatë, as Republika e as Mbretëria Shqiptare, nuk e ndryshuan prapambetjen arsimore të gruas, përkundrazi e thelluan më tej atë. Propaganda në shtyp do të përkrahte përhapjen e arsimit dhe kulturës, por në rrugë shtetërore u bë shumë pak për realizimin e këtyre premtimeve. Në letrën që Mbreti Zog i dërgonte Kryeministrit, me rastin e formimit të kabinetit të ri ministror, më 16 Janar 1929, thuhet ndër të tjera: *“Arësimit femëror i nepet një rëndësi e madhe. Të gjindet mënyra jo vetëm për naltësimin e kulturës femërore, por dhe për stërvitjen e saj për përgatitjen për jetën familjare”*. [Fletore zyrtare, 1929:24].

Përpyekjet e Mbretit Zog në vitet 1922 - 1928, u orientuan në drejtimin e përmbysjes së tendencave gati shekullore, të mungesës së predispozicionit të autoriteteve vendore për arsim. Faktet flisnin ndryshe. Në vitin e shpalljes së Monarkisë më 1928, vendi kishte 578 institute arsimore shtetërore e private, me 1. 079 mësues dhe 32. 063 nxënës. Sipas gazetës “Ora”, numri i nxënësve ishte i barabartë me 4 % të popullsisë së përgjithëshme të Shqipërisë. *“Një pikë e kësaj statistike që godit keq në sy, vazhdon gazeta, janë shifrat që tregojnë se, prapa është arësimi femëror, në krahasim me arsimin mashkullor”*. [Fletore zyrtare, 1929:24].

Në Dokumentin “*Organika e Arsimit*”, e botuar në fletoren zyrtare, 4 Gusht 1928, nr. 82, i quajtur, “9” - *Ligja, 27 Qershor 1928*”, renditeshin disa parime të rëndësishme mbi arsimin:

Parime të përgjithëshme:

Art. 1. - Arsimi, Edukata e brezit të ri gjindet nën kryesinë e mbikqyrjen e shtetit dhe mbahet me mjetet e tij;

Art. 4. - Arësimi filluer asht i detyrueshëm dhe jepet falas;

Art. 8. - Programet, orarët e mësimetve si edhe hollësinat mbi zhvillimin e çdo lande, caktohet me një rregullore të veçantë prej Ministrisë s’arësimit [Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, 1928:35].

Arsimi fillor ishte i organizuar në shkollat foshnjore dhe ato fillore, të cilat kryheshin në 5 vjet. Arsimi i mesëm ishte i klasifikuar në gjimnaze dhe lice, përkatësisht në 8 vjet dhe 9 vjet. Shkollat normale dhe ato tregëtare, konsideroheshin të larta. Zhvillimi i arsimit pati vështirësi të shumta, pasojë e gjendjes së rëndë ekonomike në të cilën Mbreti Zog e mori vendin, pas lufrash dhe pas një pushtimi 500 vjeçar, në të cilën arsimit kombëtar ju desh rrugë e gjatë për t’u zhvilluar.

Mbreti Zog ishte plotësisht i ndërgjegjshëm se, ky proces do të ishte jo vetëm i gjatë dhe i vështirë, por do të pengohej nga mungesa e kuadrove, mjeteve financiare e godinave. Në këto vite të para të republikës shqiptare, mungonin pothuajse krejt ligjet, për të mos thënë që njerëzit endeshin midis xhunglave të kodeve ligjore otomane. Që të ndërtohej një sistem kombëtar arsimor, duhej së pari; të kapërcehej mbi influencat dhe qëllimet e shkollave ekzistuese.

Deri në fund të viteve ’20-të të vetmet shkolla që ishin, drejtoheshin prej organizmave të ndryshme fetare apo prej disa privatëve të huaj. Kështu, amerikanët kishin ngritur dy kolegje bujqësore, ku përgatitej një numër i kufizuar nxënësish. Po ashtu në Shkodër funksiononin dy - tri shkolla jezuite, ku më së shumti kultura i përkiste religjionit të besimit katolik. Në Durrës e Vlorë kishte dy - tri shkolla, ku mësimi jepej në gjuhën italiane dhe nxënësit mësonin malet e lumenjtë e Italisë, pa ditur më parë gjeografinë dhe historinë e atdheut të tyre.

Përballë kësaj tabloje që nuk premtonte shumë, Mbreti Zog u kujdes të ideonte dhe zbatonte një strategji sa më kombëtare, e cila do të mund të çelte rrugë më të gjëra dhe efikase për të ardhmen. Në mënyrë që të mundësonte hapjen e shkollave në pjesë të tjera të vendit,

“Zogu ndër morri një program ambicioz reformash, i cili kishte për objektiv futjen e një rrjeti të tërë shkollash fillore në krejt vendin, të ndërtuara mbi bazën e sistemit me konvikt, për gjithë ata fëmijë që banonin në zonat e largëta dhe nuk mund të përshkonin çdo ditë rrugën për të ndjekur mësimet”.
[Fisher, Bernd, 1996:183].

Nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Mbretit Zog, me arsimin kombëtar në fokus, në fillim të viteve '30-të të shekullit të kaluar, u çelën dhjetra shkolla në Shqipëri. Kështu, u çel gjimnazi shtetëror i Shkodrës, Liceu Francez i Korçës, Liceu i Gjirokastrës, shkolla Tregëtare e Vlorës, Gjimnazi i Tiranës, Gjimnazi i Beratit si dhe dhjetra shkolla fillore të pajisura me konvikte, duke synuar përfshirjen e të gjithë fëmijëve shqiptarë në përvetësimin e njohurive të domosdoshme elementare të gjuhës, leximit në shqip dhe shkencave të tjera. Mbreti Zog përmes këshilltarëve të vet, mbante lidhje me drejtuesit e shkollës teknike në Tiranë, e cila ka pasur drejtim teknik, sidomos për teknikën bujqësore.

Duke paraparë se pjesa më e madhe e Shqipërisë ishte vend agrar, duke menduar perspektivën e ekonomisë së rënuar shqiptare, Mbreti mbështeti drejtuesit amerikan të kësaj shkolle. Pas kapërcimit të fazës së parë, monarkia kërkoi që programi mësimor i këtyre shkollave të unifikohej. Për këtë në fillim të vitit 1931 u ngrit një komision i posaçëm, i cili përgatiti një program modern dhe thellësisht kombëtar, duke synuar, së pari, unifikimin e tij dhe më pas formimin sa më të plotë të nxënësve.

“Deri me këtë datë arësimi filluer i Shqipërisë, ndiqte një sistem mësimi johomogjen; programe të ndryshme dhe prirje që mbështeteshin në mësimet që kishin marrë arsimtarët nëpër vise të ndryshme të Evropës... Me sistemin dhe inkuadrimin e programeve në një udhë të vetme dhe të re, u arrijt ajo që asht sot, një nga ndërtesat ma të bukura të regjimit Zogist, domethënë një votër rreth të cilës mblidhen mijëra e mijëra djem, që, po të në lejohet shprehja ,mun të themi se filluem të ushqehemi me qumështin e një nane të vetme”. [10 vjet Mbretni Shqiptare 1928-1938, 1938:182]

Shkolla Normale e Elbasanit fitoi një vëmendje të madhe nga Mbreti Zog, ndoshta sepse kjo shkollë përgatiste mësues që do të shërbenin në çdo skaj të vendit. Përmes një dekreti të veçantë

të tij shkolla u pajis me një program mësimor modern, si dhe me mjedise të mjaftueshme konviktores. Viti 1931 - 1932, shënoi fillimin e përgatitjes së programeve të veçanta shkollore për normalet dhe gjimnazet. Në prillin e vitit 1933, Parlamenti Shqiptar kishte aprovuar dekret - ligjin mbi organizimin e sistemit arsimor, duke synuar zhveshjen e shkollave prej ndikimeve të huaja. *“Për t’ia dhanë një amalgamin ma të fortë dhe një prirje homogjene Shkollës Kombëtare, Ministria e Arsimit mendoji, në Prillin e vjetit 1933, të bante shtetëzimin e shkollave fillore dhe të mesme”* [10 vjet Mbretëri Shqiptare 1928-1938, 1938:156]

Natyrisht, këto vizione strategjike të arsimit nuk mund të kalonin në heshtje prej fqinjëve, të cilët kërkonin përmes ndikimeve të tyre në shkollë, të përgatisnin falangat e pushtimit. Protestës së disa drejtuesve të shkollës italiane, Ministria e Jashtme Shqiptare iu përgjigj se;

“nevoja e shtetit tonë është që rinia e vendit të frekuentonte vetëm shkollat shqiptare, sepse qëllimi i saj ishte të rrënjoste tek ajo dashurinë për atdheun dhe ndjenjën e bashkimit kombëtar, çka ishte konform frymës së bashkëpunimit midis kombit shqiptar dhe atij italian...” [A.Q.SH. i R.SH. F.511, V.1938, D 100, fl.24].

Protesta të herë pas herëshme kundër reformave arsimore, monarkia do të kishte edhe prej sllavofilëve dhe grekofilëve.

Bazuar në përfundime bindëse, mbi bazën e ekspertizës së saktë të dëshmive dhe dokumenteve autentike arkivore, gjithçka vihet në shërbim të zbardhjes së të vërtetave të hidhura që kanë rënë mbi historinë shqiptare, duke pasur në qendër të tij, veçanërisht çështjen shumë të përfolur të ruajtjes dhe të përhapjes së gjuhës dhe shkollave shqipe, arsimimit dhe dijes kombëtare.

Kështu, në vitin 1936, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe mes shtetit grek e atij shqiptar, të dy palët detyroheshin të realizonin në praktikë parimin e reciprocitetit, që përfshinte shumë detyrime mes palëve. Qysh në vitin 1928, kur pushteti grek ishte bërë shumë i pranishëm në krahinat e Shqipërisë Jugore, gazeta angleze *“The Times”* shkruante një artikull me titull, *“Dielli nuk mbulohet me shoshë”*, ku trajtohej shkelja e të drejtave të njeriut për gjuhën shqipe në këto krahina. Rastet e shkeljeve flagrante kanë qenë të panumërta. Lluk Karafili, kryemësues i

shkollës qëndrore, në shkresën më dt. 3. 7. 1933, dërguar Ministrisë së Arsimit Shqiptar, vinte në dukje;

“...vështirësitë e krijuara atij qarku mësimor, të “rrethuar nga tri anë prej shkollave greke” të përtej kufirit shtetëror. Ai numëronte një për një, sidomos institucionet arsimore greke të ngritura në Korfuz e në Çamërinë e robëruar, të cilat zbraznin pa ndërprerje këndeje kufirit helmin grek”. [A. Q. SH. i R.SH.F.14,V. 1933, D. 8,fl. 16,50,].

Përballë këtyre pengesave me natyrë gati të pakapërxyeshme, për të ndihmuar, sadopak, arsimimin në gjuhën amtare,

“...shteti shqiptar kishte hapur në Sarandë, nga fundi i viteve ’20-të të shekullit XX-të, konviktin “Çamëria”, me afro 100 nxënës, që vinin, kryesisht, nga ajo trevë. Shumica e mësuesve si dhe dhjetra mësues të tjerë familjarë, që u mësonin vetiakisht fëmijëve shqiptarë shkrim - këndimin shqip, kishin kryer, pikërisht, shkollën e konviktit “Çamëria” në Sarandë. Fletoret shqiptare të kohës; “Besa”, “Vatra” dhe “Arbëria”, në vitin 1936 e më tej, ju desh të bënin mjaft shkrime për të hedhur dritë në këto përpjekje dashakeqe të qeverisë e qarqeve antishqiptare”. [Mëniqi, Kadrije, 2014:45]

Protestave dhe kundërvënieve shovene kundër përhapjes së shkollave dhe gjuhës shqipe, Mbreti Zog iu përgjigj mençurisht, duke synuar kurdoherë përmbajtjen kombëtare. Kështu, mbi bazën e Deklaratës për Mbrojtjen e të Drejtave të Minoriteteve, ai lejoi çeljen e shkollave në jug të vendit, ku jetonin minoritarët grekë. Ndihmoi, gjithashtu, paisjen e këtyre shkollave me ato mjete që dispononin dhe shkollat në gjuhën shqipe. Por gjithsesi, Mbreti nuk lejoi hapjen e shkollave private greke. Sipas nenit të veçantë të Kushtetutës Shqiptare, hapja e shkollave private u lejohej vetëm shtetasve shqiptarë, të cilët duhej të zbatonin programet e arsimit publik.

Por ndërsa u vihej fre ndikimeve italiane, greke e sllave, në sistemin arsimor shqiptar shiheshin me përparësi shkollat e drejtura prej amerikanëve e francezëve. Kështu, mbi bazën e një plani të veçantë të Ministrisë së Arsimit, ndihmoheshin shkolla teknike e Tiranës dhe shkolla teknike e Golemit të Kavajës, të drejtura prej amerikanëve. Po kështu, pati kurdoherë predispozicion prej regjimit monarkik për shkollat dhe kulturën franceze.

“Më 20 korrik 1931, Degrani vinte në dijeni Brijanin, tani ministër i jashtëm në qeverinë franceze, se në takimin që kishte pasur me, mbretin, ky kishte deklaruar se, nuk pajtohej me mendimet e lartë përmendura... Mbreti i kishte deklaruar Degranit se, “përkrah plotësisht pikëpamjet tuaja, të cilat janë shumë të urta...unë jam për zhvillimin e marrëdhënieve intelektuale midis Francës dhe Shqipërisë”. [Xoxe, Koli, 1997:116].

Është i kuptueshëm qëndrimi i Mbretit Zog ndaj ndërhyrjeve të qeverisë italiane. Meqenëse Shqipëria në ato vite merrte një hua prej Italisë, kjo e fundit kishte vendosur specialistët e saj në disa ministri, me pretendimin *“për të ndihmuar palën shqiptare të administrojë sa ma mirë paratë”*. Pasi prej shkollave shqiptare u larguan mësuesit italianë, Italia bëri presion që nga shkollat e Elbasanit, Tiranës dhe Shkodrës të largoheshin mësuesit e gjuhës frënge. Por ky propozim nuk u pranua prej palës shqiptare dhe Mbreti Zog urdhëroi vazhdimin e funksionit mësimor - edukativ të tyre.

Dashurinë dhe përkushtimin e madh për mësuesin dhe studimin e gjuhës shqipe, Mbreti Zog e shprehu në një përshëndetje që u bënte nxënësve shqiptarë në fillim të vitit 1937, ku midis të tjerave kumton:

“Gjuha e jonë asht më e bukura gjuhë e botës dhe asht shkaku ma i madh apo i vetëm, që u çlirua Shqipëria jonë, e që i dha shkasin ma të madh çështjes shqiptare për me u ba shtet ynë i sotëm. Prandaj na, këtë gur kaq të çmueshëm, duhet ta duam me gjithë shpirt dhe me një përkuqjesje të posaçme, ta ruejm në log të zemrave tona”. [Mëniqi, Kadrije, 2014:45]

Ndër kontributet e Mbretit Zog, në përhapjen e diturisë dhe arsimit, vlen të përmenden edhe nismat e tij, që këto vlera të përcilleshin tek vajzat shqiptare. Kështu, në mesin e viteve '30-të, në Tiranë u ngrit gjimnazi *“Nana Mbretëreshë”*, ku qindra vajza nga viset e shtetit amë dhe nga Diaspora, hynë në rrugën e bukur të dijes. Këto vajza shqiptare morën jo vetëm kulturën perëndimore, ç’ka servirte programi mësimor, por u njohën me traditat e lashta e të bukura të popullit tonë.

Duhet vlerësuar përpjekja e Mbretit Zog për dërgimin e studentëve shqiptarë, të cilët do të vazhdonin studimet e larta. Sigurisht, në periudhën kur filloi kjo lëvizje, mbi 90 përqind e shqiptarëve ishin analfabetë, por me mjetet e pakta financiare, qeveria e asaj kohe nuk mund të ngrinte dot universitete. Megjithatë, prej shtetit shqiptar dërgoheshin çdo vit rreth 400 studentë me bursat e shtetit apo të tyre në vendet perëndimore. Italia, Franca, Austria, Zvicra e Gjermania, ishin vendet më të preferuara për studentët shqiptarë, të cilët shkonin për studime mbi plane

konkrete të qeverisë. Gjatë kësaj kohe bie në sy numri i madh i mjekëve, oficerëve dhe ekonomistëve, nga që shoqëria shqiptare kishte shumë nevojë për këto fusha të specializuara.

Në vitin 1920, Kongresi i Lushnjës miratoi Dikasterin e Arsimit, i cili unifikoi një program të përbashkët për shkollat fillore pesëklasëshe dhe unifikimin e termave të lëndëve të ndryshme të arsimit. Në shtator 1934 - 1935, Mbreti dekretoi ligjin organik për arsimin. Sipas ligjit, arsimi fillor jepej falas dhe ishte i detyrueshëm për të gjitha foshnjat, meshkuj dhe femra, të shtetasve shqiptarë, duke filluar prej moshës 4 vjeçare dhe duke mbaruar në atë 13 vjeçare.

Këto masa shënuan një progres të dukshëm në çështjet arsimore.

“Kishte vise malësore në Mbretnin tonë që kishin mbetur të mjerume dhe të zhytuna në të për sa i përket arsimit, shkollat e ndryshme fillore, që kishin krijuar me kohat e para, në qendrat e përkufizime, gjindeshin shumë lark nga nga këto vise, aq lark sa do të kishte qenë një krim sikur të detyroheshin foshnjat e njoma të mershin për ditë një udhëtim prej shumë orësh. Njëkohësisht në fushatën, për të pajisur me kulturë gruen shqiptare, Ministrija e arsimit nisi një luftë sistematike për të çfarosur nga gjini i tyre errësirën dhe analbatizmin për këtë u krijuan, për meshkuj të rritur, kurse të posaçme me dy seksione”. [10 vjet Mbretni Shqiptare 1928-1938, 1938:154].

Reforma arsimore ndryshoi situatën e arsimit. Shkollat femërore mundësuan pjesëmarrjen e vajzave në arsim. Megjithatë, shpërndarja territoriale e shkollave nuk ishte e njëjtë. Në fshat ajo ishte shumë e vogël, ndërsa femrat përbënin më pak se një të tretën e nxënësve. Pra, arsimi vazhdoi të ngelej ende i ndarë mes femrave dhe meshkujve. [Historia e Shqipërisë III, 2007:410].

Tabela nr 1: Tabela përmbledhëse për vitet 1933 - 39, mbi numrin e nxënësve femra dhe meshkuj për institucionet arsimore:

	Statistika përmbledhëse, 1933 – 1939			
Periodha kohore	1 933	1 939	1 933	1 939
Lloji i shkollave	Meshkuj	Femra	Gjithesëj	% femra
Gjimnaze e lice	12. 567	3. 537	16. 104	22. 0
Teknike	2. 116	0	2. 116	0. 0
Tregëtare	452	0	452	0.0
Bujqësore	388	129	517	25. 0

Normale	2 632	1 209	3 841	31. 5
Qytetëse	5 666	2 089	7 755	26. 9
Shkollë vizatimi	147	0	147	0. 0
Shuma	23 968	6 964	30 932	22. 5

[A.Q.SH.i R.SH F.188 V.1933 D. 2 fl.2; F.188 V.1934 D.6 fl.1: F.188 V. 1935 D. 8 fl.1; F.188 V.1936 D.10 fl.5; F.188 V.1937 D.14 fl.1; F.188 V.1938 D,19 fl.2; F.188 V.1939 D.33 fl.4].

Në vitin 1938, në Shqipëri kishte 1. 040. 353 banorë nga këta; 15. 4 % qytetarë dhe 84. 6 % fshatarë. Në vitin shkollor 1938 - 1939, në arsimin e kulturës së përgjithëshme ishin; 55. 404 nxënës, nga këta në arsimin fillor 52. 024 nxënës [35. 067 meshkuj dhe 16. 957 femra]; në arsimin tetëvjeçar 2. 563 nxënës [1. 840 meshkuj dhe 723 femra]; në arsimin e mesëm 817 nxënës [797 meshkuj dhe 20 femra]. Në arsimin e mesëm pedagogjik ndër 657 nxënës, 377 ishin meshkuj dhe 298 ishin femra. Ky numër relativisht i rritur i femrave, tregonte kujdesin për të nxjerrë arsimtare gra [Anuari Statistikor, v. 1938]. Gjendja e arsimit nuk ndryshoi gjatë 15 viteve të qeverijes së Mbretit Zog dhe Shqipëria trashëgoi 94 % të grave e vajzave në gjendje analfabetizmi. [Siliqi 2003:46].

Tabela nr. 2: Numri i nxënësve, femra dhe meshkuj, në arsimin fillor, në vitet 1934 – 1939.

[AQSH I RSH F.188 V.1934 D. 5 fl.1:F.188 V.1935 D .7 fl.19: F.188 V. 1936 D. 9 fl.61:F.188 V. 1942 D. 18 fl.4: F.188 V. 1939 D. 31 fl.44].

Vitet	M	F	Total	% Femra
1934 – 1935	37. 705	15. 317	53. 022	28. 9
1935 – 1936	17. 329	15. 612	52. 941	29. 5
1936 – 1937	36. 898	15. 586	52. 484	29. 7
1937 – 1938	37. 323	19. 203	54. 526	35. 2
1938 – 1939	-	-	-	-

1939 – 1940	37. 265	19. 500	56. 765	34. 4
-------------	---------	---------	---------	-------

Me interes shfaqen të dhënat statistikore të numrit të nxënësve të arsimit fillor. Prania e vajzave në shkollë varjonte nga 29 - 34 për qind, duke vlerësuar në perspektiv mundësinë e vazhdimit të arsimimit në cikle të tjera shkollore. Në sasinë e përgjithëshme të nxënësve, në vitin 1934 raporti meshkuj femra arrin në 2 : 1; në vitin 1935 shfaqet gati i barabartë; në vitin 1936 shfaqet 2.3 : 1; në vitin 1937 shfaqet 1.8 : 1; në vitin 1938 nuk ka të dhëna dhe në vitin 1939 - 40 shfaqet 1.6 : 1. E vlerësuar për kohën dhe kushtet e vështira që kalonte shteti shqiptar këto tregues numerik në rritje për praninë e vajzave në shkollat e mesme pasqyrojnë në vetvete edhe një ndryshim të mentalitetit të kohës, depërtimin e elementëve civilizues dhe bindjen brenda familjes se arsimimi ishte një mundësi edhe për vajzat për të ardhmen e tyre.

Tabela nr. 3: Pasqyra përmbledhëse për arsimin fillor [meshkuj - femra].

Pasqyra përmbledhëse për arsimin fillor në vitet 1934 – 1940

Vitet	Meshkuj	Femra	Gjithësej	% Femra
1934 - 1935	37. 705	15. 317	53. 022	28. 9
1935 -1936	17. 329	15. 612	52. 941	29. 5
1936- 1937	36. 898	15. 586	52. 484	29. 7
1937 - 1938	37 .323	19. 203	54. 526	35. 2
1938 - 1939				
1939 - 1940	37. 265	19. 500	56. 765	34. 4

Shtrirja e sistemit të shkollave pothuajse në të gjithë vendin hapi rrugën për mundësinë e arsimit të vajzave. Në sistemin e shkollave të mesme funksiononin; shkolla e Punës - Peshkopi, shkolla e Punës - Durrës [27.7 për qind femra], shkolla Normale - Elbasan [2.6 për qind femra], shkolla e Punës - Elbasan [34.5 për qind femra], shkolla Mashkullore - Gjirokastrë, shkolla Femërore -

Gjirokastrë [100 për qind femra], shkolla e Punës - Berat [25. 4 për qind femra], shkolla Mashkullore - Korçë, shkolla Femrore - Korçë [100 për qind femra], Liceu - Korce, Gjinnazi - Shkodër, shkolla “Donika Kastrioti” - Shkodër [100 për qind femra], Liceu - Shkodër [1.3 për qind femra], Gjinnazi - Tiranë, shkolla Normale - Tiranë, Instituti Femror - Tiranë, shkolla Teknike - Tiranë, shkolla e Vizatimit - Tiranë, Liceu - Tiranë, Instituti Tregtar - Vlorë, shkolla e Punës - Vlorë [14 për qind femra], shkolla e Punës - Lushnje, Instituti Shqiptaro - Amerikan - Kavajë, shkolla e Punës - Kavajë, shkolla e Punës Burrel etj.

Në burimet arkivore ekzistojnë të dhëna me shkollat sipas qyteteve dhe prefekturave kryesore, të cilat tregojnë se institucionet shtetërore të kohës ishin të interesuara dhe të kujdësëshme për të evidencuar të dhënat e zhvillimit të arsimit në Mbretërinë Shqiptare, duke synuar ta vendosnin atë mbi baza moderne sipas përvojës perëndimore.

Tabela nr. 4: Të dhënat statistikore të pranisë së femrave në shkollat e mesme, 1934-1940. [A.Q.SH.i R.SH.F.188,1933, D 2, 1934, D 6, 1936, D 8, 1935/36, D 10, 1937, D 14, 1938-39, D 19, ‘39-’40,D 33].

Nx. shk. e mesme				
Viti 1933-34		AQSH F.188 V.1933 D.2 fl.2		
Lloji	Meshkuj	Femra	Gjithësej	% Femra
Gjinnaze, lice	1537	351	1888	18.6
Teknike	526	0	526	0.0
Tregëtare	238	0	238	0.0
Bujqësore	64	0	64	0.0
Normale	893	188	1081	17.4
Qytetëse	428	174	602	28.9
	13	0	13	0.0
Shkolla, vizatim				

Shuma	3699	713	4412	
-------	------	-----	------	--

AQSH i RSH F.188 V.1933 D.2 fl.2

Tabela nr. 5: Statistikat për vitet 1934 - 1935 [meshkuj dhe femra]

Gjimn. v. 1934-35		AQSH F.188 V.1934 D.6 fl.1		
Lloji	Meshkuj	Femra	Gjithësej	% Femra
Gjimnaze lice	1938	539	2477	21.8
Teknike	419	0	419	0.0
Tregëtare	28	0	28	0.0
Shk. Bujq. Kavajë	82	42	124	33.9
Normale	270	108	378	28.6
Qytetëse	981	255	1236	20.6
Shk.vizatimi	12	0	12	0.0
Shuma	3730	944	4674	20.2

AQSH i RSH F.188 V.1934 D.6 fl.1

Tabela nr. 6: Statistikat për vitet 1935 - 1936 [meshkuj dhe femra]

Gjimn. v. 1935-36		AQSH F.188 V.1936 D.8 fl.1		
Lloji	Meshkuj	Femra	Gjithësej	% Femra
Gjim lice	2127	578	2705	21.4
Teknike	313	0	313	0.0
Tregëtare	17	0	17	0.0
Shk bujq. Kavajë	61	38	99	38.4
Normale	222	120	342	35.1
Qytetëse	954	284	1238	22.9
Shk. vizatimi	15	0	15	0.0
Shuma	3709	1020	4729	21.6

AQSH i RSH F.188 V.1936 D.8 fl.1

Tabela nr. 7: Statistikat për vitet 1935 - 1936 [meshkuj dhe femra].

Gjimnazet.		viti 1936 – 37		
AQSH. F.188 V.1936		V.1936 D.10 fl.5		%
Lloji	Meshkuj	Femra	Gjithësej	FEMRA
Gjim. LICE	2243	763	3006	25.4
Tenike	277	0	277	0.0
Tregëtare	44	0	44	0.0
Shk. Bujq. Kavajë	0	49	49	100.0
Normale	294	15	309	4.9
Qytetes	1125	378	1503	25.1
Shk vizatimi	11	0	11	0.0
Shuma	3994	1205	5139	23.4

AQSH I RSH. F.188 V.1936

Tabela nr. 8: Statistikat për vitet 1937 - 1938 [meshkuj dhe femra].

Gjimnazet.		v. 1937-1938		
		AQSH. F.188 V.1937 D.14 fl.1		%
Lloji	Meshkuj	Femra	Gjithësej	FEMRA
Gjim. lice	2388	709	3097	22.9
Normale	353	263	616	42.7
Teknike	301	0	301	0.0
Tregëtare	54	0	54	0.0
Qytetase	1107	482	1589	30.3
Shk. bujqes Kavajë	78	0	78	0.0
Shk. viz. Shuma	10	0	10	0.0
Shuma	4291	1454	5745	25.3

AQSH i RSH. F.188 V.1937 D.14 fl.1

Tabela nr. 9: Statistikat për vitet 1938 - 1939 [meshkuj dhe femra].

Gjimnazet.		v. 1938-1939		
------------	--	--------------	--	--

		AQSH. F.188 V.1939 D.19 fl.2		%
Lloje	Meshkuj	Femra	Gjithësej	FEMRA
Gjimn. Lice	2334	597	2931	20.4
Shk. Normale	600	515	1115	46.2
Teknike shtëpiake	280	0	280	0.0
Shk. Tregëtare	71	0	71	0.0
Shk. pune 4vjeçare	1071	516	1587	32.5
Shk pune 2 vjeçare	86	0	86	0.0
Bujq. Ek. Shtep.	103	0	103	0.0
Shuma	4687	1628	6315	25.8

AQSH i RSH. F.188 V.1939 D.19 fl.2

Tabela nr. 10: Statistikat për vitet 1939 - 1940 [meshkuj dhe femra].

Gjimnazeve per vitin 1939-40				
AQSH. F.188 V.1939 D.33 fl.4				%
Lloji	Meshkuj	Femra	Gjithësej	FEMRA
Lice	1977	662	2639	25.1
Normale	656	540	1196	45.2
Inst teknik i Korçës	537	0	537	0.0
Inst. tregëtar Vlorë	294	30	324	9.3
Inst bujqës. Kavajë	175	0	175	0.0
Liceu - shkoll punës Gjirok.	241	70	311	22.5
Shkolla pune 4 vjeçare	691	465	1156	40.2
Shkolla pune 2 vjeçare	68	0	68	0.0
Shuma	4639	1767	6406	27.6

AQSH i RSH. F.188 V.1939 D.33 fl.4

Të evidentuara nga viti 1934 deri në vitin 1940, të krahasuara vit pas viti, konstatohet lehtë rritja numerike e pranisë së vajzave në shkollat e mesme. Gjithashtu, të krahasuara këto të dhëna me

përqindjen e vajzave në sistemin e shkollës fillore, ka një ulje të pandjeshme e cila jep të dhënat e vazhdimësisë së arsimimit për vajzat.

Pasqyrimi i të dhënave statistikore në materialin studimor nëpërmjet tabelave të nxjerra nga A.Q.SH. për shtrirjen e sistemit arsimor për periudhën e Mbretërisë Shqiptare. Nëpërmjet studimit krahasues sipas viteve, vërehet një përkujdesje e shtetit veçanërisht pas viteve 1928, kur shteti shqiptar filloi funksionin e tij kushtetues. Hapja e shkollave gradualisht sipas sistemeve moshore, dha mundësinë për praninë e vajzave dhe mundësinë e arsimimit të tyre. Në këtë periudhë, sipas zhvillimeve dhe tendencave në emancipimin shoqërorë vërehen dy pamje; së pari, gratë dhe vajzat e arsimuara në perëndim nën efektet e ndikimeve letrare të viteve '30-të dhe lëvizjes feministe në Evropë, japin sinjalet e para të pranisë së tyre aktive në mjedisin social shqiptar dhe së dyti; paralelisht me këtë brez, në sistemin arsimor fillor dhe të mesëm që u përhap në tërë vendin, po niste rrugën e arsimimit një brez i ri numerikisht në rritje, në përfaqësimin e të cilit vajzat përbënin 1/3 e numrit të përgjithshëm të nxënësve në shkolla. Reflektimet e para të këtij brezi të arsimuar dhe të edukuar me frymën kombëtare dhe vlerat e historisë së popullit shqiptar, do të shfaqeshin me pjesmarrjen masive të grave dhe vajzave shqiptare në periudhën e Luftës së Dytë Botërore për çlirimin e vendit nga pushtimi fashist.

3.2. Legjislacioni mbi çështjet gjinore dhe situatën e grave: një referim në Kodin Civil të Mbretërisë Shqiptare.

Me hyrjen në fuqi të “*Kodit Civil të Mbretërisë Shqiptare*” më 1 Prill 1929, pozita e gruas në familje mbeti e pandryshuar [Basha, Ali, 2011:160]. Megjithatë, Kodi Civil ishte një hap i mirë përpara, duke qenë i bazuar në modelin e kodeve klasike borgjeze të kohës, në rregullimin e marrëdhënieve të burrit në familje, si rrjedhim në parimin e pabarazisë së gruas me burrin. Në Kodin Civil shpallej se, gruaja kishte kapacitet të plotë civil, por nga ana tjetër kjo e drejtë

mbetej formale nga dispozitat që parashikonin ligjet në fuqi. Sipas këtyre dispozitave, gruaja nuk mund të ushtronte asnjë profesion pa lejen e burrit, vendbanimi i saj ishte ai i burrit dhe martesë e saj me një të huaj sillte automatikisht ndryshimin e shtetësisë së saj, ç'ka tregonte pozitën e nënshtruar të gruas në jetën familjare. Kodi pasqyronte raportet klasore, në të cilat gratë ndodheshin nën peshën e pabarazsisë së dyfishtë... *“në raport me burrat, ato vuanin nga pabarazia dhe inferioriteti në të cilin i kishte vënë rendi shoqëror sundues”* [Begeja, Ksanthipi, 1975:124].

Në trajtimin ligjor të problemit të martesës e familjes, Kodi Civil solli disa ndryshime të rëndësishme;

“ndaloi poligaminë, që ishte shumë e përhapur në myslimanët; bëri të detyrueshme martesën civile dhe nuk njohu pasojat juridike të martesës fetare; nuk njohu ndalimin për martesë që ekzistonte për shkak të ndryshimit të fesë së bashkëshortëve; iu njohu të drejta të barabarta për të kërkuar zgjidhjen e martesës, si burrit, ashtu dhe gruas”. [Begeja, Ksanthipi, 1989:41].

Kodi Civil 1929 [Kodi Civil i Mbretit Zog] miratuar më 1 prill të vitit 1929, hartuar nën ndikimin e modelit francez, u quajt jo rastësisht Kodi Civil i Zogut. Ai do të përfaqësonte një risi në realitetin që prezantonte shteti dhe shoqëria shqiptare e asaj kohe. Padyshim, të drejtat e huaja e veçanërisht ato franceze, italiane dhe deri diku gjermane e zvicerane, do të frymëzonin legjislatorin shqiptar për të sanksionuar në dispozitat e tij barazinë e të gjithë qytetarëve, emancipimin e pronësisë mbi tokën dhe lirinë për angazhim në aktivitete ekonomike. Dallohet si element i veçantë në marrëdhëniet familjare sanksionimi i pabarazisë së gruas dhe gjendja inferiore e saj kundrejt burrit. Kjo shprehej në nenin 188 ku thuhej se: *“Burri asht kreu i familjes. Gruaja ndjek pozitën civile të burrit, merr mbiemrin e tij dhe detyrohet me e shoqëruar kudo që ai e shef të arsyeshme me caktue qëndresën e vet”*. Martesa lidhej me kontratë, me një akt noterial para celebrimit të martesës. Gjithashtu, njëherë pavlefshmëria e kontratës së martesës, bazuar në shkaqe që shiheshin si të arsyeshme për të prishur martesën. [Rahmani, Sonila, <http://juridiksi.e>].

Megjithatë, këto të drejta pengoheshin në praktikë nga tradita shekullore që prej Kanunit të Lek Dukagjinit, i cili mbahej gjallë në zonat veriore, apo ligjeve të Sheriatit, të instaluar në kohën e pushtimit osman në Shqipëri dhe për të cilat u bë shumë pak në kohën e Mbretit Zog. Ndonëse teorikisht kundërshtoi dhe hoqi veprimin e ligjit të Sheriatit, hyrja në fuqi e Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, të përshtatura nga kodet përkatëse italiane dhe zviceriane, teorikisht e përmiresuan ndjeshëm gjendjen juridike të grave shqiptare.

Analiza studimore çon në përfundimin se, gjendja e grave nuk ndryshoi shumë, madje as në qytetet kryesore të vendit. Masat e marra nga pushteti i Mbretërisë Shqiptare ishin fasadë, madje deri në fryrje të pabazuar. U nxit shkollimi i femrave për tre klasat e para fillore, por përqindja e analfabetizmit të tyre ishte në 92 %. Madje, Tirana kishte vetëm një shkollë të mesme për vajzat e elitës, e cila u quajt *“Instituti Nana Mbretëreshë”*. Në disa punishte të pakta duhani, sapuni e tezgjahu, aq sa ofronte industria e reduktuar e kësaj kohe, e cila nuk mundësonte shumë nga pikëpamja e infrastrukturës, nxiti nevojën e punësimit të gruas.

Në këtë periudhë u arrit të punësoheshin disa dhjetra gra jashtë mureve të shtëpisë. E drejta e trashëgimisë së pronës së barabartë midis burrit dhe gruas, në përgjithësi, zbatoheshin me korrektësi nga gjykata mbretërore. E drejta e gruas për të zgjedhur lirisht bashkëshortin, si dhe për ta divorcuar atë, çalonte shumë në praktikë.

Gruaja shqiptare jo vetëm në fshat e në malësi, por shumë shpesh edhe në qytet, martohej me mblesëri, madje shitej dhe blihej. E drejta e divorcit e mbrojtur me ligj, pengohej në praktikë nga tradita shekullore në fshat e qytet.

Pjesëmarrja e tyre në jetën kulturore të vendit ishte jashtëzakonisht e kufizuar: disa shkrime në shtypin e kohës; disa këngëtare apo disa amatore të teatrit. Maksimumi që ofroi regjimi ishin fotot për shtypin e kohës të pak grave që të veshura alla frënga kalëronin, ngisnin biçikletën apo makinën. Mijëra gra shqiptare të tjera, thjeshtë jetonin në mesjetë.

KAPITULLI IV: Ndërveprimi dhe ndërvarësitë midis problemit gjinor dhe problemit fetar në shoqërinë shqiptare.

Problemi gjinor ka bashkëjetuar në çdo kohë me problemet fetare në shoqërinë shqiptare. Besimet fetare përgjithësisht kanë justifikuar dhe legjitimuar pabarazinë e grave ndaj burrave. Në këtë këndvështrim, qeveritë shqiptare dhe institucionet fetare kanë qenë në një aleancë spontane. Nga kjo aleancë bën përjashtim regjimi komunist, i cili e denoncoi lidhjen historike dhe tradicionale midis fesë dhe pabarazisë gjinore në shoqërinë shqiptare. Regjimi shkoi më tej, duke e paditur fenë si ushqimin kryesor të pabarazisë gjinore dhe luftën kundër besimeve, institucioneve fetare, e legjitimoi pikërisht me këtë interpretim.

Ndjenja e frikës për të mos e prekur, për të mos e lënduar apo hequr kapakun e vendosur mbi dhimbjen dhe vuajtjen e shumicës së individëve në sistemin e diktaturës së proletariatit, duket sikur po kërkon të shndërrohet në dëshirë të modelit demokratik për ta rivendosur besimin sa më thellë dhe sa më larg të jetë e mundur. Regjimi komunist u pozicionua kundër fjalës dhe frymës së shenjtë. Nuk i ka shpëtuar këtij qëndrimi vlerësimi i barazisë gjinore në ndërvartësi të besimit fetar. Në rastin e mundësisë dhe të mosdashjes, dëshpërimi i shoqërisë do të mbetet i pashmangshëm.

4.1. Feja në periudhën midis dy luftrave.

Qeveritë shqiptare nuk kanë qenë indiferente ndaj imponimit prej fesë, sidomos asaj myslimane, mbi traditën e zakoneve dhe normave të sjelljes së saj ndaj grave dhe vajzave. Në bisedimet e Këshillit Kombëtar më 10 mars 1923, Ali Këlcyra propozoi të vendosej heqja e mbulesës së grave myslimane. Në favor të propozimit të Ali Këlcyrës ishin Fasil Frashëri e Bedri Pejani, ndërsa kundër Shefqet Daiu, Jusuf Banka, Koço Tasi, Osman Haxhiu, Visar Xhuvani, Xhemal Bushati, Sejfi Vllamasi, Ibrahim Xhindi e Imzot Fan Noli.

Në diskutimi e tij Noli theksoi:

“Nuk dua të hyj në esencë të çështjes, se kjo është një çështje e cila duhet zgjidhur prej Vëllezërve tonë muhamedanë edhe as nuk duhet të trazohemi në punë të tyre. Vetëm dua t’i heq vërejtjen Z. Ali Këlcyrës, se nuk është parë në historinë e botës që një gjë e tillë të jetë shkaktuar nga anë e Qeverisë, Parlamentit apo kongresit. Zakonet e mbulimit të gruas nuk i kanë pasë vetëm popujt e besimit muhamedan, por edhe popujt e krishterë. Po të shikojmë librat e Sh. Palit, do të shohim se mbulesa e gruas ka qënë një mëkat më i madh; e këto zakone i kanë pasë edhe Bizantinët e Venezinët. Në të gjithë popujt Evropianë, gratë kanë dalë me një farë veli shumë më shpesh se këtu. Megjithë këtë, nuk kemi pasur asnjë urdhër asnjë sinodë me të cilën të jetë shkaktuar zbulimi i gruas; ky zbulim ka ardhë vet - vetiu, e evolucionit social ka sjellë ndërrimin gradual të zakoneve të shoqërisë, e se ato ndrrime që kanë ardhë gjatë do të vijnë edhe këtu. Se, a duhet të dali gruaja e zbuluar apo e pazbuluar, kjo nuk na intereson shumë, por duhet të na heqë vërejtjen gjendja e mjeruar në të cilën ndodhet gruaja shqiptare edhe për këtë do t’u sjell e një shëmbull, se sa heqi edhe ato gra që janë të zbuluara. Kur kam vajtur nga Vlora në Tepelenë, Elbasan e Tiranë e gjatë, kam pa katundarka të zbuluara, të cilat punojshin e mundoheshin si shtaza sa të vjen me qe, kurse burrat e tyre rrinin pa punë dhe prisnin që për çdo gjë t’u ngriheshin në këmbë ato të mjera”. [Basha, Ali ,2011:238]

Politika laike në shtetin shqiptar ishte prezente në periudhën e Mbretërisë Shqiptare, si në periudhën republikane ashtu dhe në atë mbretërore. Në Kushtetutën e vitit 1920-të, shteti ishte ndarë nga bashkësitë fetare, duke mos njohur egzistencën e një feje zyrtare në Shqipëri. Në nenin “39” të Kushtetutës përcaktohej;

“respektimi i të gjitha feve dhe besimeve, të cilat nuk u lejohej në asnjë mënyrë të ndiqnin politikën dhe shpallte parimin e një shteti laik, që nuk njihte asnjë fe të shtetit dhe deklaronte mospërzjerjen e tij në punët e fesë dhe barazinë midis feve”. [Basha, Ali, 2011:34].

Ndarja e fesë nga shteti kishte filluar shumë më herët që në vitin 1928, kur Mbreti Zog realizoi laicizimin e shtetit, pra realizoi shekullarizmin e tij, duke shpallur fenë të shkëputur nga jeta politike. Kjo nënkuptonte që, të gjithë klerikët si dhe institucionet e tyre si, kishat, manastiret, teqetë, shoqatat e besimtarëve të bëheshin persona të thjeshtë juridik dhe se shtetasit shqiptarë do t’i nënshtroheshin vetëm ligjeve shtetërore dhe jo më atyre kanonike. Lidhjet e tyre me

organizatat e tjera, do të ishin vetëm shpirtërore. Kjo “vulosi” hyrjen e fesë nën kontrollin shtetëror. Ky statut u sanksionua nga Fuqitë e Mëdha në vitin 1914, vazhdoi me Statusin e zgjeruar të Kongresit të Lushnjës, në Statusin e Republikës së Shqipërisë në vitin 1925, si dhe në statutin themeltar të Mbretërisë Shqiptare në vitin 1928. Të gjitha legjislacionet ishin bashkëkohore, ku sanksionoheshin të drejtat e barabarta të shtetasve përpara ligjit, pavarësisht besimit fetar të cilit ata i përkisnin. Juridiksioni laik zëvendësoi juridiksionin fetar në jetën shoqërore.

Mbreti Zog miratoi dekretin mbi administrimin e bashkësive fetare. Ky dekret ndryshoi si statusin, ashtu dhe privilegjet e tyre. Ata nuk kishin me të drejtë të zhvillonin asnjë veprimtari me karakter politik dhe duhej të kishin juridiksionin e vet, statusin e tyre që miratohej nga qeveria. Drejtuesit zgjidheshin nga vet mbreti, nuk kishin të drejtë votimi dhe nuk mund të kishin asnjë detyrë politike, nuk merrnin asnjë ndihmë apo subvencion nga jashtë.

“Sektet Fetare janë pjesëtarë të komunitetit përkatës. Çdo Sekt [Tarikat] përsa i përket administrimit të tij të brëndëshëm, zgjedhjes emërimit, pushimit dhe disiplinës së klerit, ashtu dhe administrimit të pasurisë, vepron në bazë të traditave dhe rregullores së vet. Çdo Kryetar Sekti, zgjidhet në bazë të rregullores së vet edhe emërohet prej Kryetarit të Komunitetit respektiv, përveç Kryetarëve të sekteve me rëndësi, që do t’i paraqiten Qeverisë në linjën e Kryesisë së komunitetit respektiv për dekretimin Mbretëror. Secili sekt ka të drejtë të zgjedh një delegat për të marrë pjesë në Këshillin e Përgjithëshëm, ose në Kongresin e Komuniteteve përkatëse”. [Basha, Ali, 2011:141-144].

“Me rastin e fronëzimit të Mbretit tonë, Zogu i I-rë, në Tiranë, krerët e klerit Bektashian ishin më të parët e çdo kleri tjetër, që u paraqitën para Madhërisë së Tij, Mbretit të Shqiptarëve, për të parashtruar urimin dhe besnikërinë e tyre. Në atë audiencë historike, në shtator të vitit 1928, për bektashinjtë e Shqipërisë ajo u kthye në një periudhë të re të lumturisë së tyre”. [Turabiu, Ali, 1929 :61].

Në këto vite besimi mysliman, bektashi dhe ortodoks shpallën autoqefalinë e tyre, duke u shpëputur shpirtërisht, ekonomikisht dhe nga ana administrative nga shteti shqiptar si dhe nga shtetet e tjera, të cilat i kishin përkrahur.

“Patrikana Greke e njohu autoqefalinë e Kishës Ortodokse në vitin 1937. Në këtë vit, në krye të Kishës Ortodokse u vendos një klerik atdhetar, Kristofer Kisi. Marrëdhëniet e tij me klerin katolik nuk ishin të njehta, patën shumë probleme me ligjet e reja për arsimin, në të cilën ai nuk lejonte shkollat e huaja me karakter fetar”. [Turabiu, Ali, 1929:302].

Ndërkohë, kleri katolik nuk e njohu legjislacionin shqiptar dhe ruajti lidhjet e tij me Vatikanin. Madje në vitin 1936, nëpërmjet një urdhëri të brendshëm dhe pa bërë asnjë ndërhyrje në legjislacion, u lejua rihapja e shkollave private vetëm për besimin katolik. Pra, për arsye të borxheve të mëdha ndaj Italisë, Mbreti Zogu i Parë i bëri lëshime rihapjes së shkollave të besimit katolik.

Kleri mysliman ishte më i bindur në këto marrëdhënie, megjithëse dhe midis klerikëve mysliman dhe shtetit pati kontradikta. Dekreti mbi komunitetet fetare, mbi bazën e propozimit të Qeverisë Mbretërore dhe Kryeministrit, me Nr.1768, datë 4. 7. 1929, rezulton i nënshkruar nga;

“Trupi Ministror, i ngarkuar me zbatimin e këtij Dekret – Ligji, nga Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Brëndëshme, K. Kotta [d.v.], Ministri i Drejtësisë: H. Delvina, Ministri i Punëve të Jashtëm R. Fico, Ministri i Punëve Botore S. Veçiterni, Ministri i Ekonomisë Kombëtare, M. Juka dhe në fund nga vetë Mbreti i Shqiptarëve, Zogu i Parë [d.v.]”. [Turabiu, Ali, 1929:66].

Në datën 9 korrik ky projekt - dekret merr miratimin e Mbretit Zog dhe në datën 9 janar të vitit 1930, fillon zbatimin e tij.

Vënia e klerit nën kontrollin e shtetit nuk ishte, siç do të shohim, një dukuri vetëm komuniste. Ky proces filloi që në kohën e Mbretit Zogu i Parë. Në përjashtim ishte kleri katolik, i cili vazhdoi të kishte lidhje shpirtërore, ekonomike dhe administrative me Vatikanin, që zgjidhte ipeshkvët dhe të gjithë hierarkët në instancat drejtuese brenda kishës katolike.

Zogu miratoi statutin civil dhe atë penal, të zbatuar më parë nga vendet perëndimore. Në kodin e ri civil, Mbreti Zog shkëputi lidhjet midis shtetit dhe kishës. Shqiptarët kishin legjislacionin e tyre juridik, duke shkëputur kështu traditën kanonike. Situata shumë e ndërlikuar në Shqipëri, prej kohësh kishte mundësuar që bashkë me besimet fetare, duke konsideruar dhe ndikimin e tyre nga shtetet e tjera, të sillte mundësinë e depërtimit të tyre nëpërmjet fesë. Kështu, kleri mysliman pati ndikim nga shteti turk për shkak të influencës turke, mbështetjes financiare apo varësisë administrative. Kështu ndodhi me klerin katolik nën ndikimin papal, apo atë ortodoks nën ndikimin grek, shtete të cilat kishin pasur interes territorial dhe politik ndaj Shqipërisë.

Gjithësesi, legjislacioni mbretëror parashikonte që,

“Komunitetet fetare, me predikimet e tyre janë të detyruara të japin këshilla për të zgjuar zhvillimin e ndjenjave Atdhetare ndaj besimtarëve të tyre në interes të forcimit të Bashkimit Kombëtar. Funksionimi i organizatave të komuniteteve fetar, do të jetë gjithmonë me baza kombëtare dhe të gjithë funksionarët do të jenë të njohur pa përjashtim me sjelljen Kombëtare“. [Turabiu, Ali, 1929:79].

Interesat e shteteve të huaja dhe fqinj ndaj Shqipërisë, lidheshin me përbërjen multifetare fetare të popullsisë së saj. Në regjistrimin e popullsisë të viteve '30-të, rezultonte se myslimanët ishin 696. 000 banorë, ortodokset 20. 000, kurse katolikët 105. 000 banorë. [Jacques, Edvin, Studime v. 1995 : 437]. Sipas këtyre statistikave, numri i myslimanëve ishte shumë më i lartë për shkak se, ishte rritur artificialisht prej politikës pushtuese të Turqisë, e cila u zbatua në shumë forma.

Në vitet në vijim, popullsia e Shqipërisë ruajti pak a shumë këto shpërpjestime. Në regjistrimin e popullsisë në vitin 1945, Shqipëria kishte 72. 8 % popullsi myslimane, 10 % katolike, 17. 1 % orthodokse [Po aty: 490], duke qenë i vetmi vend në Evropë me kaq shumë popullsi myslimane. Premtimet e bëra nga komunistët për barazi sociale, liri fetare, shoqëri pa klasa pa shtypës dhe shfrytëzues, ishin refren i kohës që gjatë luftës Nacional - Çlirimtare dhe akoma më shumë, kur ata morën pushtetin dhe filluan ta konsolidojnë atë. Shumë shpejt regjimi do të justifikonte sulmin e paprecedent ndaj klerit katolik, me fajësimin e klerikëve katolikë për krime të pakryera. Në fakt, prapa këtyre sulmeve qëndronte frika e regjimit prej faktit se, klerikët katolikë ishin shtresa më e shkolluar dhe më e emancipuar e shoqërisë shqiptare.

4.2. Sjellja e klerikëve fetarë gjatë Luftës Antifashiste Nacional - Çlirimtare dhe qëndrimi i tyre ndaj vendosjes së regjimit komunist.

Duke ju referuar botimit të *“Historisë së Bektashizmit“*, dalin në pah disa fakte që shpjegojnë liberalizimin e këtij besimi tradicional shqiptar qysh në fillim të veprimtarisë së tij në trevat

shqiptare dhe disa dukuri që tërheqin vëmendjen, veçanërisht qëndrimi ndaj grave e vajzave dhe familjes;

1]. Liria dhe nderi i grave në barazim me burrat. 2]. Faljet dhe agjërimet e pakta, por të mira dhe të plotë. 3]. Rregulli i jetesës shtëpiake në dashuri të plotë, bindje, barazi, punë dhe pastërti shembëllore. 4]. Lindja e kësaj doktrine në një fshat të vogël të Anadollit dhe përhapja e saj me hapa të shpejtë në të tre kontinentet e pushtuara nga perandoria otomane ...[Turabiu, Ali, 1929 :23]

Bektashinjtë kishin shpallur besimin e tyre te pavarur në vitin 1921, i cili u miratua si status në vitin 1923. Largimi i tyre nga ndikimi turk u shoqërua me ngritjen e qendrës së tyre në Tiranë, e cila u bë zyrtarisht Qendra Botërore e Bektashizmit. Organizimi institucional i tyre ishin teqetë që drejtoheshin nga babai ku shërbenin dervishët. Fryma kombëtare e këtij besimi shfaqej hapur në kohë të herëshme.

“Varfë Meleq, Tahir Staravecka [në kohën e fundit Baba Meleq Shëmbërdhenji] tridhjet vjetë me radhë, shëtitë Shqipërinë fshat më fshat, nga Ulqini gjer në Prevezë, duke përhapur libra për rilindjen e Shqipërisë, e të gjithë teqetë, hynë në formën e shkollave kombëtare, duke predikuar “Qerbelanë”, përkthyer me poezi të gjallë prej të pavdekshmit vjershëtor, Naim Bej Frashërit”. [Turabiu, Ali, 1929:55].

Gjatë luftës, kleri bektashian u rradhit pro Frontit. Pas çlirimit të Shqipërisë, ata u deklaruan pro qeverisë, dëshmuan vullnetin e tyre me ndihma për popullsinë. Ndërkohë, në shtypin e kohës, në të vetmin organ zyrtar, gazeta *“Bashkimi”*, aktiviteti i Kryegjyshitës Botërore ishte gjithmonë i pranishëm në përkrahje të politikës së pushtetit popullor për t’iu përgjigjur pozitivisht thirrjeve të tij. Në një prej numrave të gazetës shkruhej:

“Më 10 të këtij muaji, u çel mbledhja e këshillit të komunitetit Bektashian në qëndër Kryegjyshitës Tiranë. U bisedua pjesëmarrja e fetarëve bektashinj në aktivitetet për rindërtimin e Shqipërisë së re Demokratike. Bektashinjtë kanë qenë çerdhe të patriotizmit, duke dhuruar bijtë e saj dëshmore si, Baba Abas Rabia, Baba Fejzo Martaneshi, Baba Fejzo Krahasi. Ky bisedim u mbyll, duke sajuar vullnetarisht prej çdo Teqeje ndihmë për asistencën sociale në një shumë prej 67. 100 fr shqiptare. [Gazeta “Bashkimi”, 1945, nr.46:2].

Megjithatë edhe pse bektashinjtë dervish dhe baballarë morën pjesë në luftë kundër forcave okupatore, duke arritur dy prej tyre gradën e *“kolonelit”* si, Baba Faja Martaneshi dhe Baba Fejzo Dervishi, presionet ndaj tyre nuk munguan. Si pasojë udhëheqësi i tyre i lartë, Dede Abaz Hilmi, u vetëvra në marsin e vitit 1947, pas pretendimit se, *“ai kishte vrrarë me pistoletë dy baballarë me shumë influencë dhe të afërt me Enver Hoxhën”*.

Krahas klerit Bektashi edhe ai Ortodoks, njohu pushtetin popullor dhe u deklarua pro tij. Kishat Shqiptare të Amerikës lëshuan thirrjen: *“Kishat Shqiptare të Amerikës u bëjnë apel tre aleatëve të mëdhenj për njohjen e qeverisë demokratike. Të njihet zyrtarisht qeveria shqiptare në Berat, nën kryesinë e gjeneral - kolonel Enver Hoxha”*. [Gazeta “Bashkimi”, 1945, nr. 53:4]. Në përshëndetje të këtyre lëvizjeve të klerikëve bektashi dhe atyre ortodoks, gazeta “Bashkimi” në kryeartikullin e datës 19 prill 1945 shkruante: *“Shqiptarët e Amerikës, orthodoxe dhe muhamedanë me Konicën dhe Nolin në krye, i duall për zot bashkimit kombëtar dhe çlirimit të Shqipërisë”*. [Gazeta “Bashkimi”, 1945, nr. 100:1].

Ndërkohë që bektashinjtë dhe ortodoksët kishin shpallur autoqefalinë, kleri katolik vazhdonte lidhjet me Vatikanin, të akuzuar për lidhje me pushtuesit gjatë periudhës së luftës. Marrëdhëniet e mira midis klerit katolik dhe pushtuesve italianë filluan që në vitin 1943, për shkak të lidhjeve të ngushta me Vatikanin. Vasalitetin ndaj pushtimit italian e shpallën edhe krerët ortodoksë, myslimanë dhe katolikë. Në veri lidhja me Italinë ishte shumë e largët, që nga koha e Skënderbeut dhe lidhjet me Venedikun lanë gjurmët e tyre. Kleri katolik pati përfaqësuesin e tij në qeverinë gjermane, të krijuar në vitin 1943.

Në vazhdim, kisha katolike u akuzua si predikuese kundër reformës agrare. Në një letër drejtuar legatës mbretërore për ndihmë financiare nga Qeveria Mbretërore Italiane theksohet se, *“Toka i takon atij që e punon - ky është parimi i ligjit thotë pushteti popullor, ndërsa Krishti nuk ka thënë t’u merret toka e fitume me mund dhe djersë atyne që e kanë dhe t’u epet fshatarëve që punojnë”*. [Gazeta “Bashkimi”, 1946, nr. 326:1]. Kjo shërbeu për t’i trajtuar klerikët si armiq të reformës. Nisur nga shkrimet e tyre gjatë qeverisjes italiane, siç ishin Pater Giuseppe Valentini dhe Fulvio Cordignano, në revistën “Leka” në kryeartikullin e saj do të theksohej: *“Kush don me krye detyrën, kush do me kenë i drejtë, kush asht gati me u ba fli për të mirën e vëllazërisë, le ta quajë veten fashist”* 1941. [Gazeta “Bashkimi”, 1946, nr. 326:1].

Ndërsa Gordignano, në revistën “D’albania” në 1941 shkruante; *“gjithë kjo, sigurisht do të ndreqet nga një aktivitet fetar, në kuadrin e asaj drejtësie absolute, që sot Italia i ka sigurue popullit shqiptar”*. [Gazeta “Bashkimi”, 1946, nr. 329:1].

Gjyqet kundër klerikëve filluan në shkurt të vitit 1946. Prandaj duhet pranuar se viti 1967, nuk ishte sulmi i parë dhe i vetëm ndaj klerit. Gjyqet filluan kundër Patër Anton Harapit, i cili u gjykua për fjalimin e tij të famshëm të Regjencës: *“Mue më ban me dyshue për sinqeritetin e kësaj rryme shqiptare. Masat terroristike mandej vëllavrasja”*. [Gazeta “Bashkimi”, 1946, nr. 340:3]. Ndërkohë, në gjyqin kundër tyre u treguan dhe letrat e Patër Gjergj Fishtës, me simpatinë e tij për pushtuesit italian dhe ndihmën që ata po i jepnin popullit shqiptar; *“..për të ngritur nga mizoria shumë shekullore popullin e mjerë shqiptarë”*. [Gazeta “Bashkimi”, 1946, nr. 340:3].

Don Lazër Shantoja, Patër Fausti, Baba Qamil Gllava, Dede Abaz, Sheh Ibrahim Karbunara, Emezot Viçenc Prendushi, Sali Myftia, Sheh Zenel Fratari, Xhemal Naipi, u cilësuan si tradhëtarë, sabotatorë, komplotistë, bandë kriminale. Myftiu i Durrësit, Mustafa Varoshi, Xhovalin Vllashi, dhe klerikë të tjerë katolikë, të cilët u quajtën *“grupi i Durrësit”*, në lidhje dhe bashkëpunim me deputetë si, Riza Dani, u akuzuan për shërbime ndaj të huajve dhe Vatikanit. Po në këtë vit, në qendrën e Kryegjyshit Botënore në Tiranë, u vranë Baba Fejzo Dervishi dhe kolonel Baba Faja Martaneshi, për të cilën u akuzua padrejtësisht Dede Baba Abas. Pra, u eliminuan figura të shquara të luftës kundër pushtuesit.

Në atë kohë, E. Hoxha do të shprehej:

“Në këtë luftë vigane të popullit t’onë, u shemb nga themelet shoqëria e vjetër e privilegjeve dhe e padrejtësisë, nga gjiri i popullit u ngrit pushteti popullor. Tashmë u thyen zinxhirët e beut për t’i dhënë fshatarit dritë dhe kulture, për të hapur rrugë, shkolla, kanale, spitale, për të ngritur nivelin e jetesës”. [Gazeta “Bashkimi”, 1947, nr. 856:2].

Dobësimi ekonomik, pas reformës agrare dhe ai politik pas statutit, u shoqëruan me valë të egra represioni ndaj klerikëve dhe me fushata agresive në shtyp, në shkolla, institucione apo

organizata të tjera shoqërore. Filloi një konfrontim i pashoq me klerikët, i cili u instrumentalizua nga organet e sigurimit, nëpërmjet direktivave të partisë për të realizuar edukimin ateist të shoqërisë, më tepër të brezit të ri. Në programet shkollore, nuk iu bë asnjë lëshim botëkuptimit fetar. Lufta kundër fesë u intensifikua në fshat, ku ishte numri më i madh i besimtarëve. Në këtë mjedis të prapambetur, propaganda ateiste ishte e organizuar në të gjitha shkallët e saj, si në organizatat e rinisë, partisë, gruas etj.

Të tjerë klerikë, që u bashkuan me organizatat antikomuniste nacionaliste, u vranë duke luftuar me strukturat e regjimit, ose kaluan kufirin drejt Italisë dhe Greqisë. Policia sekrete shqiptare u implikua në vrasjen e dy bektashinjve shqiptarë në ambjentet e tyre, por për këtë vrasje fajësuan kreun e tyre.

Pas prishjeve të marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe intensifikimit të marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, ndryshoi qëndrimin ndaj fesë, duke ndjekur një politikë më tolerante. Nën kujdesin e Stalinit, regjimi komunist akuzoi Koçi Xoxen për sulme të hapura ndaj fesë. Pothuajse çdo klerik i burgosur, u lirua ose dënimi i tij u reduktua. Një shenjë e reflektimit të politikës antifetare ishte gjithashtu fakti se gjatë viteve 1945 - 1965, u ekzekutuan vetëm dy priftërinj katolik dhe disa kisha të mbyllura u lejuan të hapeshin. Një numër i kufizuar të rinjsh, u lejuan të studionin në shkollat e mesme katolike. Disa prona të kishës, u kthyen përsëri në zotërim të tyre. U rilejua botimi i *“Hyllit të Dritës”* dhe u botuan disa libra fetar. Megjithatë, propaganda ateiste vazhdoi duke përdorur çdo mjet juridik për të penguar funksionimin normal të aktiviteteve fetare. Policia sekrete depërtoi në rradhët e klerit katolik shqiptar edhe pse me sukses të kufizuar. Përveç kësaj u përdorën mjete të tjera ligjore si, tatimet e rënda dhe gjobat, për të dobësuar ekonomikisht kishën katolike.

Në këtë periudhë [1947 - 1949], u zbut qëndrimi ndaj Kishës Ortodokse dhe u liruan disa klerikë ortodoksë. Në vitin 1949 Kryepeshkopi Kristofor Kisi u shkarkua dhe u burgos. Më pas në vitin

1958, ai vdiq [Jacques, Edwin, 1995:498-500], duke u zëvendësuar nga Kryepeshkopi Paisi Vodica, i cili shpalli se, “*detyra e kishës ishte besnikëria ndaj pushtetit popullor*”. [Jacques, Edwin, 1995:500]. Kryepeshkopi vendosi marrëdhënie të mira me patriarkanën e Moskës, por këto lidhje nuk do të zgjasnin shumë. Kisha Ortodokse Shqiptare u kthye në një shtojcë të kishës së Moskës.

Në këto kushte statuti themeltar i kishës u ndryshua, për t’u përshtatur në një vijë të pandryshuar në raport me politikën shtetërore. Pronat e Kishës Ortodokse Shqiptare po pakësoheshin dhe tjetërsoheshin përditë e më shumë, duke përdorur dhunën fiskale në vend të konfiskimeve. Në fund të viteve ‘50-të, u ndaluan lidhjet episkopale me Patrikanën e Konstandinopojës dhe Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë. Çdo kontakt me këto institucione, ruhej nëpërmjet Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Studentët shqiptarë nuk u lejuan të studionin jashtë në Bashkimin Sovjetik, apo në vende të tjera të krishtera të ish bllokut komunist. Propaganda kundër fesë dhe ajo ateiste vazhduan.

Në të njejtën mënyrë u veprua me myftinjtë, që u liruan nga burgu në 1949. Megjithatë, disa prej tyre kishin vdekur për shkak të torturave dhe trajtimeve të ashpra në burg. Gjatë kësaj periudhe, prona e madhe e vakëfit ishte shpronësuar me mjete të rënda si, taksat, gjobat, shembje të ndërtesave apo kthimit të tyre në magazina apo qendra kulturore. Të detyruar nga presioni, myftinjtë u kthyen në shërbëtorë të bindur të regjimit. Botimi i Kuranit të Shenjtë u kufizua dhe ai u publikua në 1956, pas Kongresit të XX-të të P. K. të Bashkimit Sovjetik. Gazeta e përjavshme e komunitetit mysliman, vazhdoi të publikohej, por për çdo numër duhej të merrte pëlqimin e organeve të pushtetit. Jeta fetare e komunitetit mysliman, por jo vetëm e tij, ishte nën kontrollin e plotë të pushtetit komunist dhe veçanërisht të policisë sekrete. Myslimanët u sulmuan më pak për arsye se, ishin shumë më të varfër ekonomikisht dhe intelektualisht.

Pas aprovimit të statuteve të institucioneve fetare pas viteve 1950, të gjitha besimet iu nënshtuan politikave imponuese të shtetit. *“Në këto situata revolucionare, kemi marrë vesh se kryesia e klerit bektashian dhe mysliman, u kanë lëshuar një qarkore të gjithë hoxhallarëve e dervishlerëve të heqin çallmat dhe taçet, të heqin xhybet dhe të dorëzojnë teqet dhe xhamitë”*. [ASHV i R.SH. Durres, F.3,V.1967,D. 94,fl.9].

4.3. Ndryshimi i statusit të besimit në Shqipëri në vitet 1950.

Në Shqipëri, praktikoheshin të tri besimet fetare, ai Mysliman, Ortodoks, Katolik. Secili prej tyre, për shkak të ndikimit të pushtimeve të huaja në Shqipëri, padyshim që kishte një orientim të huaj. Nga të gjitha besimet fetare, kisha katolike kishte të kaluar shumë patriotike dhe kulturore në historinë e Shqipërisë. Ajo kishte kontribuar në çdo lëvizje kulturore dhe arsimore. *“Kisha e parë Katolike u ndërtua në Shkodër, në 1857, duke krijuar kuvendet jezuite të vajzave, shkollave”*. [Jacques, Edwin, 1995:284].

Shkolla e parë e dokumentuar në gjuhën shqipe, u hap në Velje të Mirditës më 1632; aty mësohej gramatika shqipe dhe përdorehin librat e Bardhit, Budit dhe Bogdanit. Arsimi katolik mori vrull të madh në Shkodër në vitin 1855, kur krerët françeskan hapën shkollën françeskane; më vonë u themelua një mision në Durrës. Më 1877 jezuitet themeluan në Shkodër një tjetër qendër me influencë për arsimin e lartë; Kolegjin e Shën Françesk Saverit; Observatorin Meteorologjik, i cili u themelua në 1888, i pari në Ballkan deri në 1946, kur u konfiskua nga regjimi komunist. [Jacques, Edwin, 1995:313]. Katolikët kishin të kaluar shumë të pasur në kontributin e tyre atdhetar. Nuk mbeteshin më pas tyre institucionet ortodokse. Kështu, shtypshkronja e Voskopojës u themelua në vitin 1720, e para në Ballkan. Ajo u bë qendra e arsimit dhe e cultures pasi atje u ndërtua *“Akademia e Re”*, e cila u themelua në 1744. [Jacques, Edwin, 1995:315]. Shkrimi më i vjetër toskërisht është ai i vitit 1764 - 1768 i Kosta Jermonak

Beratit, i shkruar në gjuhën shqipe mbi bazën e alfabetit grek. [Jacques, Edwin, 1995:316]. Shkrimet më të hershme në gjuhën shqipe janë “*Kodikët e Beratit*” të vitit 1868, të evidencuara në kishën e Shën Gjergjit. [Jacques, Edwin, 1995:316].

Pas shpalljes së pavarësisë për shtetin shqiptar mjaft klerikë atdhetarë të shquar, duke filluar nga Vehi Dibra, filluan organizimin e institucioneve islamike në Shqipëri, për të qenë të pavarur nga Kalifati. Përfundimisht, pavarësia e besimit në Shqipëri u realizua administrativisht në vitin 1923, me shkëputjen nga Kalifati në Kongresin e parë Mysliman. Kjo u pasua nga krijimi i institucioneve, siç ishin “*Gjyqi i Naltë i Sheriatit*” dhe kryemyftiu Vehi Dibra si dhe gjyqet e Sheriatit nëpër qarqe, të cilat filluan të mbaheshin në gjuhën amtare. Po ashtu, gjithë veprimtaria fetare dallohej për përdorimin e simboleve kombëtare dhe përhapjen e gjuhës shqipe.

Gjatë luftës Nacional - Çlirimtare myslimanët, pjesa më e madhe e tyre, u radhitën në krahun e Frontit. Ata në programin e tyre, padyshim panë aspiratat për një vend të lirë dhe të pavarur. Aspiratat e përfaqësuesve mysliman nuk ishin drejtuar më nga jashtë, por më tepër ata përfaqësonin shumicën e popullatës të vendosur në Shqipërinë e Mesme dhe atë të Jugut. Në rradhët e tyre kishin shumë kuadro që vinin nga lufta, më shumë se besimet e tjera, prandaj qëndrimi ndaj tyre u mbajt më i zbutur pas çlirimit të vendit. Pavarësisht kësaj, ata u trajtuan njëkohësisht si bashkëpunëtorë në shekuj të obskurantizmit në Shqipëri, pra të akuzuar për lidhjet e tyre me periudhën e pushtimit turk.

Në këto kushte, klerikët mysliman do të mbanin përsipër këtë peshë të rëndë morale. Realisht gjatë periudhës së luftës, krerët e lëvizjes antifashiste nuk kishin shprehur hapur synimet e tyre ndaj fesë dhe institucioneve të saj. Madje në propagandën e tyre, po ashtu dhe në programin e tyre të perspektivës, më vonë ata u shprehën hapur për lirinë e besimit dhe pronës, si vlera të paprekëshme të shoqërisë. Klerikët në luftë ruajtën pozicionin e pritshmërisë, duke mos u prononcuar as “*pro*” nacionalistëve, por as “*pro*” forcave të Frontit Nacional - Çlirimtar, duke

mos u ballafaquar hapur në këtë konflikt midis tyre. Por krerët e besimit fetar morën pjesë në Këshillin e Regjencës, një organizëm qeverisës i krijuar nga pushtuesit gjermanë. Përfaqësues i myslimanëve syni në Regjencë, ishte Fuat Dibra. Përfaqësues i besimit ortodoks ishte Lef Nosi, ish anëtar i qeverisë së parë të Ismail Qemal Bej Vlorës, intelektual dhe protagonist i luftërave për pavarësi. Përfaqësuesi françeskan ishte At Anton Arapi. Prezenca e tyre në Qeverinë e Përkohshme të krijuar nga gjermanët në momentin kur ata erdhën në Shqipëri pas largimit të trupave italiane, ishte një njollë politike, morale, fetare dhe kombëtare. Këto personalitete, shumë shpejt në vitin 1946, u dënuan për pjesëmarrjen e tyre në këtë Këshill, si armiq të vendit dhe kolaboracionistë, duke implikuar në këto gjyqe shumë individë të spikatur të familjeve të pasura dhe intelektuale të kohës.

Në vitin 1949 regjimi komunist nxori dekretin nr. 743, ku; *“parashikonte lirinë e fesë si afirmim i lirive kushtetuese dhe parashikonte dënime kundër cilitdo që kufizonte ushtrimin e lirë të besimit fetar”* [Basha, Ali, 2011:451], por me kusht që, ata të rishikonin statusin e tyre. Gjithçka, rregulloret, botimet, buxheti, simbolet etj. duhej të miratoheshin nga Këshilli i Ministrave, duke i lenë vetëm tre muaj kohë për të formuluar statusin e ri. Kisha Katolike në statusin e saj, e kishte shprehur mjaft qartë administrimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Papa dhe Vatikani, duke mos njohur absolutisht asnjë dekret mbretëror. Selia e Shenjtë vazhdoi të kishte me klerin katolik, jo vetëm lidhje shpirtërore, por dhe administrative e financiare. Ndarja e kishës nga shteti solli gjithashtu probleme financiare, si dhe uljen e dominimit të tyre në politikën e vendit, sidomos në emërimin e ipeshkëve. Emërimet bëheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Papa, i cili kishte fuqi legislative të plotë mbi institucionet klerike katolike shqiptare.

Shumë shpejt regjimi do të kërkonte ndryshimin e statutit të fesë. Pavarësisht se klerikët katolikë u munduan të hynin në bisedime me qeverinë për të mos e ndryshuar statusin, përsëri nuk arritën ta realizonin synimin e tyre. Statuti i rishikuar prej tyre përmbante varësi legislative, juridike

nga Papa, si e vetmja figurë që emëronte përsëri Ipeshkët, pra një statut në kundërshtim me politikën qeverisëse komuniste në Shqipëri.

“Me anën e Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Shkodrës, i është komunikuar Kishës Katolike, kopja e vërejtjeve që i janë bërë Statutit, në mënyrë që t’u vlejë si orientim në modifikimin e tij, duke u dhënë një afat të ri deri më 31 Mars 1950”. [A.Q.SH.i R.SH.F.14, V.1949, D 520,fl.12,14].

Pas këtij ultimatumit, Statuti i Kishës Katolike nuk do të kishte ndonjë ndryshim themelor nga ai i mëparshmi. Përsëri kisha ishte nën varësinë e Papës, megjithëse porositë e partisë - shtet që ajo të ndryshonte. Ndryshe nga besimet e tjera fetare në Shqipëri, ajo ishte e vetmja që kishte lidhje me organizata jashtë vendit dhe nuk ishte e pavarur. Pushteti po kërkonte një organizim të klerit katolik në baza kombëtare, autoqefale. Në vitin 1949 bisedimet vazhduan për një kohë të konsiderueshme, midis përfaqësuesëve të klerit katolik dhe institucioneve shtetërore. Kisha përfaqësohej nga figura të shquara si, Don Ernest Çobën, At Marin Sirdani. Pavarësisht përpjekjeve të katolikëve për të mos iu nënshtruar ligjit mbi komunitetet fetare, pasi fillimisht ai mendohej të bëhej në bazë të propozimeve nga vet klerikët, ligji u realizua ashtu siç kishin menduar përfaqësuesit institucional të regjimit komunist.

Për të mbajtur larg opinionin publik dhe për të mos rrezikuar në kundërshtimin e tyre mbi këto ndryshime, sepse feja ishte e rrënjësuar në shpirtin dhe ndërgjegjen e popullit, institucionet shtetërore vepruan në konspiracion të plotë, duke mos lëshuar dokumente zyrtare dhe çdo gjë u bë në fshehtësi. Kleri katolik do të vuante padyshim një formë represioni shumë më të egër, në krahasim me klerikët mysliman dhe ortodoks. Ndërsa të gjitha besimet fetare pranuan të ndryshonin statutin e tyre për të shpalluar varësinë ndaj shtetit, në vitin 1949 kleri katolik nuk pranoi një varësi të tillë.

Situata e nderë zgjati deri në 20 korrik të vitit 1951, vit në të cilin u realizua nënshtrimi i plotë i Kishës Katolike ndaj shtetit. Kjo kishte ndodhur më parë edhe me besimet e tjera, duke i lënë klerikët pa ndihma financiare, pa kuadro të lartë dhe pa mbështetje popullore, si pasojë e propagandës në sistem kundër tyre. Punësimi nisi të bëhej mbi kritere të rrepta antifetare,

mbështetur nga informacione të sigurta që kandidatët nuk ishin frekuentues të kishave apo xhamive. Mbi të njëjtat kritere madje më të ashpra, filloi të bëhej pranimi në parti. Madje në vitin 1949 u propozua krijimi i Drejtorisë së Posaçme pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila do të kishte lidhje të drejtpërdrejta me klerin. Tekstualisht, në një relacion për Kishën Ortodokse thuhej:

“1- Formimi i një drejtorie të posaçme pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila të ketë lidhje të rregullta me të gjithë kultet fetare dhe të bëjë politikën e shtetit ndër këto. Kjo drejtori të mbajë lidhje të rregullta dhe me Ne”.

2- Ndryshimi i statutit mbasi qëndron në fuqi akoma ai i vitit 1929 i bërë nga Visarjoni, por ky më parë duhet të studiohet nga drejtoria, për të cilën folëm më lart. [A.Q.SH.i R.SH.F.14/AP,Str.D 520,V.1949,fl.4,9].

Po të njëjtat relacione ishin po për klerin Bektashi dhe atë katolik, madje për këtë të fundit situata u bë akoma më shumë problematike, për shkak të lidhjeve me Vatikanin. Lufta ndaj besimeve fetare mori kohën e vet, për të shmangur ngjalljen e pakënaqësive në masat popullore, apo për të mos shtuar rradhët e kundërshtarëve politikë ndaj regjimit. Pavarësisht etiketimeve që u përpoqën t’u vinte propaganda komuniste, në opinion dihej që feja sidomos ajo islame, kishte traditat e saj historike në kontributin në lëvizjet atdhetare dhe një ndikim të madh në popull. Prandaj qeveria u detyrua të deklarojë lirinë e besimit fetar. Për t’u maskuar si një qeveri demokratike, ajo vazhdoi të përhapte dhe të ushqente iluzionet në popull, për qëndrimin e saj në bazë të Kushtetutës së miratuar. Por kjo situatë ndryshoi shumë shpejt. Shteti garantoi lirinë fetare, por dhe intensifikoi propagandën ateiste.

Puna kundër klerit nuk u bë asnjëherë e hapur, por gjithmonë në konspiracion të plotë, maskuar pas direktivave të lëshuara nga K.Q. i Partisë, nga të cilat mblidheshin informacionet për veprimtarinë e tyre të përditshme, pozicionimin e tyre “*pro apo kundër*” regjimit dhe vazhdohej të mblidheshin të dhëna rreth biografive të tyre. Qëllimi i regjimit, ishte lufta ideologjike kundër besimit fetar. Në nenin e Kushtetutës deklarohet: “*Kushtetuta ndalonte përdorimin e fesë për qëllime politike dhe formimin e organizatave politike mbi baza fetare*”. [Basha, Ali, 2011:432].

Shumë shqetësuese u paraqit në kohë situata në rrethin e Shkodrës, për shkak të përhapjes dhe ndikimit që kishte në këto zona kleri katolik, që në themelimin e katoliçizmit në vendin tonë. Shkodra ishte një zonë me tradita të forta katolike. Besimi katolik në këto zona ishte shumë i përhapur në të gjithë shtresat sociale, përfshi masën e rinisë. Influenca e klerit katolik në Shkodër kishte lidhje me influencën italiane në këto zona. Vet lidhja e klerit katolik, që nga themelimi i tij shumë shekuj më parë, kishte bërë që gjatë pushtimit Italian, ndikimi i tyre të ishte i ndjeshëm për shkak të lidhjeve të ngushta që kishte kleri katolik me Italinë, si rezultat i varësisë që gëzonte nga Vatikani.

Influenca e fortë italiane dhe e klerit katolik, ndikoi në dobësinë e jetës politike të organizatave të partisë në Shkodër. Realisht konstatohej se përbërja e organizatave të partisë apo rinisë në fillimet e saj, ka qenë e sektarizuar dhe pjesëmarrja e katolikëve në to ka qenë shumë e pakët. Megjithatë, shumë shpejtë do të merreshin masa për rritjen e rolit të grupeve kulturore dhe pjesëmarrjen e rinisë katolike ndër to; për ngritjen e organizatave në të gjitha lagjet apo fshatrat; ngritjen në përgjegjësi të rinisë katolike; ngritjen e shtëpive të pionierit dhe vatrave të kulturës si dhe përfshirjen e grave dhe vajzave në këto aktivitete; nxitjen e rritjes së rolit të organizatës së gruas si dhe bashkëpunimin e saj me organizatën e rinisë, si një armë e fuqishme në luftën kundër zakoneve prapanike dhe paragjykimeve të kohës.

Sipas pretendimeve të regjimit, prejardhja e prapambetjes së femrës ishte në bazën e veprimtarisë së kishave, sidomos asaj katolike që vepronte në zonat veriore, aty ku dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit kishte luajtur rol shumë të madh në jetën sociale dhe administrative të zonës. Për të dobësuar sa më shumë rolin e besimit fetar,

“u fshinë në kalendarin zyrtar të kremtet fetare, duke i zëvendësuar ato me përvjetorët e çlirimit, shpalljes së pavarësisë, ditën e revolucionit të Tetorit etj, duke lënë vetëm festimin e Bajramit, Pashkëve, Krishtlindjeve dhe Hashures së komunitetit bektashian, të cilat shumë shpejt do të eliminoheshin plotësisht. Me një urdhër të 20 nëntorit 1952, këto data u fshinë nga festat zyrtare”.
[A.Q.SH.i R.SH. F.14/AP, V.1952, D. 62, fl.14, 131].

Mbasi aprovuan statutet e fesë në vitin 1950, duke i vënë ekonomikisht dhe politikisht nën kontrollin e plotë të shtetit, shumë shpejt i erdhi rradha hapit tjetër politik të shtetit komunist. Në vitin 1955, në diskutimin për hapjen e shkollave fetare dhe për studentët që do të shkonin për studime teologjike jashtë vendit, E. Hoxha dhe M. Shehu, dy krerët kryesorë të regjimit, do të nënvizonin:

M. Shehu: “Çfarë do të ndodhte në rast se komunitetet fetare nuk do t’i linim të hapnin shkolla dhe të pregatisin kuadrot e nevojshëm? Ortodoksët dhe katolikët kanë të drejtë të thonë përse muslimanët e kanë të hapur medresenë dhe ne nuk kemi shkollat tona? Subvencionet çdo vit duhet t’ua ulim, por pa përgatitur kuadro nuk mund t’i lëmë. Unë mendoj që t’i lëmë t’i hapin seminarët, por me disa kondita, siç kemi bërë me medresenë”.

E. Hoxha: “Të ngarkojmë qeverinë të rishikojë heqjen e subvencionit komuniteteve fetare, heqjen e triskave kuadrove fetare dhe të privilegjeve të vjetra që ata kanë, dhe ata vetë me forcat e tyre le të bëjnë ç’të duan. Ne duhet t’i bëjmë ata që të dërgojnë sa më pak në shkollat e tyre dhe ata që duhet të vënë atje, duhet patjetër të kenë mbaruar shkollën shtatëvjeçare dhe mos t’u japim triska, ushqimi. [A.Q.SH.i R.SH. F.14/AP,V. 1955, D. 32,fl.14,100- 102].

Gjithçka armiqësore dhe më shumë se kaq ishte kundër klerit katolik, i cili kishte një influencë të madhe në zonën veriore, por jo vetëm aty. Në këto vite, qëndrimi ndaj myslimanëve dhe ortodoksve ishte më i zbutur. Nën ndikimin e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, qëndrimi ndaj ortodoksve dhe klerikëve në përgjithësi ishte më tolerant. Ndikimi i jashtëm nuk ishte vetëm për klerin, por dhe për vet regjimin komunist. E. Hoxha shprehej:

“Për këtë çështje, unë kam biseduar edhe me Leviçkinin. Edhe ai thotë duhet parë mundësia që t’u jepen komuniteteve fetare edhe bursa, d.m.th. ishte i një mendimi me mua; ç’farë do të ndodhte në rast se komunitetet fetare nuk do t’i linim të hapnin shkolla dhe të përgatisnin kuadrot që u nevoiten - Mehmet Shehu”. [A.Q.SH.i R.SH.F.14/ AP,V. 1955, D. 32,fl. 100].

Në këtë kohë u miratua dërgimi i një delegacioni në Moskë, për të marrë pjesë në festën fetare të Kishës Ortodokse Ruse, i cili përbëhej nga Paisi Vadica, kryetar i Kishës Ortodokse dhe Niko Cane, sekretar i përgjithshëm. [A.Q.SH.i R.SH.F.14/AP,V.1955,D.52,fl.45].

E. Hoxha nënvizonte:

“Në bisedimet që patëm me Kryetarin e degës së brendshme në Shkodër, na tha; Tani për tani kleri katolik punon më shumë se sa ne. Qëllimi i kësaj pune, të klerit është që të përhapin influencën e tij në rini; ta largojë atë nga organizata jonë dhe aktivitetet e saj, dhe në fund të përdorë për qëllimet e tij armiqësore kundër partisë dhe pushtetit. Shfaqje të këtilla në rininë katolike të Shkodrës ka. Kështu, në gjimnaz dhe në shkollën pedagogjike dështojnë mbrëmjet e vallëzimit që organizon organizata jonë”. [A.Q.SH.i R.SH.F.14/AP/Str,V.1951, D. 683,f 1.3,4,7].

Edukimi i rinisë ishte i ndikuar dhe nga organizata të ndryshme me karakter fetar, mjaft të përhapura, siç ishin; “*Shoqëria Katolike e bijave të zotës për të rejat*”; “*Don Bosco*”, të cilat ishin shumë të organizuara me aktivitetet e tyre. Këto organizata edukonin rininë me frymën e huaj italiane, e cila tashmë binte ndesh me parimet e regjimit. Influenca e klerit ishte shumë shqetësuese në fshat, ku besimi ishte më i rrënjosur, numri i kishave ishte më i madh dhe besimtarët, rinia e shkollave më shumë se ajo punëtore frekuentonin rregullisht kishat. Regjimi komunist ishte mjaft strategjik në programimin e dobësimit të rolit të fesë. Sulmet shtoheshin dita ditës; filluan me heqjen e ceremonive fetare, shpalljen e ditëve të diela ditë të aksioneve, si një mënyrë për të shkëputur lidhjen e njerëzve me kishën, kufizimet ekonomike dhe të shkollimit për të përgatitur kuadro fetar.

Kjo u evidencua qartë në vendimin e B.P. të K.Q. në 15. 8. 1955, i cili vendosi:

“Hapja e shkollave 4 - vjeçare fetare, do të donte personel arsimor dhe administrativ me shpenzime të konsiderueshme për shtetin. Për të plotësuar nevojat e tyre të hapen seminare një vjeçare, sipas nevojave të çdo komuniteti. Në programin arsimor të parashikohen tema për edukimin politik për njohjen e statutit tonë, të Republikës dhe ligjeve të saj; Gjithashtu nuk jemi dakord për dhënien e dy tre bursave për jashtë shtetit; Dërgimi i tyre në këto institucione thelogjike, nuk do të jetë shumë i frytëshëm, mbasi edhe në drejtimin e këtyre institucioneve ka patjetër priftërinj të një fryme tjetër”.
[A.Q.SH.i R.SH.F.14/AP,V.1955, D. 32,fl. 56].

Qëllimi ishte i qartë: mungesa e kuadrove fetar do të sillte si pasojë mbylljen e kishave dhe xhamive. Kështu komunitetet fetare, në mungesë të kuadrove do të vendosnin njerëz jo shumë të shkolluar, ç’ka i interesonte regjimit komunist për të pasur përballë njerëz të pashkolluar, të paaftë për të bërë propagandë fetare. Kjo do të sillte dobësimin e institucioneve fetare dhe largimin e besimtarëve prej tyre, sidomos të rinisë së shkollave, sepse punësoria pak e shqetësonte pushtetin. Problem ishin gjithashtu moshat e thyera, sepse me to për shkak të tradicionalizmit dhe besimit thellë në ndërgjegjen e tyre, regjimi parandiente dhe e kuptonte që betejën e kishte të humbur.

Në këto kushte E. Hoxha do të urdhëronte:

“Të rishikojë subvencionin që u jepet komuniteteve fetare dhe të marrë masa duke shkuar drejtë pakësimit të subvencionit nga ana e shtetit; Të studiojë tërheqjen e triskave kuadrore fetare si njerëz që nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin;”. [A.Q.SH.i R.SH.F.14/AP,V.1955, D. 32,fl.59].

Kundërshtimi i vendimeve të tilla bëhej me kujdes, pasi koha po vërtetonte se egërsia e pushtetit ndaj klerit nuk do të ndalej. Në bisedim e sipër Dom Ernest Çoba ka thënë: *“se me pushtetin deri tani jemi dakort, por në rast se na prek në kodin kishtar si edhe lidhjet me Papën, neve nuk do ta pranojmë”*. [A.Q.SH.i R.SH.F.14/AP/Str,V.1949, D. 520,fl.14].

Agresioni ndaj fesë në Shqipëri nuk ishte i rastësishëm. Ai nisej nga rrethana ideologjike, politike dhe pragmatike. Besimi fetar në Shqipërinë komuniste konsiderohej i papajtueshëm me marksizmin. Parrulla komuniste në lidhje me fenë ishte citati i deformuar i Marksit *“Feja është opium për popullin”*. Gjatë luftës Antifashiste Nacional - Çlirimtare, komunistët mbajtën një qëndrim të kujdesshëm dhe të rezervuar ndaj fesë. Fillimisht ata kamufluan ateizmin e tyre me patriotizmin; diversiteti fetar dhe kundërshtitë fetare ua lanë vendin unitetit dhe bashkimit kombëtar, si çështje më e rëndësishme e momentit. Pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare ishin mysliman. Qëndrimi i tyre në luftë ishte pro Frontit Antifashist Nacional - Çlirimtar. Kleri mysliman, po ashtu baballarët dhe dervishët, mbështetën luftën. Disa prej tyre u bënë oficer komandues në ushtrinë partizane, duke arritur gradën e oficerit të lartë.

Pas çlirimit të vendit, filloi persekutimi ndaj klerit katolik. Sipari i këtij tragjizmi u ngrit në dhjetor të vitit 1944, me dënimin e priftit italian At Xhovani Faust, i akuzuar si spiun. Një javë më vonë, ai u vu përballë skuadrës së pushkatimit. Një ditë më vonë, shtëpia e murgeshave Karmelitas u mor në sekuestrim e justifikuar *“për nevojat e ushtrisë partizane”*. Ajo ishte kthyer në një burg të improvizuar dhe bodrumi në nëntokën e shtëpisë ishte kthyer në dhomë torturash, edhe pse e drejta e besimit, formalisht konsiderohej si një e drejtë e shenjtë e qytetarit shqiptar.

Kleri katolik do ta kishte shumë të rëndë shkëputjen nga Papati, por do ta paguante shumë shtrenjtë qëndresën e tij. Kjo u vërtetua në kohën e pasçlirimit me burgosjen dhe pushkatimin e mjaftë prej tyre. Ky sulm filloi me qytetin e Shkodrës, zemra e besimit të katoliçizmit në

Shqipëri. Katolikët ishin ata që përfaqësonin shtresën më intelektuale në Shqipëri, klerik të arsimuar në shkollat perëndimore dhe kisha nuk kishte shpalluar autoqefale nga Vatikani, duke ruajtur strukturën e organizimit të saj me qendër në Shkodër. Në krahasim, kleri mysliman e kishte shpallur autoqefalinë e institucioneve fetare që në vitin 1929, e po kështu dhe kleri ortodoks që në vitin 1922, me seli në Tiranë.

Sulmi ndaj klerit nuk ishte vetëm diskriminues në planin politik e moral apo dhe shkatërrimin e tij në planin ekonomik, por mbi të gjitha në atë fizik, që do të *“kurorëzohej”* me ekzekutime, siç ndodhi në vitet e para të pasluftës. Të akuzuar si bashkëpunëtorë me armikun dhe për përgatitjen e sulmit për rrëzimin e qeverisë, u dënuan me pushkatim 18 përfaqësues të *“Urdhrit Jezuit”* në Shkodër. Ndër to ishin personalitete, si redaktori i revistes françeskane, *“Hylli i Dritës”*, At Gjon Shllaku etj. Në vitin 1948 e pati të njejtin fat At Vinçens Prendushi, i cili ishte arqipeshkvi i Durrësit dhe Imzot Gasper Thaçi, i cili ishte arqipeshkvi katolik i Shkodrës, një Urdhër ky i formuar që në vitin 1855.

Kisha Ortodokse e vuajti dënimin më pak se ajo Katolike. Kryepeshkopi i kishës, shumë shpejt u zëvendësua me të birin e një komandanti të luftës, Ksenofon Kristi. Megjithatë, sekuestrimi i pasurive, ndalimi ose kufizimi i botimeve apo mbyllja e shkollave të tyre, qenë me intensitet më të ulët se në rastin e katolikëve. Priftërinjtë ortodoks që mbështetën luftën së bashku me fëmijët e tyre, u pranun të bënin karrierë në hierarkine kishtare. Ata ishin portretizuar si priftërinj *“të mirë dhe patriot”*, në ballafaqimin me priftërinjtë katolikë, *“të këqinj dhe profashist”*. Të paprekur nga sulmi ndaj fesë, nuk do të mbeteshin as klerikët mysliman, por kjo ndodhi në përmasa më të vogla se katolikët dhe ortodoksët.

4.4. Feja nën regjimin komunist.

Legjislacioni kontrollues ndaj fesë, do të mbetet pjesërisht në fuqi në kohën e regjimit komunist, i cili shkoi në ekstrem me kontrollin e tij ndaj institucioneve fetare. Gjatë vitit 1945 - 1946, *“shteti nxori jashtë ligjit shkollimin fetar, duke mbyllur shkollat private fetare, që kishin mbetur deri në atë kohë. Shteti ndaloj gjithashtu, të gjitha botimet dhe komunikimet fetare dhe të rinjtë u këshilluan të mos merrnin pjesë në veprimtaritë fetare”*. [Basha, Ali, 2011:430-431].

Pas vitit 1945, filloi një valë represioni ndaj klerit katolik. Me anë të të ashtëquajturave *“gjyqe popullore”*, u dënuan të ashtuquajturit tradhëtarë, anëtarë të organizatës *“Bashkimi Shqiptar”*, nën akuzën e nxjerrjes së *“trakteve ndaj Frontit Demokratik”*. U dënuan me pushkatim 18 klerikë, figura të shquara si, At Gjon Shllakun, At Xhovani Fausti etj. U urdhërua mbyllja e *“Urdhërit Jezuit”*, u mbyllën institucionet e tyre deri në sekuestrimin e sendeve personale. Më pas, do të ishte radha e *“Urdhërit Françeskan”*, anëtarët e të cilit u akuzuan *“për mbajtje armësh dhe municionesh”* për të rrëzuar pushtetin popullor, duke i akuzuar përsëri se, luftonin kundër Frontit Demokratik. Deri në vitin 1946, ishin egzekutuar 20 priftërinj françeskan dhe burgosur 20 të tjerë. [Jacques, Edwin, 1995:494]. Bashkë me ta u dënuan shumë bejler, intelektual, të gjithë të konsideruar armiq të popullit.

Ndryshimet në legjislacioni mbi arsimin, shkëputën njëherë e mirë lidhjet midis arsimit dhe kishës. Institucionet fetare nuk kishin më të drejtë të krijojnë institucione arsimore, por gjithashtu, nuk kishin as të drejtë të jepnin mësim në shkollat shtetërore. Ata u detyruan ta izolojnë veprimtarinë e tyre vetëm në kisha apo xhami. Fillimisht, iu lejua të jepnin mësim në rrugë private, por edhe kjo shumë shpejt u ndalua.

Feja në Shqipëri kishte luajtur një rol të madh në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore. Në vitin 1915, zbulohet në Bibliotekën Laurentine të Firences, një letër qarkore të shkruar në vitin 1462 nga Pal Engjëlli [bashkëjetues i Gjergj Kastriotit Skënderbeut], i njohur si Arqipeshkvi Katolik i Durrësit, i cilësuar si teksti më i hershëm në gjuhën shqipe. [Jacques,

Edwin, 1995:310]. Klerikët fetar, si Pjetër Budi, i cili ishte ipeshkv, Gjon Buzuku, Frang Bardhi, ipeshkv në Mat, i cili realizoi dhe fjalorin e parë në gjuhën shqipe, Pjetër Bogdani etj. ishin shquar për kontributin e tyre patriotik dhe kombëtar. Të gjithë këta klerik, kishin aq shumë kontribute në gjuhën dhe kulturën shqipe, sa që regjimi nuk mund t'i eliminonte nga letërsia apo historia shqiptare.

Feja nuk u godit vetëm ekonomikisht, por veçanërisht në aspektin politik. Pas shumë ndërhyrjeve dhe reformave, radha i kishte ardhur arsimit për të mundësuar edukimin ateist të brezit të ri, për të shpëputur përfundimisht lidhjet midis rinisë dhe fesë, sidomos në zonat veriore dhe në fshat, ku rinia ishte e lidhur ngushtë me klerin katolik. Reforma e arsimit e vitit 1946 sanksionoi: *“Reforma ka për qëllim t’i pastrojë fëmijët nga të gjitha paragjykimet, bestytnitë dhe fanatizmi fetar”*. [Basha, Ali, 2011:434]. Vendin e besimit fetar e zuri edukimi ateist i rinisë. Mësimi me karakter fetar, u shpall dhe u ligjërua i dëmshëm për rininë dhe shoqërinë. Baza e edukimit të rinisë do të ishte ideologjia marksiste - leniniste. Si argument kryesor vazhdonte të përdorej roli reaksionar i fesë, e cila po akuzohej si shkaktare kryesore për prapambetjen e shqiptarëve dhe obskurantizmin e një pjese të shoqërisë. Feja u konsiderua dhe u identifikua në raportet shoqërore me një klasë shfrytëzuese, si mjet për poshtërimin dhe nënshtrimin e plotë të gruas.

Në përfundimin e Këshillit të Përgjithshëm Arsimor, Ministri i Arsimit i asaj kohe, Kolë Paparisto shprehej: *“Përsa i përket edukatës mendore, ajo do të përfaqësojë shkencën e ngritur në baza marksiste - leniniste, që të pastrohet shkolla nga bagazhi i supersticioneve të trashëguara nga e kaluara”*. [Gazeta “Bashkimi”, 1947, nr. 824:2].

Fryma propagandistike shkoi më tej. Në një letër të hapur drejtuar të gjithë nxënësve dhe prindërve me rastin e vitit të ri shkollor, Ministria Arsimit u bën thirrje të gjithë arsimtarëve;

“Të bëhet një luftë më e ashpër me shtrembërimet dhe ideologjitë e huaja dhe reaksionare në shkollën tonë. Të ngrihet niveli i punës ideo - politike në mësimet e gjuhës e letërsisë, historisë, gjeografisë, shkencave biologjike. Të luftohen mbeturinat e feudalizmit në ndërgjegjen e nxënësve, zakonet e këqija, supersticionet e kota fetare”. [Gazeta “Bashkimi”, 1947, nr. 867:2].

Regjimi komunist e trajtoi klerin katolik si armik të popullit, madje si objektiv të veçantë në zhvillimin e luftës së klasave. Për këtë, u shfrytëzua niveli i ulët arsimor dhe kulturor i popullsisë. Nëpërmjet luftës kundër analfabetizmit, në të cilën u siguria një pjesëmarrje e gjerë e popullsisë, nëpërmjet frymës me efekte mobilizuese dhe shtrirjes së investimeve për rindërtimin e vendit, nëpërmjet hapjes së ndërmarrjeve të reja ekonomike, regjimi komunist e pati të lehtë të indoktrinonte popullsinë dhe të mbillte brenda gjirit të saj politikën ateiste. Përkrahësit e besimit nuk shikoheshin më me simpati në opinionin e gjerë. Sidomos, pas gjyqeve famëkeqe të tyre në vitin 1947, nën tryninë e regjimit klerikët e të gjithë besimeve filluan të shiheshin me sy armiqësor nga masa e gjerë e njerëzve.

Pas dekreteve të vitit 1949 dhe reformës agrare, shumë pasuri të institucioneve fetare ishin konfiskuar. Ato kishin mbetur pa mbështetje financiare dhe ekonomike, të cilat ishin pakësuar dhe ishin të vetmet burime që jepeshin nga shteti, mjaft institucione fetare ishin mbyllur, konfiskuar dhe transformuar në destinacionin e tyre, duke i kthyer në shtëpi kulture apo magazina. Infrastruktura fetare dhe pasuritë e patundëshme në pronësi të institucioneve fetare u goditën rëndë. Ndërtesat fetare si, kishat, manastiret, shkollat, konviktet, jetimoret, magazinat u konfiskuan në bazë të nevojave të ushtrisë, për të strehuar të pastrehët e luftës, apo jetimët. Në dhjetor të vitit 1945, u miratua reforma mbi tokën [agrarë], e cila sekuestroi mbi 26.000 hektarë tokë të institucioneve fetare. Kjo reformë ishte paraprirë nga një propagandë e shtrirë në kohë kundër priftërinjve dhe hoxhallarëve. Të gjitha bashkësitë fetare iu konfiskuan pronat e tyre, të cilat ishin vakëf të lëna prej besimtarëve. Këto masa dobësuan ekonomikisht institucionet e besimeve fetare. Publikimi i revistave, gazetave, librave fetare, u ndalua ose u reduktua, pasi ato konsideroheshin të dëmshme për moralin dhe për idealet antifashiste të popullit shqiptar. Mbi të gjitha, mjaft klerikë në këtë periudhë rezultonin të dënuar apo të vrarë.

Regjimi komunist kërkonte të shkëpuste lidhjet e institucioneve fetare me besimtarët e tyre, duke përdorur forma nga më të ndryshme të persekutimit, pavarësisht se qeveria e përkohshme e vlerësoi të drejtën e besimit të shenjtë për shqiptarët, qysh në mbledhjen e Beratit, në vitin 1944.

Qëllimi kryesor i këtyre masave, ishte dobësimi i pozitave ekonomike, financiare dhe politike të institucioneve fetare. Duke “asgjësuar” mbështetjen e tyre ekonomike, regjimi komunist synonte të dobësonte lidhjet e tyre me qytetarët, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe duke përgatitur kështu mbjelljen e ideologjisë ateiste, me synimin e qartë; dobësimin e botëkuptimit fetar në popull.

“Kjo nismë u pasua me ndalimin e zhvillimit të mësimin prej institucioneve fetare. Feja u nda nga shteti, por u nda edhe nga shkolla. Dekreti, “Mbi bashkësitë fetare” i vitit 1949, ndalonte funksionarët fetar të kishin detyra jashtë vendit; [neni nr. 13], ndalonte studimet jashtë vendit; [neni nr. 17] ndalonte organizatat e tyre të mbanin lidhje me organizatat e huaja fetare jashtë vendit; [neni nr. 15] të merrnin ndihma nga jashtë, përveç se rasteve që mund të lejoheshin me vendim të Këshillit të Ministrave”. [Basha, Ali, 2011:452].

Neni 12-të i Kushtetutës, diktonte para institucioneve fetare jo më edukim fetar, por edukimin e besimtarëve ndaj partisë dhe pushtetit; propaganda fetare u vu nën kontrollin e shtetit. Në preteksin e krijimit të një feje “autoqefale”, ligji ndaloi marrëdhëniet e drejtpërdrejta të fesë me institucionet homologe jashtë shtetit, ose i kushtëzoi ato me ndërhyrjen e qeverisë; u ndalua ngritja e urdhërave fetar. Ligji i jepte të drejtë qeverisë të vendoste për titullarët e komuniteteve fetare. [Basha, Ali, 2011:452].

Besimi musliman në Shqipëri ka përbërë shumicën dhe toleranca e kësaj shumice, u vu në bazën e ruajtjes së harmonisë dhe bashkëjetesës fetare në popullin tonë. Toleranca muslimane u bë shkak i kuptimit dhe mbështetjes së reformave politike partiake kundër besimit fetar në Shqipëri, duke vënë në plan të parë interesin kombëtar. Kjo dukuri reflekton sot dhe përbën një vlerë në hapësira kontinentale për popujt e tjerë.

Baza e reformave me karakter emancipues ishte lufta kundër fesë, si përçuese e zakoneve kanunore obskurantiste, që kishte goditur në rrënjë barazinë gjinore, veçanërisht figurën e gruas

në shoqërinë e prapambetur shqiptare. Kundër vlerësimit përgjithësues të sitemit komunist dhe ideologjisë së tij, në procesin e vazhdimësisë nuk ka pauza, por në momentet e shfaqjes së qëndrimeve me motive politike, atëherë bëhet vlerësimi, shtohen idetë të reja duke mbështetur subjektin politik. Kështu bënë shumë klerikë shqiptar në besimet fetare në raport me direktivat partiake. Induksioni politik në masat e gjera të popullit shqiptar pati efekte gjithpërfshirëse, pasi ishte e vetmja alternativë, me rrugë të tjera të zëna nga vet natyra e sistemit.

4.5. Sulmi ndaj fesë në emër të revolucionarizimit.

Për regjimin komunist në Shqipëri, problemi gjinor ushqej kryesisht nga rrënjët fetare. Prandaj dhe lëvizja për të ashtuaquajturin “*emancipim të gruas*”, nisi nga lufta kundër fesë. Me frazën e mëposhtme në fjalimin e mbajtur në Tiranë me organizatat bazë të disa ndërmarrjeve, E. Hoxha do të deklaronte të hapur luftën kundër besimit fetar:

“Gjithë partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, të djegin me zjarr e t’i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave. Këto janë probleme moralo - politike me rëndësi të madhe”. [Gazeta, “Zëri i Popullit”, 1967 nr 32:1].

Ashpërsia e këtij gjykimi do të shkaktonte tragjedinë më të madhe antifetare, e cila do të fillonte me pasojat e saj menjëherë pas çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj.

Pa ngurrim, ajo filloi të vepronte çdo ditë, e prezantuar në shtypin e kohës, në libra, takimet e hapura, në ngjarjet kulturore të kohës, duke u bërë moto politike e ditës. Luftën kundër fesë, E. Hoxha e kishte shprehur shumë qartë në fjalimin e mbajtur në Kongresin e 4 të Frontit Demokratik të Shqiperisë, në 14 shtator 1967;

“Lufta kundër fesë e zakoneve prapanike në të cilin një rol të madh ka luajtur dhe luan organizata jonë e Frontit Demokratik, është një nga drejtimitet e rëndësishme të revolucionit ideologjik dhe kulturor”. [Hoxha, Enver, “Raporte e Fjalime 1967 – 1968”, 1968:147, 194-198].

Qeveria komuniste në fillimet e saj, lejoi lirinë e besimit fetar, e garantuar në Kushtetutën e vitit 1946. Kushtetuta garantonte liri për të gjithë shtetasit e saj përpara ligjit, pavarësisht racës, fesë, pronës apo origjinës kombëtare. Shteti shqiptar ishte laik dhe lejonte veprimtarinë e të tre institucioneve fetare, mysliman, katolik dhe ortodoks.

Megjithatë, qëndrimi i regjimit komunist ndaj fesë do të qartësohej sapo ata të konsolidonin pushtetin e tyre politik. Mbasi e dobësuan klerin fetar nga ana ekonomike dhe arsimore, sekuestruan të gjitha pasuritë dhe ofiqet e tyre, burgosën, torturuan dhe vranë shumë prej tyre. Viti 1967, sipas mendimit të udhëheqjes komuniste, kishte ardhur koha dhe ishte momenti më i përshtatshëm për t'i dhënë sulmin përfundimtar klerit të të tri besimeve. Këtë radhë synoi t'i eleminonte të gjithë pa dallim, pa asnjë diferencë midis tyre.

Pas fjalës së 7 shkurtit të vitit 1967, në përmbajtjen e tij goditja nuk ishte direkte kundër besimit fetar, por në qendër të kritikës u vunë zakonet e prapambetura [prapanike]. Vetë zhvillimi i këtyre proceseve revolucionarizuese [sipas konceptit të kohës] e çoi luftën edhe kundër fesë, e cila konsiderohej si nxitëse dhe frymëzuese e zakoneve tradicionale. Ajo ushqente disa ndërhyrje në jetën sociale të familjes, veçanërisht në fejesat që në djep. Në mitingjet denoncuese të organizuara, veçanërisht në rrethet veriore të vendit, nga këto mitingje gratë e të gjithë moshave drejtuan kritika të forta deri akuza kundër rolit të klerikëve, veçanërisht në fshat dhe kundër paragjykimëve të burrave ndaj femrës.

Kjo situatë pasohet me një ndodhi të kohës. Në maj të vitit 1967, Vito Kapo [atëherë kryetare e BGSH-së] kishte pritur në takim një grup gra dhe vajza shqiptare të ardhura nga rrethet e ndryshme të vendit. Gratë kërkuan takim me Enver Hoxhën. Rreth 80 gra ngritën para tij jo vetëm problemin e zakoneve prapanike, por dhe ndikimin e priftit dhe hoxhës në këto zakone. “*Gratë në Malsi janë skllave*”. Në thelb akuzat ndaj klerit dhe mentalitetit mashkullor, shtroi kërkesën e mbylljes së institucioneve fetare. Nga përmbajtja dhe denoncimi rezultoi se, kleri

ishite mbështetja logjike, morale e zakoneve tradicionale në familjen shqiptare, me pasoja deri në nxitjen e gjakmarrjes, sipas neve të Kanunit.

Ky takim u propogandua masivisht dhe fryma e tij u përhap në tërë vendin. Midis dilemës politike dhe sociale të qëndrimit ndaj fesë dhe përjashtimit të saj, u muar vendimi për vazhdimin e nismës së të rinjve të dy gjimnazeve të qytetit të Durrësit. Filloi masivizimi i fletë rrufeve kundër zakoneve dhe klerit, vendosja e karikaturave në mjediset publike. Kjo situatë solli një fenomen të ri, të cilin propaganda e kohës ishte e detyruar ta interpretonte si një lëvizje “*që forcën e saj e kishte nga poshtë*”, nga vet vullneti dhe dëshira e grave dhe vajzave shqiptare. Edhe pse fillimisht për shkak të përvojës sovjetike [pushteti sovjetik e lejonte besimin fetar dhe institucionet fetare], vendimi i udhëheqjes kishte drojen dhe pasigurinë brenda, megjithëse reagimi popullor nga poshte ishte shumë i fuqishëm. Direktiva merrte fuqi mbi bazën e bindjes absolute që ishte krijuar në popull në drejtësinë e saj.

Duke trajtuar besimin e njerëzve çështje të misticizmit, idealizmit, të cilat binin në kundërshtim me teorinë marksiste - leniniste, e cila shprehej se, “*Feja është psherëtimja e krijesës së shtypur, zemra e një bote pa zemër, ashtu sikurse ajo është shpirti i një sistemi të pashpirt. Feja është Opium i popullit*”. [Materializmi Dialektik dhe Historik, 1971:608]. E. Hoxha ngriti në pedestal këtë thënie, në momentin që vendosi të eliminoj fizikisht klerikët dhe ta trajtoj fenë si dogmë filozofike, që helmonte jetën e njeriut. Njerëzit nuk e kishin kuptuar se si feja kishte ndërhyrë në jetën e tyre të përditshme me disiplinat e saj. “*Liria e ndërgjegjes borgjeze nuk është asgjë më tepër, veçse tolerancë për të gjitha llojet e lirisë së ndërgjegjes fetare...Liria e plotë e ndërgjegjes së njeriut, mund të arrihet vetëm në socializëm*”. [Materializmi Dialektik dhe Historik, 1971:615].

Këto “*leksione*” marksiste - leniniste, regjimi i përshtati mjaft mirë në distancimin e fesë nga shkolla, komunitetet fetare u shpallën të ndara nga shteti, i cili shpalli në Kushtetutë mbrojtjen e

lirisë së propagandës ateiste - shkencore. Për sulmin ndaj tyre, E. Hoxha e artikuloi shumë qartë në një Qarkore drejtuar Komitetit të Partisë së rrethit Durrës, në shkurt 1967. Në këtë qarkore, krahas masave që duheshin marrë kundër fesë, artikulohej sulmi ekonomik ndaj institucioneve të besimit, i cili kishte filluar me grabitjen e pronave gjatë zbatimit të reformës agrare.

Nga ana tjetër, u realizua ndryshimi i statutit të tyre, për t'i vendosur nën kontrollin e plotë të shtetit, u ndaluan mbështetja financiare dhe u kontrolluan botimet. Klerikët, sidomos ata katolikë u befasuan, për faktin se ishin më të shkolluar dhe e njihnin mirë ideologjinë marksiste që me revolucionin e Tetorit në Bashkimin Sovjetik. E. Hoxha do të shprehej:

“Ne nuk kemi lënë asnjë shkollë, qoftë edhe të ulët, për të nxjerrë klerikë të rinj dhe për t'u dhënë këtyre një edukatë të rregullt dhe të interpretuar të doktrinës së tyre fetare. Kështu që, klerikët e çdo besimi kanë shteruar dhe do të shterojnë edhe më shumë si kuadro, kurse përse i përket shtypit të librit dhe të dogmave të tjera, kjo ka vdekur me kohë për ta. Pra, bazën materiale dhe propagandistike për shumëzimin e librave fetare e kemi zhdukur. Ne kemi zhdukur gjithashtu mundësinë e nxjerrjes së kuadrove. Tash është çështja t'u prishen kishat dhe xhamitë, të vetmet mjete kryesore, ku klerikët grumbullojnë besimtarët për të mbajtur gjallë besimin, qoftë edhe në formë dekadente. Prishja e kishave, xhamive, teqeve e manastireve, natyrisht paraqitet më e vështirë, për arsye se nuk duhet shkuar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me atë pjesë të popullit që beson. Në këtë formë duhet të vazhdojmë ne, deri sa t'i rrafshojmë nga faqa e dheut tonë. Institucioneve fetare ne duhet t'u heqim, atje ku kemi lënë diçka, të gjithë tokën, ndonje ulli ose të ardhur tjetër që mund të kenë akoma kishat, xhamitë etj.”. [A.Q.SH,i R.SH. F.14/AP, V.1967, D 94,fl.3,4].

Në këtë dokument, i cili ishte klasifikuar “*Tepër Sekret*”, duket qartë sulmi ndaj klerit në Shqipëri, në këtë vend që prej shekujsh në mënyrën më të veçantë kishin bashkëjetuar të tri besimet fetare. Regjimi i trembej sidomos klerit katolik, si më i organizuar, më i kulturuar, pasi materialet dhe botimet e të cilit ishin të gjitha në gjuhën shqipe dhe për këtë arsye, kleri katolik e zhvillonte besimin e tij si filozofi. Më pak i dëmshëm për regjimin ishte kleri ortodoks, të cilët vetëm Ungjillin kishin në gjuhën shqipe. Ndërsa myslimanët ishni shumë më pak të rrezikshëm, për shkak se të gjitha shkrimet ishin në gjuhën arabe. Kjo ishte një arsye më shumë, që e bënte bindëse pamundësinë e predikimit të fesë në formën dhe përmbajtjen e koncepteve filozofike.

Lufta kundër fesë ishte një instrument për të nxitur emancipimin e gruas. Nga ana tjetër, lufta kundër fesë u ekspozua si një rrugë për t'i hapur perspektivën rinisë. Pra, feja shpallej dy herë fajtores: a] si pengesë për përparimin e grave dhe vajzave; b] pengesë për pjesëmarrjen në jetën

sociale të rinisë. Në aspektin e perspektivës së përgjithëshme, sulmet e institucioneve të regjimit komunist e shpallën klerin si fajtor të varfërisë së popullit deri para çlirimit dhe si burim ushqyes të konservatorizimit, zakoneve të vjetra prapanike dhe kanunore. Për të gjitha këto arsye, për regjimin komunist veprimtaria fetare duhej të zëvendësohej me atë ateiste, me teorinë e materializmit shkencor, pra synohej të zëvendësohej kulti fetar me atë ideologjik partiak.

Regjimi nuk e fshehu në asnjë moment kujdesin për të mos mundësuar një konfrontim me masat e gjëra, pasi besimi fetar ishte pjesë e jetës së tyre, ishte rrënjësor në shpirtin dhe në ndërgjegjen e tyre. Madje pas miratimit të statuseve të tyre, regjimi filloi të përzgjidhte personalitetet drejtuese, duke aplikuar në këtë proces kritere politike, ideologjike dhe partiake. Padyshim, lufta ideologjike nuk kishte arritur ende të eliminonte besimin fetar, sado që ishte shtrirë në çdo fushë të jetës nëpërmjet punës së organizatave të partisë në çdo lagje, fshat, ndërmarrje. Kudo ku partia zhvillonte aktivitetin e saj, vetëm flitej kundër konservatorizmit, bestytynive, prapambetjes së gruas, flitej për revolucion tekniko - shkencor, për të ngritur idetë ateiste. Megjithatë, propaganda ishte e pamjaftueshme për të shkukur nga vetëdija e njerëzve ndjenjat ndaj besimit fetar. Kreu i regjimit, E. Hoxha do të nënvizonte:

“Këtë anë të shpjegimit historik të praktikave të fesë, ne nuk duhet të harrojmë, po t’a përdorim dhe tok me të, të ngjallim dhe të vemë në luftë me këto praktika fetare, patriotizmin e madh të masave. T’u shpjegojmë masave historikisht dhe materialisht ç’vuajtje, ç’mjerime, gjakderdhje e shtypje ka pësuar populli ynë, veçanërisht nga feja, se si ajo përçante, vinte në luftë vëllanë kundër vëllait për të na shtypur më mirë, për të na robëruar më lehtë dhe për të na pirë gjakun në emër të saj. Feja kristiane duhet thënë është më e egra, me reaksionarja. Por të gjithë derrat një turi kanë”. [A.Q.SH.i R.SH. F.3,V.1967, D 94,f.6].

Qëndrimi ndaj klerit mysliman dhe atij të sektit bektashi ishte më i moderuar. Madje në letrën drejtuar Komitetit të Partisë së rrethit të Durrësit, konstatohet vlerësimi i E. Hoxhës rreth veprimeve të klerit mysliman, sapo filloi inisiativa e rinisë së shkollës “Naim Frashëri”, për prishjen e kishave dhe xhamiave. Kleri mysliman, ndryshe nga klerikët e krishterë, ortodoksë dhe katolikë, iu përgjigj kësaj thirrje me aksione personale për të dorëzuar gjithçka. Këto veprime i shkuan për shtat regjimit, qëndrimeve të tij politike, qëllimi final i të cilës ishte i

lexueshëm. Klerikët mysliman për të shmangur një sulm tjetër ndaj tyre, lëvizën më shpejtë duke dorëzuar gjithçka dhe duke u dorëzuar para sfidës që u kishte vënë përballë regjimi.

“Në këto situata revolucionare, kemi marrë vesh se kryesia e klerit bektashian dhe mysliman u kanë lëshuar një qarkore të gjithë hoxhallarëve e dervishlereve të heqin çallmat dhe taçet, të heqin xhybet dhe të dorëzojnë teqet dhe xhamitë. A është kjo një iniciativë e mirë nga ana e tyre? Po të na kishin pyetur ne, ne nuk do t'i këshillonim t'a bënin, por tash që e bënë, ne as nuk u themi të tërhiqen. Gjesti i tyre sado, sido i shpejtuar, prapë i shërben interesave të përgjithëshme. Ai është një gjest patriotik dhe i guximshëm nga ana e tyre, se pavarësisht se do të vazhdojnë të besojnë në fe, ata thyen një traditë shekullore, gjë që i nderon ata, pse në vetvehte është një mendim dhe vendim përparimtar”. [A.Q.SH. i R.SH. F.3, V.1967, D 94, fl.9].

E. Hoxha do të vinte në dukje mbështetjen, në fakt të imponuar, që gjeti kjo platformë radikale e regjimit nga organizata shoqërore më masive e kohës, Fronti Demokratik i Shqipërisë.

“Kjo lëvizje e madhe, e cila përfshiu të gjithë vendin, që pati si objektiv të saj mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave tona, u përkrah aktivisht nga Fronti Demokratik... Organizatat e Frontit e kanë bërë problemin e gruas, problem të të gjithë shoqërisë”. [Hoxha, Enver, “Raporte Fjalime 1967-1968”, 1968:194-198].

E filluar menjëherë pas luftës kundër okupatorëve, lufta kundër fesë nuk kishte pritur Revolucionin Kulturor Kinez. Viti 1967 shënoi fillimin e fundit të goditjes kundër fesë. Duke pasur frikën e besimtarëve, regjimi komunist kishte vepruar më shumë në fshehtësi, nëpërmjet organeve të sigurimit të shtetit, apo nëpërmjet propagandës në të gjitha nivelet. Propaganda partiake do të vazhdonte presionin e saj me direktiva, duke vënë në lëvizje levat më të fuqishme të saj. Shembull u bë K.P. Të rrethit të Durrësit:

“Me qëllim që të intensifikohet propaganda ateiste shkencore, po përgatiten dhe do t'u dërgohen dy broshura; Klasikët e marksizëm – leninizmit kundër fesë dhe disa materiale të partisë kundër fesë; një material i mirë është, feja është opium për popullin”; Propaganda ateiste shkencore të bëhet e diferencuar sipas fesë përkatëse bazë zone e fshati. Duke shpjeguar kotësinë e besimeve e zakoneve fetare, të bëjmë demaskimin e thellë të tyre”. [A.Q.SH. i R.SH. F.3, V.1967, D. 94, fl.12].

Pas vitit 1967 të daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, vendi u përfshi nga pasoja të rënda, nën efektet e përfshirjes së kontinenteve në “luftën e ftohtë”. Rugëzgjdhjet për këtë situatë do të kërkoheshin nga udheheqja politike në planin e brendëshëm, duke e mbuluar realitetin me një propagandë të fuqishme. Kulti i Zotit po zëvendesohej me atë të E. Hoxhës. Në shkurt të vitit 1967, u zhvillua akti i fundit i tragjedisë së institucioneve fetare.

Nisma filloi nga nxënësit e gjimnazit “Naim Frashëri” në Durrës. Ndonëse jo me vullnetin e tyre të lirë, ata nxitën një lëvizje masive për të ç’rrenjosur fenë dhe besimet nga gjiri i popullit. Tashmë dorashkat ishin hequr. E drejta e fesë ishte afirmuar në Kushtetutën e regjimit komunist të vitit 1946. Megjithatë, ajo ishte vullnet i qytetarëve dhe natyrisht, qeveria shqiptare në aparençë, nuk shkoi kundër vullnetit të popullit. Grupet e të rinjve, të ndihmuar nga ushtarët dhe policët civilë, sulmuan kishat, manastiret, xhamitë dhe teqetë. Turmat sulmuan fizikisht institucionet fetare, duke përdhosur çdo objekt të shenjtë. Zyrtarët “i lanë” qytetarët të shprehnin “vullnetin” e tyre! Gjatë gjithë vitit ata demaskuan në mbledhje kolektive dhe dënuan klerikët.

Kjo nismë ishte kopjimi i Revolucionit Kulturor Kinez në Shqipëri, i cili më vonë do të shfaqet në të gjitha fushat, do të ndryshojë jetën sociale, nëpërmjet zhdukjes së besimit fetar, ideologjizimit të artit dhe kulturës, duke synuar krijimin e “njeriut të ri”. Shëmbëlltyra e veprimit kinez do të depërtonte në jetën shqiptare në mënyrë institucionale.

“Ne nuk kemi lënë asnjë shkollë, qoftë dhe të ulët për të nxjerre klerikë të rinj, kështu klerikët e çdo besimi kanë shteruar. Muslimanët as kanë as mund të kenë dhe as mund të këndojnë dot ndonjë kuran të vjetër, pasi ai është në arabisht. Praktikisht, ato rrojnë me disa bejte të kuranit që i mësojnë përmendësh, që nuk i kuptojnë apo transmetojnë gojarisht. Ortodoksët s’janë as më të pasur as me të ngritur. Ata kanë vetëm avantazhin që ungjillin e kanë në shqip. Kurse katolikët dhe kleri sidomos është më i pasur në libra, më i ngritur vetë dhe atje ku mundin, ata vazhdojnë të zhvillojnë fenë katolike, në filozofi. Pra, bazën materiale dhe propagandistike për shumëzimin e librave fetare e kemi zhdukur. Ne kemi zhdukur gjithashtu, mundësinë e nxjerrjes së kuadrove. Tash është çështja të prishen kisha dhe xhamia, të vetmet mjete kryesore ku klerikët grumbullojnë besimtarët për të mbajtur gjallë besimin, qoftë dhe në formë dekadente. Prishja e kishave, xhamive, teqeve e manastireve, natyrisht paraqitet më e vështirë, për arsye se nuk duhet shkuar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me atë pjesë të popullit që beson. Por mjaftë prej tyre janë prishur pa ngjallur asnjë reaksion, disa të tjera janë prishur se kanë rënë, ka nga ato që janë kthyer se kanë ngelur pa hoxhë apo pa prift dhe nuk funksionojnë; t’i rrafshojmë nga faqa e dheut”. [A.Q.SH.i R.SH. F.3,V.1967 D. 94,fl.3, 4].

Pjesë të këtij dokumenti shprehin shumë qartë synimin e vërtetë të qeverisë dhe E. Hoxhës për zhdukjen e fesë. Edhe pse u munduan që këtë betejë përfundimtare t’ia “faturonin” rinisë, si inisiativë e saj, direktivat e Komitetit Qëndror shprehnin haptazi qëllimin e ç’rrenjosjes së fesë brenda mjedisit social shqiptar. Akuzat u fokusuan në bazën historike tradicionale të besimeve fetare, duke krijuar një klimë të besueshme për opinionin shqiptar të maskuar nën petkun e urrejtjes që kishte brenda vetëdijes së tij populli shqiptar në raport me pushtuesit e vendit.

“Një armë historike kundër fesë dhe klerikëve reaksionarë, është dhe fakti se, feja muslimane ka qenë ideologjia e pushtuesve turq, feja ortodokse ideologjia e shovinistëve greke që pushtonin në kohët e kaluara vendin tonë dhe feja katolike me qendër Vatikanin ka qenë ideologjia e pushtuesve italianë”. [A.Q.SH.i R.SH.F.3,V.1967, D. 94,fl.3, 8].

Duke folur në Kongresin e 5-të të partisë për luftën e klasave, E. Hoxha do të theksonte:

“Luftë klase është lufta kundër ideologjisë fetare, paragjykimeve, bestynive e zakoneve prapanike. Komiteti i partisë i rrethit të Durrësit, është ndalur në zbërthimin e aspekteve të veçanta dhe ka përcaktuar detyrat kryesore. Aksioni revolucionar i rinisë së shkollës “Naim Frashëri”, udhëhiqet nga organizata e rinisë”. [Gazeta”Zëri i popullit”, 1967, nr. 33:1-2].

Nisma e rinisë në rrethin e Durrësit do të bëhej objekt i fjalimit të E. Hoxhës në kongres, duke i dhënë hapësirë më të gjerë dhe më komplekse synimit politiko ideologjik në interes të forcimit të situatës së brendëshme.

“Partia shtron detyrën që letërsia dhe artet të bëhen një armë e fuqishme në duart e partisë për edukimin e punonjësve me frymën e socializmit dhe komunizmit, që ata të qëndrojnë në radhët e para të luftës për të edukuar një rini të pastër ideologjikisht e moralisht; që gjithë krijmtaria artistike të ketë një nivel të lartë ideologjik të përshkohet nga fryma revolucionare luftarake e partisë, si dhe fryma e shëndoshë kombëtare; arti dhe kultura jonë socialiste duhet të mbështeten fortë në tokën tonë amëtare, ato duhet të burojnë nga populli dhe të jenë plotësisht në shërbim të tij. Revolucionarizimi duhet të jetë i gjithanshëm, të përfshijë vetë sistemin arsimor, brendinë e punës arsimore edukative, si dhe metodat e mësimin e edukimit, lidhjet e mësimin me punën”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr. 263:2].

Lëvizja pati si qëllim edukimin me frymën komuniste dhe lidhjen e ngushtë me fshatarësinë. Duke qenë se përbënte pjesën më të madhe të popullsisë, fshatarësia u pa si mbështetëse kryesore e kësaj lëvizje. Por ajo që do të kishte rëndësinë më të madhe në këtë revolucion kulturor, do të ishte kultura e re socialiste, e cila do të frymëzonte njeriun e ri. Partia do të ishte udhëheqëse e këtij revolucion kundër çdo gjëje të vjetër, reaksionare, borgjeze.

Rinia shqiptare duhej të frymëzohej me frymën e materializmit dialektik dhe historik, ajo do të ishte elementi që do të përmbyste të vjetrën. Me frymën revolucionare dhe me rolin e shkollës, rinia u lidh me realitetin, me kontributin e saj për ndërtimin e socializmit, duke njohur praktikën dhe jetën. Rinia duhej të edukohej me botkuptimin komunist, jo vetëm në programin mësimor, por dhe në familje.

“Pse ne mund t’a edukojmë mirë të riun tonë në mëngjes, po pasdreke ose në mbremje ata i edukon filmi borgjez, muzika dekadente ose romani borgjez. Në këtë drejtim, ne duhet të pastrojmë me fshesë të madhe, por dhe duhet të perpiqemi t’i zëvendësojmë këto që do të pastrojmë, me gjërat tona të bukura, revolucionare”. [Hoxha, Enver, 1979:369].

Asgjë nuk ndryshonte me Revolucionin Kulturor Kinez. Frymëzimi prej tij imponoi lidhjen e punës prodhuese me mësimin; intelektualët, artistët, shkrimtarët, arsimtarët, punonjësit e administratës, të gjithë duhet të njihnin më mirë jetën, duke qëndruar me afër punëtorëve dhe fshatarëve. Filloi kudo përgatitja fizike dhe ushtarake, për të qenë gati për mbrojtjen e atdheut, jo vetëm e rinisë, por e të gjithë punonjësve. Në të përditëshmen zyrtare “Zëri i Popullit”, do të realizohej në mënyrë periodike sensibilizimi i opinionit, duke reflektuar ndaj letrës së hapur të K.Q. të Partisë. Letra falënderimi vinin nga ndërmarrjet apo zotimet e tyre për të marrë pjesë në punën prodhuese, duke iu referuar kështu lidhjeve të intelektualëve me prodhimin, për të vënë në jetë fjalën e partisë.

“Ajo do të bëjë që fryma revolucionare, ajo e vënies së interesit të përgjithshëm mbi atë personal, lidhjet e ngushta me popullin në punë dhe jetesa, të përshkojë gjithë qenien tonë; sot mbi 20. 000 të rinj po punojnë në Thumane, Çermë, Sukth, në ndërtimin e rrugëve e pyjore në fshat”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr. 182:2].

Kultura fizike dhe përgatitja ushtarake morën një rëndësi të veçantë për të mbrojtur vendin nga armiqtë imagjinarë. Parrulla luftarake shpërthyen kudo, propaganda dhe puna e organeve të partisë, e instaluar në çdo qelizë të shoqërisë, do të merrnin të parat iniciativat për të arritur më pas masivitetin e kësaj lëvizje, e cila ndryshoi të gjithë jetën shoqërore. Ishte një gjetje e kohës, vendosja në qendër të propogandës partiake të frymës së ndërgjegjes kombëtare, e cila lidhej me rrezikun e pushtimit të vendit, duke i servirur popullit parrullën me efekte psikologjike; “*armiku tek porta*”. Ngritja në nivel shumë të lartë të propogandës në drejtim të mbrojtjes së vendit, krijoi imazhin e një patriotizmi që reflektonte me pjesmarrjen masive të njerëzve, burrave, grave dhe vajzave në çështjet e mbrojtjes së vendit. “*Masiviteti po bëhet gjithmonë e më shumë dallues i kësaj lëvizje; Parrulla luftarake revolucionare e saj; “Të ndërtojmë socializmin, duke mbajtur në njerën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën*”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr. 182:1].

Direktivat e partisë do të bëheshin shumë të rëndësishme në lidhje me përgatitjen fizike dhe ushtarake të popullit. Përgatitja fizike e rinisë dhe e mbarë popullit, u konceptua si element

mbizotërues në arritje më të larta në prodhim, në kapërcimin e vështirësive në jetë. Parulla revolucionare,

“gati për punë e mbrojtje”, përfshinte të gjithë njerëzit veçanërisht rininë, të marrin pjesë aktive në ushtrimin e të gjitha llojeve të sporteve, që nga gjimnastika e përditëshme, atletika e lehtë, marshimet turistike, eskursionet ngjitjet alpinistike, noti, mundjet, ngritja e peshave dhe të gjitha llojet e tjera të sportit, veçanërisht ato ushtarake; të kombinohet edukimi i përgjithshëm fizik me edukatën paraushtarake dhe ushtarake, sidomos me qitjen, marshimet dhe elementet e tjerë të sporteve ushtarake; gjimnastika e mëngjesit që lindi si një lëvizje vullnetare dhe e ndërgjegjshme e masave, hodhi poshtë pretendimin se ky aksion është vetëm i rinisë”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr.186:1].

Në panoramën e përgjithëshme politike dhe sociale të kësaj periudhe, këto ndryshime, mbi bazën e të gjithë direktivave partiake, kishin në qendër të synimit *“ndërtimin e njeriut të ri shqiptar”*, sipas përvojave të regjimeve në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë. Thelbi i direktivave partiake synonte ndryshimin e realitetit që zvarritej brenda sistemit politik me stadin e rezistencës, e cila edhe pse e dobët, shqetësonte udhëheqjen e lartë të shtetit komunist.

Kjo filozofi filloi të fitonte terren duke u propaganduar si shpëtim. Propaganda kundër sistemit kapitalist dhe *“egërsisë”* së tij, filloi të futej në poret e shoqërisë. U shfrytëzuan politikisht reformat e thella. Shqipëria nga një vend thellësisht agrar i prapambetur, u fut në një stad zhvillimi, që duke kaluar etapë pas etape, arriti të depërtonte në psikologjinë e masës me një sistem propagandistik të fuqishëm dhe të kontrolluar. Për hir të së vërtetës, të gjitha këto ndryshime arritën të krijojnë një sistem bashkëpunimi, solidariteti, të cilët sipas kohës vlerësoheshin si element formues të njeriut të ri.

Në planin psikologjik u synua drejt shoqërisë pa strese, duke imponuar tek individ i mendimin dominant se, përreth tij ekzistonte solidariteti dhe çdo evendiment social bëhej pjesë e raporteve shoqërore. Me këtë synohej arritja e korelacioneve, lidhjeve individ - shoqëri, duke arritur realizimin e idesë fikse të raporteve të pashkëputura midis tyre. Ky ishte një lloj skllavërimi i iniciativës personale dhe ndaj të menduarit ndryshe. P.sh. të arsyetojmë mbi problemet e seksit, veçanërisht për rininë, e cila kishte mendimin tabu, se një fenomen i tillë ishte *“mëkat”* dhe propogandohej si shkalla më e lartë e imoralitetit.

Familja ishte e papërgatitur të edukonte fëmijët dhe shpesh për shkak të injorancës, detyroheshin të gënjenin për hir të ruajtjes së moralit dhe për t'u hequr nga koka këtë ndjesi të imponuar nga çështja e opinionit shoqëror. Gjykimi edhe pse ishte i dhimbshëm dhe kontradiktor, ndodhej në trysinë e realitetit shoqëror. Kjo çonte në depersonalizimin e individit, në trysni psikologjike, shpesh në tronditje sociale me ngjarje të rënda të pashpallura në opinion, përballë gjendjes së alarmit të brendshëm për t'i ndrydhur me çdo kusht problemet brenda familjes. Kjo situatë vazhdonte të kryente erozionin social të padukshëm, përballë synimit në opinionin shoqëror që, “*ky sistem vlerash*” të mbetet i pacënuar.

Në këtë plan, u synua solidariteti midis shtresave të shoqërisë, punëtorëve, duke i joshur me “*sundimin e ideologjisë së klasës punëtore*” në pushtet, intelektualëve, ushtarakëve, fshatarësisë kooperativiste. Me një vështrim të kujdeshëm, mungesa e disa elementëve të tillë social shtuan në mënyrë të pashmangëshme stresin në shoqëri, përballë përgjegjësisë shoqërore dhe legjislacionit në pamje demokratik, në thelb autoritarist në shërbim të pushtetit. Ato fenomene janë bërë shkak për ekzistencën e stresit në nivel të lartë edhe në kohën e sotme.

Dy pozicione arsyetohen në planin psikologjik. “*Njeriu i ri*” do të kthehej në një kopje e shëmtuar e ndikimit sovjetik, duke mos arritur të justifikonte një mal me difekte në trajtimin social psikologjik të individit nga politikat e sistemit. Kjo e dyta, bëri që lufta e klasave të depërtonte frikshëm në sistem në disa breza, duke rritur artificialisht përgjegjësinë dhe “*mëkat*in” ndaj pushtetit popullor.

Në planin psikologjik, nxjerr krye veçoria shqiptare për të krjuar ngjarje dhe heronj, të cilët ekzistonin për së gjalli. Kopja e keqe e “*Korçaginëve dhe Lej Fenëve*”, sollën shembullin dhe heronjtë, të cilët u përdorën shpesh rëndom për të rritur vullnetarizmin në punë. Kjo solli një veçori të re për “*njeriun e ri*”; të mësohej nga shembulli pozitiv duke e masivizuar atë. Në pamje teza rezultonte e drejtë, ndërsa në thelb ofronte rrugëzgjdhje jo të drejta. Ekzagjerimi me disa

figura, bëri që në opinion në formën satirike të qarkullonin barsaletat, si mënyra e hollë dhe më pak e dëmshme e shfaqjes së mendimit ndryshe. Zakonisht, si shembuj pozitivë merreshin njerëz që sakrifikonin jetën, qoftë nga periudha e luftës apo dhe e ndërtimit socialist, por merreshin edhe njerëz të gjallë, që nuk u dihej historia dhe më tej, fati i tyre. Shumë nga këta “heronj” u groposën.

Në planin politik, sistemi u mundua të jepte dimensione reale, duke e burokratizuar dhe standardizuar “njeriun shqiptar”. Mbi përvojën personale gjykoj se, sot termi “njeriu i ri” i sistemit socialist, përdoret me sarkazëm, duke shprehur paradoksin e thelbit të sistemit komunist.

Në planin politiko - ideologjik, përfaqësuesit ishin të zakonshëm, shpesh të ngritur nga hiçi, të cilët të lartësuar në majën e pushtetit dhe në hijen e udhëheqësit tentonin të bënin për njeriun e thjeshtë “edhe diellin dhe hënën”. Rruga e kalimit nga thelbi i filozofisë së “njeriut të ri”, në standardizimin e tij, u shoqërua me shumë gabime. Solidariteti u keqpërdor për të rritur nivelin e kontrollit dhe ndëshkimit, u shoqërua me një nivel të ulët kulturor, duke synuar një stad të ri shoqëror, nëpërmjet edukimit “në gjirin e klasës punëtore”, duke sjellë në realitet uniformizimin e jetës sociale, që solli pasoja të rënda në tjetërsimin artificial të individit.

Hedhja e tezave nga udhëheqja, u kthye në detyrim për strukturat shoqërore dhe individin, në gjetjen me çdo kusht të “realiteteve”, duke sajuar gjithçka deri në pamundësi. “Njeriu i ri” shqiptar u vu përballë kontrollit të gjithanshëm deri në jetën e tij private brenda familjes. Në këtë “reformim” social psikologjik në shtresën fshatare, paralelisht me dashurinë që ushqenin për udhëheqjen, ajo mbante brenda vetes besimin fetar, të cilin e ruante dhe e shprehte në mënyrën e vet. Çështja e besimit mbeti një “problem - pezull” në masat e gjera popullore, i cili nuk mund të unifikohej lehtë me kërkesat politike dhe ideologjike, edhe pse realiteti e përjetoi atë ideologjikisht.

Beteja për të fituar *“njeriun e ri”* për sietmin ishte shumë e vështirë dhe nuk u arrit kurrë edhe pse *“boshllëku”* ideologjik nuk ekzistonte për shkak të trysnisë së propogandës të ngritur në sistem. Në këtë kontekst, për sistemin qëllimi mund të ishte shumë i madh, por kushtet, mjetet, rrugët për ta arritur këtë mungonin. Realiteti shqiptar edhe pse i ndodhur nën trysinë e filozofisë dhe ideologjisë komuniste, përsëri mbetej kokëfort. Mjaft nga elementët social psikologjik dhe kulturor, që i atriboheshin me entuziazëm partiak natyrës *“së njeriut të ri”*, nuk i rezistuan kohës. Nga vetë elita komuniste, çështja e sistemit socialist u muar shumë lehtë e thjeshtë, në mënyrë mekanike, duke përgatitur gradualisht rënimin e tij.

Në studim këtë aspekt e kam trajtuar më gjerësisht, duke pasur parasysh faktin që, brenda kësaj punë marramendëse propogandistike, të shoqëruar me masa shtrënguese partiake e ligjore, kishte praninë e saj femra shqiptare, e cila përbënte gjysmën e popullsisë dhe shfaqte interesimin e veçantë të pushtetit politik. Synimi drejt *“njeriut të ri”*, synonte gruan dhe vajzën shqiptare të burrëruar, të emancipuar, punëtore dhe të përgatitur ushtarakisht për mbrojtjen e vendit. Kapërcimi i parashikimeve dhe mudnësive të saj reale, sollën sforcimin femëror që mbulohej me zgjuarësi nga propoganda e regjimit. Një aspekt i veçantë që do të terheq vëmendjen edhe të studjuesve të tjerë.

4.6. Ndryshimet social - kulturore, si pasojë e revolucionarizimit dhe reflektimi i tyre në problemin gjinor.

Ndikimet kineze që ndodhën në Shqipëri, nuk patën asnjë ndryshim nga ajo që ndodhi në Kinë, përfshirja në revolucion në të gjithë jetën shoqërore të vendit. Një mëngjes që fillonte në çdo ndërmarrje apo dikaster me gjimnastik, me realizimin e planit, me zborin për mbrojtjen e atdheut për të qenë të përgatitur fizikisht, aksionet nëpër fshatra, rrugë apo vepra industriale. Puna prodhuese, që u bë detyrim për çdo kuadër për të siguruar lidhjet me masat, çdo gjë për masat

dhe në emër të masës. Edukimi revolucionar i saj konsiderohej si vlerë e paçmuar. Madje kërkohej që arti, bota e krijmtarisë të ishte Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, e krijuar në vitin 1957, institucioni ku kalonte gjithçka që kishte të bënte me botën e krijmtarisë, të mos i shpëtonin revolucionit kulturor.

Arti mori tipare popullore, motivi tij duhej të ishte revolucioni popullor. Tradita popullore gërshetohej me profesionalizmin, por dhe me amatorizmin. Si në fshat dhe në qytet, masat duhej të merrnin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin kulturor, prej nga dilnin talente. Në këtë art, sipas konceptit ideologjik që dominonte, populli ishte protagonist kryesor; rrënjët e artit ishin në popull; arti ishte realist dhe ai pasqyronte jetën e thjeshtë në fshat dhe qytet, në mal apo në fushë.

I nxitur nga entuziazmi formal udhëheqësi komunist E. Hoxha, do të deklaronte: *“Arti dhe kultura jonë të jenë socialiste nga përmbajtja dhe kombëtare nga forma”*. [Hoxha, Enver, 1981, V.34:69]. Më poshtë ai i referohej Leninit, duke shfaqur vendosmërinë e nxënësit të zellshëm:

“Arti i përket popullit. Ai duhet t’i shtrijë rrënjët e tij të thella në shtresat e dendura të masave të gjera punonjëse. Ai duhet të jetë i kuptueshëm prej tyre dhe i dashur për ta. Ai duhet të bashkojë ndjenjat, mendimet dhe vullnetin e këtyre masave, t’i ngrerë ato. Ai duhet të lindë tek ata, artistët, dhe t’i zhvillojë”. [Materializmi Dialektik dhe Historik, 1971:591-592].

Zhvillimi i kulturës socialiste, u shtri në qelizën më të rëndësishme të shoqërisë, në arsim, në të gjitha tekstet shkollore, të cilat morën karakter indoktrinues për brezin e ri. Arsimimi u ndërtua në baza ateiste - shkencore. Arti dhe kultura duhej të kishte karakterin kombëtar, në pedestal të saj duhet të ishte heroi i punës, në çdo aspekt kulturor, në teatër, në film, në vepra, në shfaqjet e ansambleve dhe estradat e ngritura në çdo qytet apo ndërmarrje. Heroi që lufton për ndërtimin e socializmit, mbrojtjen e atdheut apo çuarjen përpara të revolucionit socialist, duhet të vihet në qendër të tyre.

Krijimi i “njeriut të ri” ishte një prirje e sistemit, i cili mbi bazën e ideologjisë së re u fut në një proces të gjatë ndryshimesh, por që nuk ja arriti qëllimit. Nëse do të ishte arritur ky objektivi, atëherë do të mendonim se dhe vet sistemi socialist nuk do të ndryshonte. Çështja e këtij objektivi, në thelb ideologjik, është paksa e vështirë për t’u shpjeguar kur ende mjaft fije lidhëse akoma ekzistojnë në veprimin e tyre në hije. Ai lidhej tërësisht nga mënyra se si do të ndërtoheshin marrëdhëniet ekonomike, të cilat do të arrinin ose jo, të integronin njerëzit në tërë sistemin e ingranazheve që do të funksiononin në shoqërinë siocialiste.

Gjithçka kishte të bënte me edukimin komunist, në themel të të cilit qëndronte prona e përbashkët. Ndërgjegja komuniste e “njeriut të ri”, që vendos interesin e përgjithshëm mbi interesin personal, ishte garancia e kësaj prone. Ideologjia e klasës punëtore u bë pikë referimi. Intelektuali, i gjendur nën trysinë e bashkëpunimit të tij jo me botën e brendëshme shpirtërore, por me atë që orientonte partia, duhej ta gjente frymëzimin te punëtori, fshatari, mjelësja, gjithçka që kishte të bënte me revolucionin. Punëtori duhej të ndjehej i barabartë me intelektualin. Në këtë mënyrë, kultura do të ishte dhe pronë e klasës punëtore.

Më vonë E. Hoxha do të dilte kundër Revolucionit Kulturor Kinez. Ai shkruante:

“Sipas këtyre, këtej e tutje nuk është e nevojshme të frymëzohesh nga Revolucioni Kulturor, ashtu sikundër u zevëndësua marksizëm - leninizmi me “maocedun - idenë” ashtu edhe revolucioni kulturor ka brenda revolucionin socialist të Tetorit. Këto shkruanin gazetat kineze. Ky qëndrim është i turpshëm dhe antimarksist. Ushtria të ishte gati, por të mos lëvizte; punësia dhe fshatarësia të mos nxiteshin dhe të gjitha këto të mbuloheshin me kultin e Maos”. [Hoxha, Enver, 1979:274-275].

E. Hoxha kritikoi revolucionin kinez dhe kultin e individit, megjithëse vetë nuk bëri asgjë ndryshe, madje ndërtoi një sistem kulturor më të egër. Duke ndjekur shembullin e “Gardistëve të Kuq”, ai ia la këtë mision rinisë, me orientimin rezervë se në udheheqje të saj është Partia ku shumicën nuk e përbënin intelektualët, por klasa punëtore dhe fshatarësia. “Diktatura e proletariatit, është një luftë e ashpër me gjak e pa gjak, e përdhunueshme e paqësore, ushtarake e ekonomike, pedagogjike e administrative kundër forcave dhe traditave të shoqërisë së vjetër”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr. 147:1].

Realiteti shqiptar përjetoi të njejtat spazma të Revolucionit Kulturor Kinez. Viti 1967 ishte i mbushur me jehona të përditshme të shtypit të kohës mbi punën e rinisë me arritjet e saj, forcën e saj të madhe në familje dhe shoqëri si dhe në ndërtimin e socializmit. Kudo flitej për iniciativat e rinisë për atdheun, për përgatitjen e saj fizike dhe ushtarake, për një brez që i përballon fuqishëm vështirësitë e jetës, që njeh punën dhe respekton atë, duke u edukuar me frymën e saj që në shkollë për të siguruar lidhje të ngushta me fshatin, për të mos i përbuzur, por për të respektuar punën dhe kontributin e fshatarëve.

“Berati në ditët e para të vitit të ri, jeton në një atmosferë mendimi dhe pune revolucionare, këtë e ndjen dhe e sheh kudo që kalon këtyre anëve. E sheh në qytet dhe fshat, në zonat e fushës dhe të maleve; ka kaluar pak kohë nga mbyllja me sukses e kongresit të 5-të të partisë dhe në përgjigje të thirrjes së tij; “t’u qepemi kodrave dhe maleve t’i bëjmë dhe ato të begatëshme si fushat”, të rinjtë e Lapardhasë dhe pas këtyre iniciativave të guximshme mijra të rinj e të reja nga të katër anët e Shqipërisë, filluan një punë, që nga përmbajtja e saj ideologjike komuniste, është me vlerë të pallogariteshme, 860 të rinj të Vlorës vajtën për të hapur tokat e reja në Tragjas; 800 të rinj të kooperativës fushore të Shkodrës vajtën në Korçë, Lushnjë, Përmet. Të 9. 000 të rinjtë e të rejtat që po punojnë në malësitë tona, po tregojnë se idetë e mëdha revolucionare, zgjojnë energji të mëdha, se aksioni revolucionarizon prodhimin, rrit prodhimin dhe përvetësojnë cilësi komuniste”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1967, nr. 2:2].

Tre ditë më pas, do të jepej njoftimi tjetër propogandistik, që përfshinte një masë shumë të madhe të rinjsh, të përfshirë në vullnetarizëm:

“Janë regjistruar 80. 000 të rinj në hekurudhën Rrogozhinë - Fier, ndërsa 13. 000 të reja janë ngjitur kodrave e maleve për hapjen e tokave të reja; 6000 të rinj e të reja në hekurudhën Rrogozhinë - Fier, e cila iu besua rinisë në kongresin e 5-të të saj”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1967, nr. 5:3].

Kontributi vullnetar, përtej propagandës së përgatitjes fizike dhe lidhjes së teorisë me praktikën, ishte një e ardhur shumë e mirë ekonomike. Nga viti 1947, viti i ndërtimit të hekurudhës Durrës - Peqin, aksionet me punë vullnetare u bënë sistematike. Propaganda ishte e pandërprere, jo vetëm në shtyp, por dhe në opinionin publik, duke i reklamuar aksionet dhe punën vullnetare si dëshirë të vet rinisë.

Në kushtet e sistemit totalitar, ideologjia dhe psikologjia shoqërore trajtoheshin në një kapitull të përbashkët dhe në unitet thelbësor me njëra - tjetrën. Ideologjia përfshinte ide dhe pikpamje të përgjithësuara teorikisht, të çliruara nga ndjenjat dhe përfytyrimet e trubullta të pjestarëve të klasës, si i vetmi favor partiak për të ruajtur pushtetin. Ideologjia si mendim i përpunuar teorik,

shprehej "në doktrinat e ndryshme politike, juridike, etike, estetike, fetare, filozofike...dhe pse jo dhe psikologjike" [Materializmi Dialektik dhe Historik, 1971:548]. Kostatimi, se në shoqëritë me klasa "psikologjia shoqërore ka karakter klasor", ishte në qendër të trajtimeve teorike në këtë fushë. Ky përbënte një rregull që nuk pranonte asnjë përjashtim.

Ky orientim bëhej me të vetmin synim, për të dalë në vlerësimet superiore të psikologjisë dominuese të sistemit, në psikologjinë e klasës punëtore. "Nëpërmjet ideologjisë klasa bëhet e vetëdijëshme për interesat dhe qëllimet e saj, kurse nëpërmjet psikologjisë ajo i ndjen dhe i përjeton këto interesa dhe qëllime" [Materializmi Dialektik dhe Historik, 1971:550] Në këtë aspekt nuk përjashtohet mbizotërimi i elementit spontan, "instiktit të klasës". Ky element psiko - social, krijonte në masë dhe mbi drejtuesit ndjesi të kornizuara, duke standardizuar vlerat e klasës punëtore, si pjesa pararojë në udhëheqjen e vendit nëpërmjet partisë së saj, si doktrina bazë e filozofisë së kohës. Orientimi politikisht shfaqej i qartë;

"Psikologjia shoqërore është tërësia e ndjenjave, përjetimeve, vullnetit dhe gjëndjes shpirtërore të njerëzve, grupeve dhe klasave të ndryshme në një etapë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë"
[Materializmi Dialektik dhe Historik, 1971:538].

Pra elementi bazë, ndarja e shoqërisë në klasa, shprehte thelbin e mendimit në shoqërinë shqiptare. Është kjo një nga arsyet, që në këtë fushë nuk mund të kontribonte kushdo dhe nuk mund të dilej jashtë këtij konteksti. Ky kushtëzim, i jepte të drejtën vetëm një kategorie njerëzish të përfshiheshin në drejtimin e shoqërisë, duke krijuar sistemin klanor të familjeve të mira, të mbiemrave, fiseve të lidhura me pushtetin popullor, në mes të të cilëve lundronin në joshjen e vlerave tradicionale kombëtare shumë pasardhës të figurave të shquara të kombit shqiptar.

Vetëm duke analizuar këto të slligane politiko filozofike të ideologjisë komuniste, të dhënat propogandistike në shtypin e kohës, gjykoj se efektet përgjithësuese mbi situatën revolucionare të krijuar masivisht duke kontrolluar gjithçka, e kthente këtë makineri gjigande të pushtetit në një mekanizëm veprues marramendës, që nuk linte hapësira dhe kohë boshe për interpretime të tjera. Në një plan të padukshëm, kjo situatë shoqërohej me masa të tjera plotësuese në vijën politike që

përcillej në organizatat e partisë dhe në ato të masave, ku fetishizohej gjithçka që kishte të bënte me drejtësinë e vijës politike të partisë në interes të masave të gjera popullore. Ekzistonte një lloj imponimi për ta pranuar këtë realitet. E shmugur deri në përbuzje, përballë këtij realiteti qëndronte shtresa e grave dhe vajzave shqiptare.

Pavarësisht kësaj fasade, realiteti shqiptar në drejtimin e shoqërisë njohu deformime të tjera, të cilat penalizuan inteligjencien dhe shtresën gjinore, duke e futur atë nën trysinë e morsës sociale të psikologjisë së nënshtrimit.

KAPITULLI V: Pozita e gruas dhe pabarazia gjinore gjatë shndërrimeve ekonomike, politike dhe kulturore, 1945 - 1967.

5.1. Gjendja sociale e gruas gjatë Luftës Antifashiste Nacional - Çlirimtare dhe pas çlirimit.

Gruaja shqiptare ishte pjesëmarrëse e denjë e Luftës Nacional - Çlirimtare. Duke lënë pas paragjykimet e kohës, gratë shqiptare ndoqën shembullin e grave antifashiste në mbarë botën, në luftën kundër fashizmit, si një hap i rëndësishëm për fitoren e të drejtave të tyre. Gratë përfaqësonin një forcë kaq të rëndësishme të shoqërisë, e cila me përpjekjet dhe vetmohimin e saj, kontriboi për t'u çliruar nga zinxhirët e robërisë familjare dhe shoqërore.

Puna me gratë u konsiderua si një element i rëndësishëm nga organet drejtuese të luftës, duke i konsideruar ato të barabarta me burrat. Në këtë aspekt, formacionet partizane ndryshonin nga forcat nacionaliste, të cilët ishin në pozita shumë më konservatore e tradicionaliste. Komunistët shqiptarë ishin më realiste dhe më afër paraqitjes moderne të zgjerimit të mbështetjes për gratë, nëpërmjet pjesëmarrjes dhe kontributit të tyre. Ato u rreshtuan përkrah forcave antifashiste dhe progresiste. Gratë gjermane, si pjesë e milicisë së “*Folksturm-it*”, apo vajzat gjermane në përbërje të “*Hitlerjungen-it*”, luftuan me armë në dorë, jo vetëm kundër Ushtrisë së Kuqe, por

edhe kundër aleatëve në frontin e perëndimit. Gratë angleze ishin pjesë e ekuipazheve të artilerisë kundërajrore. Gratë sovjetike luftuan me armë në dore si partizane, madje edhe si pilote, në rradhët e Ushtrisë së Kuqe dhe në tokat e pushtuara. Gratë shqiptare iu bashkuan kësaj përfshirje në luftën antifashiste mbarevropiane. Pjesëmarrja e tyre në luftë ishte domosdoshmëri e kohës. Me pjesëmarrjen në këtë lëvizje, ato nisën emancipimin e tyre politik dhe shoqëror. Gratë shqipëtare u bënë pjesë e formacioneve të luftës që në fillimet e viteve 1942. Në qarkoren drejtuar orgnizatave të partisë të qarkut të Tiranës, në Nëntor të vitit 1942, E. Hoxha do të shprehej:

“Puna me gratë është lënë gjithashtu në një gjëndje të vajtueshme. Shokët kujtojnë se me gratë duhet të punojnë vetëm gratë, sikundër me të rinjtë vetëm rinia dhe dëndur vijnë raporte nga shokët: “unë kam tri gra simpatizante, unë kam pesë çupa, t’i marrë një shoqe”. Përse veprohet në këtë mënyrë? Arsyeja është e thjeshtë: se duan t’i heqin qafe, se s’duan të mundohen, se duan të jenë të lirë...; Kjo është arsyeja e thjeshtë, aq sa është e thjeshtë edhe direktiva e Partisë, se si me punue me gratë. [Hoxha, Enver, 1968, V.1:135].

Gratë e Shqipërisë, organizata e të cilave ishte formuar gjatë Luftës Nacional - Çlirimtare, mbajtën në vitin 1943 kongresin e tyre, në të cilin kryetare u zgjodh Ollga Plumbi. Në vitin 1946, vendin e saj e zuri Nexhmije Hoxha, e cila në vitin 1955 u zëvendësua nga Vito Kapo. Komunistët shqiptarë çdo vlerësim e veprim në drejtim të gruas, e shikonin nën prizmin e kontributit të saj në luftën kundër okupatorit. Gratë filluan të merrnin pjesë në kurse kundër analfabetizmit apo në mbledhjet e grupeve edukative. Ato morën pjesë, jo vetëm në veprimtaritë e tyre tradicionale në dobi të luftës, si në atë të përgatitjes së veshjeve për partizanët, por dhe në demonstratat antifashiste, duke filluar nga pranvera e viti 1942. Pjesëmarrja e tyre në propagandën antifashiste u kthye në rutinë. Ato u prezantuan që në Konferencën e Pezës, duke u trajtuar kështu si forcë e barabartë në luftë. Organizimi i grave u vlerësua nga komunistët si detyrë e rëndësishme e partisë së tyre. Viti 1943 shënoi një hap përpara në drejtim të organizimit të grave në luftë.

E. Hoxha do shprehej kështu në mbledhjen e K.Q. të P.K.SH:

“Gruaja shqiptare është e shtypur nga fashizmi, nga traditat dhe ligjet borgjeze e feudale; ajo e ndjen me tepër se kushdo luftën tonë, në të cilën ajo sheh dhe çlirimin e saj, ajo është gati të bëjë çdo sakrificë për vëllain e saj, për burrin, djalin, që luftojnë. Duhet të formojmë frontin e përbashkët antifashist të gruas shqiptare. Si punojnë shoqet tona, ashtu duhet të punojnë dhe gratë e popullit, sepse edhe ato e ndjejnë këtë luftë”. [Hoxha, Enver, 1968, V.1:222].

Shumë shpejt E. Hoxha do të hidhte një hap tjetër, atë të krijimit të organizatës antifashiste të grave, e cila i kishte hedhur rrënjët e saj që në vitin 1942, me pjesëmarrjen e tyre në Konferenca në të cilat bisedohej për çështje të rëndësishme politike, në kurset kundër analfabetizmit, në kurse të ndryshme ekonomie etj. Fillimisht u krijuan këshillat e lagjeve dhe qyteteve, të cilat u bënë më pas pjesë e frontit antifashist të grave.

Në direktivën e K.Q. të P.K.SH, thuhej:

“Me autorizimin e Komitetit Qëndror, është marrë iniciativë dhe u është dërguar gjithë qarkorëve një qarkore, me të cilën këshilloheni që të filloni punën për krijimin e organizatës së Bashkimit të Gruas Antifashiste Shqiptare...Shoqet tona t’ja kushtojnë punën më të madhe krijimit dhe forcimit të një aparati organizativ..”. [Hoxha, Enver, 1968, V.2:20,30].

Në këtë periudhë, ishin krijuar kushtet për një pjesëmarrje të tyre jo më spontane, por përmes një organizimi të drejtuar nga vet partia. Këmbëngulja e P.K.SH. realizoi pjesëmarrjen e grave në luftë, duke bërë që ato të fitojnë nëpërmjet kontributit në luftë të drejtat e tyre të barabarta me burrat. Jo vetëm juridikisht, por edhe praktikisht. Këto të drejta, të cilat morën formë ligjore në vendimin e marrë nga K.A.N.Ç. me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm, E. Hoxha:

“Para këtij faktori të rëndësishëm të Luftes Nacional - Çlirimtare, organizatës i paraqiten disa detyra, nga të cilat më kryesori është formimi i frontit antifashist të gruas shqiptare. Për formimin e këtij fronti, duhet të grumbullohen masat e gjëra të grave të çdo kategorie e çdo shtrese shoqërore; do të na ndihmojë në formimin e këtij fronti, kurset e ndryshme për zhdukjen e analfabetizmit, e sidomos ndër fshatra, të marrin pjesë të gjitha gratë e fshatit e të qytetit, që kanë në shpirt luftën kundër armikut, të çdo tendence e rryme politike”. [Hoxha, Enver, 1968, V.1:262 - 265].

Shumë shpejt, në verën e vitit 1943, pak para largimit të forcave italiane, shumë gra dhe vajza në mjaft qytete të vendit, dolën në mal si partizane. Këshillat e organizatës së gruas filluan të formoheshin kudo, duke i dhënë një formë shumë më të organizuar luftës së tyre. Gratë shqiptare do të merrnin pjesë, jo vetëm në formacionet partizane, në male dhe në guerriljet në qytete, por dhe në organet embrionale të pushtetit komunist, siç ishin Këshillat Nacional - Çlirimtare të qyteteve dhe qarqeve, apo si delegatë në Kongresin e Përmetit dhe atë të Beratit. Këto arritje të

femrave shqiptare, do të shërbenin si bazë e fortë në emancipimin e tyre të mëtejshëm në vitet pas luftës. Mbledhja e Këshillit të Dytë Antifashist Nacional - Çlirimtar, i cili i zhvilloi punimet në nëntor 1944, sanksionoi të drejtat e barabarta të grave me burrat.

Në të do të deklarohej:

“Deklarata e këshillit i jep gruas të drejta të barabarta me burrin, të drejtën për të marrë pjesë në jetën politike dhe shoqërore të vendit. Kjo e drejtë që i akordohet gruas është një e drejtë legjitime, të cilën ajo e ka fituar me gjak. Gruaja antifashiste shqiptare në këtë pushtet demokratik, me forcat e saj të pashteruara dhe me ndjenjat e saj të larta, do të bëhet një nga shtyllat e fuqishme të Shqipërisë së re”. [Hoxha, Enver, 1968, V.2:381 - 382].

Këto të drejta më vonë do të sanksionoheshin në Kushtetutën e parë të Shqipërisë, neni 15-të i të cilës shpallte se:

“Gruaja është njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike e shoqërore”. [Zëri i Popullit, 11 Janar 1947, nr 634]. Këto të drejta ishin deklaruar që në Kongresin e Dytë të Grave të Shqipërisë, në 4 Korrik 1946: “Qeveria do të verë të gjitha fuqitë, që gruas t’i japë arsim dhe kulturë, t’i japë mundësi të marrë pjesë në jetën ekonomike dhe shoqërore. Organizata juaj këto detyra duhet t’i kuptojë mirë dhe duhet të jetë një mbështetje e madhe për zbatimin e programit të qeverisë”. [Hoxha, Enver, 1986:36].

Në fushën juridike u bënë ndryshime të rëndësishme, të cilat i vendosën gratë shqiptare në pozita të ngjashme me gratë e vendeve të përparuara të kohës, duke i dhënë atyre të drejtën e votës apo të divorcit. Niveli kulturor i grave në Shqipëri, ashtu si edhe pjesa tjetër e popullsisë, ishte i ulët. Shkollimi kishte qenë një privilegj i elitave. Pjesa më e madhe e grave shqiptare, jo vetëm në malësi por dhe në qytet, ishin analfabete. Lufta kundër analfabetizmit ishte shfaqur që gjatë viteve të luftës, si një nga format për të bërë të mundur organizimin e gruas në këshilla. Në kohën kur regjimi nazist i ndiqte këmba këmbës organizimet e tyre, përsëri bëheshin mbledhje për të sensibilizuar gratë në luftë kundër armikut, si dhe kundër shtypjes së tyre.

Kjo kërkesë mbas çlirimit të vendit, mori një qëllim shumë më emancipues, atë të zhvillimit kulturor të gruas si një armë e fuqishme në duart e saj, për të qenë një përfaqësuese e fuqishme me kulturën dhe forcën e saj, brenda dhe jashtë mureve të shtëpise. Nëpërmjet reformave, gratë do të shikoheshin jo vetëm si nëna të mira, amvise e rritëse fëmijësh, robinjë e zakoneve të së kaluarës, e shtypur brenda familjes, por ajo do pajisej me arsim dhe kulturë, për të qenë një forcë

e barabartë në shoqëri. Këto detyra të rëndësishme u vlerësuan si prioritare nga P.K.SH. menjëherë mbas luftës, duke përcaktuar dhe rrugët e arritjes së tyre.

Në lidhje me këtë konstatim, në fjalën përshëndetëse të Kongresit të 2-të B.G.SH. E. Hoxha do të deklaronte:

“Gruaja duhet të pajiset me kulturë. Në vendin tonë, mjerisht, gruaja, nga shkak i së kaluarës, ka mbetur prapa, përqindja e analfabetizmit është shumë e madhe, rreth 90 %; gruaja duhet ta fitojë me të vërtetë pavarësinë e saj, që ajo të bëhet e zonja e vetes, të hyjë në prodhim, të punojë në fabrikë, në spitale e zyra, të punojë kudo ku punojnë dhe burrat”. [Hoxha, Enver, 1986:35].

Gjendja e gruas ndryshoi me fillimin e qeverisjes së re, krahasimisht me kohën e Mbretërisë Shqiptare dhe shumë periudhave të mëparëshme, pavarësisht se kishte sanksionuar të drejtën e divorcit apo të drejtën e votës, asnjëherë të realizuara praktikisht.

Në prag të çlirimit të vendit, ajo që u trashëguar nga e kaluara ishte shumë pak për emancipimin e gruas. Shqipëria nuk mundësoi një zhvillim ekonomik, i cila do të sillte natyrshëm pjesëmarrjen sociale të gruas. Dërgimi i vajzave dhe grave në kurset kundër analfabetizmit, do të jetë analoge edhe me vajtjen e tyre në shkollë.

5.2. Reformat për punësimin e gruas si tregues i emancipimit.

Për të realizuar ngritjen kulturore të vajzave dhe grave, qeveria ndeshej në pengesa serioze të kohës, siç ishin patriarkalizmi dhe konservatorizmi i shoqërisë shqiptare. Ky problem ishte i mbartur nga e kaluara, edhe pse me përpjekjet e qeverisë së Mbretit Zog për arsimimin e femrave, realisht u arrit të bëhej shumë pak në këtë drejtim. Emancipimi i vajzave dhe i grave u zhvillua në luftë të hapur me besimin fetar, duke e akuzuar atë si një forcë regressive në shoqëri.

Në mbledhjen e dytë të Frontit Demokratik, në 7 tetor 1946, E. Hoxha do të shprehej:

“Çështja e dërgimit të vajzave në shkollë duhet të merret si një problem serioz dhe i rëndësishëm. Shumë klerikë dhe sidomos ata të veriut dhe disa njerëz prapanikë, përpiqen të pengojnë vajtjen e vajzave në shkollë. Qëllimi i tyre s’do shpjegim, por ne u themi se një akt i tillë formon një krim të rëndë kundër përparimit të popullit dhe se ata që do të guxojnë ta vazhdojnë këtë propagandë, shpejtë do të pendohen”. [Hoxha, Enver, V. 3, 1969:467 - 476].

Mbi të gjitha u punua në drejtim të minimizimit të konservatorizmit brenda familjes shqiptare. Pjesëmarrja e grave në kurset kundër analfabetizmit, në prodhim, në shkollë, ndeshi në qëndresë të madhe. jo vetëm të familjeve, por dhe të mbarë shoqërisë konservatore shqiptare. Megjithatë, propaganda nuk do të ngurronte të paraqiste shifrat për kohën, duke e krahasuar situatën me gjendje e paraçlirimit.

“Nën udhëheqjen e Partisë, viti 1948 shënonte mbi 11. 000 gra që janë zgjedhur në këshillat popullorë, 600 punëtore në industri, ku para çlirimit kishte vetëm 668 gra në marrëdhënie pune, kurse sot në aparatet shtetëror e kooperativist ka 7. 570; në kooperativat bujqësore ka 990 gra anëtare dhe në ato të artizanatit 709 gra...në 1947 - 1948, 113. 708 gra kanë punuar kolektivisht”. [Hoxha, Enver, 1970, V. 5: 566 - 568].

Emancipimi i grave u bë në luftë kundër fanatizmit, pasojë e trashëgimisë së kaluar, e prapambetjes feudale, e cila në fshatra apo në zonat e thella malore, ishte më e theksuar. Megjithëse fillimisht u bë shumë për të tërhequr gratë dhe vajzat në luftën kundër analfabetizmit, heqjes së perçes, apo shitblerjes së vajzave, ato u angazhuan me ndihmën e organizaes së gruas, të rinisë apo nëpërmjet organeve të partisë, të vendosura në krye të kësaj lëvizje.

Në fjalën e tij në Kuvendin Popullor, E. Hoxha deklaronte:

“Ju duhet të hyni në masë të gjërë në prodhim, shumë funksione shtetnore duhet të jenë në duart tuaja. Ju duhet të jeni në fabrika, ndër kooperativa, ju duhet të jeni në ara, në shkolla. Nuk mund të realizohet plani ynë pa pjesëmarrjen tuaj të gjërë. Është e natyrëshme dhe nuk mund të kuptohet emancipimi i gruas, në qoftë se kjo nuk merr pjesë aktive së bashku me të gjithë pjesën tjetër të popullit në prodhim. Në radhë të parë, kërkohet një luftë e ashpër e madhe kundër injorancës shekullore të gruas dhe mentaliteteve të ndryshkura, si në fshat ashtu edhe në qytet. Futja në masë e gjerë e gruas në prodhim si në fshat ashtu edhe në qytet, do të bëjë të mundshme në përqindjen më të madhe edhe zgjidhjen e problemit të gjetjes së fuqisë punëtore. Nuk duhet kuptuar si një gjë që duhet bërë vetëm nga organizata e gruas..u përket të gjithëve, si pushtetit dhe organizatave të tjera të frontit..në fshat gruaja ka të gjitha mundësitë të zëvendësojë burrin në bujqësi.....ato punojnë me guxim në çdo aksion, janë ato gra që ndjekin kurset kundër analfabetizmit, që vënë në rregull në konferenca dhe që kanë hedhur mënjanë perçen e zezë të fanatizmit. Sa më mirë të realizohet kjo, aq më shumë do të shtohet fuqia punëtore, aq më shumë do të realizohet plani i shtetit”. [Gazeta” Bashkimi”, 1947, nr. 809:1].

Duke llogaritur dëmtimet gjatë luftës, Shqipëria ishte në një prapambetje të thellë ekonomike, aq sa në rend të ditës ishte sigurimi i bukës për qytetarët, sepse dhe ato pak ndërmarrje që funksiononin, pushuan së egzistuari apo u shkatërruan gjatë luftës. Regjimi komunist filloi të

konfiskonte pasurinë e pronarëve të pasur të vendit tregtarët, industrialistët, bankierët, të cilëve, në emër të ideologjisë marksiste - leniniste, iu sekuestruan të gjithë kapitalin, me qëllim për ta shtetëzuar atë. Regjimi e vuri zbatimin e luftës së klasave në rendtë ditës dhe nëpërmjet saj, filluan të dënonin njerëzit e pasur në kampet e punës apo me burgosje, duke i trajtuar si armiq të popullit. Ata konfiskuan dhe mbyllën koncesionet e huaja, grabitën floririn, banesat, tokat, drithin dhe gjithçka tjetër, në emër të popullit, duke bërë shtetëzimin e tyre.

Pasi shtetëzuan të gjithë tokat e pronarëve të mëdhenj, për të mundësuar kalimin e fuqisë së tyre ekonomike në duart e pushtetit, komunistët bënë reformën agrare, duke bërë të mundur realizimin e ëndrrës së fshatarit. Ky i fundit, tërë jetën e kishte kaluar argat në tokat e çifligarit dhe një vit pas luftës bëhet me tokë, ndërkohë që një vit më vonë, filloi krijimi i kooperativave fshatare, ku realisht bashkimi i pronave të fshatarëve në kooperativa të përbashkëta, nuk ishte asgjë më shumë se shtetëzimi i tokës.

Në këtë organizim, ata zotëronin vetëm mjetet e punës. E njejta gjë ndodhi dhe me industrinë. Këto reforma i paraprinë shtetëzimit të ekonomisë. Nevojat e menjëherëshme mbas luftës, ishin të shumta. Mbi të gjitha synohej mbijetesa, sidomos pas shkatërrimeve të luftës në të mbjella apo ndërmarrje, rrezikonte kriza e urisë, sidomos në drejtim të ushqimeve dhe medikamenteve. Pavarësisht ndihmave që mori nga U.N.R.A. të cilat nuk mjaftuan, ndihma erdhën nga vende të cilat ndoqën të njëjtën politikë komuniste, si Jugosllavia etj. E shkëputur nga perëndimi, Shqipëria u lidh me Jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik, sidomos pas incidentit me anglezët në kanalin e Korfuzit, politika e komunistëve u drejtua vetëm ndaj bllokut komunist.

Marrëdhëniet me Jugosllavinë nuk zgjatën shumë. Viti 1948 shënoi shkëputjen nga Jugosllavia apo nga vija titiste, duke i denoncuar ata si “revizionistë”. [Jacques, Edwin, 1998:511]. Nga Jugosllavia, regjimi siguroi vetëm disa makineri të vjetra dhe disa ndihma ushtarake. Modeli sovjetik do të ishte më pas model i qeverisjes së Shqipërisë, si në drejtimin politik dhe atë

ekonomik. Menjëherë, në vitin 1949, ajo u bë anëtare e K.N.E.R-it [po aty], nga e cila siguroi jo vetëm ndihmat për ndërtimin ekonomik, por dhe ndihmën e ekspertëve rusë apo shkollimin studentëve shqiptarë në shkollat ruse. Shqipëria ishte ende një vend i varfër në shkolla, kuadro, aq të rëndësishëm për punësimin në ndërmarrjet industriale të siguruar nga B.S. për një vend që ndërtonte ekonominë.

Programet e zhvillimit të industrisë do të ishin ato pesëvjeçare dhe një ekonomi të tipit të centralizuar, model terësisht sovjetik. Me një popullsi të vogël në numër, me rritje demografike të ulët dhe me një numër të lartë të vdekshmërisë foshnjore, sigurisht që Shqipëria kishte nevoja të konsiderueshme për fuqi punëtore dhe për punë vullnetare. Prandaj hyrja e gruas në prodhim, përtej emancipimit të saj, ishte e nevojshme, sidomos në disa degë ku prania e saj ishte shumë e domosdoshme. Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, më 30. 07. 1947, nën kryesinë e E. Hoxhës, mbështetur në Kap III, Art. 15, *“Mbi të drejtat e barabarta të burrit dhe gruas në lëmin politik, ekonomik, e kulturor”*, duke marrë parasysh nevojën e madhe të fuqisë punëtore për realizimin e Planit të shtetit, do të theksohej: *“...shihet e nevojshme që pjesëmarrja e gruas duhet të jetë n’atë shkallë, që e kërkon zhvillimi i situatës së sotme të vëndit tonë”*. [Gazeta “Bashkimi”, 1947, nr. 812:1].

Në urdhëresën e vitit 1947, lëshuar të gjithë dikastereve, E. Hoxha do të urdhëronte:

“Që në të gjithë aparatit shtetëror, zyrat mvartësi shtetnore, ndërmarrjet, institutet shkencore etj, të bëhet zëvendësimi i burrit me gruan, me qëllim që pjesëmarrja e gruas në prodhim të bëhet më e gjerë, për të mos lënë që punët që mund t’i kryej grua të kryhen nga burrat dhe këta të fundit të vihen në punë të tjera, që grua s’mund t’i kryejë. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjithë organet e Aparatit të shtetit, Dikasteret dhe Komitetet Ekzekutive të prefekturave dhe nënprefekturave”. [Gazeta “Bashkimi”, 1947, nr. 812:1].

Problemi i punësimit të grave ndeshi me fanatizmin e kohës. Vajzat dhe gratë nuk lejoheshin në pjesën më të madhe të tyre të dilnin prej mureve të shtëpisë. Propaganda e shtypit do luante një rol të rëndësishëm në shfaqjen e problemit, në forma të ndryshme të kritikës ndaj të vetmit shkaktar të prapambetjes, atë të besimit fetar dhe injorancës që përcillte kjo ideologji.

Në Pleniumin e IV të Këshillit të Përgjithshëm të B.G.SH, Nexhmije Hoxha do të theksonte:
“Rastet që fanatizmi pengon pjesëmarrjen e gruas në punë e në prodhim janë të shumta. Lufta kundër fanatizmit nuk duhet kuptuar vetëm me disa forma agjitacioni, por hallka për luftën ndaj fanatizmit, është tërheqja e gruas në prodhim”. [Gazeta “Bashkimi”, 1947, nr. 817:1].

Lufta kundër analfabetizmit ishte çuar më tej në atë të punësimit. Emancipimi i gruas u shoqërua me masa të tjera, të cilat imponoheshin nga kushtet e zhvillimit dhe gjendja e ekonomisë së vendit. Situata e brendëshme nuk ishte aspak premtuese për qeverinë, pavarësisht reformave në ekonomi dhe arsim. Në fjalën përshëndetëse në Pleniumin e IV të gruas, E. Hoxha citonte:

“Gruaja duhet të mësojë të shkruajë të këndojë, të futet në punë kudo që të jetë, të ç’duki fanatizmin. Gruaja të punojë njësoj si burri, se puna i ç’dukë të gjitha fanatizmat e mendimet e ndryshkura. Këto ide dhe mendime të ndryshkura i mbrojnë ata që se duan të mirën e gruas. Ata që përhapin parrulla, qofshin të veshur këta me rroba civile ose fetare, që thonë se gruaja nuk duhet të dalë që nuk duhet të punojë, pse priset nderi, ata janë armiq të e përparimit të gruas dhe të Atdheut tonë. Një grua e zonja që i bën të gjitha punët, në arë në shtëpi përjashta e kudo, është e zonja t’a ruaj nderin e saj dhe të bëjë që të respektohet prej të tjerëve”. [Gazeta “Bashkimi”, 1947, nr. 821:1].

Ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike me Jugosllavinë në vitin 1949, bëri që Shqipëria të drejtohej drejt Moskës. Nevojat imediate të ekonomisë e detyruan qeverinë të nënshkruante një serë marrëveshesh ekonomike të rëndësishme për përmirësimin e situatës së brendëshme të vendit.

“Në vitin 1959, u nënshkrua marrëveshja ekonomike, nga e cila Shqipëria përfitoi 300 milion rubla për veprat industriale, të cilat do të ndërtoheshin gjatë viteve 1961 - 1965. Sipas burimeve sovjetike, Shqipëria në vitet 1945 - 1960, ka marrë gjithësej nga Bashkimi Sovjetik kredi dhe ndihma të tjera, në shumën mbi 422 milion rubla”. [Historia e Popullit Shqiptar IV, 2009:245-246].

“Veç ndihmës ekonomike dhe në atë të mbrojtjes, gjatë kësaj periudhe Bashkimi Sovjetik e ndihmonte Shqipërinë dhe për zgjidhjen e mjaftë problemeve të zhvillimit të arsimit dhe kulturës në vënd. Në këto vite, mbaruan studimet e larta civile dhe ushtarake, në BS, mbi 3 mijë studentë shqiptarë. Por ndihma në këto fusha la gjurmë e krijoi probleme. Gjatë viteve 1949 – 1961, gjuha ruse ishte e vetmja gjuhë e huaj që mësohej në shkollat shqiptare, ndërkohë që literatura dhe tekstet mësimore ishin gjithashtu të ndikuara nga shkollat sovjetike. Po kështu, në fushën e artit kinematografik, në teatër dhe zhanret e tjera, u ndjenë dukshëm ndikime të kulturës sovjetike”. [Historia e Popullit Shqiptar IV, 2009:246 - 247].

Në një ekonomi të centralizuar, e cila operonte me plane pesëvjeçare, gjithçka ishte e orientuar drejtë prodhimit, degëve, sasisë, gjithçka jepej në direktivat e kongreseve, sikurse ishte i orientuar dhe i orkestruar punësimi i grave. Ky orientim u konceptua si emancipim me daljen e grave nga

ambjentet shtëpiake dhe pjesëmarrjen e tyre në prodhim. Ndërsa në planin e parë pesëvjeçar, 1951 - 1955, rezultatet flisnin për zhvillime të konsiderueshme në lidhje me arsimin dhe punësimin, në Rezolucionin e Kongresit të Dytë të P.P.SH. më 6 prill 1952 do të deklarohesh:

“Pjesëmarrja e gruas në punë në vitin 1950 ka qenë 18 % mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve. Ndërsa në vitin 1938 përta i përkët arsimit, kishte vetëm 643 shkolla fillore me 52. 000 nxënës, në vitin 1950 kemi pasur mbi 2. 000 shkolla fillore mbi 150. 000 nxënës. Në vitin 1938 kishte 11 shkolla të mesme dhe unike, me rreth 6. 300 nxënës, në vitin 1950 kemi 193 shkolla unike me rreth 18. 000 nxënës, dhe 23 shkolla të mesme me më shumë se 5. 000 nxënës, si dhe Instituti pedagogjik 2 - vjeçar me 130 nxënës, përveç 900 studentëve në Bashkimin Sovjetik. Numri i mësuesve dhe i profesorëve u rrit nga 1. 620 në vitin 1938, në 5. 100 në vitin 1950. Numri i analfabetëve ka zbritur nga 679. 000 që ishte në 1945 në 375. 000 në vitin 1950. U çelën tre Institute të reja; ai pedagogjik; bujqësor dhe politeknik; si dhe ai shkencor”. [P.P.SH.Dokumenta kryesore II, 1972 : 287].

Rezultatet e planit pesëvjeçar ishin mjaftë premtuese për forcën punëtore të munguar. Regjimi dukej se kishte fituar një betejë të rëndësishme, atë të punësimit të gruas, por që nuk shfaqej me të njejtat ritme nga qyteti në fshat, apo nga veriu në jug. Planet e mëtejshme programonin “transformimin socialist të bujqësisë”, e cila kërkonte rritjen e punësimit të gruas, veçanërisht në fshat.

Në vitin 1950, në mbledhjen e B.P. të K.Q. të P.P.SH. më 10 gusht 1950, u vendos:

“Për pjesëmarrjen e gruas në prodhim dhe në gjithë sektorët e aktivitetit politiko - shoqëror të vendit, është e domosdoshme të punohet shumë për arsimimin edhe përgatitjen profesionale të grave dhe të të rejave. T’i propozohet Këshillit të Ministrave që, në planin e shtetit të parashikohet futja e më shumë femrave në shkollat e kurset dhe dhënia e më shumë bursave që të favorizohet pjesëmarrja e tyre edhe në punë drejtuese. Si dhe krijimin e konditave lehtësuese të domosdoshme për futjen e gruas në prodhim, si ngritja e çerdheve, kopshteve për femijet”. [P.P.SH.Dokumenta kryesore II, 1972:163-167].

Vendimet e marra në Kongresin e 2-të të Partisë, synonin drejtë kolektivizimit të fshatit. Ngritja e kooperativave bujqësore ishte realizuar më shumë në zonat fushore. Kooperativat kërkonin më shumë rendiment pune, më shumë fuqi punëtore. Aty duhej insistuar për të përfshirë gruan në prodhim, prandaj kjo kuptonte emancipimin e saj në disa fronte, njeri prej të cilëve ishte puna në fshat. Në diskutimin i tij në mbledhjen e Sekretariatit të K.Q. të P.P.SH. më 1 qershor 1951, E. Hoxha do të insistonte:

“Emancipimi i gruas dhe roli i organizatës së gruas në fshat të jetë më i fuqishëm, sepse atje ishte forca më e madhe e grave dhe atje ka më shumë fanatizëm e zakone të vjetra .Gruaja në fshat është gjysma e popullatës. Po të marrë pjesë si duhet në bujqësi, jo vetëm që ajo vetë do të përparojë, por do të shtohet dhe prodhimi bujqësor”. [Hoxha, Enver, 1971,V.8:239-242].

Në mbledhjen e Sekretariatit të K.Q. të P.P.SH. E. Hoxha parashtroi detyrat për organizatën e gruas, sidomos në fshat, aty ku dallohej diferenca në punësim, e krahasuar me qytetin. Emancipimi i gruas ishte vija e partisë, detyrë e të gjitha organizatave të gruas, të rinisë dhe të bashkimeve profesionale. Roli i tyre ishte vendimtar nën udhëheqjen e partisë. Në këtë mbledhje E. Hoxha jep direktivat e rradhës, si për partinë ashtu dhe për organizatën e gruas:

“Ka sektorë, si ai i tregtisë, ku duhet të jenë akoma me shumë gra; prandaj në këta sektorë, ku ka mundësi të hiqen burrat, në vend të tyre të vendosen grate; Shteti nga ana e tij, sipas mundësisë, duhet t’u japë ndihmë grave, me shumë fëmijë; Kur gruaja punon në sektorë që kanë të bëjnë me vajra e me makineri, në fabrika, në dyqane etj; ajo duhet të ketë veshjen e punës, e cila mund të mos jetë edhe aq e hijëshme, por kur të dalë nga puna, ajo duhet të mësohet të vishet mirë dhe pastër”. [Hoxha, Enver, 1986:55].

Direktivat e partisë synonin deri veshjet e gruas apo vendet e punës ku ato do të punësoheshin, gjithçka e programuar e orientuar, duke mos qenë kështu një zgjedhje e lirë apo një zgjedhje e tregut të punës.

Një nga problemet e kohës, ende i pazgjidhur, ishte mbulimi i grave si dhe angazhimi i tyre në punë. Kjo çështje u bë problem imediat i partisë, u bë një problem politik, sepse sipas E. Hoxhës; *“...feja dhe perçja shërbejnë për të mbajtur të tjerët në errësirë”*. [Hoxha, Enver, 1972, V.9:374 - 377]. Emancipimi i gruas bëhej mbi baza ideologjike marksiste - leniniste. Emancipimi nënkuptonte luftën kundër fesë, sepse ajo ishte e dëmshme për gruan. Problemi i gruas vazhdonte të ishte shqetësues dhe kjo nënkuptohej në shtrimin e vendimit të Byrosë Politike të K.Q. të P.P.SH. në 16 janar 1953. Pas analizës për gjëndjen e gruas, u konstatua që kishte ende shumë për të bërë:

“Organizatat e BGSH-së u akuzua për një punë jo të mirë politike me gratë, sidomos ato në fshat, puna e dobët edukative dhe kulturore për likujdimin e analfabetizmit apo pjesëmarrjen e tyre në prodhim dhe zëvendësimi i fuqisë punëtore të burrave me gra, nuk ka ecur sipas një planifikimi”. [Hoxha, Enver, 1986:63-68].

Duke mos pasur një platformë të qartë për ta integruar gruan në prodhim, por jo vetëm, në këtë mbledhje u morën dhe vendime që kishin të bënin me gjëndjen kulturore të gruas në rrethe apo zakoneve prapanike dhe luftën kundër tyre nga organizatat e partisë dhe ato të masave. Byroja

Politike e K.Q. të P.P.SH duke diskutuar “Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës me gruan”, me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm Enver Hoxha, më 16 janar 1953, vendosi:

“Duke filluar që nga 30 marsi 1953, drejtoritë e ndërmarrjeve të ndryshme të planifikojnë përqindjen e grave që kanë në punë; të planifikohet nga çdo komitet egzekutiv në rrethe përqindja e vajzave që do të mësojnë në shkollë dhe e bursave që do t’i jepen atyre”. [P.P.SH.Dokumenta Kryesore II, 1972:331-336].

Nje periudhë mjaftë intensive, me deklarime të bijëshme në të gjitha forumet partiake, për të propaganduar arritjet e regjimit në fushën e reformave dhe veçanërisht në emancipimin, arsimimin dhe angazhimin e grave dhe vajzave në jetën social ekonomike të vendit. Intensiteti dhe arritjet mbi bazën e të dhënave, shtonte ambicjen e udhëheqjes komuniste. Në Kongresin e III-të të P.P.SH. mbajtur më 25 maj - 3 qershor 1956, u diskutua në lidhje me planin e dytë pesëvjeçar [1956 - 1960] dhe u morën vendime të rëndësishme, midis të cilave:

“Numri i puntorëve dhe nënpunësve në vitin 1960 të arrijë në 165 mijë vetë ose 19 % më shumë se në vitin 1955...Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore, 7 - vjeçare dhe të mesme në vitin 1960 të jetë jo më pak se 249 mijë ose 31 % më tepër se në vitin 1955....Numri i studentëve në institutet e larta brënda dhe jashtë shtetit në vitin 1960 të arrijë në rreth 3. 000 vetë ose 31 %”. [P.P.SH.Dokumenta Kryesore II, 1972:644 - 648].

Të krahasuara me shifrat dhe statistikën në tabelat e mëposhtme, rritja graduale e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në sektorët e rëndësishëm të jetës ekonomike, kulturore, arsimore dhe institucionale, përbënte në pamje një sukses, i cili nuk kalonte pa sjellë ndryshime në psikologjinë individuale e kolektive që kishte filluar të mbizotëronte në Shqipëri.

E krahasuar me gjendjen e rëndë të pasçlirimit, gjithçka që shoqëria shqiptare trashëgoi nga e kaluara, nuk mund të mos vlerësohej prej shtresave sociale, të cilët u bënë protagonistë të këtyre ndryshimeve, duke ju nënshtruar ideologjizimit, politikës partiake, por duke ndrushuar në një farë mënyre jetën e tyre. Në të gjithë sektorët e ekonomisë shqiptare, roli i grave dhe vajzave kishte sjellë ndryshime në pamjen e jashtëme, duke reflektuar në mënyrë propagandistike arritjet, por duke lënë në hije gjithçka që vepronte në skutat e errëta të politikës së partisë shtet.

Sipas statistikave të kohës, disa degë të ekonomisë njohën rritjen e numrit të grave dhe vajzave, veçanërisht sektori i shëndetësisë, tregëtisë, arsim kulturës, sistemit financiar, por gjithësesi,

prania e burrave do të mbetej përsëri prioritare. Raporti 3 : 1 në favor të punësimit të burrave, edhe pse gruaja realisht përbënte gjysmën e popullsisë, përsëri do të konsiderohej një arritje cilësore nga propaganda shtetërore e partiakë.

Tabela nr 11: Numri i punëtoreve dhe nënpunësve të sektorit socialist sipas degëve të ekonomisë popullore, në 31 dhjetor 1961.

[Renditja progresive sipas degëve me më shumë të punësuar].

Dega e ekonomisë	Total	Meshkuj	Femra
Të gjitha degët	214. 207	157. 955	56. 252
Industri	70. 916	51. 575	19. 341
Bujqësia [pa punonjësit kooperativist]	35. 730	27. 191	8. 539
Ndërtim	30. 940	29. 100	1. 840
Arësim e culture	15. 847	9. 044	6. 803
Transport – ndërlidhje	14. 974	14. 235	739
Tregëti	14. 358	7. 715	6. 643
Shëndetësi	10. 304	3. 394	6. 910
Administrata dhe organizatat e masave	8. 585	6. 981	1. 604
Komunale	7. 073	5. 405	1. 668
Grumbullim	4. 608	2. 835	1. 773
Institutet e kreditit	872	480	392

[Anuari Statistikor, 1961:85].

Këto direktiva pasqyrohen mjaftë qartë në tabelat e mëposhtëme, në të cilat vihet re përqindja më e lartë e të punësuarave femra në të gjitha degët e ekonomisë. Në grafik paraqiten në rend progresiv degët, më të cilat përqindja e femrave ishte më e lartë, në shëndetësi, një nga degët të cilës ju kushtua rëndësia më e madhe propagandistike dhe në mbështetjen e saj me fonde ekonomike, si një nevojë e zhvillimit të vendit. Dega e shëndetësisë ishte dega me përqindjen më

të madhe të femrave. Politika e regjimit kishte trajtuar prej kohësh problemin e zhvillimit të shëndetësisë.

Në pesëvjeçarin e dytë në vitin 1955 – 1960, u vunë në zbatim direktiva të rëndësishme në lidhje me kujdesin shëndetësor në qytet por dhe në fshat.

E. Hoxha do të shprehej: “Të sigurohet përmirësimi i mëtejshëm i gjëndjes shëndetësore të popullit. Të ndërtohen spitale të reja dhe të bëhet zgjerimi i spitaleve egzistuese, në mënyrë që numri i shtretërve të arrijë në vitin 1960, në jo me pak se 1. 960 ose në 23 % më tepër se në vitin 1955. Të tregohet interes i veçantë për forcimin e punës në institucionet e nënës dhe fëmijes”. [P.P.SH.Dokumenta Kryesore II, 1972:648].

Tabela nr 12: Renditja progresive e meshkujve të punësuar në degë të ndryshme të industrisë.

Dega e ekonomisë	Total	Meshkuj	Femra
Shëndetësi	100 %	32. 9	67. 1
Tregëti	100 %	53. 7	46. 3
Institutet e kreditit	100 %	55. 1	44. 9
Arësim e kulturë	100 %	57. 1	42. 9
Grumbullim	100 %	61.5	38. 5
Të gjitha degët	100 %	73. 7	26. 3
Bujqësi [pa punonjësit kooperativist]	100 %	76. 1	23. 9
Komunale	100 %	76. 4	23. 6
Industri	100 %	72. 7	22. 3
Administrata dhe org. e masave	100 %	81. 3	18. 7
Ndërtim	100 %	94. 1	5. 9
Transport – ndërlidhje	100%	95. 1	4. 9

[Anuari Statistikor, 1961:85].

Puna me gruan ishte konsideruar shumë e rëndësishme, e cila duket qartë në mënyrën e organizimit të saj. Një rol të rëndësishëm luajti dhe B.G.SH. Në pleniumin e 8-të të Këshillit të

Përgjithshëm të B.G.SH ndërmjet të tjerash u theksua; *“Format e ndryshme të punës politike midis grave, si konferencat, takimet, leksionet dhe bisedat individuale e kolektive, kanë bërë që të gjitha gratë të dëgjojnë zërin e partisë dhe të mobilizohen për të zbatuar politikën e saj”*. [Gazeta “Zëri i Popullit”, 1955, nr.176:1]. Të gjitha direktivat vinin nga lartë. Partia mendonte për gjithçka pavarësisht mendimit të gruas, gjithçka ishte e organizuar dhe planifikuar. Reformat patën karakter masiv.

Politika e orientuar drejtë B.S. deri në vitet 1961, solli prishjen e marrdhënieve diplomatike dhe tërheqjen e të gjithë specialistëve rusë që vepronin në fusha të ndryshme, ndërmarrje, arsim, kulturë nga vendi jonë por dhe kthimin e shumë studentëve që studionin atje në fusha të ndryshme, sidomos ato ushtarake apo inxhinerike, duke krijuar kështu një ngërç të madh ekonomik. Në një varësi të plotë ekonomike, që prej vitit 1949 si pjesë e K.N.E.R.-it dhe prej vitit 1955 prej Traktatit të Varshavës, Shqipëria iu nënshtrua përshtatjes dhe adaptimit të modelit sovjetik. Statistikat e vitit 1961 bëjnë të mundur që të kuptohen ndikimet e reflektuara nga lëshimi i direktivave partiake, të cilat i dhanë përparësi zhvillimit të industrisë. Në direktivat e planit të 3-të pesëvjeçar në vitet 1960 - 1965, të përpunuara në Kongresin e IV [13 - 20 shkurt 1961] u dhanë këto direktiva:

“Pesëvjeçari i tretë të shënonte një hap të rëndësishëm përpara në ndërtimin e bazës materiale - teknike të socializmit; Shqipëria të ecte më shpejtë në rrugën e shndërrimit nga një vend agraro - industrial në një vend industrial - agrar; prodhimi bujqësor të shtohet me hapa më të mëdha dhe, si rrjedhim, të ngrihet më shumë niveli material dhe kulturor i masave punonjëse”. [Jacques, Edwin, 1995:523].

Në pesëvjeçarin e tretë industria mori rëndësi, duke realizuar investime të mëdha. Ato u siguruan nga ndihmat e marra nga B.R.S.S. *“Pas prishjes së marrdhënieve me të, drejtimi i jashtëm ishte Kina, e cila në pesëvjeçarin e tretë arriti t’i sigurojë Shqipërisë 125 milion dollarë dhe përfundimin e 25 veprave të lëna përgjysëm nga qeveria Sovjetike”*. [Jacques, Edwin, 1995:523]. Pavarësisht që zhvillimit të bujqësisë iu kushtua një rëndësi e madhe në buxhet, përsëri ajo arriti të merrte vetëm 15% të fondeve, ndërsa për industrinë 49% e fondeve. [Jacques, Edwin,

1995:524]. Plani i dytë Pesëvjeçar respektivisht kishte sjellë rezultate evidente. Në raportin e B.G.SH u deklaruan këto shifra për vitin 1962 - 1963:

“Në këtë periudhë gjithësej kuadro me arsim të lartë ishin 7. 130 nga këto, 1. 159 gra [16.7 %], kuadro me arsim të mesëm 12. 134, nga të cilët 4. 065 ishin gra [33. 4 %]. Për vitin 1962 - 1963: 1. 152 vajza ndoqën Universitetin ditën, 187 natën, 886 me korrespondencë. Kuadrot gra me arsim të mesëm përbëjnë 33. 4 % të numrit të përgjithshëm të kuadrove. Kuadrot gra me arsim të lartë përbëjnë 16. 7 % të numrit të të cilëve 55 vajza, Fakulteti i Mjekësisë, kishte 876 studentë nga të cilët 241 vajza, dy vjeçare pedagogjike 775 nxënës, prej këtyre 434 ishin vajza [50. 6 %], shkollat fillore e 7 vjeçare për vitin 1962 - 63 i ndoqën 132. 542 vajza nga 18. 206 që ishin në vitin 1938”. [A.Q.SH.i R.SH. F.723,V.1963, D. 105,fl.14].

Ndihmat nga qeveria kineze mundësuan hapjen e shumë veprave industriale, duke krijuar më shumë vende pune. Kjo mundësi do të rriste pjesëmarrjen e gruas në prodhim, duke e konsideruar një forcë të rëndësishme punonjëse. E. Hoxha u mor personalisht me këtë iniciativë të tij, duke nxitur pjesëmarrjen e gruas në të gjitha fushat e jetës, si një lëvizje e realizuar nga lartë, përmes direktivave të partisë. Realisht, në shtypin zyrtar të kohës pati një sensibilizim të ndjeshëm nga mbarë populli për të përshëndetur nismën e partisë dhe vetë Enver Hoxhës, për të luftuar prapambetjet e kohës, për të lejuar gruan të jetë forcë në prodhim, në ndërtimin e vendit. Në letra përshëndetëse grupe qytetarësh zotoheshin për të luftuar zakonet e rënda të trashëguara nga kanunet, që pengonin daljen e gruas nga shtëpia.

Direktivat e Partisë dukej se “*kishin dhënë*” rezultatin e pritur. I gjithë organizimi politik për të siguruar fuqinë punëtore kishte mundësuar pjesëmarrjen e gruas në prodhim, e cila në vitin 1969 kishte arritur në 38, 6 %. Një arritje e konsiderueshme, duke menduar se Shqipëria në 1944 ishte një vënd me një popullsi 90 % analfabete dhe mundësite e punësimit të grave ishin të pakonsiderueshme, në një industri, e cila përmbledhej vetëm në disa fabrika në të gjithë vendin. Direktivat e Partisë për kolektivizimin dhe zhvillimin e një ekonomie industriale dhanë rezultate për punësimin e gruas në prodhim. Politika gjinore ishte e orkestruar nga lartë, nëpërmjet direktivave dhe reformave ekonomike në shumë drejtime, por mbi të gjitha në luftë me besimin fetar.

Siç do të shihet në tabelën e mëposhtëme, brenda këtyre shifrave në rritje, një vend të rëndësishëm zë synimi i përfaqësimit të grave dhe vajzave, si një forcë reale në tregun e punës dhe administratës, veçanërisht në sektorët social shëndetsor dhe arsimor. Brenda një dekade numri i grave dhe vajzave si pjesmarrëse aktive në jetën prodhuese të vendit, në qytet dhe në fshat do të pësonte rritje, duke dhënë mundësi më të mira për kontributin e tyre në tregun e punës. Kështu; në numrin e përgjithshëm të pranisë së femrës në sektorët ekonomik, industri, bujqësi, arsimi, shëndetsi dhe sektorëve të tjerë rritja është 2 - 3 herë më shumë. Pjesmarrja e femrës në sektorin e industrisë paraqitet 4 herë më shumë, në ndërtim 3.5 herë, në bujqësi 4.5 herë, në transport ndërlidhje 4 herë, në shërbimet komunale 5 herë më shumë, në arsim 3 herë më shumë, në shëndetsi 2 herë më shumë, në administratë 2 herë më shumë, në institute krediti 2 herë më shumë dhe në shërbime të tjera 3 herë më shumë.

Tabela nr. 13: Të dhënat statistikore mbi numrin e grave dhe vajzave sipas sektorëve të ekonomisë.

Degët e ekon.	1960	1965	1966	1967	1968	1969
Numri i përgjith.	204.192	274.006	286.908	317.647	346.113	371.916
Industri	64.421	86.803	95.775	110.858	123.436	130.830
Bujqësi	33.684	53.212	56.657	62.123	66.122	69.512
Ndërtim	33.558	38.738	35.023	38.157	42.652	46.640
Trasp – Ndërlidhje	8.863	11.369	11.186	12.087	13.400	14.263
Tregëti – Grumb.	25.211	29.629	32.977	33.083	36.543	38.429
Komunale	3.224	3.224	4.267	4.299	4.759	8.208
Arsim Kulturë	13.923	13.923	24.281	26.201	28.269	31.513
Shëndetsi	9.881	9.881	13.841	14.370	15.407	16.506
Administratë	8.133	8.133	7.154	8.299	8.377	8.874
Institute e tjera.	3294	3294	5747	8170	7148	7141

[Anuari Statistikor 1969/1970,faqe.38].

Këto ritme të pjesmarrjes së femrës shqiptare në jetën aktive të vendit reflektuan ndryshime edhe në mënyrën e jetesës, të veshjes, marrëdhënieve sociale, duke forcuar frymën e solidaritetit dhe të ndihmës reciproke, kundrejt kërkesës dhe mundësisë së rritjes së aftësive profesionale dhe barazitizmit me burrat. Rritja e përqindjes së pjesmarrjes nga 25. 1 për qind në vitin 1960 në 38. 6 përqind e numrit të përgjithshëm të punonjësve në vitin 1969 krijoi mundësitë për ndryshime edhe më të mëdha të pjesmarrjes së femrës në tregun e punës.

Tabela nr. 14: Numri i përgjithshëm i punonjësve femra në sektorët kryesor të ekonomisë, arsim kulturë dhe shëndetsi.

Numri i përgjith.	51.312	81.934	96.345	116.128	132.867	143.758
Industri	16.538	24.760	30.241	40.753	47.939	52.545
Ndërtim	1.861	2.733	3.202	3.850	4.532	4.685
Bujqësi	7.401	16.519	20.359	24.561	27.150	29.156
Trasport Ndërlidh.	617	983	1.124	1.486	2.022	2.319
Tregëti Grumbull.	9.742	13.338	16.352	17.049	19.808	20.642
Komunale	642	1.249	1.481	1.683	1.852	2.974
Arsim e kulturë	5.550	10.422	11.418	12.561	14.744	15.305
Shëndetesi	6.602	9.074	9.586	9.936	10.958	11.840
Administratë	1.441	1.560	1.389	1.956	1.899	2.063
Institut kreditit	350	472	473	529	557	603
Të tjera	568	824	720	1.764	1.406	1.626
Përqindja	25.1%	29.9%	33.5%	36.5%	38.3%	38.6%

[Anuari Statistikor, 1969/70 ,faqe.38].

5.3. Zhvillimi kulturor i gruas.

Regjimi i kohës filloi punën në drejtim të ngritjes ideologjike dhe kulturore të gruas, si një forcë e madhe e shoqërisë dhe barazia e saj intelektuale me burrat. Regjimi e trajtoi gruan si pjesë të pandarë për revolucionarizimin e jetës dhe shoqërisë brenda kuadrit të diktativave partiake me karakter ideologjik. Sipas këtij orientimi, pretendimi ishte i hapur që vetëm në sistemin socialist ka emancipim dhe barazi të burrit dhe gruas. Lidhur me këtë orientim E. Hoxha do të theksonte:

“Askush nuk mund të thotë se është i lirë, kur nuk lufton për çlirimin e të tjerëve dhe në radhë të parë të gruas shqiptare; Pa barazinë e plotë të gruas me burrin, pa unitetin e kthjelltë dhe respektin midis tyre, nuk mund të këtë Shqipëri plotësisht të lirë, nuk mund të ndërtohet socializmi dhe jeta e lumtur për popullin me atë shpejtësi dhe me atë hov që kërkon partia“. [Hoxha, Enver, 1986:208].

Në drejtim të pabarazive kulturore, arsimore, tekniko - profesionale, regjimi arriti të kishte suksese të dukshme, duke ç'rrenjosur ato që ai i quante ideologji “*të huaja*” të emërtuara; borgjeze, feudale, fetare, konservatore, të gjitha këto jashtë familjes shqiptare.

Shumë më e vështirë u paraqit beteja brenda saj. Familja socialiste konceptohej në një formë krejt tjetër. Padyshim që ishte brenda parimeve marksiste - leniniste të krijimit dhe organizimit të saj, të cilat, sipas Engelsit presupozjnë se; “*Askush nuk është i detyruar të lidhë martesën, sipas Marksit, por secili duhet të detyrohet t'u nënshtrohet ligjeve të martesës*”. [Materializmi Dialektik dhe Historik, 1971:519].

Pavarësisht se e pranoi divorcin si një të drejtë të gruas, përseri kjo e drejtë nuk u trajtua si absolute, sepse çdokush që krijonte një familje duhet të kishte një ndjenjë të fortë ndaj saj. Mbi gjithçka qëndronte detyra bashkëshortore, që kishte lidhje me edukimin e brezit të ri.

“Martesa socialiste nuk lejoi divorcin e lirë, flirte të monemtit apo tradhëtinë bashkëshortore. Liria e vërtetë e martesës në socializëm qëndron në lirinë për ta zgjedhur vetë bashkëshortin, me një qëndrim serioz, të ndërgjegjshëm ndaj detyrës bashkëshortore”. [Materializmi Dialektik dhe Historik, 1971:519].

Burri u konsiderua si shoku dhe mik i pandarë i jetës për gruan. Ky botëkuptim përfshinte rregulla të forta ndaj familjes, apo martesës. Regjimi luftoi Kanunin dhe konservatorizmin që buronte prej tij, jo në kornizën e një shoqërie të lirë, por e futi drejtë rregullave të reja, të cilat në pamje të parë luftuan për emancipimin arsimor dhe kulturor të gruas, por me rregullave të tjera brenda një kornize tjetër. Gjendja e gruas në shoqëri vazhdoi dhe mbeti në kushte jo të barabarta.

Problem i madh i kohës ishte ngarkesa e grave, veshja e saj ende në shumë zona të vendit me çitjane, sepse deri në vitet 1960, ajo vazhdonte të mbulohej sipas traditës së fesë myslimane.

“Dhe pse familja u konsiderua element me rëndësi në shoqëri, konstatohet një rritje e numrit të shkurorezimeve në vitet 1955 - 1961, numri në mënyrë specifike shkoi nga 1. 057 në 1. 314. Kjo gjë vihet re si në qytet dhe në fshat. Qytetet me numrin më të lartë janë Tirana [226] dhe Korçë [207], qytete të dalluara për emancipimin e tyre sidomos në drejtim të figurës së gruas”. [Anuari Statistikor, 1961:25].

Detyrat e ngarkuara në pesëvjeçarin e zhvillimit të vendit, u zgjeruan dhe më tej. Qëllimi ishte që, çdo femër e punësuar të kishte arsimin përkatës dhe të rritej numri i vajzave dhe grave në arsimin e mesëm. Qytetet shfaqeshin me ritme të tjera dhe të kënaqëshme, ndërsa problem mbeteshin vajzat dhe gratë në fshat, sepse aty shfaqej pjesa më injorante dhe më afër ndikimit fetar, pjesa më patriarkale dhe më fanatike, ku reflektoheshin zakonet e vjetra dhe bestynitë. Hov të madh mori sidomos organizimi i punës kulturore me gratë e fshatit. Kjo pas pleniumit të VIII-të B.G.SH. i cili vendosi që puna me gratë e fshatit të bëhej më serioze, sidomos në drejtim të futjes së tyre në prodhim. Ky plenium do të tërhiqte vëmendjen:

“Prandaj edhe në t’ardhmen organizata jonë duhet të zgjerojë punën kulturore me gratë sidomos në fshat. Vatrata e kulturës duhet të bëhen qendrat kryesore ku do të zhvillohet aktiviteti politik e kulturore me gratë, ku të ngrihen kurset e ekonomisë shtëpiake, rrobaqepësisë, qëndisjes për nëna e fëmijë. Arsimtaret e fshatit duhet të lozin një rol të madh në funksionimin e mirë të këtyre formave dhe në përhapjen e njohurive të thjeshta shkencore”. [A.Q.SH. i R.SH. F.723, V. 1961, D. 73, fl.20].

Viti 1961 e gjeti gruan në një pozitë ende të pabarabartë me burrin, duke u nisur nga egzistenca e një zakoni të rëndë shekullor, siç ishte perceptimi i saj si një fuqi bartëse, ashtu siç ishte vendosur edhe në kanunin e Lekë Dukagjinit. Ky zakoni i së kaluarës, u ndalua me një urdhëresë qeveritare nr. 11, datë 27. 10. 1961 në nenin “1” të së cilës përcaktohej:

“Ndalohet rreptësisht që gruaja të përdoret si fuqi bartëse, duke u ngarkuar me sende të ndryshme, që ulin dhe poshtërojnë dinjitetin dhe pozitën që ajo zë në shoqërinë socialiste. Neni 2: Kryetarët e kooperativave bujqësore dhe çdo punëdhënës tjetër që detyrojnë gratë të ngarkohen, duke i përdorur si fuqi bartëse, dënohen me gjobë gjer në 3. 000 mijë lekë ose me punë korrektorje gjer në një muaj. Me të njëjtin dënim dënohen edhe ata që, për shkak të marrëdhënieve familjare, ose të vartësisë, detyrojnë në çdo mënyrë gratë për t’u ngarkuar si fuqi bartëse. Neni 3: Gratë që pa u detyruar nga të tjerët ngarkohen vetë me sende që ulin dhe poshtërojnë dinjitetin dhe pozitën e tyre, dënohen me gjobë gjer në 1. 000 [njëmijë] lekë ose me punë korrektorje gjer më dhjetë ditë. Neni 4: Vërtetimi i kontravajtjes bëhet nga këshillat popullore të fshatrave dhe lokaliteteve, nga policia popullore dhe nga organet e tjera shtetërore që me ligjë janë ngarkuar të vërtetojnë kontravajtjen. Neni 5: Gjykimi i kontravajtjes bëhet simbas ligjës mbi “kontravajtjet”. Neni 6: Kjo urdhëresë hyn në fuqi që nga 1 Janari 1962 [A.Q.SH. i R.SH. F.723, V.1961, D. 70, fl.1-3].

Gruaja duhej të bënte gjithçka në shtëpi, përtej nënshtrimit të saj në punët në prodhim. Regjimi e trajtoi gjërësisht problemin e saj brenda familjes, duke dhënë direktiva për ndarjen brenda shtëpise së punëve në mënyrë të barabartë midis të gjithë pjeshtarëve të familjes. Në zonat veriore vazhdonte ende të vepronte Kanuni i Lekë Dukagjinit, sipas të cilit; *“Grueja njifet si një çalike me frymë për me bajte sa të jetë në derë të burrit, nje rob ma tepër sa për krah të punëvet, sa për të shtuem të fëmijeve”*. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:10, 19].

Të gjitha zakonet kanunore u panë të lidhura ngushtë me fenë dhe çdo luftë për emancipimin e gruas u bë kundër fesë dhe zakoneve prapanike. Çlirimi ekonomik i gruas u bë në emër të luftës kundër ligjeve të borgjezisë. Regjimi e konsideroi familjen, bërthamën në të cilën rritej dhe edukohej brezi i ri, duke e parë këtë detyrë natyrore si rol të gruas, duke rritur fëmijë të denjë për shoqërinë socialiste. Ky edukim ishte një edukim komunist, si e gjithë shoqëria. Në këtë drejtim, regjimi punoi shumë për t’i ardhur në ndihmë familjes dhe mbi të gjitha gruas, ngriti institucione të shumta, duke filluar nga çerdhet, kopshtet, kampet e pushimit për fëmijë, shkolla, qendra kulturore, kinema, teatro, stadione, qendra sportive, në këtë mënyrë edukimi i brezit të ri nuk ishte një detyrë vetëm e familjes, por e gjithë shoqërise duke krijuar tërësisht një brez të ideologjizuar.

Më shumë rezultate pati jashtë familjes, megjithë rolin e organizatës së gruas, të organizatës së rinisë apo K.Q. të Partisë, gjendja e saj ngeli thellësisht konservatore. Në fshat gjëndja mbetej më problematike, vazhdonin akoma fejesat në djep, fenomeni i shitblerjes së vajzave si dhe martesat e tyre me burra në moshë të madhe dhe pa i njohur apo parë asnjëherë. Diferencimi midis Veriut dhe Jugut, ishte i ndjeshëm jo vetëm në drejtim të arsimit, po dhe pjesëmarrjes në prodhim apo vajtjes së rinisë nëpër aksione, në të cilat pjesëmarrja e vajzave dhe grave veriore ishte e kufizuar. Jugu përfaqësonte trevat më të zhvilluara të Shqipërisë për shkak të klimës, të emigracionit, zhvillimit ekonomik - kulturor, prandaj dhe fejesat në djep ishin diçka më e rrallë, punësimi, arsimimi i tyre ishte në tregues shumë më të lartë.

Çështjen e futjes së gruas në prodhim, regjimi e siguroi përmes kolektivizimit. Kolektivizimi në zonat malore u bë më vonë, pas viteve 1965, për faktin se vetë banorët nuk e pritën me entuziazëm procesin. Megjithatë, kooperativizimi arriti të siguronte pjesëmarrjen e grave në mënyre masive në prodhim, për shkak të nevojës të forcës punëtore.

E. Hoxha do të shkruante: “Viti 1967 ishte një “revolucionarizim i jetës së vendit, pra përmbysjen e zakoneve të vjetra, normave të jetesës dhe zëvendësimin e tyre me të reja”. [Hoxha, Enver,V.35, 1982:302 - 308, 311 - 313]. Pa lënë mënjanë entuziazmin e arritjeve E. Hoxha do ta shtrinte problemin më tej, duke dhënë të kuptohej, se askund nuk ka vend për vetkënaqësi:

“Në parti ka 8. 7 % gra në komitete e partisë 8. 6 % dhe në byrotë e tyre 4. 3 %. Në organet drejtuese të rinisë në qendër e në rrethe ka 185 të reja ose 22. 5 %. Në industri 30 % e punëtorëve janë gra; në miniera 6. 6 %; në arsim 37 % dhe në shëndetesi 37. 4 % në prodhim dhe në administratë arrin mbi 25. 000. Por akoma gratë marrin pjesë në mënyrë të kufizuar në punët e shtetit të partisë dhe në sektoret ekonomikë dhe shtetërorë. Arsyeja kryesore ngelet se, niveli kulturor i grave, i cili mbetet ende shumë i ulët dhe kjo pengon seriozisht zhvillimin e tyre shoqëror. Tek gratë mbizotërojnë zakonet prapanike dhe paragjykomet. Fanatizmi, konservatorizmi dhe mungesa e besimit nga ana e burrave, influencojnë shumë në mbajtjen gjallë të zakoneve prapanike. Sipas statistikave, deri sot kanë kaluar në kurset kundër analfabetizmit rreth 109. 000 gra. Ka akoma rreth 90. 000 gra analfabete. Lufta kundër analfabetizmit akoma nuk konsiderohet nga organizata bazë e partisë dhe organet shtetërore si kusht i parë për të luftuar paragjykimet e prapambetjen. Organizatat e partisë duhet të luftojnë që komunistët të japin shembullin të parët në punën për aktivizimin e grave të tyre; të tregohet një kujdes më i madh në zbatimin e vendimeve të Komitetit Qëndror të Partisë dhe të Byrosë Politike për punën me gruan”. [Hoxha, Enver,V.2, 1968:140-141,285 - 288].

Në tabelën e mëposhtëme paraqiten disa të dhëna mbi raportet gjinore në organet e qeverisjes vendore dhe në Kuvendin Popullor.

Siç shihet, përqindja e femrave vjen duke rënë, sa më shumë që ngjitemi në analizën e niveleve të pushtetit. Raporti midis përfaqësimit në këshillat lokale të lagjeve pasqyron një ulje të ndjeshme në raportet midis pjesmarrjes së grave të qytetit dhe grave në fshat. Gjithashtu përfaqësimi i grave në Kuvendin Popullor, në raport me pjesmarrjen e tyre në Këshillat e rretheve dhe të qyteteve, pasqyron një nivel mjaftë të ulët përfaqësimi. Edhe pse brenda 15 viteve të pasçlirimit konstatohet një ndryshim thelbësor në çështjet e emancipimit dhe të pjesmarrjes së grave dhe vajzave në jetën aktive të vendit, krahasimi i shifrave dhe statistikave

në raport me propagandën partiake nuk kanë përfaqësuar realitetin e pritshëm sipas vetë ambicjeve të udhëheqjes komuniste në suksesin e reformave.

Tabela nr 15: Pjesëmarrja në votime në zgjedhjet e këshillave popullorë në vitet 1949; 1952; 1954; 1955; 1956; 1960.

Emërtimi i institucionit	Nr. i deputetëve Total	Nr. i deputetëve femra.	% e femrave.
Këshillat poullor të lagjeve 1960.	1. 236	415	33. 6
Këshillat popullor të qyteteve 1960.	1. 094	364	33. 3
Këshillat popullor të rrethit 1960.	1. 540	309	20. 1
Këshillat popullor të fshatrave 1960.	14. 733	2. 730	18. 5
Kësh. popullor të lokaliteteve 1960.	3. 669	623	17. 0
Kuvendi popullor 1962.	214	25	11. 7

[Anuari Statistikor i Shqipërisë,viti 1961,faqe.48].

Në tabelën e mëposhtëme paraqiten disa të dhëna mbi raportet gjinore në Kuvendin Popullor.

Tabela nr 16: Numri i deputetëve të kuvendit popullor për vitet 1945; 1950; 1954; 1958, 1962.

Datat e zgjedhjeve	Numri i deputëteve Total	Numeri i deputeteve femra	% femrave
28 Maj 1950	121	17	14
3 Qershor 1962	214	25	11.7
30 Maj 1954	134	15	11.2
1 Qershor 1958	188	17	9
2 Dhjetor 1945	82	6	7.3

[Anuari Statistikor,viti 1961,faqe.49].

Siç shihet, nga pikëpamja kronologjike në krahasueshmërinë e shifrave, në seritë kohore të mësipërme, përfaqësimi i grave në pushtetin legjislativ paraqet luhatje. Edhe pse nga legjislatura në legjislaturë shifrat e grave deputete shihen në rritje, deri në legjislaturën e fundit kjo shifër nuk e kaloi masën 12 për qind. Siç shihet në tabelën e mëposhtëme, prej deputetëve të 13 rretheve të vendit nuk figuronte asnjë grua. Kjo tregon për mungesën e vizioni të qartë prej regjimit për rritjen e përfaqësimit të grave në këtë institucion të rëndësishëm të qeverisjes së vendit.

Në tabelën e mëposhtëme paraqiten disa të dhëna mbi raportet në Kuvendin Popullor, sipas rretheve.

Siç shihet nga tabela e mëposhtëme, përfaqësimi i grave shënonte kuota më të larta në qytetet e mëdha dhe zonat jugore të vendit. Pra, politika shqiptare arriti rezultate të dukëshme, duke e krahasuar me realitetin para viteve 1945, me përfshirjen e gruas në prodhim në ato pak ndërmarrje, fabrika, uzina që u hapën. Vetëm pjesëmarrja e saj në bujqësi ishte realizuar ndjeshëm, ndikuar kjo nga fryma kolektive e punës dhe nevoja për fuqi punëtore, për të siguruar normën e prodhimit.

Regjimi pati një ndikim të ndjeshëm në drejtim të emancipimit të gruas. Kjo kishte të bënte me mungesën e vartësisë ekonomike të gruas ndaj burrit, aspekt ky që në realitetin e varfër shqiptar vihej re ndjeshëm, si në drejtimin ekonomik, ashtu edhe atë kulturor. Mjafton të citojmë pjesë të Kanunit të Lekë Dukagjinit, ligji i kohës në zonat e Malësisë së Veriut: *“Burri ka tagër: a) me këshillue e me qortue gruen; b) me rrahë e me lidhe gruen e vet, kur të mbërrijë me i a perbuzë fjalën e urdhnit”*. [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1933:21]. Krahasueshmëria më tre periudha të ndryshimeve historike në Shqipëri në shekullin e XX, sjell një pasqyrim interesant të rolit të femrës në jetën social politike të Shqipërisë.

Tabela nr 17: Numri i deputetëve sipas rretheve për vitet 1945; 1950; 1954; 1958 dhe 1962.

Viti 1962 Rrethi	Numri i deputeteve	Femra	% femra
Q. Tiranë	16	6	37.5
Gramsh	3	1	33.3
Lezhë	3	1	33.3
Lushnjë	8	2	25
Pogradec	5	1	20
Sarandë	6	1	16.7
Vlorë	13	2	15.4
Elbasan	14	2	14.3
Fier	15	2	13.3
Durrës	16	2	12.5
Rr.Tiranë	8	1	12.5
Shkodër	17	2	11.5
Korçë	19	2	10.5
Berat	11	0	0
Ersekë	2	0	0
Gjirokastrë	6	0	0
Krujë	6	0	0
Kukës	7	0	0
Librazhd	4	0	0
Mat	5	0	0
Mirditë	2	0	0
Peshkopi	11	0	0
Përmet	4	0	0
Pukë	3	0	0
Skrapar	3	0	0
Tepelenë	4	0	0

Tropojë	3	0	0
---------	---	---	---

[Anuari Statistikor,viti 1961,faqe.49].

Në grupin e parë qeverisës të Shqipërisë, prej vitit 1912 nga kryeministri i parë, Ismail Qemal Bej Vlora, deri në fillimin e drejtimit politik prej Ahmet Zogut, në 13 qeveritë shqiptare që kanë drejtuar vendin, nuk figuron asnjë emër gruaje.

Në periudhën e qeverisjes së Shqipërisë prej Ahmet Zogut, pas tre Kongreseve të Lushnjes dhe më pas kabinetet qeveritare pas shpalljes së tij Mbret i Shqiptarëve, [gjithësejt 18 të tillë], nuk figuron asnjë femër me detyra ministrore dhe detyra të tjera shtetërore.

Në periudhën e pushtimit fashist të Shqipërisë, në 9 kabinetet qeveritare që drejtuan jetën e vendit nuk figuron asnjë emër femre me detyra ministrore. Qeveritë shqiptare të kësaj periudhe kanë qenë nën kontrollin dhe autoritetin e Komandës së Lartë të ushtrisë fashiste Italiane dhe Gjermane.

Drejtimi i shtetit shqiptar nën autoritetin e sistemit politik komunist nis me qeverinë e dalë nga konferenca e Beratit. 23 tetor 1944, e cila e çoi drejtimin e Shqipërisë deri në mandatin e radhës në 21 mars të vitit 1946. Qeverisja e parë nën autoritetin e PPSH-së filloi më 22 mars 1946 deri në 1 tetor 1948. Në vitin 1954 fillon mandate i parë i qeverisjes së Mehmet Shehut, e pasuar nga 7 mandate të tilla radhaz, deri në 18 dhjetor të vitit 1981. Më pas do të pasuhej drejtimi ekzekutiv i Shqipërisë nga qeverisja Adil Çarçani me tre mandate deri në rrëzimin e saj dhe hapjen e mundësive të jetës së pluralizmit politik në Shqipëri. [<https://wikipedia.org>, 1991]. Në këtë histori një shekullorë, veçojmë rastin e parë të vendosjes së një femre shqiptare në një post të lartë ministror të drejtimit të shtetit.

Në qeverisjen e Shqipërisë në periudhën e sistemit komunist, në kabinetet qeveritare për herë të parë vendoset një femër minister në vitin 1946, me detyrën e Ministres së Arsimit. Naxhije Dume lindi në 3 janar të vitit 1921, në fshatin Lubonjë të Kolonjës, në një familje atdhetare dhe arsimdashëse. Babai i saj, Dume Dumja ishte specialist pyjesh. Ai luftoi kundër forcave rebele të Haxhi Qamilit, ndërsa nëna e saj, Vezirja, e ndoqi Naxhijen pas në çdo vështirësi të jetës. Shtëpia e saj, në rrugën e Shëngjergjit, në Tiranë, ku rrinte me qera, u bë bazë e rëndësishme e luftës për liri. Nga që i ati punonte nëpunës dhe që lëvizte shpesh nga një qytet në tjetrin, Naxhijes iu desh ta vazhdonte shkollën në shumë rrethe të vendit, si në Ersekë, Sarandë, Shkodër, Elbasan dhe Korçë.

Në vitet 1933-1941, mbaroi Institutin Femëror “*Nana Mbretëreshë*”, nga i cili ruante kujtime të bukura. Në vitin 1943, mori pjesë në Konferencën e Parë të P. K. Sh. të vendit dhe, kur ajo ishte vetëm 23 vjeçe, u zgjodh një nga 15 anëtarët e Komitetit Qendror të P. K. Sh. Një vit më vonë, u zgjodh delegate e qarkut të Korçës për në Kongresin e Përmetit, nga ku u kthye anëtare e Këshillit Antifashist. Së bashku me Kristo Themelkon, bënë organizimin e Brigadës së 22-të Sulmuese. Naxhija ishte një nga gratë, që mori pjesë në mbledhjen për krijimin e Qeverisë së parë shqiptare, në Berat. Me transferimin e Qeverisë së re në Tiranë, u emërua pranë aparatit të K. Q të P. P. SH dhe më vonë Sekretare e Parë e Komitetit të Partisë për Tiranën, ku qëndroi deri në vitin 1947. Në dhjetor të vitit 1946, ajo u zgjodh deputete në Kuvendin Popullor. Ndërsa më 6 shkurt të vitit 1948, Naxhije Dume emërohet Ministre e Arsimit. [Harka,Sejdo,2015: <http://www.tiranaobserver>].

Femrat shqiptare janë bërë për herë të parë pjesë e Parlamentit në Legjislaturën e parë, atë të viteve 1945 - 1950. Në një total prej 82 deputetësh, 6 prej tyre ishin femra. Katërvjeçari pasues e çoi numrin e tyre në 17. Sipas të dhënave statistikore, në parlamentin e Shqipërisë pas vitit 1945 në vitin 1950 nga 121 deputet vetëm 17 prej tyre ishin femra, ose 17 për qind; në vitin 1954 nga 134 deputet vetëm 15 prej tyre ishin femra, ose 11.2 për qind; në vitin 1958 nga 188 deputet,

vetëm 17 prej tyre ishin femra, ose 9 për qind; në vitin 1962 nga 214 deputet vetëm 25 ishin femra, ose 11.7 për qind e tyre. Në dy dekada të funksionimit të Kuvendit të Shqipërisë, me një mesatare përfaqësimi 10.6 për qind konstatohet një rritje e lehtë e pranisë së grave shqiptare në këtë institucion.

Prania e femrës në Parlament u rrit progresivisht deri në legjislaturën 1974 - 1978, ku nga 250 deputetë në Parlament, 88 prej tyre ose 35 për qind ishin femra. Disa femra njëkohësisht ishin anëtare të Byrosë Politike të atyre viteve, u emëruan ministre për më shumë se një mandat. Ministria femër më jetgjatë në Parlamentin e para '90-ës ka qenë Themie Thomai, ministre e Bujqësisë në vitet 76 - 89. Tefta Cami, tjetër figurë e njohur politike e sistemit komunist, qëndroi për 11 vite në krye të Ministrisë së Arsimit, në vitet 76 - 87. Vito Kapo mbajti për 8 vite postin e ministres së Industrisë së Lehtë nga viti 82 deri në vitin '90. Në legjislaturën më të fundit, para përmbyesjes së sistemit komunist, në vitet '87 - '91 në Parlament hynë 75 gra. [Femrat në politikë: <http://top-channel.23/04/2013>].

Nisur nga këto tregues, shpesh nuk mbetej pas as shtypi perëndimor, duke publikuar të dhëna, të cilat ishin të orientuara nga mbështetja e krahëve në politikën majtiste evropiane, duke i bërë jehonë arritjeve të sistemit socialist në Shqipëri në aspektin e vendit dhe rolit të femrës shqiptare në jetën social politike të vendit. Pas vizitës së 3 deputeteve franceze në Shqipëri në vitin 1981, publikimi i opinionit të tyre në gazetën “*Le Mond*”, do të pasohej nga gazeta italiane “*La Stampa*”, e cila midis të tjerash do të shkruante:

“Shqiptaret, të emancipuara, falë revolucionit socialist, janë të barabarta me burrat në të gjitha aspektet, tashmë ushtrojnë një rol të dorës së parë”. Përpara çlirimit, jeta e gruas ishte akoma e rregulluar nga zakonet prapanike të shekullit XV-të, të cilat ia linin babait në dorë të drejtën për ta shitur të bijën, e burri me të cilin do të martohej, kishte të drejtën edhe ta vriste gruan e “pabesë”. Sot, grua, mund të mbajë, si çdo qytetar shqiptar, një armë të sajën personale, për të marrë pjesë në mbrojtjen e vendit. Gjithsesi, nëse i hedhim një vështrim, se sa gra e femra e kalojnë mbrëmjen nëpër qytete e fshatra, vizitori i huaj mbetet i impresionuar për shkallën e ulët të grave që preferojnë ndërkohë të rrinë me burrat. Pak, edhe çiftet madje, pak janë të dashuruarit e përqaftuar: ndoshta qytetarët e këtij vendi virtuoz e puritan, duan të evitojnë të bëjnë sikur luajnë me ndjenja që nuk janë politike. [Gazeta “La Stampa”, 1981:4].

Refleksionet e kësaj situatë vrehen me kohë në vitet e mëvonëshme në Shqipëri. Në qeverisjen e parë pluraliste të kabinetit “*Nano*”, prej 22 shkurt 1991 deri në 10 maj 1991, nuk figuronte asnjë femër në detyrë ministrore. Po kështu edhe në madantin pauses “*Nano - 2*” shfaqet e njejta situatë. Numri më i ulët i femrave në Parlament ka qenë në legjislaturën 91 - 92, në zgjedhjet e parakohshme, me vetëm 9 gra deputete, tetë të Partisë Demokratike dhe një e Partisë Socialiste. [Gazeta “Shekulli”, Gratë në politikë, Tiranë 30 qershor 2014].

Në qeverinë e stabilitetit të kryesuar nga Ylli Bufi, 11 qershor 1991 - 6 dhjetor 1991, nga 25 ministra nuk rezulton asnjë femër. Në qeverinë Teknike me kryeministër Vilson Ahmeti, 18 dhjetor 1991 - 13 prill 1992, e cila përgatiti vendin drejt zgjedhjeve parlamentare të 22 marsit të vitit 1992, nuk kishte asnjë femër në kabinetin e tij.

Në Shqipërinë pluraliste, në mandatin e Qeverisë Meksi - 1, 13 prill 1992 - 16 gusht 1996, në 23 ministra në përbërje të kabinetit nuk figuronte asnjë femër. Në mandatin e dytë Qeverisja Meksi - 2: [11 korrik 1996 - 1 mars 1997], nga 26 ministra vetëm 4 femra. [Gazeta “Panorama”, 2013].

Në qeverisjen e Pajtitimit Kombëtar me kryeministër Bashkim Finon, 9 Mars 1997-29 Qershor 1997. Nga 16 ministra nuk figuron asnjë femër në këtë kabinet. [wikipedia.org/Qeveria e Pajtitimit Kombëtar; 1997:13]. Duke analizuar dy qeverisjet e fundit në Shqipëri, qeveria e kryesuar nga z. Sali Berisha, 10 shtator 2005 - 23 qershor 2013. Në 15 ministra të kabinetit figuron vetëm Ministria e Integritetit. [https://wordpress.com - 3 shtator 2009]. Qeveria e kryesuar nga z. Edi Rama, 23 qershor 2013 - në vazhdim. Në përbërjen e kabinetit me 21 emra, rezultojnë në poste ministrore 6 femra. Ndërsa nga 23 zëvendësministra, 8 prej tyre janë femra. [Gazeta “Shekulli”, 2013:11]. Ndërsa në parlamentin e legjislaturës së fundit në Shqipëri nga 140 mandate, rezultojnë 24 femra deputete.

Në metodologjinë politike të trajtimit të problemit, në shtimin e kaluar, brenda propagandës dhe realitetit funksiononte fenomeni i angazhimit sasior, i cili ofronte dhe prurjet cilësore në

përfaqësimin e grave dhe vajzave shqiptare në të gjithë fushat e veprimtarisë shoqërore, deri në instancat më të larta të piramidës shtetërore. Një veprimtari që sillte rezultatet e përfaqësimit nga poshtë lartë, por që kontrollohej dhe bëhej efikase nga lartë.

5.4. Sinergjia e çështjes gjinore me luftën kundër fesë.

Gjendja dhe situatat e gruas shqiptare ndryshonin shumë nga ato vendeve të tjera të Evropës, shumë afër tyre gjeografikisht, por praktikisht larg relitetit të këtyre vendeve. Lëvizjet feministe në vendet perëndimore nuk kishin asgjë të përbashkët me lëvizjen e emancipimit të gruas në Shqipëri. Ato kishin në thelbin e tyre kërkesa të reja, duke nisur me divorcin apo të drejtën seksuale. Kujdesi i regjimit shqiptar për emancipimin e gruas e shihte gruan jo si individ, por si numër në radhët e partisë. Ky vizion reflektohej në drejtim të militantizmit për të pranuar gjithçka, për të jetuar si qytetare, por jo për t'u ndjerë të tilla. Ishte arritje shumë e madhe që gratë të mos ndjeheshin skllave të dëshirave apo urdhërave të burrit. Këtu vlen të përmendet situata e gruas në veri të Shqipërisë, që dallohej për një obskurantizëm të dukshëm ndaj femrave. Përkrahja e gruas veriore nga regjimi, u pa si një arritje madhështore, duke vlerësuar origjinën nga e cila ajo vinte. Përkrahja e partisë shkoi deri aty, sa të merrej me organizimin e jetës familjare, duke ndërhyrë deri në qelizën bazë të shoqërisë, në familje.

“400 komunistë të lagjes 1 në Shkodër, morën inisiativën për të bërë një ndarje të drejtë në shtëpi të punëve. Për komunistin është i huaj mendimi; “Ç’më duhet mua, ajo është çështje personale. Në aktiv u diskutuan dhe për çështjet e edukimit ideopolitik dhe kulturor në familje, sepse kjo nuk ishte bërë traditë. Kjo bën që tek ne mjaftë familje të festohen të kremtet fetare dhe të mbahen ikona. Ne duhet që të kalojmë me guxim eliminimin e kremteve fetare dhe zëvendesimin me festat kombëtare dhe ndërkombëtare, duke filluar me 8 Marsin. Kjo duhet bërë një aksion i të gjithëve. Aksionin ja besuam organizatave të frontit, u organizuam në mbledhje në të gjithë blloqet e lagjes nëpërmjet agjitacionit dhe kritikës së masave në forma të ndryshme, fletë - rrufe, gazetë e murit, këndet humoristike”. [Gazeta “Zëri i Popullit”, 1967, nr. 36:1].

“Kudo anembanë Shqipërisë organizatat e partisë bënë një punë shumë të mirë për të detyruar luftën kundër fesë. Kjo ishte e evidente, sepse në çdo cep kushdo si përfaqësues i partisë jepte shembullin personal, duke bërë rolin e të interesuarit për t'i shërbyer kauzës”. [Hoxha, Enver, 1982, V.35:139 – 141,258,279].

Pas fjalimit të E. Hoxhës më 6 shkurt, u prishën rreth 7. 318 fejesa me të mitur. Në emër të emancipimit, kushdo mendohej të jepte shembullin personal për t'i shërbyer sa më mirë partisë.

Regjimi kishte dhënë prova për të dënuar kundërshtarët e tij dhe për të shpërblyer sa më mirë përkrahësit. Në një letër drejtuar E. Hoxhës prej aktivitetit të partisë së rrethit Tepelenë shkruhej:

“Ju premtojmë shoku Enver. Do të luftojmë fuqimisht për edukimin e mëtijshëm politik, ideologjik e kulturor të grave, do t’u presim rrugën një herë e përgjithmonë mbeturinave të tilla siç janë fejesat në mituri, martesat pa e njohur njëri – tjetrin, do t’i ndihmojmë gratë në punët e shtëpisë, do të zhvillojmë një punë më të gjërë e të organizuar edukative me njerëzit për t’i ç’rrenjosur deri në fund zakonet prapanike, paragjykimet fetare dhe konceptet e vjetra, të cilat pengojnë ushtrimin e të drejtave të barabarta të gruas me burrin”. [Gazeta “Zëri i Popullit”, 1967, nr. 70:1]

Në çdo përshëndetje shprehej qartë gadishmëria e komunistëve për shembullin personal, por dhe për të kontribuar në sulmin ndaj të vetmit armik, klerit. Kudo shpërthyen aksione sulmi, madje pretendohesh hapur se dhe gjendja e rëndë e gruas në familje ishte pasojë e klerit. Në letrën nga të rinjtë dhe të rejtat e kombinatit të tekstileve “Mao Ce Dun” në Berat, drejtuar E. Hoxhës shkruhej:

“Ne jo vetëm hoqëm dorë nga kremtimi i bajramit, pashkëve mbajtja e ramazanit, kreshmeve dhe të tjera, por dhe do të punojmë për të bindur dhe prindërit e të afërmit që të ndjekin shembullin tonë. Kështu ne do të shkelmojmë fanatizmin mesjetar që u mohonte të rejave për të mësuar notin dhe për të marrë rreze dielli”. [Gazeta “Zëri i Popullit”, 1967, nr. 73:1].

Gjithçka u drejtua nga organet e partisë, sepse qëllimi kryesor ishte edukimi socialist i punonjësve. Kjo u arrit vetëm duke luftuar frymën e vjetër, që sipas E. Hoxhës identifikohesh me fenë. Feja u konsiderua fajtorë për gjëndjen e mjerueshme dhe të prapambetur të gruas, sidomos në fshat, ku besimi fetar ishte më i përhapur për shkak të prapambetjes. Sigurisht, në revolucionin ideologjik dhe kulturor pjesëmarrja e gruas ishte e rëndësishme. Si përçuese e jetës dhe edukimit të fëmijëve, ajo do të relizonte edukimin revolucionar të brezit të ri. Ato kërkuan vendin e tyre në ndërtimin e socializmit. Regjimi trumbetoi me të madhe barazinë midis burrit dhe gruas, barazinë gjinore, duke e trumbetuar atë si fitore në shoqërinë socialiste. Duke filluar me shkollimin e punësimit, të pakonceptuara me parë për femrën shqiptare, sipas vizionit që një grua që aktivizohesh në jetën politike shoqërore, mund të aktivizohesh dhe në prodhim. Kjo luftë u intensifikua sidomos në zonat malore, ku ligjet kanunore drejtonin prej shekujsh jetën shoqërore. Aty ishin shumë më të forta zakonet fetare dhe paragjykimet, të cilat lufta prej regjimit i bashkonte në një të vetme.

Gazeta e kohës, Zëri i Popullit, shkruante: *“Tek ne feja nuk mundi të zhvillohej në formën e një botëkuptimi filozofik të stërholluar, por ajo është pleksur ngushtë me traditat zakonore dhe mënyrën e jetesës, ka futur helmin e saj në gëzim dhe hidhërim në të gjitha shfaqjet e jetës së përditshme që nga lindja deri ne vdekje”*. [Gazeta”Zëri Popullit”, 1967, nr. 222:1].

Lufta për emancipimin e gruas pati një shkallë të lartë organizimi në të gjithë vendin, nga të gjitha organizatat e rinise, gruas, partisë dhe të bashkimeve profesionale. Mbledhje e kuvende u organizuan në të gjithë vendin, ku burra, gra, të rinj dhe të moshuar dënonin paragjykimet dhe zakonet prapanike. Këto zakone aq të rënda për gruan dhe femrën shqiptare, siç ishin ato të Kanunit që pretendoheshin se mbaheshin gjallë nga vetë feja, u dënuan rëndë edhe në letrat e premtimeve që i bëheshin vetë udhëheqësit E. Hoxha.

Në një të tillë, nga Katundi Shtiqën, thuhej: *“Ne vendosëm: 1- Mos me i dhanë djalit para për cucën; 2- Mos me dhanë cucën baba tek një burrë në moshë të madhe”*. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1967, nr.827:3]. Me këto premtime mbusheshin faqet e shtypit zyrtar, për të sensibilizuar opinionin publik për rolin e gruas në shoqërinë socialiste, jo vetëm në prodhim. Pengesa kryesore për emancipimin e saj nuk ishin vetëm zakonet konservatore, të cilat funksiononin prej shekujsh në Shqipëri, të ngulitura fuqishëm në jetën e tyre të përditshme, në traditë dhe në ndërgjegje. Arsimimi u vlerësua si elementi më i rëndësishëm, për të nxjerrë gruan nga robëria.

Në një tjetër letër të dërguar nga pleqtë e Dukajit [Tepelenë] jepet shumë qartë gjëndja e gruas në zonat e thella të vendit:

“Morëm zotim të hedhim poshtë: Zakonet prapanike që marin nëpër këmbë të drejtat e grave, besimet e kota fetare që për tërë jetën na kanë mbajtur në shtypje dhe shfrytëzim, si dhe zakonet e tjera prapanike, që na pengojnë për të shkuar përpara dhe na dëmtojnë ekonomikisht. Nuk do të lejojmë që në familjet tona të përdoret ngarkesa e grave, veshja e tumanëve, nuk do të përdorim më fejesat në moshë të mitur dhe pa pëlqimin e tyre, ceremonitë e dasmave me shpenzime të tepërta, apo epitetet për njerëzit e burrit si “aga”; “bej”, ose nusja mos të flasë në emër burrit; nuk do të përdorim më duvakun; burri do të ndihmojë në punët e shtëpisë. Në të gjitha gostitë familjare do të lejojmë pjesëmarrjen e djemve së bashku me vajzat dhe nuset. Nuk do të frekuentojmë më teqet dhe mekamet, që na kanë mbajtur skllëvër të padijes, dy teqe i mbyllëm dhe asnjë kremte fetare nuk do të festojmë. Edhe të yshturat dhe duvatë do t'i dënojmë. Nuk do të pengojmë të rinjtë të marin pjesë në aksionet

shoqërore dhe ne do të shkojmë në hekurudhën Rrogozhinë - Fier. Do të pakësojmë kopshtet personale”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1967, nr. 76:3].

Të gjitha letrat jepnin një pasqyrim të gjëndjes së rëndë të gruas në atë kohë, sidomos në zonat fshatare dhe veriore të Shqipërisë. Organizatat premtinin dhe zvogëlimin e oborreve personale, në emër të ekonomisë kolektive socialiste. Viti 1967 shënoi direktiva të rëndësishme të partisë, që kishin të bënin me arsimin e grave, si rrugë për të mundësuar punësimin e tyre. Arsimi 8 - vjeçar i detyruar, krijoi mundësi të mira në prodhim, po ashtu arsimi i mesëm dhe ai profesional, i shtrirë më shumë në qytete. Roli i burrit në familje duhej të ishte më i madh. Të parët që duhet të jepnin shembullin e tyre në familje, ishin komunistët.

Shtrirja e të drejtave të grave u reflektua në norma ligjore, shërbimet sociale, lehtësimin e punëve të saj nëpërmjet teknologjive të reja në përdorimin e përditshëm. Propaganda komuniste deklaronte se, sukseset ishin të dukëshme në shoqërinë socialiste, sepse vetëm ajo mundësoi çlirimin e gruas në një shoqëri pa klasa pa shtypës dhe shfrytëzues. Qëllimi i revolucionit ishte të luftohej e vjetra pa asnjë lëshim dhe të zëvendësohej me të rene.

Lufta kundër fesë, zakoneve të prapambetura, ceremonive, kishave, xhamive, hoxhës dhe priftit, ishte një luftë pa ndërprerje, luftë midis të resë dhe të vjetrës midis dy qëndrimeve të kundërta. Çdo botëkuptim fetar duhej të zëvendësohej me atë marksist - leninist. Një luftë për të sjellë të rene, për të mos lejuar ringjalljen e së vjetrës, atë borgjeze dhe armike, sepse dhe vetë feja u konsiderua në shërbim të të huajve, u konsiderua një ideologji e huaj. Lënia e femrës në atë gjëndje, u interpretua si ndikim i drejtpërdrejtë i saj, një fe obskurantiste aspak me baza fetare që më shumë i kishte shërbyer injorancës, konservatorizmit dhe mbrojtjes së zakoneve kanunore.

“Por sot grueja - po flasim për atë të qytetit, sesa për atë të maleve deri tash s’e kena gjith at ankim - ka fillue me u ftohtë kah besimi, e tuj u ftohtë kah besimi, ka fillue me lanë mbas dore detyrët familjare, detyrën e një nanës së vërtet, detyrën e një edukueses së kujdesëshme. Ç’at ditë qi, rrejtë prej të joshunavet të shekullit, ka fillue me qitë në harresë misjonin e vet si fat e si nanë, e ka bjerrë forcën e vet. Sot grueja ka ndrrue qind me qind: I shkon gjithë dita në derë t’oborri, ka kapë shetinë, argtimet, ka fillue me rrah kafet, kinematografat sallat e ballit. S’ka në mënd tjetër, por me ndejt tuj kqyrë si veshet kjo e ajo, për mos me u da shoqesh e mos me i lanë gja të mangut modës; si me u la e me u lye, si me i pre e me i kaçurrelue flikë”. [Revista” Hylli i Dritës”, 1932, nr. 10].

Në pak hapësirë të organit zyrtar të klerit katolik në *“Hyllin e Dritës”*, kushtuar gruas, kishte vend për ta akuzuar si faktor të prapambetjes së grave klerin. Në këto shkrime, gruaja trajtohet vetëm si nënë, roli i së cilës ishte rritja dhe edukimi i fëmijëve. Ajo nuk u trajtua aspak si një forcë e rëndësishme shoqërore. Shtypi françeskan kishte një influencë të padiskutueshme në potencialin njerëzor, në atë letrar në kohën e regjimeve të ndryshme, të Mbretit Zog dhe veçanërisht në kohën e pushtimit fashist.

Sipas analizës së shifrave dhe statistikave të kohës, regjimi komunist pati arritje në lidhje me emancipimin e gruas, sidomos në luftën kundër zakoneve dhe paragjykimeve fetare. Pati arritje të padiskutueshme dhe në punësimin e gruas apo arsimimin e saj, krahasuar me periudhat e mëparëshme, ku 90 % e popullsisë ishte analfabete. Ato pak ndërmarrje të ngritura në Mbretërinë Shqiptare, nuk arrinin të punësonin një numër të konsiderueshëm punëtorësh, kështu që, nuk bëhej fjalë për punësimin e grave apo vajzave. Arsimitimi i tyre u realizua në kushte të vështira ekonomike dhe politike për Shqipërinë. Emancipimi i saj pagoi një *“çmim”* të shtrenjtë, atë të zëvendësimit të patriarkalizmit familjar me atë komunist.

Politika e regjimit komunist kishte bërë hapa më përpara në raport me Mbretërinë. Nga lufta kundër analfebetizmit, në arsimimin dhe punësimin e grave dhe vajzave. Kishte ardhur momenti për edukimin politik të tyre, i cili nuk ju la në dorë vetëm organizatës së gruas, por ishte i drejtuar nga Partia me ndihmën e organizatave të rinisë dhe të bashkimeve profesionale. Të gjithë organizatat ishin të koordinuara në punën e tyre për të ndihmuar gruan, sidomos atë në fshat. Puna politike dhe edukative ishte pjesë e bindjes ideologjike, që kishte përfshirë çdo qelizë të shoqërisë. Disiplina, përgjegjësia, vigjilenca ishin detyra politike, që shërbenin për ndërtimin e socializmit, pjesë e rëndësishme të së cilës ishte gruaja. Niveli i ulët kulturor i gruas barazohej me influencën e tyre ndaj *“zakoneve prapanike”*. [Hoxha, Enver, “Raporte Fjalime 1967-1968”, 1968:147,194-208].

Megjithatë, gjendja e gruas ishte jo aq pozitive sa shprehej në shtypin apo propagandën e kohës. Puna në prodhim dhe ajo në familje, të cilat në pjesën më të madhe ishin familje konservatore, rëndoi gjendjen e saj fizike. Pavarësia ekonomike u trumbetua si faktor që e çlironte gruan nga varësia e burrit. Pagesat shumë simbolike, për të mos folur për fshatin, ku jeta e gruas shkonte gjithë kohës në arë, në një punë me normë dhe një pagë që nuk mjaftonte për mbijetesë, sidomos pas krijimit të kooperativave bujqësore dhe zhdukjes së pronës private. Në këto rrethana, gratë nuk mund të siguronin pavarësinë ekonomike. Gratë më shumë u burrëruan se sa u emancipuan.

KAPITULLI VI: Lëvizja për të drejtat e grave dhe vajzave, si një dukuri e importuar: ndikimi i konteksteve ndërkombëtare ideologjike, politike dhe kulturore.

6.1 Ndikimi i Revolucionit Kulturor Kinez në dëformimin e jetës shoqërore, politike dhe kulturore në Shqipëri.

Për hir të miqësisë dhe të kredisë ekonomike dhe ushtarake kineze, udhëheqja shqiptare u solidarizua me Revolucionin Kulturor Kinez. Pas kundërshtimit publikisht të politikave reformatore komuniste në Bashkimin Sovjetik, E. Hoxha intensifikoi marrëdhëniet me Kinën. Këto marrëdhënie ishin vendosur që në vitin 1949, me shpalljen e Republikës Popullore të Kinës, të cilën Shqipëria ishte ndër vendet e parat që e njohu. Tirana ishte bërë një lloj menaxhereje dhe zëdhënëse e Mao Ce Dunit në Nju Jork, me kredenciale të plota dhe si e tillë, tërhiqte pas vetes shumë të tjerë. Shqipëria e kishte propozuar futjen e Kinës në OKB qysh në vitin 1963, me

cilësinë e anëtares së kësaj organizate, në të cilën aderonte qysh nga viti 1955. Gjatë gjithë këtyre viteve, ajo kishte luftuar pandërprerje për të arritur në sukses nga pikëpamja e teknikave juridiko - diplomatike, derisa rezoluta për pranimin e Kinës në OKB, u miratua më 25 tetor 1971, gjatë sesionit të 26-të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara. [Polovina, Ylli, Gazeta “Shqiptarja.com”, 2013;<http://shqiptarja.com/m/home/ja>].

Krahas marrëdhënieve ekonomike, teknike, kulturore e shkencore dhe mbështetjes financiare për ndërtimin e veprave të mëdha industriale, komunistët shqiptarë, me vetëdije importuan mjaftë modele e praktika kulturore dhe ideologjike. Njëra prej tyre ishte revolucioni kulturor kinez, i udhëhequr nga idetë kaotike të Mao Ce Dunit, i cili do të ndryshonte thellësisht jetën sociale, kulturore, arsimore e madje edhe politike në Shqipëri. Revolucioni kulturor do të shoqërohej me mbylljen e institucioneve fetare, eliminimin e besimit fetar dhe shpalljen e shtetit të parë ateist në botë.

Revolucioni Kulturor Kinez ishte vetëm preteksti i kësaj lufte ndaj klerit, e cila ishte zhvilluar përditë dhe veçanërisht ndaj klerit katolik, armiqësi e cila kishte lindur që në luftën Nacional - Çlirimtare, duke i akuzuar krerët katolikë, si tradhëtarë të aspiratave kombëtare. Viti 1967 shënoi vetëm aktin e fundit të tragjedisë së institucioneve fetare në Shqipëri, e cila u shndërrua, jo papritur në shtet ateist, duke realizuar një kapërcim rrënjësor të Kushtetutës së vitit 1946. Sulmi ndaj fesë u krye në emër të emancipimit të gruas, luftë të cilën e udhëhiqte rinia, si një forcë e pa indoktrinuuar nga pikëpamja fetare, si një forcë e re, e edukuar me frymën revolucionare komuniste.

E. Hoxha, në kongresin e 6-të të Partisë në direktivën për luftën e klasave theksoi: *“Lufta e klasave është lufta kundër ideologjisë fetare, paragjytimeve, bestynive e zakoneve prapanike”* [Gazeta “Zëri i Popullit”, 1967, nr. 33:1].

Të friksuar nga kundërevolucioni i vitit 1956 në Hungari si dhe ndryshimi i kursit në Bashkimin Sovjetik, udhëheqja komuniste shqiptare gjeti te Revolucioni Kulturor Kinez mënyrën dhe mekanizmat për të goditur veprimtaritë e fshehta kundërevolucionare, antisocialiste, antiparti, pra përpjekjet e borgjezisë për të rimarrë pushtetin. Kjo luftë klasash, e projektuar nga udhëheqja kineze dhe e përqafuar nga udhëheqja shqiptare, përfshinte të gjitha fushat e jetës; ekonomike, politike, ushtarake, ideologjike dhe kulturore. Revolucioni kulturor duhej të luftonte çdo mbeturinë si dhe paragjykimet e zakonet e vjetra, të cilat u konsideruan kundërshtarë, madje armiq të vijës marksiste - socialiste. Udhëheqëse e këtij revolucion do të ishte rinia, si e vetmja trashëgimtare e revolucionit proletar. Qëllimi i tij ishte krijimi “i njeriut të ri”[Hoxha,Enver,1979:625]. Ky revolucion shihej nga udhëheqja shqiptare si rruga më e drejtë për të çuar përpara çështjen e komunizmit.

Për fillimin e zbatimit të këtij revolucion, Plenumi i 11-të i P.K.K. hartoi vendimin e K.Q.P.K.K. për fillimin e revolucionit proletar. [Gazeta “Zëri i Popullit”, 1967, nr. 4:1].

Grupimi “*Gardistët e kuq*”[Jacques, Edwin, 1995:528-529], i cili përfaqësohej nga grupet rinore, krijoi njësitë e veta në të gjithë vendin, në shkolla, uzina, fabrika, fshatra e qytete. Qëllimi i tyre ishte flakja e zakoneve të vjetra, të ideologjisë së vjetër dhe mbjelljes së frymës së proletariatit. Kjo do të realizohej nëpërmjet lidhjes së intelektualëve me masat, duke përzenë në fshatra dhe zona të largëta mjaftë prej tyre, profesorët dhe shkrimtarët, për të mësuar nga masat.

Viti 1967 ishte viti i kritikës së thellë dhe radikale, kundër vijës reaksionare borgjeze dhe e likujdimit të ndikimit të saj; viti i fitores vendimtare ndaj rrugës kapitaliste; viti i kritikës kundër “*autoriteteve*” reaksionare borgjeze në shkencë; viti i kritikës kundër ideologjisë borgjeze dhe të të gjitha klasave shfrytëzuese; i transformimit të të gjitha fushave të të ashtuquajturës “*superstrukturë*”[Materializmi Dialektik dhe Historik,1971:331-335], të cilat nuk pajtoheshin me të ashtuquajturën “*bazë ekonomike të socializmit*”[po aty]; punëtorët dhe fshatarët ishin forca e

këtij revolucion; organet e diktaturës së proletariatit ishin garantuesit e të drejtave demokratike të popullit, të garantimit të zbatimit normal të shprehjes së plotë e të lirë të mendimeve nëpërmjet “*Dacibaove*”.[Hoxha,Enver,1979:306].

Revolucioni Kulturor Kinez u zhvillua në një realitet të ndryshëm historik, krahasimisht me Shqipërinë. Ai do të merrte vrullin e tij në vitin 1966, me urdhërin e Mao Ce Dunit, kundër grupeve komplotiste brenda P.K.K. Paraprakisht ky revolucion kishte filluar në vitin 1956, me fushatën e “*Njëqind Luleve dhe të konkurimit të njëqind shkollave të mendimit*”. [Kissinger, Henry, 2013:206], e cila “*ftoi*” në debate publike të hapura intelektualë të shquar për të shprehur mendimin e tyre. Revolucion i më vonë u kthye kundër tyre, duke arrestuar, internuar, burgosur dhe vrarë mijëra intelektualë, që guxuan të shprehnin mendimin e tyre kritik. Revolucioni kulturor ishte pasojë e “*Hopit të madh*” [Kissinger, Henry, 2013:207] i cili kishte projektuar zhvillimin industrial dhe bujqësor të Kinës, si pjesë e pandarë e “*Revolucionit Kinez*”. [Luthi, Lorenc M, 2008:76 <https://www.mcgill.ca>]. Shtetëzimi i plotë i pronës private shkoi deri në krijimin e “*komunave popullore*” [Xhonson, Pol, 1996:156], pasojë e së cilës ishte vetëm kriza e urisë së Kinës, një katastrofë e cila gjatë viteve 1959 - 1962 shkaktoi “*vdekjen e më se njëzet milion vetëve*”. Revolucion i Kulturor hodhi poshtë vlerat e traditës shekullore kineze: “*Zhdukni katër gjërat e vjetra, mendimet e vjetra, kulturën e vjetër, zakonet e vjetra, traditën e vjetër*”. [Xhonson, Pol, 1996:153]. Zemërimi i gardistëve të kuq u sul kundër gjithçkaje që binte era kulturë, duke përfshirë kishat, të krishterët, biblën dhe letërsinë e krishterë. [Jacques, Edwin, 1998:528-529].

Organizata “*Gardistët e kuq*” filloi aktivitetin në 29 Maj dhe përbëhej nga fëmijë të moshës 12 - 14 vjeçare, të cilëve iu bashkuan dhe grupmosha të tjera dhe antarë të lidhjes së rinisë komuniste [Xhonson, Pol, 1996:162]. Ata u ngritën kundër udhëheqjes së tyre zyrtare. Kjo organizatë fanatike rinore, nisi të bastiste shtëpitë e zyrtareve “*të korruptuar*” apo “*oportunistë*” dhe të sulmonte burokratët, mësuesit, artistët, shkrimtarët dhe intelektualët, duke psallur si të tërbuar

citete nga kryetari Mao, të tipit: “Kryetari Mao na mëson se, nuk mund të ketë ndërtim, pa shkatërrim”. [Po aty].

Revolucioni kulturor synonte të realizonte edukimin komunist në masë, luftën kundër burokratizmit, i cili kishte shkëputur intelektualët nga masat. Mësimi i nxënësve do të hidhte bazat e lidhjes së teorisë me praktikën, për të zhdukur dallimet midis punës fizike dhe mendore. Rinia e shkollave dhe ajo studentore, e vendosur në ballë të këtij revolucioni, po luftonte armikun e klasës. Pronarët e mëdhenj, por dhe prodhuesit e vegjël, të cilëve iu ishin konfiskuar pronat, por jo idetë, u quajtën reaksionare, sepse kundërshtonin vijën e të vetmes parti në pushtet. Revolucionit kulturor synonte të realizonte edukimin socialist, për të konsoliduar ideologjinë proletare dhe diktaturës së proletariatit në të gjitha fushat e jetës, për të luftuar ideologjinë revizioniste, për të mos lejuar restaurimin e ideologjisë borgjezo - revizioniste. Më 3 shkurt 1979, “*Gardistët e kuq*” kishin vrarë rreth 400. 000 njerëz”. [Xhonson, Pol, 1996:164].

Ideologjia e Revolucionit Kulturor Kinez, ishte një përjasje midis teorisë së marksizëm - leninizmit dhe konfucianizmit tradicional historik kinez. Koha provoi që, revolucioni në Kinë i dha saj me kalimin e kohës leadershipin në treguesit e ekonomisë botërore. Ky revolucion nuk ishte një marrëzi, siç u kritikua nga E. Hoxha në dy botimet e tij, “*Shënime për Kinën*”. Ai u shfaq si një “*det i vdekur*” për pastrimin e barrierave respektive të klasës kundërshtarë të regjimit. Dëmet e shumta mbi tradicionalizmin kinez u bënë objekt i vetkorrigjimit, gjë e cila nuk ndodhi në Shqipëri. Në Kinë, kundër mbiekzistencës duhej të bëhej ndryshimi, pa e marrë shumë seriozisht marksizëm - leninizmin. U eliminuan kundërshtarët dhe u bë hapja me botën për t’i shpëtuar izolimit, duke përmirësuar marrëdhëniet në shkallë botërore me fuqitë e mëdha.

Kjo platformë e zhvillimit të Kinës u kritikua më vonë nga E. Hoxha, megjithëse ai e zbatoi revolucionin shumë më egër se në Kinë. Vite më vonë ai do të shkruante:

“Partia jonë përfitoi nga mësimet e Stalinit, i ndoqi ato besnikërisht, prandaj dhe nuk u gabua. Është për këtë arsye që në Shqipëri nuk ngjet ajo që ngjet sot në Kinë. Atë që bën sot Partia Komuniste e

Kinës me anë të Revolucionit Kulturor, Partia jonë e ka bërë me kohë, vazhdimisht, me konsekuencë, hap pas hapi në mënyrë revolucionare dhe me cilësi”. [Hoxha, Enver, 1979 : 321].

Kritika ndaj revolucionit kinez u parashtrua gjerësisht në librin, “*Shënime për Kinën*” [Hoxha, Enver, 1979:247]. Prej E. Hoxhës revolucioni kinez u kritikua për objektiva jo të qarta dhe për një ndikim të pakët të partisë. Gardistët sulmuan gjithçka, kudo në Kinë ndizeshin zjarre të mëdhenj që digjnin gjithçka të huaj, mbyllën bibliotekat, dogjën librat, veshjet me ndikim perëndimor u dënuan, muzika e huaj u ndalua. Revolucioni Kinez u kthye në një anarshi të vërtetë, fillimisht i drejtuar nga ushtria, e më pas nga organizatat rinore, ai doli tërsisht jashtë kontrollit policor brenda vendit. U kritikuan rëndë vepra artistike e romane. Në thelb, ky revolucion nuk ishte proletar: “*Kultura në socializëm nuk është stoli vetëm e një shtrese, por pasuri e gjithë popullit*”. [Hoxha, Enver, 1979:256-257]. Ndikimi i kulturës borgjeze revizioniste në emër të të cilit u bë revolucioni, nuk ndikon vetëm tek rinia por në të gjithë shoqërinë. [Hoxha, Enver, 1979:274]. Më pas ky revolucion kaloi nën ndikimin e ushtrisë, nën udhëheqjen e Maos, duke mistifikuar figurën e tij dhe duke e kthyer në një revolucion politik.

“Në qoftë se kundër armiqve ata do të mbajnë qëndrime të buta, oportuniste, siç kanë mbajtur deri tash, atëhere ky është zjarr prej kashte. Kjo do të thotë t’i lësh armikut të kuptojë që të konservohet për të marrë fuqi me vonë, se përpara disfatës; armiqet ndërrojnë taktikë, “pendohen”, “bejnë autokritike të singertë”, “brohorasin”. Rroftë Maoja” e të tjera manovra të tilla. Revolucioni s’duhet lënë në mes të rrugës; po e fillove, duhet ta çosh deri në fund. Duhet të jemi të pamëshirshëm kundër armiqve të partisë, të popullit, të marksizëm - leninizmit dhe të revolucionit” [Hoxha, Enver, 1979:314].

Pas prishjes së marrëdhënieve, E. Hoxha ushtroi kritikën mbi thelbin dhe përmbajtjen e revolucionit, por në fakt, “*Shënimet për Kinën*”, nuk ishin shënime dhe përfundime për Kinën, por një paralajmërim i asaj që do të ndodhte për analogji në Shqipëri, veçanërisht në luftën e brendshme politike. Frymëzimi fillestar në Shqipëri u tkurr me kalimin e kohës, për shkak të efekteve negative në opinionin e brendshëm shqiptar. Ngjarjet negative të këtij revolucioni u përsëritën të gjitha në Shqipëri, të avancuara deri në ekstremet e tyre. Ajo u nxit nga frika e trashëgimisë së pushtetit politik pas vdekjes së E. Hoxhës.

Në këtë kohë shtypi shqiptar e dënoi Revolucionin Kulturor Kinez, sepse revolucion po kryhej vetëm nga rinia e shkollave të mesme dhe ajo e universiteteve, pa pasur një udhëheqje në këtë lëvizje, pa pasur pjesëmarrje të klasës punëtore dhe të fshatarësisë.

Pas eliminimit të plotë të pronës private, ishin krijuar rrethanat për edukimin komunist, i cili ishte dhe qëllimi i vërtet i revolucionit, ose siç quhej ndryshe, krijimit i njeriut të ri me frymën revolucionare. Kooperativizimi u zgjerua, duke u konsideruar si pjesë e politikës për të rritur frymën e kolektivizimit, për të krijuar bindje të reja sipas parimit, *“Vënia e interesit të përgjithshëm mbi atë personal”*. [Gazeta “Zëri i Popullit”, 1966, nr.35:1].

6.2. “Revolucionarizimi” i arsimit dhe rritja e aksesit të vajzave në shkollim.

Në politikat e shpallura të qeverisë, arsimimi nuk ishte privilegji vetëm i shtresave të pasura, por dhe i *“popullit”*. [Hoxha, Enver, V.3, 1969 :94, 111-114]. Qeverisja e Mbretit Zog e kishte lenë defiçitar zhvillimin e arsimit. Pavarësisht se Mbreti Zog u përpoq t’i jepte karakter laik arsimit, frekuentimi i shkollave dhe përhapja e tyre ishin të kufizuara. Gjatë kësaj periudhe, edhe pse u investua në shkollat fillore, përhapja e tyre në fshatra ishte e kufizuar.

“Shkollat e mesme funksiononin vetëm në qytetet e mëdha dhe frekuentoheshin nga fëmijët e familjeve me të ardhura të konsiderueshme. Shumica e shkollave deri në vitin 1933, kishin karakter fetar ose ishin hapur nga pushtuesit që gjatë Luftës së Parë Botërore. Mësimet në shumicën e shkollave nuk zhvilloheshin në gjuhën amtare. Ndërkohë, shkollat në gjuhën shqipe ishin të pakta, sepse burimet buxhetore për t’i mbajtur ato ishin të kufizuara. Në vitin shkollor 1926 - 1927 funksiononin 536 shkolla fillore, në të cilat jepnin mësim 830 mësues dhe mësonin 26. 612 nxënës, në një popullsi 834 mijë banorë. Kishte vetëm 10 gjimnaze, në të cilat jepnin mësim 101 mësues dhe mësonin 1. 328 nxënës, prej të cilëve vetëm 10 % ishin vajza”. [Historia e Popullit Shqiptar III, 2007:255].

Shkollat e mesme ishin hapur kryesisht nga të huajt, ndërsa për arsim të lartë nuk flitej fare.

Shkollat femërore ishin gjithashtu të pakta. [Historia e Popullit Shqiptar III, 2007:255]. Në dekret - ligjin e 14 Shtatorit të vitit 1932, i cili u miratua nga Parlamenti në pranverën e vitit 1933, u ndalua frekuentimi i shkollave të huaja. Ky akt ishte shumë i rendësishëm për të forcuar

pozitat e shkollës kombëtare. [Historia e Popullit Shqiptar III, 2007:310]. Në vitin 1938 - 1939, në Shqipëri numëroheshin gjithsej 643 shkolla fillore me nga 5 pesë klasa.

Në kushtet e pas luftës, problem për qeverinë komuniste nuk ishte vetëm lufta kundër analfabetizmit, por ngritja e shkollave të mesme si dhe përgatitja e teksteve shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm. *“Hapat e parë për krijimin e arsimit të detyruar fillor u hodhën në Plenumin e katërt të K.Q. të P.K.SH. të mbajtur më 17 tetor 1945”*. [Hoxha, Enver, V. 3, 1969:127, 160 - 161] dhe vazhdoi me tej në Plenumin e V-të të mbajtur në 21 shkurt 1946. [Hoxha, Enver, V.3, 1969:245,280-281]. Menjëherë pas këtij vendimi dhe miratimit të reformës arsimore të vitit 1946, u rindërtuan dhe u hapën shumë shkolla të reja. Në shkollat e të gjitha niveleve, u rrit jo vetëm numri i meshkujve, por dhe numri i femrave. Si rrjedhim, ndodhi një rritje e treguesve arsimor, në krahasim me vitet 1935 - 1940.

Lufta kishte shkaktuar dëme të ndjeshme në Shqipëri. Në kushtet e mungesës së kuadrove brenda vendit, u morën masa për ngritjen e kurseve pedagogjike për përgatitjen e arsimtarëve. Fillimisht në shkolla u punua me tekstet dhe programet e vjetra dhe me lëndët e historisë, gjeografisë, psikologjisë, pedagogjisë. Më vonë, Plenumi i V-të përcaktoi detyra emergjente në fushën e arsimit, *“duke filluar nga lufta kundër analfabetizmit, rindërtimi i shkollave dhe hapja e shkollave të reja. Popullsia analfabete në pjesën dërrmuese të saj në vitin 1947 kapte shifrën 81. 22 %”*. [Gazeta”Bashkimi”,1947,nr.733:1]. *“Të gjitha vendimet e plenumit u shtrinë në programin e qeverisë së parë të Republikës Popullore të Shqiperisë, në 24 mars 1946”*. [Hoxha, Enver, V.3, 1969:298,305 - 307]. Në këtë program u pasqyrua problemi i gruas. Për nevojë të kuadrove të lartë dhe për t’i plotësuar këto nevoja, në vitin 1946 filloi nga puna Instituti Pedagogjik dyvjeçar. Qeveria inkurajoi gjithashtu që në shkolla të ketë sa më shumë vajza, në mënyrë që gruaja të luante rolin e saj të merituar në Shqipërinë e re. [po aty]. Reforma arsimore filloi të zbatohet në Shqipëri pas aprovimit nga Kuvendi Popullor i ligjit Nr. 282, 17 gusht 1946.

“Reforma përcaktonte karakterin shtetëror, laik, demokratik. Ajo përcaktonte gjithashtu ndërtimin e sistemit të ri arsimor: arsimin parashkollor; arsimin e përgjithshëm; arsimin profesional dhe shkollat për të rriturit. Reforma parashikonte një strukturë të re të shkollave të arsimit të përgjithshëm: shkolla fillore nga klasa e parë në klasën e katërt; shkolla shtatëvjeçare nga klasa nga e pestë në të shtatë; shkolla e mesme me katër klasa mbi shtatëvjeçaren”. [A.Q.SH.i R.SH.F.511,V.1947,D. 17,fl.61].

Reforma arsimore i mundësonte çdo shtetasi arsimimin në të gjitha nivelet. Arsimi fillor fillonte në moshën 7-vjeçare dhe ishte i detyrueshëm për të gjithë, djem dhe vajza. Programet shkollore u unifikuan, duke hequr mësimin e fesë, gjuhës latine, greqishten e vjetër, dhe duke i dhënë kujdes më të madh gjuhës amtare dhe letersisë, matematikës, fizikës, kimisë, historisë, gjeografisë, biologjisë dhe kushtetutës. Po në këtë vit, në të gjitha shkollat e mesme hyri të mësuarit e marksizëm - leninizmit dhe të gjuhës ruse. Rëndësi iu kushtua punës mësimore - edukative, lidhjes së teorisë me praktikën.

Reforma përcaktoi në thelb një arsim laik, por realisht kjo politikë arsimore rezultoi antifetare dhe jo laike. Si në çdo fushë edhe arsimi mori një rrugë, që nuk kishte aspak lidhje me politikat e vendeve demokratike për arsimin. Kjo reformë e bëri arsimin plotësisht të ideologjizuar, për të propaganduar vijën e partisë dhe krijimin e botëkuptimit komunist, sidomos të rinia. Në vitet 1950, u rrit numri i instituteve të larta dyvjeçare, si Instituti Bujqësor; Instituti Politeknik; Instituti Pedagogjik 4-vjeçar; Instituti Mjekësor dhe Instituti Juridik.

“Në vitin 1957, u themelua Universiteti Shtetëror i Tiranës”. [Historia e Popullit Shqiptar III, 2009:222]. Një rëndësi shumë të madhe mori organizimi i arsimit profesional - teknik për përgatitjen e kuadrove të profesioneve të ndryshme, “të rëndësishëm dhe të nevojshëm për të nxjerrë vendin nga prapambetja arsimore, duke i dhënë asaj karakter popullor, por po aq dhe politik”. [Hoxha, Enver, 1970,V.5:183,417,419-434].

Në fillim, në sistemin arsimor u përdorën plane, programe dhe tekste nga shkollat ruse. Mbas një dekade politike arsimore, të drejtuar formalisht nga Fronti Demokratik, por praktikisht nga Partia Komuniste, në raportin e Kongresit të 3-të të P.P.SH. të zhvilluar në 25 maj 1956 u deklarua se,

“analfabetizmi mori fund”. [Hoxha, Enver, 1973, V.13:271, 393-400, 402-403]. Me gjithë vështirësitë e mëdha ekonomike, që rezultuan nga lufta dhe problematikat e rindërtimit, “kjo ishte një fitore përkundrejt gjendjes arsimore të popullsisë pas luftës, kur llogaritej se 81.22 % e popullsisë ishte analfabete”. [Gazeta “Bashkimi” 1947, nr.733:1]. Direktivat e Kongresit u shndërruan në një platformë për zhvillimin e arsimit, me objektiva të ndryshme, krahasuar me atë të vitit 1946. Direktivat përmbanin:

1] Shkollat të pajisen me një numër të madh tekstesh të bazuara në metodologjinë marksiste - leniniste; 2] Në radhë të parë, të meren masa për të lidhur më mirë teorinë me praktikën, mësimin me jetën; 3] Të përmirësohet puna mësimore në shkollat e fshatit; 4] Të rritet numri i Instituteve Pedagogjike; 5] Arsimi i natës dhe me korespondencë të rritet; 6] Të zgjerohet rrjeti i konvikteve për nxënësit që nuk kanë mundësi të ndjekin shkollat në zonat e tyre; 7] Aktiviteti kulturor me masat duhet të synojë në propagandimin e ideve të partisë sonë, në krijimin e botëkuptimit materialist; 8] Të realizohet arsimi i përgjithshëm shtatëvjeçar duke synuar që në fund të 5-vjeçarit të tretë, 1965, të thithen në arsimin shtatëvjeçar 80 % e fëmijëve që mbarojnë shkollën fillore. Për këtë qëllim gjatë 5-vjeçarit të tretë do të hapen 200 shkolla të tjera 7-vjeçare dhe 35 shkolla me konvikte, që do të thotë të shtrihemi deri në fshatrat dhe zonat më të thella, ku të sigurojmë të paktën 15 nxënës për klasën e parë. Për këto shkolla do të duhen të përgatiten rreth 1.000 kuadro të rinj. [A.Q.SH. i R.SH.F.511, V. 1947, D. 6, fl.2].

Pleniumi i 19-të i K.Q. të P.P.SH. më 8 tetor 1960, përcaktoi orientime të reja për sistemin arsimor. Me vendosjen e tetëvjeçares, si sistem i arsimit të detyrueshëm, çdo i ri ose e re do të jetë i/e përgatitur në mënyrë të mjaftueshme të ndjekë shkollat e ulëta e të mesme profesionale, ose të arsimit të përgjithshëm, me shkëputje ose pa shkëputje nga puna. “Në shkollat shqiptare u fut puna praktike, e cila do të bëhej në fabrika e uzina, në kooperativat bujqësore e të tjera”. [Hoxha, Enver, 1971, V. 19:308 - 324]. Direktivat përcaktonin se,

“në qoftë se shkollën do ta bëjmë 12-vjeçare, ne duhet ta mbushim programin me diçka tjetër, me synimin për t’i përgatitur nxënësit me jetën, për prodhimin. Përsa i përket afatit të shkollës së mesme të arsimit të përgjithshëm, pas diskutimesh, u vendos që ajo të jetë 12-vjeçare”. [Hoxha, Enver, V.29 1979 :39:539-545].

Problemi i revolucionarizimit të shkollës u udhëhoq nga vet partia, me diskutime të hapura. U morën masa që shkolla në programin e saj, të studionte klasikët e marksizëm - leninizmit. Arsimi ishte pjesa më e ndjeshme ndaj orientimeve ideologjike. Deklarata e E. Hoxhës për karakterin e shkollës, u bë në diskutimin e tij në mbledhjen e B.P. të K.Q. të P.P.SH.

“Shkolla jonë nuk është një shkolle apolitike, ajo është një shkollë ideopolitike dhe teknike. Këtij qëllimi i shërbejnë mësuesit, pedagogët, tekstet, e gjithë puna mësimore - edukative e shkollës,

natyrisht edhe organizata jonë e rinisë; që të gjitha këto drejtohen dhe frymëzohen nga Partia. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës për këtë qëllim, të zgjedhë njerëzit më të mire, jo vetëm nga ana pedagogjike po dhe politike e ideologjike, që këta të kuptojnë se, shkolla jonë është shkollë politike dhe ideologjike. Sekretari bazë i partisë duhet të bëjë me ta mbledhje dhe të shikojë nëse puna e tyre është e nivelit që kërkohet, nëse është e nevojshme për nxënësin ajo që bën mësuesi”. [Hoxha, Enver,V.29, 1979 : 165-179].

Propaganda komuniste intensifikohet më tej, me fillimin e Revolucionit kulturor në vitin 1961. Kjo lëvizje u zhvillua paralelisht me Revolucionin Kulturor në Kinë, në vitin 1965. Çdo formë e shfaqjes së kultures së huaj borgjeze konsiderohej reaksionare. Programet shkollore përfshinë një lidhje të ngushtë midis teorisë dhe punës praktike. Në të gjitha shkollat e vendit filloi ngritja e bazës prodhuese, e cila kishte orët e saj në programin mësimor, për të njohur të rinjtë me punën dhe për t’i përgatitur për ndërtimin e atdheut. Të rinjtë kryenin praktika pranë ndërmarrjeve apo kooperativave bujqësore,

“për të forcuar lidhjet me klasën punëtore dhe fshatarësinë. Praktika, ky element kaq i rëndësishëm i teorisë marksiste - leniniste vlerësohej në drejtim, sipas konceptit marksist që, teoria e mësuar në libra pa u lidhur me jetën praktike do të mbetej diçka pa shpirt, pa jetë, një gjë e vdekur”. [P.P.SH. Dokumenta Kryesorë II ,1972:271].

Në tabelën e mëposhtme paraqitet trajektorja e numrit të shkollave, nxënësve [meshkuj, femra] dhe mësuesve [meshkuj, femra] gjatë viteve 1938/1939 - 1969/1970.

Tabela nr 18: Arsimi i përgjithshëm 8-vjeçar, për vitet shkollore, 38 – 70, në qytet dhe në fshat. [Anuari Statistikor,viti, 1969,faqe. 70:116].

Emërtim	1938/39	1950/51	1955/56	1960/61	1965/66	1966/67	1967/68	1968/69	1969/70
Shkolla	-	193	341	557	769	808	871	1038	1.284
Nx të rregj	54.587	170.821	193.619	249.370	361.241	380.786	445.628	473.687	506.683
Femra	176.80	77.515	90.887	116.359	165.849	176.737	204.693	216.863	283.844
Me shk. puna	54.587	169.177	179.973	248.251	348.471	374.926	412.655	439.664	465.875
Femra	17.680	77.303	82.729	112.352	162.572	175.189	192.875	204.941	220.625

Pa shk. puna	-	1.644	13.646	26.686	12.567	5.860	32.973	34.023	40.808
Femra	-	212	7.558	4.007	3.277	1.548	11.818	11.922	13.219
Të rinj kl. e I	12.470	32.495	36.702	44.290	56.760	60.174	69.602	65.838	67.344
Femra	4.550	15.530	16.565	20.521	27.394	29.542	34.542	32.162	32.638
Me shk. puna	12.470	32.250	34.200	43.033	55.421	60.067	63.320	63.326	65.823
Femra	4.550	15.480	16.410	20.307	26.617	29.506	30.839	30.685	31.784
Pa shkëputje	-	245	2.502	1.257	1.339	107	6.282	2.512	1.521
Femra	-	50	155	214	777	36	3.712	1.477	854
Mb. 8-vjeç.	410	3.630	9.666	14.945	9.645	11.570	23.505	29.599	-
Femra	105	1.220	3.847	5.217	3.694	5.437	10.954	13.981	-
Me shk. puna	410	3.567	8.404	11.135	8.957	11.068	22.415	27.516	-
Femra	105	1.195	2.905	4.150	3.539	5.259	10.552	13.208	-
Pa shk. puna	-	63	1.262	3.810	638	502	1.090	2.083	-
Femra	-	25	942	1.067	105	178	402	773	-
Mësues	1.431	4.851	6.007	8.569	12.980	14.000	15.845	16.872	17.915
Femra	375	1.388	2.083	2.940	5.795	6.496	7.617	8.204	8.685


Ligji Nr. 3697, datë 11. 6. 1963 sanksiononte:

“Neni 1- Sistemi arsimor në Republikën Popullore të Shqipërisë ka për qëllim edukimin e gjithanshëm të brezit të ri dhe përgatitjes së tij për të marrë pjesë aktive në ndërtimin e shoqërisë socialiste. Ai ka si detyrë të pajisë të rinjtë me njohuri të shëndosha shkencore, të formojë botëkuptimin marksist - leninist, të japë përgatitje profesionale dhe për punë, t'i edukojë të rinjtë në frymën e patriotizmit socialist dhe internacionalizmit proletar dhe të sigurojë edukimin moral, fizik dhe estetik të tyre. Neni 4 - Parimi themelor i punës në shkollat, si dhe në institucionet e larta arsimore është lidhja e të mësuarit dhe edukimit me jetën, me prodhimin, me praktikën e ndërtimit socialist të vendit. Neni 10 - Arsimi tetëvjeçar është i detyruar për të gjithë fëmijet, djem e vajza, prej moshës 7 gjer 16 - vjeç. Mbas ligjit mbi arsimin të miratuar në vitin 1963, ndryshon raporti midis vajzave dhe djemve në pjesëmarrjen e tyre në shkollat 8-vjeçare”. [Hoxha, Enver., V.19, 1975:308-323]

Krahasimi që përpiquej të bënte propaganda e regjimit komunist, duke vënë përballë shifrat dhe statistikat e periudhës së Mbretërisë Shqiptare, ishte një veprim me karakter politik që realizonte njëkohësisht goditjen e kësaj periudhe, si një periudhë “e errët” për historinë e popullit shqiptar, në mbështetje të vendimeve të Kongresit të Përmetit për qëndrimin e regjimit ndaj Mbretit Zog.

Në figurën e mëposhtme paraqitet rritja e numrit të nxënësve femra, kundrejt numrit të përgjithshëm të nxënësve gjatë viteve; 1938 / 1939 - 1969 / 1970.

Figura nr. 1: Rritja e numrit të nxënësve femra, kundrejt numrit të përgjithshëm të nxënësve, gjatë viteve 1938 / 1939 - 1969 / 1970.



Siç shihet, numri i femrave që ndiqnin shkollën në Shqipëri në vitin 1970, ishte rreth 17 herë më i lartë se numri i tyre në vitin 1938.

Kjo rritje ishte shumë më e madhe se sa rritja e numrit të përgjithshëm të nxënësve, e cila ishte rreth 10 herë. Nga tabela shihet se, rritja e numrit të femrave në shkollim ka filluar që në vitin 1950; në këtë vit në Shqipëri ndiqnin shkollën rreth 4. 5 herë më shumë vajza, se sa në vitin 1938. Gjithashtu, me përjashtim të vitit shkollor 1960 - 1961, ku numri i femrave nxënës rezulton më i madhe se sa i meshkujve, në të gjithë vitet e tjera raportet janë në favor të nxënësve meshkuj.

Në figurën e mëposhtme paraqitet trajektorja e përqindjes së numrit të nxënësve femra, kundrejt numrit të përgjithshëm të nxënësve gjatë viteve 1938 / 1939 - 1969 / 1970.

Figura nr. 2: Përqindja e numrit të nxënësve femra kundrejt numrit të përgjithshëm të nxënësve, gjatë viteve 1938 / 1939 – 1969 / 1970.





Figura e mësipërme na tregon se, trajektorja e rritjes së përqindjes së vajzave që ndjekin shkollën, u rritën në mënyrë të ndjeshme gjatë periudhës 1938 - 1950; nga 32.4 % në 45.3 %.

Gjatë periudhës 1950 -1969, rritja ka vazhduar në mënyrë tepër të moderuar, për t'u theksuar në vitin 1969 - 1970, kur arriti në masën 56 %.

Figura nr. 3: Femra e meshkuj [në %] nxënës të shkollave, gjatë viteve 1938 / 1939 - 1969 / 1970.



Siç shihet nga figura e mësipërme, në vitin shkollor 1969 - 1970, për herë të parë, përqindja e femrave që vazhdonin shkollën, ishte më e lartë se sa përqindja e meshkujve: 55.9 %, kundrejtë 44.1 % të tyre.

Nga krahasimi i rritjes së numrit të nënësve dhe rritjes së përqindjes së femrave në numrin e përgjithshëm të nxënësve në të gjitha nivelet / gradat e shkollimit, ka ecur paralel me rritjen e kapacitetet akomoduese të arsimit shqiptar; rritjen e numrit të shkollave të të gjitha niveleve, të cilat gjatë periudhës 1938 - 1970 u rritën rreth 12 herë, si dhe rritjes së numrit të mësuesve, të cilët gjatë periudhës 1938 - 1970 u rritën rreth 5 herë.

Revolucionarizimi i shkollës u drejtua nga direktivat partiake, duke u zbatuar nga komisioni i posaçëm i K.Q. të drejtuar nga Kryeministri. Gazeta Zëri i Popullit do të shkruante në vitin 1966:

“...në të gjitha kategoritë kanë mësuar 430. 000 nxënës dhe studentë, afërsisht një në katër vetë. Tani në arsimin e përgjithshëm të detyrueshëm tetëvjeçar mësojnë 90 % e fëmijëve të moshave përkatëse. Numri i specialistëve me arsim të lartë, është rritur nga 380 që ishin në 1938, në 9. 200 në 1965. Ne nuk duhet të harrojmë faktin se, Shqipëria është një vend i vogël, që ndërton socilaizmin në zemrën e Evropës kapitaliste të molepsur në revizionizëm, i rrethuar nga imperjalistët e revizionistët, të cilët e kanë halë në sy Republikën tonë”. [Gazeta “Zëri i Popullit,1966,nr.276:1].

Tabela nr. 19: Treguesit kryesorë për vitet shkollore 1938 / 39, 1950 / 51, 1955 / 56, 1959 / 60

Gradat e arsimit	1938/39	1950/51	1955/56	1956/57	1957/58	1958/59	1959/60
Edukimi parashk.							
Kopshte.	23	155	289	303	330	381	415
Femijë.	2434	10004	15868	16533	17148	19534	21630
Edukatore.	40	297	606	639	700	818	926
Ars. i kult. përgj.							
Shkolla.	3	8	9	10	10	10	10
Nxënës.	675	1935	2077	1957	2301	2676	3244
Personeli mës.	18	61	126	117	125	124	164
Ars. mesëm ped.							
Shkolla.	3	8	9	10	10	10	10
Nxënës.	675	1935	2077	1957	2301	2676	3244
Personeli mësim.	18	61	126	117	125	124	164
Ars. i ulët prof.							
Shkolla.	11	8	15	16	17	18	26
Nxënës.	2056	1045	2106	457	2395	2841	3742
Personeli mës.	109	34	72	80	77	116	151
Ars. mesëm prof.							
Shkolla.	2	9	15	20	20	18	22
Nxënës.	204	1918	4964	5154	5234	5535	5918
Personeli mësimor	16	110	260	253	252	273	302
Arsimi i lartë.							
Shkolla.		1	7	7	4	3	6
Fakultete.		5	22	22	14	12	21
Student.		130	2301	2910	3351	3278	3890
Të huaj që qëndr.			6	12	26	26	26
Pedagogë.		13	156	208	266	258	297

[Anuari Statistikor i Shqipërisë, 1960, faqe 286; këtu përfshihen shkollat, nxënësit, studentët, dhe personeli mësimor i ditës dhe i mbrëmjes].

Në kontekstin e këtij procesi, u shënuan disa tregues sasiorë dhe cilësorë; arsimi tetëvjeçar u bë i detyrueshëm; arsimi i mesëm katërvjeçar u zgjerua në shkolla të mesme dhe ato profesionale, duke u shtrirë në të gjithë vendin; u zgjerua rrjeti i arsimit të ulët tekniko - profesional dyvjeçar për të siguruar fuqi punëtore të kualifikuara; u hapën kurse të shumta me profile të ndryshme për kualifikim apo specializim; arsimi i lartë pranonte studentë vetëm pasi kishin bërë një vit pune prodhuese pas ciklit të mesëm; Universiteti Tiranës i zgjeroi filialet e tij në shumë rrethe. [AQSH i RSH.F.511,V.1957,D.4,fl.1].

6.3. Ndikimi i proceseve “revolucionarizuese” në deformimin e procesit të socializimit dhe zhvillimeve gjinore.

I ashtuquajtur *“proces i revolucionarizimit”*, pati një ndikim të ndjeshëm në zvizollimet rinore dhe gjinore në Shqipëri. *“Revolucionarizimi”* synonte zgjerimin e mbështetjes së rinisë dhe të grave në zhvillimet shoqërore, politike dhe ekonomike në Shqipëri, nëpërmjet përfshirjes së tyre në betejat ideologjike e kulturore, kundër besimeve dhe institucioneve fetare si dhe ndaj standardeve të vjetra të sjelljes, që ushqeheshin nga këto besime. Por këto qëllime të shpallura, në praktikë u zëvendësuan më tharjen e jetës shpirtërore të vendit dhe vënien e saj nën sundimin ideologjik, politik dhe vleror të partisë. Për më tepër, rinia dhe gratë u përdorën si një arsenal për të sendërtuar obektivat e regjimit për mbrojtjen nga rreziku, që në gjuhën e kohës quhej *“rrethimi imperialisto - revizionist”*.

Përfshirja e rinisë, grave e vajzave në aksionet në prodhim, stërvitjen ushatarake dhe në praktikat e tjera, disa të huazuara nga Revoluzioni Kulturor Kinez, disa të tjera origjinale nga praktika e

vetë të regjimit, deformuan thellësisht procesin e socializimit të rinisë dhe e orientuan mbështetjen e saj dhe të grave, drejtë proceseve që synonin sterilizimin e jetës shpirtërore, kulturore, arsimore dhe shoqërore të vendit.

Thellimi i të ashtuquajturit, “*procesi i revolucionarizimit*”, synonte që edukimi i brezit të ri të ishte në përputhje dhe shërbim të ideologjisë komuniste. Thirrja, “*T’u qepemi kodrave e maleve, t’i zbukurojmë e t’i bëjmë ato pjellore si dhe fushat*”, [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr. 276:2], imponoi vënien e brezit të ri, brenda dhe jashtë sistemit të shkollimit, në shërbim të programeve të zhvillimit të ekonomisë, sidomos të bujqësisë dhe infrastrukturës rrugore e hekurudhore. Rinia merrte pjesë në ndërtimin e shumë veprave bujqësore dhe hekurudhave të vendit.

Qëllimi i këtyre aksioneve ishte zhvillimi i zonave malore, si pjesë e ekonomisë socialiste, për t’i përfshirë ato në proceset kolektivizuese të pronës dhe punës. Kjo pritej të realizonte emancipimin e këtyre zonave të thella. “*Të sigurojmë bukën në vend*”, u bë parulla kryesore e Kongresit të V-të të P.P.SH.

Edukimi fizik dhe sportet morën një rëndësi të jashtëzakonëshme, në emër të revolucionarizimit dhe kalitjes fizike në shkolla. Parulla, “*Gati për punë e mbrojtje*” i drejtohej veçanërisht rinisë, duke i bërë thirrje të ushtronte të gjitha llojet e sporteve; gjimnastika e përditëshme, atletika e lehtë, marshimet turistike, eskursionet, ngjitjet alpinistike, noti, mundja, ngritja e peshave dhe llojet e tjera të sportit, veçanërisht ato ushtarake. Direktiva ishte; “*të kombinohej edukimi i përgjithëshëm fizik me edukatën paraushtarake dhe ushtarake, sidomos me qitjen, marshimet dhe elementet e tjerë të sporteve ushtarake*”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr. 186:1].

Kultura fizike dhe përgatitja ushtarake morën një rëndësi të veçantë për të mbrojtur vendin nga armiqtë imagjinarë. Parrulla luftarake shpërthyen kudo, propaganda dhe puna e organeve të partisë e instaluar në çdo qelizë të shoqërisë, do të merrnin të parat iniciativat për të bërë më pas

masivitetin e kësaj lëvizje, e cila ndryshoi të gjithë jetën shoqërore. Reflektimi i drejtëpërdrejtë do të ndodhte në masat e gjithanëshme, në kuadrin e mbrojtjes së vendit.

Forcat e Armatosura [F.A.] tradicionalisht kanë mbetur “*organizata konservative*” dhe i kanë rezistuar tendencës së përfshirjes në to të një numri më të madh të femrave në shërbimin ushtarak. Në kohën e regjimit komunist, nën orientimin e politikave shtetërore sipas direktivave ideologjike, gjinia në përgjithësi nuk shihej e vlerësohej si strukturë e marrëdhënieve të harmonizuara sociale dhe si tërësi e praktikave në shërbim të këtyre marrëdhënieve. Hartimi dhe zbatimi i politikave gjinore në sektorët e dominuar historikisht nga meshkujt, veçanërisht pjesëmarrja e grave dhe vajzave në strukturat ushtarake të shtetit, përbënte një sfidë të kohës.

Në periudhën e Mbretërisë Shqiptare as që mund të bëhej fjalë për praninë e gjinisë femërore në strukturat ushtarake. Formaliteti në zhvillimin e reformës, edhe pse me një legjislacion të ri modern, nuk i dha mundësinë shtetit mbretëror që të aplikonte realisht ndryshime thelbësore në jetën social politike të vendit. Ushtria Mbretërore për gratë shqiptare ishte një sektor hermetikisht i ndaluar.

Në Shqipëri, në vitin 1967, për herë të parë u futën femrat në ushtri, nën propogandën intensive partiake të emancipimit të gjithanshëm dhe të përfshirjes së gruas në të gjitha sektorët e jetës. Gratë filluan të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, të ngarkuara me detyra e funksione në të gjithë sektorët e armëve dhe shërbimeve. Tendencia për të mos mbetur vetëm si fasadë e përfshirjes, por të realizohej ajo me masa e mekanizma veprues, ishte një shqetësim i politikës së kohës, që realisht solli disa ndryshime cilësore në praktikën e barazisë gjinore në strukturën e mbrojtjes.

Pas këtij viti, në strukturën e Forcave të Armatosura u futën gratë oficerë, të cilat mbuluan të gjithë sektorët e shërbimeve dhe u futën në rrugën e karrierës ushtarake, pothuajse në shanse të barabarta me meshkujt. Kundër tradicionalizmit mashkullor, kundër agresivitetit dhe diferencave

të forcës fizike mashkullore, kjo ishte një arritje e kohës. Vazhdimi i traditës prej strukturave të ushtrisë Nacional - Çlirimtare, në vitet e pasçlirimit, ushtria vazhdonte të përbënte një simbolikë prototipe të maskilizmit, përballë kriterit numerik dhe atij cilësor, të cilat nuk do të kalonin lehtë, nëse do të merret në konsideratë fakti që, në strukturat rezerviste të ushtrisë shqiptare ishin të inkadruara mijëra gra dhe vajza të të gjithë profesioneve, nga mosha rinore deri në 35 vjeç.

Politika partiake në Shqipëri nuk i shpëtoj dot konceptit të pjesmarrjes së grave dhe vajzave; ndryshe në kohë lufte [maksimalisht] dhe ndryshe në kohë paqe [minimizimi nga mungesa e pranisë së tyre]. Ato vlerësoheshin më të domosdoshme në strukturat e Forcave Vullnetare të Vetmbrojtjes Popullore [F.V.V.P.].

Brenda kulturës dhe pranisë mbizotëruese mashkullore, gratë dhe vajzat bënë përpjekje të mundimëshme të bëheshin pjesë e saj. Tendencat diskriminuese dhe dalluese, që vështirësonin praninë dhe aftësitë e tyre kulturore e profesionale, kanë qenë të pranishme, të shfaqura në brezin e vjetër të oficerëve madhorë të lidhur tradicionalisht me ndikimet psikologjike të luftës çlirimtare.

Grupimi i grave dhe vajzave në strukturat ushtarake, nuk i pati mundësitë e përfaqësimit si grup interesi për karrierën dhe kontributin e tyre, por u trajtuan nën frymën e ndikimit të përgjithëshëm të zbatimit të direktivave partiake, të cilat po aq sa jepnin hapësirën formale të vlerësimeve gjinore, po aq arrinin të mbulonin me një lloj konservatorizmi tradicional vlerësimin dhe kontributin real të potencialeve të mëdha që përfaqësonin gratë dhe vajzat në këtë strukturë.

Koncepti sasior përballë kërkesave maksimale të çështjeve të mbrojtjes, rriti në mënyrë artificiale pengesat, që gratë dhe vajzat të kishin mundësinë të ushtronin aftësitë e tyre në të gjitha fazat e karrierës ushtarake. Kufizimi për ngritjen e tyre profesionale në Akademinë e Mbrojtjes, kushtëzoi praninë e tyre në detyra funksionale, jashtë të drejtës së instancave të drejtimit dhe komandimit, vetëm në shërbimet pranë shtabeve të njësive dhe reparteve ushtarake.

Në kushtet e veprimit të sistemit politik me bazë ideologjike, shteti shqiptar arriti të pranonte dhe të zbatonte kërkesat e “Rezolutës së Këshillit të Sigurimit Nr. 1325 të Kombeve të Bashkuara, apo UNSCR 1820, UNSCR 1818, UNSCR 1889, UNSCR 1960, lidhur me gratë, paqen dhe sigurinë”, [Jahollari, Suzana, <http://www.aliiss.org/aliiss>], por e zhvilloi propagandën mbi të drejtat, pjesmarrjen e grave dhe vajzave në strukturat ushtarake, vetëm sipas interesave partiake në kuadrin e përgjithëshëm të reformës emancipuese dhe detyrimeve që rridhnin prej direktivave të udhëheqjes.

“Përfaqësimi i ulët i femrave në rangjet më të larta [të komandim - drejtimit] tregonte që në këtë sektor të rëndësishëm ekzistonte “tavani i qelqit”, që femrat nuk mund të arrinin në rangjet më të larta, për shkak të mentalitetit e barrierave kulturore”. [Jahollari, Suzana, <http://www.aliiss.org/aliiss>].

Konstatimet nuk janë të rastësishme. Femra në ushtrinë shqiptare nuk u pa si një forcë reale me të drejta të barabarta, por u konsiderua si forcë numerike brenda detashmentit të mbrojtjes së vendit. Prania e tyre në këtë strukturë në vendimarrje, mungonte.

Në shërbim të propagandës së kohës, Zëri i Popullit do të shkruante: “Masiviteti po bëhet gjithmonë e më shumë dallues i kësaj lëvizje; Parrulla luftarake revolucionare e saj, “Të ndërtojmë socializmin, duke mbajtur në njerën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr. 186:1].

Sot funksionon shoqata e “Gratë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, [Msc. Suzana Jahollari, po aty], e krijuar më 04. 02. 2011, e cila është vënë në shërbim të promovimit të lirive dhe të drejtave njerëzore, barazisë gjinore, masat kundër dhunës dhe diskriminimit gjinor, të drejtën e këshillimit me udhëheqësinë shtetërore dhe përfshirjen e plotë e grave dhe rritjes së rolit të përfaqësimit të tyre në të gjithë nivelet e vendimarrjes brenda standardeve bashkëkohore.

Kalitja fizike, si iniciativë e masave dhe imitim i Revolucionit Kulturor Kinez, u shtri kudo. Stërvitja fizike dhe ushtarake trajtohej jo si argëtim, por si shprehje e kuptimit politik të situatës. Parrulla tjetër, “Në njerën dorë kazmën, dhe në tjetrën pushkën”, bënte thirrje që rinia të ishte sa

më e ditur dhe e kulturuar, e zonja për të zgjidhur në mënyrë të kualifikuar detyrat e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. [Gazeta”Zëri Popullit”, 1966, nr.19:3].

“Ajo do të bëjë që fryma revolucionare, ajo e vënies së interesit të përgjithshëm mbi atë personal, lidhjet e ngushta me popullin në punë dhe jetesa, të përshkojë gjithë qenien tonë; sot mbi 20. 000 të rinj po punojnë në Thumanë, Çermë, Sukth, në ndërtimin rrugësh pyjore në fshat”. [Gazeta”Zëri i popullit”, 1966, nr. 182:2].

Rinisë iu bë thirrje, madje iu imponua kalimi nga procesi i socializimit konsumator në socializimin prodhues. Gazeta Zëri i Popullit shkruante:

“Janë regjistruar 80. 000 të rinj në hekurudhën Rrogozhinë – Fier, ndërsa 13. 000 të reja janë ngjitur kodrave e maleve për hapjen e tokave të reja”. 6. 000 të rinj e të reja në hekurudhën Rrogozhinë - Fier, e cila iu besua rinisë në kongresin e 5-të të saj” [Gazeta “Zëri i Popullit”, 1957, nr. 7:1].

Kontributi vullnetar, përtej propagandës së përgatitjes fizike dhe lidhjes së teorisë me praktikën, ishte dhe një burim të ardhurash, në kushtet e burimeve të kufizuara financiare e buxhetore të shtetit. Zëri i Popullit shkruante:

“Ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste, kërkon një qëndrim të drejtë ndaj punës, e cila jo me fjalë por me praktikë, duhet të konsiderohet çështje e dorës së parë. Ai kërkon një luftë të pamëshirshme kundër çdo shfaqjeje të huaj, si tendenca e rehatit, mungesa e shpirtit të sakrificës, përbuzja dhe përçmimi për punën fizike, tërheqja përpara vështirësive, vënia e interesit të përgjithshëm mbi atë personal, shkëputja nga masat e popullit dhe jeta e tyre etj. Shfaqje të tilla e kanë burimin në mbeturinat mikroborgjeze e borgjeze, ose lindin si reflex i presionit të ideologjisë, kapitaliste, revizioniste”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966,nr.160:2].

Në këtë fjalim jepet shumë qartë kuadri i dukurive që përbënin shfaqje të huaja, si një objektiv i luftës së klasave. Duke imituar në çdo detaj Revolucionin Kulturor Kinez, lufta e klasave kaloi në një nivel të ri, jo vetëm kundër armiqve të jashtëm, por edhe të brendshëm. Ajo ishte një luftë brenda gjirit të masave, për të luftuar çdo shfaqje të huaj borgjeze e konservatore, kundër zakoneve patriarkale. Lufta ideologjike u pasua nga përdorimi i gjerë i “Dacibaove”, imitim i “revolucionarëve” kinez, i konsideruar si “një përvojë revolucionare”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1967, nr. 4:3].

Revolucioni ideologjik u pasua nga revolucioni tekniko - shkencor, sipas të cilit ligjet shkencore do të zhvillonin ekonominë, duke u mbështetur në forcat e brendëshme. “Do të jetë gabim që revolucionin tekniko - shkencor do ta bëjnë vetëm disa njerëz të mësuar. Jo, siç do revolucion i

vërtetë, edhe revolucionin tekniko - shkencor do ta bëjnë masat e gjëra të punonjësve”. [Hoxha, Enver,” Raporte e Fjalime 1967 – 1968”,1968:255].

Revolucioni tekniko - shkencor kërkoi si plotësues të vetin revolucionarizimin e artit, letërsisë, dhe kulturës, të cilat duhej të mbizotëroheshin nga fryma e realizmit socialist dhe përpjekjet për të zhdukur çdo mbeturinë të së kaluarës.

Revolucionarizimi i jetës përfshiu dhe revolucionarizimin e administrimit dhe administratës publike. Në këtë kontekst, u intensifikua lufta kundër burokratizimit për të siguruar, siç u reklamua, lidhjen e aparateve qendrore me popullin.

Revolucionarizimi u shoqërua me krijimin e atmosferës së rrezikut dhe nevojës së mbrojtjes nga rreziqet e jashtme dhe të brendshme. Puna ideologjike, propaganda dhe agjitacioni synonin formimin revolucionar të njerëzve, sipas parimit, *“Të mendojmë, të punojmë dhe të jetojmë si revolucionarë”*, e cila përbënte thelbin e edukimit komunist, sipas konceptit marksist, *“Diktatura e proletariatit, është një luftë e ashpër me gjak e pa gjak, e përdhunueshme e paqësore, ushtarake e ekonomike, pedagogjike e administrative kundër forcave dhe traditave të shoqërisë së vjetër”*. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr. 147:3].

Misioni që iu ngarkua rinisë në të ashtuquajturin proces të *“revolucionarizimit”*, kërkonte përgatitjen e saj kulturore. Kjo do të realizohej nëpërmjet marrëdhënieve të reja të rinisë me letërsinë dhe artin socialist. Direktiva partiake ideologjike do të tërhiqte vëmendjen në të gjithë nivelet:

“Partia shtron detyrën që, letërsia dhe artet të bëhen një armë e fuqishme në duart e partisë për edukimin e punonjësve me frymën e socializmit dhe komunizmit, që ata të qëndrojnë në radhët e para të luftës për të edukuar një rini të pastër ideologjikisht e moralisht; që e gjithë krijimtaria artistike të ketë një nivel të lartë ideologjik të përshkohet nga fryma revolucionare luftarake e partisë si dhe fryma e shëndoshe kombëtare; Arti dhe kultura janë socialiste duhet të mbështeten fortë në tokën tonë amëtare, ato duhet të burojnë nga populli dhe të jenë plotësisht në shërbim të tij. Revolucionarizimi duhet të jetë i gjithanshëm, të përfshijë vetë sistemin arsimor, brendinë e punës arsimore edukative, si dhe metodat e mësimiit e edukimit, lidhjet e mësimiit me punën”. [Gazeta”Zëri i Popullit”, 1966, nr. 263:1].

Arti dhe kultura e re duhet të transmetonin vrullin e jetës revolucionare, heroizmin e njeriut socialist. Artit iu imponua të pasqyronte heroin e ditës. Në qëndër të vëmendjes së letërsisë dhe arteve *“duhet të viheshin heronjtë e kohës, punëtorët, fshatarët, intelektualët popullorë, njerëzit e rinj, që me vetmohim e heroizëm punonin e luftonin për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e lulëzimin e atdheut”*. [Hoxha ,Enver,”Raporte e Fjalime 1967-1968”,1968:497].

U ngritën estradat amatore në çdo ndërmarrje, grupet artistike të cilat filluan të konkurronin hapur artistët e mëdhenj; arti i vërtet ia la vendin amatorizmit popullor dhe temave revolucionare; çdo vepër artistike duhej të fliste për heroin e luftës, jetën e thjeshtë, gruan revolucionare.

“Në popull ne duhet të gjejmë frymëzimin tonë tingujt e këngës, ritmet e valles, pastërtinë e gjuhës, tempot e punës, frymëzimin e krijimit, shembullin e heroizmit e të sakrificës, virtytet e larta të thjeshtësisë popullore, të drejtësisë popullore etj. Baza e krijmtarisë, si për çdo gjë, ashtu dhe në art e kulturë, duhet të jetë baza popullore”. [Gazeta”Zëri i Popullit”,1966,nr.39:3].

Asnjë aspekt i veprimtarisë krijuese nuk duhej t’i shpëtonte revolucionit kulturor. Artit iu imponuan tipare popullore që buronin nga revolucionin popullor. Tradita popullore duhej të gërshetohej me profesionalizmin dhe amatorizmin. Por ky trinitet ishte i vështirë për t’u jetësuar. Parimi se, *“Arti dhe kultura janë duhet të jenë socialiste nga përmbajtja dhe kombëtare nga forma”*, ishte asgjësues dhe asfiksues për artin e vërtetë.

“Pse ne mund ta edukojmë mirë të riun tonë në mëngjes, po pasdreke ose në mbremje ata i edukon filmi borgjez, muzika dekadente ose romani borgjez. Në këtë drejtim ne duhet të pastrojmë me fshesë të madhe, por dhe duhet të përpiqemi t’i zevëndësojmë këto që do të pastrojmë, me gjërat tona të bukura, revolucionare”. [Hoxha, Enver, 1979:369].

Zhvillimi i kulturës me karakter socialist, e cila u shtri në gjitha nivelet e arsimit dhe në tekstet shkollorë, bëri që shkollimi dhe dijet shkencore të asfiksoheshin nga indoktrinimi ideologjik. Partia - shtet kishte monopolin e katërfishtë të përhapjes së ideologjisë së vet revolucionare, nëpërmjet: a] mjeteve të shtypit të shkruar, gazetave, revistave, masmedias, radios, televizionit; b] sistemit arsimor; c] institucioneve të artit dhe kulturës, ku letërsia dhe filmi zinin vendin kryesor; ç] mjeteve të dhunës.

Arti i realizimit socialist ishte pjesë integrale e këtij sistemi, i lindur prej tij dhe në funksion të tij. Nga shumica e gjinive të artit, filmi u synua të shndërrohej në instrumentin kryesor për të krijuar perceptimin për “*shoqërinë e re socialiste*”, e cila do të bazohej në “*krijimin e njeriut të ri*” dhe në “moralin komunist”.

Imazhi dhe roli i gruas ishte shumë i rëndësishëm për regjimin komunist, sepse ajo mund të simbolizonte më mirë se kushdo tjetër “*botën e re*”. Për partinë - shtet, gruaja ishte një objekt perfekt për inxhinierinë e tyre sociale, sepse ajo konsiderohej si e shtypur nga një trashëgimi e dyfishtë e së shkuarës; prapambetja e varfëria dhe mënyra patriarkale e jetesës.

Ky konceptim nënkuptonte një lloj pozite të dobët shoqërore të gruas, e cila mund të kthehej në një element regresiv, mikroborgjez dhe të dëmshëm për revolucionin, nëse nuk shpëtonte nga kjo trashëgimi. Prandaj, nxjerrja e gruas nga prapambetja ekonomike - kulturore dhe çlirimi i saj nga normat patriarkale, u zbatua i lidhur ngushtë me pjesëmarrjen e saj në jetën publike. Me fjalë të tjera, ky proces u quajt “*emancipimi i gruas*”.

Kinemaja shqiptare njohu një zhvillim të konsiderueshëm vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. “*Në dhjetor të vitit 1945 u krijua Agjencia Shqiptare e Filmave, e cila në janar 1946 u shndërrua në Ndërmarrjen Shtetërore Kinematografike Shqiptare. Në vjeshtë të vitit 1947, u prodhua filmi i parë kronikal shqiptar*”. [Hoxha, Abaz.1987:9]. Kinemaja kishte disa përparësi në rolin e saj si agjensi socializimi:

a] ishte një art masiv, sepse në sallat e kinemasë mund të mblidheshin qindra vetë; b] filmat e realizimit socialist kishin në bazë skenarë të thjeshtë, me heronj pozitivë dhe negativë, me synimin që të bëheshin të asimilueshëm për masat e gjera; c] kinemaja mund të ndryshojë thelbësisht sensin e kohës dhe të hapësirës, duke bërë të mundur homogjenizimin kulturor dhe ideologjik të popullsisë; ç] filmi ishte një art që mund mbahej më lehtë nën kontroll, në ndryshim nga letërsia, e cila mund të bënte “diversione” midis rreshtash. [Hoxha, Abaz, 1987:14-16].

Pa mohuar ndryshimet në jetën e gruas, në fakt “*emancipimi*” ishte një lloj zëvendësimi i autoritetit patriarkal të mashkullit të shtëpisë me autoritetin autokrat të Partisë së Punës. “*Emancipimi*” nuk duhet kuptuar vetëm si një realizim individual i personalitetit të gruas, por

dhe si një shërbim “vullnetar”, që ajo i bënte shoqërisë së re socialiste. Pjesëmarrja e gruas në jetën publike më vonë do të merrte disa forma, të cilat do të propagandoheshin, stimuloheshin dhe përhapeshin nga filmat shqiptarë.

“Këto forma do të ishin rolet që do të personifikonin “gruan socialiste”, e cila do të shfaqej si; a] nënë heroinë, kryesisht në filmat me tema historike dhe të luftës; b] si partizane në mal dhe si aktiviste komuniste ilegale në qytet, dhe më pas për periudhën e pasluftës si; c] si kooperativiste; ç] si punëtore; d] si grua urbane, në rolin e vajzës, motrës, të bashkëshortes, si intelektuale, etj”. [Puto, Artan, 2013: <http://www.peshkupauje.com>].

Shfaqja e roleve pozitive të gruas shqiptare në filma kishin karakteristikat e tyre vizive. Kështu, një nënë heroine do të kuptohej nga flokët pak të bardha në ballë, nga shamia e zezë në kokë që mbledhte vetëm flokët, për të bërë kujdes mos të dukej si perçe, një partizane që do të kishte gërshta dhe do të ishte e veshur si djalë me kilota ushtarake, një aktiviste komuniste në qytet që do të ishte kryesisht një vajzë gjimnazi ose shkolle me pamje të rregullt dhe veshje modeste, kryesisht e varfër, por dhe ndonjë vajzë nga familjet e pasura, si për të treguar forcën tërheqëse të ideve komuniste. Një kooperativiste dhe një punëtore do të dalloheshin nga pamja burrërore, nga veshjet mashkullore dhe nga pozita në procesin e prodhimit, që më parë ishte zotërim mashkullor.

Gruaja urbane shfaqej në pamje të ndryshme, në varësi të roleve që duhej të përfaqësonte, por mbizotëronte një pamje të “rregullt” estetikisht, gjë që sipas normave të realizmit socialist, donte të thoshte në radhë të parë, mungesë feminiliteti. Pamjet e ndryshme të rolit të gruas në kinematografinë komuniste, kushtëzoheshin nga periudhat kohore kur prodhoheshin filmat.

Tipar tjetër i roleve femërore në kinematografinë e kohës, ishte qasja ndaj marrëdhënieve midis burrit dhe gruas, ndryshimet midis tyre, ose theshte marrëdhëniet dashurore. Ndonëse propagandohej për barazi gjinore, rolet e gruas shqiptare në kinematografi do të ruanin tiparet “tradicionale”, ç’ka nënkuptonte se ajo ishte jo vetëm një punëtore dhe kooperativiste e mirë, por dhe grua e devotshme, nënë e përkushtuar, që kishte respekt për brezin e vjetër. Ndonëse

ideologjia komuniste pretendonte se do të krijonte një “botë të re”, në fakt gruaja që shfaqej ishte një kombinim i vlerave tradicionale me vlerat “e reja” socialiste.

“Një aspekt tërësisht “shqiptar” i rolit të gruas në kinematografinë e kohës, “e cila mbeti mënyra më e gjetur për të treguar dhe trasmetuar opinionit se si shfaqeshin marrëdhëniet dashurore, të cilat ishin puritane, pa prekje fizike, me përjashtime të pakta, të përshkuara nga një sentimentalizëm prozaik, i shtirur dhe foshnjarak”. [Puto, Artan, 2013: <http://www.peshkupauje.com>].

Këto tipare të mënyrës së trajtimit të imazhit të gruas në kinematografinë shqiptare, ishin refleks i tipareve të vetë thelbit të ideologjisë së regjimit komunist dhe i natyrës drejtë të cilës po orientohej shoqëria shqiptare.

Regjimi komunist mbeti deri në fund radikal dhe dogmatik, imponoi një skemë të ngurtë të realizimit socialist në art. Por mbi të gjitha, Shqipëria nuk njohu procesin e de-stalinizimit, aq i rëndësishëm në vendet e ish kampoit socialist, sidomos në vitet 1960, e cila në vendet e tjera e çliroi në një masë të ndjeshme prodhimtarinë artistike nga trysnia e politikës. Po kështu, natyra patriarkalo - rurale e shoqërisë shqiptare të asaj kohe, megjithë ndryshimet që pësoi gjatë dekadave të komunizmit, “nuk mund të lejonte lehtëzi paraqitjen e një gruaje të dliur, të shpenguar, të brishtë dhe në fund të fundit femërore”. [Puto, Artan, 2013: <http://www.peshkupauje.com/>].

Duke depërtuar në mënyrë analitike brenda këtij sistemi të kapur në këto shtylla kryesore mbështetëse të regjimit komunist, arësyetojmë se, në këtë rrjedhë filozofike dhe ideologjike, veprimtaria sociale e individit [e konsideruar “qenie”] sot vazhdon të endet midis mendimit, idesë, realitetit dhe po shfaq konflikte të diferencuara në thelbin sinkretik të antropisë [sjellja njerëzore], entropisë [sjellja e natyrës].

Balancat midis tyre me deformime jo të rastësishme, japin shfaqjen më të plotë në mentalitetin dhe psikologjinë e individit [institucionit] në drejtimin e shoqërisë. Ende stadi i rezistencës vazhdon trysninë e tij mbi sistemin demokratik. Është kjo një arësye bindëse, që analiza e sistemit që lam pas, në funksion të raporteve midis individit dhe shoqërisë, të shpjegohet në

mënyrë shkencore, për të kuptuar dhe krijuar bindjen se, ideja e formimit “*të njeriut të ri socialist*” ishte një dështim i radhës.

Kjo arësye përcakton hapësirën e filozofisë të lidhur me psikologjinë dhe natyrën e tyre të shumfaktorëshme, në kushtet e veprimit të një sistemi të caktuar shoqëror që ushtronte në thelb vullnetin e diktaturës së proletariatit dhe udhëhiqej nga partia - shtet. Sipas konceptit të Spinozës, “*organizimi politik dallon nga vyrteti, pushteti dhe liria të ndërthurura këto me rolin e individit që drejton dhe shtresave të tjera të popullsisë*”. [Spinoza, Benedict, 2004:99]. Është rasti të shikojmë këtë përcaktim në kënvështrimin e psikologjisë që dominonte në sistemin e kaluar, për të njohur elementët që kanë vepruar në krijimin e asaj psikologjie dominuese, e cila në përfaqësimin e vet në raportet individ - sistem shoqëror, tregonte vetë thelbin e pushtetit politik, që vepronte “*në emër të popullit*”.

Në thelbin e psikologjisë dominuese në sistemin socialist, raportet që ndërvepronin brenda elementëve të tij, ishin të pashkëputur nga dogma “*drejtues - individ*”, deri në kultin e skajshëm të tij. Raportet midis individit me “*natyrë të re socialiste*”, mbeteshin vetëm formalisht në ndërveprimin e kategorisë psikologjike “*intelekt dhe vullnet*”, sepse ato në shumë raste përfaqësoheshin nga njerëz të mbetur në drejtim me dekada të tëra, dhe diktonin me injorancën e tyre, jo më mbi bazën e iteligjencies, por të vullnetit politiko - ideologjik dhe të shkallës së lartë të besimit në vijën e partisë pushtet.

Parimi thelbësor dhe parësor i rendit politik, është vërshimi i lirë i opinionit. Vetëm kështu arësyeja mundet të ndikojë në drejtimin e politikës pa shkatërruar themelet e shtetit. “*Nëse një shtet synon të jetë i aftë të mbijetojë - rekomandon Spinoza - administrata e tij duhet të organizohet në atë mënyrë që që të mos ketë rëndësi nëse sundimtarët e tij [liderët] udhëhiqen nga pasioni apo arësyeja*”. [Spinoza, Benedict, 2004:125]. Pavarësisht këtyre arsytetimeve, në thelbin e psikologjisë që dominonte në shtetin komunist, nuk mund të arrihet sot në përfundime

të pranueshme mbi vetë vlerat e “*njeriut të ri socialist*”, nëse nuk analizohen në kompleks përvojat dhe sistemi i vlerave që u arritën, pa përgjithësuar vetë sistemin.

Krijimi i “*njeriut të ri*” ishte një prirje e sistemit, i cili mbi bazën e ideologjisë së re u fut në një proces të gjatë ndryshimesh, por që nuk ja arriti qëllimit. Nëse do të ishte arritur ky objektivi, atëherë do të mendonim se dhe vetë sistemi socialist nuk do të ndryshonte. Ky element thelbësor në Shqipëri, që do të sillte një ndryshim të pritshëm në psikologjinë e njeriut shqiptar. Kjo u konceptua politikisht duke e çuar shoqërinë në rrjedhën e një gabimi trashanik. Situata me gjithë përmirësimet, nuk arriti të zgjidhte nevojat imediate të lirisë së ëndërruar dhe minimumit jetik të popullsisë. Pra, ishin predispozitat që gradualisht të krijohej “*njeriu i ri*”, jo vetëm për veteveten, por t’i përkiste edhe shoqërisë. Sa më shumë të zhvillohej shoqëria, aq më shumë do të rriteshin raportet e individit me të. Dështimin e shikojmë në analizën që i është bërë gjendjes dhe situatës së grave dhe vajzave, duke i parë ato si një forcë e madhe prodhuese [si krahë pune] dhe jo si një shtresë vitale, me mundësi të jashtëzakonëshme në progresin shoqëror.

Trajtimi që u është bërë këtyre elementëve në materialin studimor, edhe pse në pamje duket sikur propogandohen arritjet “*e hatashme*” në fushat e ndryshme të jetës shqiptare, edhe pse ato kanë pozitivitetin e tyre në pamje të jashtëme, në thelb dalin në dritë raportet e brendëshme të lidhjes shpirtërore të popullit, masës së grave dhe të vajzave shqiptare me falsitetin apo nënshtrimin e butë ndaj rrjedhave të jetës, që buronin nga natyra e sistemit dhe pushtetit. Analiza dhe kritika e mbështetur mbi parimet e lirisë, të shpirtit të lirë të individit brenda një sistemi që gjeneron energji pozitive, nuk lejon të përgjithësohen vlerat e sistemit të kaluar.

Ky qëndrim konstruktiv ndaj të drejtës njerëzore të orienton, në analizën social - psikologjike të periudhës në demokraci, sot të kthehet në një fushë eksplorimi teoriko - praktik të pamatë, për të qenë realist dhe nuk ka arsye të tërhiqemi përpara autoritetit kulmor të disa arritjeve, të cilat nuk

kishin të bënin me individin, por me kushtet në të cilat synohej drejtë një jete dhe lirie të ëndërruar, duke u bërë pa nostalgji pjesë modeste dhe reale e saj.

Injoranca profesionale e justifikuar nga besueshmëria politike dhe e kultivuar nga neopotizmi, vrau qysh në fillësën e saj aftësinë për të kultivuar raporte të drejta në fushën e edukimit, formimit psikologjik, të të drejtave brenda “*standardit të demokracisë popullore*”, në mënyrë që me objektivitet “*njeriu socialist*” të arrinte të dallonte objektivat parësore jetësorë dhe me krahasueshmërinë ndaj tyre, të vlerësonte realisht mundësitë, oportunitetet e munguara krejtësisht, zgjidhjet organike si dhe vlerat, kontributet e domosdoshme të “*njeriut të ri*”, si subjekt politik, ideologjik, *etiko moral dhe profesional*.

Në këto rrethana, shpesh individi mbetet përballë dilemës shkatërruese. Paqësisht kishte ndodhur ekuacioni i distancës së vetëdijes me aftësinë “*...për të menduar lirshëm, por jo për t’u shprehur po lirshëm*”, i nënrenditur padrejtësisht me dilemën e brendëshme të rezultatit dhe specifikës së arsytimit “*për të gjykuar*”. Kjo nuk mund të ndodhte dhe mbetet një aspekt i mbyllur. Mosdija dhe mosnjohja e kishin të pëlqyeshëm paragjykimin. Cila rrugë duhej zgjedhur? Përfitimi dhe vuajtja ishin më shumë të karakterit shpirtëror se sa ligjor, pjesë e gjendjes psikologjike të sistemit të gjykuar sipas tij, në raportet e iponuara individ - shoqëri.

Ta shkruajmë historinë siç është, ta deformojmë sipas rastit, në kuadrin e interesave dhe konjunkturave, apo t’i referohemi asaj ashtu si na paraqitet në fakt dhe si arrijmë ta konceptojmë këtë luhajtje “*intelektuale*”? Një pyetje që na imponohet edhe sot me brutalitetin dhe pangopësinë e saj. A ka interes sot të dimë shkurt se, kush kanë qenë përfaqësuesit më të zellshëm të këtij qëndrimi? Si do të mundim t’i etiketonim ata, si adaptivist, realist, irrealist, deformist, kamuflist, egocentrist, tendencialist, ekzistencialist, etj, etj. Pyetje të tilla do t’i shtronte çdo studjues, nisur nga fakti që në periudhën e ndryshimeve të mëdha social - politike dhe ekonomike, krijimi i sistemit të ri të vlerave, jo rrallë ka shfaqur dhe të kundërtën e tij, përballë stadi të rezistencës që

paraqitet sot prej mbeturinave të sistemit të kaluar komunist. Përvoja jonë në vitet e demokracisë njih shembuj të tillë, që na çojnë deri në kufijtë e tronditjeve të mëdha shpirtërore dhe shoqërore.

Retrospektiva në vite, mbi efektet e psikologjisë në shtresëzimet e kushtëzuara sociale, parandryshimeve demokratike dhe efektet e mundëshme të mjedisit social - psikologjik shqiptar janë domethënëse në paraqitjen dhe kuptueshmërinë e tyre. Në analizën e saj, ajo nuk është një vështrim me efekte të thjeshta historike, por vepruese. Kërkesat për ndryshim tërheqin vëmendjen, kjo bazë e herëshme ideologjike dhe psikologjike vazhdon të ndikojë fuqishëm në vitet e ndryshimeve demokratike. Koha pësoi devijime të pafalëshme dhe u projektua mbi baza politike, jo studimore shkencore, duke i dhënë një goditje traditave dhe vlerave më të mira të jetës shqiptare, jashtë ndikimeve ideologjike të së kaluarës. Institucionalizimi i reformimit dhe krijimi i shtratit të duhur drejt të ardhmes, duhet të mbështetet në ligjet e shtetit demokratik dhe perspektivave të zhvillimit evropian të Shqipërisë.

KAPITULLI VII: Përfundime.

1. Problemi gjinor në shoqërinë shqiptare u ndie me intensitet të lartë, në vitet 30-të të shekullit të kaluar. Zhvillimet në Europën e pas simbolizmit të viteve '20-të të shekullit XX-të, nxitën fillimin e lëvizjes feministe në Shqipëri.
2. Ndjeshmëria e shoqërisë ndaj problemit gjinor dhe pabarazisë gjinore, u pasqyrua në mendimin shoqëror shqiptar të kohës, sidomos në mendimin dhe krijimtarinë letrare. Në Shqipërinë e viteve '30-të, po krijoheshin kushtet e një psikologjie të re mbi mundësitë e zhvillimit të vendit mbi bazën e barazisë gjinore. Megjithatë, për shkak të kushteve historike, politike, ekonomike e shoqërore, emancipimi real i grave dhe vajzave, në kontekstin e viteve '30-të, ishte i vështirë, pothuajse i pamundur.
3. Mendimit letrar nxiti analizën shoqërore, e cila filloi të denonconte prapambetjen shoqërore dhe pozitën e diskriminuar të grave dhe vajzave shqiptare. Përfaqësuesit më në zë të saj me përfaqësim edhe të grave shkrimtare, projektuan ngrehinën shoqërore, e cila përfaqësonte përpjekjet për t'u larguar nga përmbajtja e saj orientale.
4. Letrarët dhe intelektualët e kohës përballuan me kurajo rrezikshmërinë sociale brenda një mjedisi shoqëror dhe politik të zhytur në paragjykime dhe errësirë. Arsyetimi logjik i situatës kohore mbi dukuritë e saj në jetën e femrës shqiptare, e trajtuar në mënyrë artistike, i shkoi për shtat gungës patriarkale të jetës shqiptare. Koha kërkonte ndryshimin.
5. Ndryshimi i gjendjes së elitës femërore të shoqërisë shqiptare në këtë periudhë buroi nga mundësia e shkollimit jashtë vendit, e cila i vendosi ato përballë nevojës për ndryshim dhe kundër ndikimit të ashpër të padrejtësive sociale ndaj gjinisë femërore. Paraqitjet e tyre në opinionin shqiptar, çuan në qëndrime të ndërlikuara, të cilat do të ndryshonin një realitet patriakal dhe vetë thelbin e shoqërisë shqiptare.

6. Qasja krahasuese e aktivitetit të feministeve shqiptare kishte një distancë me lëvizjen feministe europiane. Prandaj në vitet '30-të, shoqëria shqiptare ishte ende larg besueshmërisë mbi aftësitë dhe daljen në hapësirën sociale aktive të femrës shqiptare, si një forcë e ndryshimit shoqëror.
7. Ndryshimet politike, ekonomike dhe kulturore në Shqipërinë e pasluftës, ndikuan në rikonfigurimin e problemit gjinor dhe pabarazisë gjinore, e cila ka qenë dhe mbetet ndër problemet e mprehta studimore të shoqërisë shqiptare për shkak të thelbit të saj politico ideologjik dhe dukurive masive të tij.
8. Politikat institucionale të kohës së para dhe pas luftës, në mënyrë tepër të shtrënguar, me tendenca kundërshtuese, përjashtuese për gratë dhe vajzat shqiptare, i shndërruan në tipare themelore elementët frenues, duke i sunduar në kohë dhe në hapësirë të gjithë faktorët qytetërimor e civilizues, që ndikonin në heqjen e këtyre barrierave.
9. Lëvizja për të drejtat e grave dhe vajzave në Shqipërinë e pasçlirimit, ishte një dukuri e importuar dhe e imponuar prej refleksioneve ndërkombëtare ideologjike, politike dhe kulturore. Zbatimi i përvojave sovjetike e kineze, ushtruan ndikim të dëmshëm, duke asfiksuar energjitë pozitive të shtresave sociale dhe duke deformuar jetën shoqërore, politike dhe kulturore në Shqipëri, veçanërisht në procesin e socializimit mbi bazën e traditës historike të marrëdhënieve gjinore.
10. Lufta kundër konservatorizmit dhe fesë si dhe lëvizja për emancipimin e gruas, lëvizja rinore, imituan modele të huazuara të Revolucionit Kulturor Kinez dhe deformuan zhvillimin politik, shoqëror dhe kulturor në Shqipëri.
11. Regjimi komunist në Shqipëri nuk kishte një platformë të mirëfilltë, por orientimin e ideologjizuar mbi trajtimin e barazisë gjinore. Politikat për barazinë gjinore, lufta kundër konservatorizmit dhe fesë si dhe lëvizja për emancipimin e gruas, ishin instrumente në shërbim të forcimit të sundimit partiak.

12. Beteja e rregjimit totalitar për të fituar “*njeriun e ri*” për sistemin ishte shumë e vështirë dhe nuk u arrit kurrë. Realiteti shqiptar, edhe pse i ndodhur nën tryshninë e filozofisë dhe ideologjisë komuniste, përsëri mbeti kokëfort. Mjaft nga elementët social psikologjikë dhe kulturor, që i atribuoheshin thelbit ideologjik “*të njeriut të ri*”, nuk i rezistuan kohës. .

13. Evidencimi i kontradiktave, midis pozitivitetit që sillnin reformat në një vend krejtësisht të varfër dhe të prapambetur nga koha dhe pasojave të tyre në aspektin social, mbetet një kapitull i vështirë, që nuk pranon oportunitet në trajtimin analitik të tij. Kontradikta ishte vet sistemi dhe ai filloi të ekzistonte jashtë realitetit që trashëgoi vendi. Shqipëria, e dalë nga një luftë shkatërrimtare, u përfshi në ideologjinë dhe bllokun e Lindjes, por në kushtet e shpresës për një jetë më të mirë, atëherë askujt si shkonte ndërmend se, ndërrimi i sistemit ishte një e mirë ose e keqe kolektive, që do të reflektonte pasojat e tij të rënda në shtresat e ndryshme të shoqërisë.

14. “*Revolucioni*” në fushën kulturore, ekonomike dhe të emancipimit në përgjithësi të shoqërisë, i shkarkoi pasojat mbi pronën, klerin dhe inteligjencien shqiptare, veçanërisht asaj të arsimuar në perëndim.

15. Kopjimi dhe zbatimi i formave reformuese kineze i solli jetës shqiptare deformimin më të plotë, kundër traditës tonë historike. Ideologjia e Revolucionit Kulturor Kinez, ishte një përjasje midis teorisë së marksizëm - leninizmit dhe konfucianizmit tradicional historik kinez. Koha provoi mbi dëmet e shumta mbi tradicionalizmin kinez, të cilat u bënë objekt i vetkorrigjimit. Frymëzimi fillestar në Shqipëri u tkurr me kalimin e kohës, pasi ngjarjet negative u përsëritën në Shqipëri, në ekstremet e tyre.

16. Gjatë gjithë historisë moderne të vendit, në shoqërinë shqiptare janë konstatuar ndërveprime dhe ndërvarësi të dukshme midis problemit gjinor dhe problemit fetar. Trajektorja e ndikimit të institucioneve, besimeve dhe ideve fetare në shoqërinë shqiptare, ka prodhuar midis të tjerave trajektoren e problemit gjinor, të pabarazisë gjinore dhe qëndrimit të spikatur të shoqërisë ndaj fesë.

17. Besimi musliman në Shqipëri ka përbërë shumicën dhe toleranca e kësaj shumice, u vu në bazën e ruajtjes së harmonisë dhe bashkëjetesës fetare në Shqipëri. Toleranca muslimane u bë shkak i kuptimit dhe mbështetjes së reformave politike partiake kundër besimit fetar në Shqipëri, duke vënë në plan të parë interesin kombëtar. Kjo dukuri reflekton sot dhe përbën një vlerë në hapësira kontinentale për popujt e tjerë.

